

BANKA E SHQIPËRISË
RAPORTI
VJETOR 2009



*Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558
E-mail: public@bankofalbania.org*

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 900 kopje

P Ë R M B A J T J A

FJALA E GUVERNATORIT	11
KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE	15
I.1. Ecuria e aktivitetit ekonomik	15
I.2. Politika monetare dhe tregjet financiare	18
I.3. Ecuria e çmimeve të mallrave kryesore	19
KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE	25
II.1. Stabiliteti i çmimeve dhe objektivi i Bankës së Shqipërisë	25
II.2. Zhvillimet makroekonomike	33
KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE ECURIA E TREGJEVE FINANCIARE	59
III.1. Zhvillimet monetare	59
III.2. Zhvillimet në tregjet financiare	71
KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE	85
IV.1. Instrumentet e politikës monetare	85
KAPITULLI V. MBIKËQYRJA BANKARE	95
V.2. Licencimi	97
V.3. Zhvillimet në sistemin bankar	100
V.4. Inspektimet në vend	105
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	113
VI.1. Zhvillimet në sistemin e pagesave	113
VI.2. Emisioni i monedhës	120
VI.3. Puna kërkimore në Bankën e Shqipërisë	122
VI.4. Aktivitetet statistikore të Bankës së Shqipërisë	124
VI.5. Marrëdhëniet me publikun	130
VI.6. Integrimi dhe bashkëpunimi	135
VI.7. Ndryshime të bëra në legjislacionin bankar gjatë vitit 2009	140
KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2009	149
Raporti i Auditorëve të Pavarur	149
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009	158
SHTOJCA STATISTIKORE	198
1. ÇMIMET, PRODHIMI DHE TREGU I PUNËS	198
1.1. Indeksi i çmimeve të konsumit	198
1.2. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit sipas grupeve kryesore	199
1.3. Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim	200
1.4. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të prodhimit dhe të indeksit	

	<i>të kushtimit në ndërtim</i>	200
1.5	<i>Prodhimi i brendshëm bruto sipas metodës së shpenzimeve</i>	201
1.6	<i>Vlera e shtuar sipas aktivitetit ekonomik</i>	201
1.7	<i>Punësimi, papunësia dhe pagat</i>	202
2.	FINANCAT E QEVERISË	202
2.1	<i>Të ardhurat e buxhetit të qeverisë</i>	202
2.2	<i>Shpenzimet e buxhetit të qeverisë</i>	203
2.3	<i>Financimi i deficitit buxhetor</i>	203
2.4	<i>Shpenzimet sipas klasifikimit funksional (COFOG)</i>	204
2.5.	<i>Borxhi i brendshëm</i>	204
3.	STATISTIKAT MONETARE E BANKARE	205
3.1	<i>Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre</i>	205
3.2	<i>Kundërpartitë e agregatëve monetarë</i>	206
3.3	<i>Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në lekë sipas sektorëve</i>	206
3.4	<i>Depozitat me afat në lekë sipas sektorëve</i>	207
3.5	<i>Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat në valutë sipas sektorëve</i>	207
3.6	<i>Depozitat me afat në valutë sipas sektorëve</i>	207
3.7	<i>Kredia sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës për bizneset</i>	208
3.8	<i>Kredia sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës për individët</i>	208
3.9	<i>Kredia sipas aktivitetit ekonomik</i>	209
3.10	<i>Kredia sipas rretheve</i>	209
3.11	<i>Bilanci sektorial i bankave paradepozituese</i>	210
3.12	<i>Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë</i>	211
4.	TREGJET FINANCIARE	212
4.1	<i>Normat e interesit për kredinë e re sipas monedhave</i>	212
4.2	<i>Normat e interesit për depozitat e reja sipas monedhave</i>	213
4.3	<i>Normat e interesit për bonot e thesarit</i>	214
5.	KURSI I KËMBIMIT	215
5.1	<i>Kursi i këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore</i>	215
6.	NORMAT E INTERESIT TË INSTRUMENTEVE TË POLITIKËS MONETARE	216
6.1	<i>Normat bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë</i>	216
7.	STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM	216
7.1	<i>Bilanci i Pagesave</i>	216
7.2	<i>Eksporti i mallrave sipas partnerëve</i>	217
7.3	<i>Eksporti sipas grupmallrave</i>	217
7.4	<i>Importi cif sipas partnerëve</i>	218
7.5	<i>Importi cif sipas grupmallrave</i>	218
7.6	<i>Pozicioni ndërkombëtar i investimeve</i>	219
7.7	<i>Borxhi i jashtëm</i>	219

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE

Tabelë 1.	Disa tregues kryesorë makroekonomikë.	16
Tabelë 2.	Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.	17
Tabelë 3.	Tregues ekonomikë për vendet e rajonit.	17

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE

Tabelë 1.	Disa tregues të ekonomisë në vite.	33
Tabelë 2.	Ngadalësim i aktivitetit prodhues në degën e industrisë (ndryshime vjetore,%).	38
Tabelë 3.	Tregues të bilancit energjetik.	39
Tabelë 4.	Sasia e konsumit të energjisë elektrike sipas përdoruesve.	39
Tabelë 5.	Tregues të bilancit të pagesave.	46
Tabelë 6.	Zërat kryesorë të të ardhurave, në miliardë lekë dhe ndaj PBB-së 2008-2009 (%).	51
Tabelë 7.	Zërat kryesorë të shpenzimeve në miliardë lekë dhe ndaj PBB-së (%).	52
Tabelë 8.	Deficiti buxhetor dhe instrumentet e përdorura për financimin e tij në miliardë lekë, 2006-2009.	53

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE ECURIA E TREGJEVE FINANCIARE

Tabelë 1.	Shumëzuesi i parasë dhe pesha e parasë jashtë bankave ndaj M3 për disa nga vendet e rajonit.	62
-----------	----------------------------------------------------------------------------------------------	----

KAPITULLI V. MBIKËQYRJA BANKARE

Tabelë 1.	Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2008.	98
Tabelë 2.	Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2009.	98
Tabelë 3.	Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2001 deri në fund të vitit 2009.	100
Tabelë 4.	Rezultati neto në miliardë lekë.	101
Tabelë 5.	Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative).	101
Tabelë 6.	Tregues të përfitueshmërisë të sistemit bankar (në përqindje).	101
Tabelë 7.	Pesha e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.	102
Tabelë 8.	Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.	102
Tabelë 9.	Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2009.	103
Tabelë 10.	Ecuria e raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit për sistemin bankar.	104
Tabelë 11.	Ecuria e treguesit kredi ndaj depozitave në përqindje.	104
Tabelë 12.	Inspektimet e kryera gjatë vitit 2009.	106

KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Tabelë 1.	Ecuria e transaksioneve në AIPS për periudhën 2007-2009.	113
Tabelë 2.	Shpërndarja e transaksioneve në AIPS sipas tremujorëve të vitit 2009.	113
Tabelë 3.	Llojet e transaksioneve në AIPS.	114
Tabelë 4.	Treguesit e përqendrimit për sistemin AIPS.	114
Tabelë 5.	Kredia brenda ditës për pjesëmarrësit në sistemin AIPS.	115
Tabelë 6.	Ecuria e pagesave në AECH për periudhën 2007-2009.	115
Tabelë 7.	Shpërndarja e pagesave në AECH sipas tremujorëve të vitit 2009.	115
Tabelë 8.	Shpërndarja e pagesave në AECH sipas seksioneve të klerimit gjatë vitit 2009.	115
Tabelë 9.	Treguesit e përqendrimit për sistemin AECH.	116
Tabelë 10.	Numri i pajisjeve ATM dhe POS në 31 dhjetor 2009, krahasuar me fundin e vitit 2008.	116
Tabelë 11.	Numri i llogarive bankare të klientëve për kryerje pagesash.	117
Tabelë 12.	Numri i kartave bankare në qarkullim në 31 dhjetor 2009, krahasuar me fundin e vitit 2008.	117
Tabelë 13.	Transaksionet e realizuara me karta bankare gjatë vitit 2009, krahasuar me vitin 2008.	118
Tabelë 14.	Ecuria e transaksioneve "home banking" për periudhën 2007 – 2009.	118
Tabelë 15.	Katalogu i tabelave të publikuara në faqen e Bankës së Shqipërisë.	128

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE

Grafik 1.	Ecuria e normave bazë të interesit.	18
Grafik 2.	Normat e liborit 12-mujor usd dhe euro (majtas) dhe ecuria e kursit euro/dollar (djathtas).	19
Grafik 3.	Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/usd.	20
Grafik 4.	Ecuria e indekseve të çmimeve sipas grupmallrave kryesore.	20

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE

Grafik 1.	Inflacioni vjetor qëndroi pranë objektivit në fund të vitit 2009.	25
Grafik 2.	Luhatjet në inflacion dhe në prodhim në Shqipëri më të ulëtat në rajon.	26
Grafik 3.	Kontributi i kategorisë "Ushqime të papërpunuara" formoi në masën 82% inflacionin vjetor në terma mesatarë për vitin 2009 (në pikë përqindjeje).	27
Grafik 4.	Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje).	28
Grafik 5.	Inflacioni formuar kryesisht nga kontributi në rritje i përbërësës jobazë dhe i asaj të sektorit të tregtueshëm. Intensifikim në përcimin e efektit të nënçmimit të lekut.	29
Grafik 6.	Përcimi i plotë i nënçmimit të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit, kryesisht në tremujorin e katërt të vitit.	30
Grafik 7.	Kostot e prodhimit kanë ardhur në rënie duke mos ushtruar presione inflacioniste.	31
Grafik 8.	Ritme rritjeje të PP-së dhe qëndrueshmëri në treguesin e KPNj.	31
Grafik 9.	Pritjet për inflacionin pas një viti të konsumatorëve, të bizneseve dhe të bankave qëndrojnë brenda intervalit 2 – 4%.	32
Grafik 10.	Ngadalësim i rritjes ekonomike dhe nivelet e ulëta të shfrytëzimit të kapaciteteve.	34
Grafik 11.	Reduktim i kërkesës konsumatore dhe prirje në rritje për kursim.	35
Grafik 12.	Tkurra e aktivitetit investues në sektorin privat.	36
Grafik 13.	Eksportet neto kanë kontribuar negativisht në kërkesën agregate por në masë më të ulët se vitin e kaluar (në milionë euro).	37
Grafik 14.	Kontributet e sektorëve në rritjen vjetore të PBB-së dhe treguesi i tendencës ekonomike (në pp, grafiku majtas) dhe ecuria e TBI-së, TBN-së dhe TBSH-së (në pp, grafiku djathtas).	37
Grafik 15.	Shifra e afarizmit në vëllim sipas degëve të industrisë (grafiku majtas) dhe shifra e afarizmit në vëllim dhe vëllimi i ndërtimit (grafiku djathtas, ndryshime vjetore në përqindje).	39
Grafik 16.	Rritje e çmimeve të shitjes së banesave dhe rënie e lehtë e qirave gjatë vitit 2009.	40
Grafik 17.	Rritja e raportit çmim/qira (majtas) dhe çmimet e prodhimit në ndërtim (balancë) e indeksi i kushtimit në ndërtim (djathtas).	41
Grafik 18.	Kontributet e nëndegëve në rritjen vjetore të prodhimit bujqësor (grafiku majtas, në pp) dhe ecuria e prodhimit agroindustrial (grafiku djathtas, ndryshime vjetore në %).	42
Grafik 19.	Shifra e afarizmit në vëllim (grafiku majtas) dhe vlera e shtuar në prodhimin e brendshëm bruto (grafiku djathtas) sipas aktiviteteve të shërbimeve.	42
Grafik 20.	PBB me çmime bazë dhe numri i të punësuarve (% vjetore, grafiku majtas) dhe ecuria e indeksit të punësimit sipas aktiviteteve ekonomike (% vjetore, djathtas).	43
Grafik 21.	Indeksi i punësimit sipas aktiviteteve ekonomike.	44
Grafik 22.	Paga mesatare në disa prej sektorëve të ekonomisë për periudhën T1:2004-T3:2009.	45
Grafik 23.	Paga mesatare në ekonomi dhe paga mesatare mujore në sektorin shtetëror për periudhën T1:2004-T3:2009.	46
Grafik 24.	Kontribuesit kryesorë në llogarinë korente (flukse neto në milion euro, në % ndaj PBB-së).	47
Grafik 25.	Ngushtimi i lehtë i deficitit tregtar (ndryshim vjetor, %).	47
Grafik 26.	Rënie vjetore në importin e kategorive mallra kapitale, të ndërmjetme dhe pandryshueshmëri në importin e mallrave të konsumit (%).	48
Grafik 27.	Kontribuesit kryesorë në llogarinë financiare (flukse neto në milion euro, % ndaj PBB-së).	49
Grafik 28.	Shuma rrëshqitëse e balancës primare për 12 muaj, 1999M12 – 2009M12.	50
Grafik 29.	Ndryshimet vjetore në zërat kryesorë të të ardhurave, janar '05-dhjetor '09.	51

Grafik 30.	Të ardhurat dhe zërat kryesorë nga tatimet dhe doganat ndaj PBB-së (në %), në boshtin majtas dhe të ardhurat nominale në miliardë lekë në boshtin djathtas, 1999-2009.	51
Grafik 31.	Ndryshimi vjetor i shpenzimeve totale dhe kontributi në rritje i shpenzimeve korente dhe kapitale, janar '05-dhjetor '09.	52
Grafik 32.	Shpenzimet dhe zërat kryesorë ndaj PBB-së (%) në boshtin majtas, dhe shpenzimet nominale në miliardë lekë në boshtin djathtas, 1999-2009.	53
Grafik 33.	Balanca buxhetore dhe instrumentet e financimit të tij në raport ndaj PBB-së në boshtin majtas dhe balanca buxhetore në miliardë lekë në boshtin djathtas, 1999-2009.	53
Grafik 34.	Borxhi i brendshëm, i jashtëm dhe publik ndaj PBB-së (%) në boshtin majtas dhe stoku i borxhit publik në miliardë lekë në boshtin djathtas, 2000-2009.	54

KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE ECURIA E TREGJEVE FINANCIARE

Grafik 1.	Rritja vjetore e M3 dhe kontributi sektorial i kërkesës për mjete monetare në terma të rritjes vjetore të M3 (në %).	59
Grafik 2.	Ritmet mesatare vjetore të agregatëve monetarë; fluksi vjetor i rritjes së mjeteve valutore të sistemit (në miliardë lekë).	60
Grafik 3.	Pesha e depozitave sipas shkallës së likuiditetit dhe sipas sektorëve.	61
Grafik 4.	Ecuria e shumëzuesit të parasë dhe likuiditetit në sistemin bankar.	63
Grafik 5.	Ecuria e multiplikatorit në lekë dhe ndryshimi vjetor i parasë jashtë bankave.	64
Grafik 6.	Raporti i depozitave në lekë ndaj M2 (majtas) dhe kontributi i secilit grup në rritjen vjetore të depozitave në lekë (në %, djathtas).	64
Grafik 7.	Raporti i depozitave në valutë ndaj depozitave total (majtas) dhe kontributi i secilit grup në rritjen vjetore të depozitave në valutë (djathtas).	65
Grafik 8.	Totali i kredisë dhe depozitave të agjentëve ekonomikë në sistemin bankar (në miliardë lekë).	66
Grafik 9.	Aktivitet dhe pasivitet financiar të agreguara të bizneseve dhe individëve në valutë të shprehura në milionë euro.	66
Grafik 10.	Rritja vjetore (majtas) dhe raporti ndaj PBB-së (djathtas) i kredisë për sektorin privat.	67
Grafik 11.	Rritja vjetore (në %, majtas) dhe fluksi tremujor neto (në miliardë lekë, djathtas) i kredisë sipas monedhave.	68
Grafik 12.	Rritja vjetore (në %, majtas) dhe fluksi tremujor neto (miliardë lekë, djathtas) i kredisë për biznese sipas qëllimit.	69
Grafik 13.	Rritja vjetore (në %, majtas) dhe fluksi tremujor neto (në miliardë lekë, djathtas) i kredisë për individë sipas qëllimit.	69
Grafik 14.	Shpërndarja e depozitave dhe kredive sipas rretheve, dhjetor 2009.	70
Grafik 15.	Shpërndarja e depozitave të individëve dhe e popullsisë (majtas) dhe e depozitave të bizneseve (djathtas), sipas valutës.	70
Grafik 16.	Shpërndarja gjeografike e kredisë për biznese dhe numrit të bizneseve (majtas) dhe e kredisë për individë sipas qëllimit (djathtas).	71
Grafik 17.	Normat e interesit në tregun ndërbankar (majtas) dhe volumi ditor në miliardë lekë (djathtas).	73
Grafik 18.	Yield-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar (majtas) dhe pjesëmarrja në ankandet e bonove të thesarit 12-mujore (djathtas).	74
Grafik 19.	Yield-et e obligacioneve në tregun primar (majtas) dhe pjerrësia e normave të interesit (djathtas).	74
Grafik 20.	Ndryshimet vjetore të lekut në terma nominalë efektivë, NEER (majtas) dhe ecuria e indeksit NEER në terma mesatarë vjetorë 2000-2009, (djathtas).	75
Grafik 21.	Ecuria ditore e raportit euro/lekë dhe usd/lekë (majtas) ecuria e raportit euro/lekë e grupuar sipas muajve për periudhën 2007-2009 (djathtas).	76
Grafik 22.	Ecuria ditore e raportit euro/usd dhe usd/lekë.	76
Grafik 23.	Luhatshmëria e kursit të këmbimit të lekut në terma mesatarë vjetorë (majtas) dhe ecuria ditore e raportit euro/monedhë vendase për vendet e rajonit, indeks me bazë 1 tetor 2008 (djathtas).	76
Grafik 24.	Ecuria e interesave 12-mujore të depozitave në lekë dhe në euro (majtas) dhe diferenca midis normave 12-mujore të interesit të depozitave në lekë dhe në euro (djathtas).	77
Grafik 25.	Ecuria e interesit mesatar të ponderuar për kredinë në lekë (majtas) dhe ecuria e interesit mesatar të ponderuar për kredinë në euro (djathtas).	78
Grafik 26.	Marzhet e ndërmjetësimit në lekë dhe në euro (majtas) dhe diferenca midis interesit mesatar të ponderuar të kredisë në lekë dhe asaj në euro (djathtas).	79

KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE		
Grafik 1.	Operacionet e tregut të hapur dhe përdorimi i lehtësive të përhershme.	85
Grafik 2.	Operacioni kryesor i tregut sipas datave të ankandëve (në miliardë lekë).	86
Grafik 3.	Operacionet rregulluese të tregut sipas datave të ankandëve (në miliardë lekë).	86
Grafik 4.	Rezerva e detyruar (në miliardë lekë).	88
Grafik 5.	Normat e remunerimit të rezervës së detyruar.	89
KAPITULLI V. MBIKËQYRJA BANKARE		
Grafik 1.	Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.	102
KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË		
Grafik 1.	Monedha në qarkullim (në 000 lekë).	120
Grafik 2.	Struktura e kartëmondhës.	120
Grafik 3.	Struktura e monedhës metalike.	121
Grafik 4.	Raporti i monedhës metalike kundrejt kartëmondhës.	121



Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani.



Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Në rreshtin e parë, nga e majta në të djathtë:

<i>FATOS IBRAHIMI</i>	<i>Zëvendëskryetar</i>
<i>ARDIAN FULLANI</i>	<i>Kryetar</i>
<i>TEFTA ÇUÇI</i>	<i>Anëtare</i>
<i>KSENOFON KRISAFI</i>	<i>Anëtar</i>

Në rreshtin e dytë, nga e majta në të djathtë:

<i>ADRIAN CIVICI</i>	<i>Anëtar</i>
<i>HALIT XHAFA</i>	<i>Anëtar</i>
<i>ARJAN KADAREJA</i>	<i>Anëtar</i>
<i>LIMOS MALAJ</i>	<i>Anëtar</i>
<i>BENET BECI</i>	<i>Anëtar</i>

FJALA E GUVERNATORIT

I dashur lexues!

Me kënaqësi të veçantë sjell përpara jush Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2009. Në këtë dokument do të gjeni një opinion të plotë të Bankës së Shqipërisë mbi ecurinë e ekonomisë shqiptare dhe të tregjeve financiare. Më tepër se një detyrim ligjor, Banka e Shqipërisë e sheh këtë mundësi si një hap të nevojshëm në rrugën e saj të transparencës dhe të edukimit të publikut. Në këtë kontekst, ky raport është një pasqyrë e detajuar e përmbushjes së objektivave ligjorë të Bankës së Shqipërisë si dhe e punës së institucionit që unë drejtoj.

Aktiviteti ekonomik i vendit dhe zhvillimi i tregjeve financiare shqiptare u zhvillua nën ndikimin e krizës ekonomike e financiare botërore. Duke dashur të përmbledh esencën e konkluzioneve tona në hapësirën e kësaj parathënieje të shkurtër, dëshiroj që në fillim, të theksoj se ekonomia shqiptare shfaqti një shkallë të admirueshme rezistence gjatë vitit 2009. Ndonëse pasojat e krizës botërore u ndjenë herët në aktivitetin ekonomik, ashtu si edhe në shumicën e vendeve të rajonit dhe të atyre në zhvillim, gjendja e shëndoshë fillestare e ekonomisë dhe e sistemit tonë financiar, si dhe reagimi i shpejtë e i vendosur i autoriteteve monetare dhe fiskale, arritën të kufizojnë ndikimin e tyre në ekonominë tonë. Ekonomia shqiptare arriti të sigurojë një rritje pozitive gjatë vitit, duke ruajtur ekuilibrat më esencialë makroekonomikë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar.

Megjithatë, aktiviteti ekonomik në vend shfaqti shenja të qarta të një ngadalësimi progresiv gjatë vitit. Gjashtëmuji i parë u shoqërua me probleme likuiditeti në sistemin bankar, të cilat u reflektuan në ritme të ulëta kreditimi dhe tendenca rritëse të normave të interesit në tregjet financiare. Pozicioni i jashtëm i vendit u karakterizua nga një ngadalësim i eksporteve dhe i hyrjeve të tjera të kapitalit, duke lëkundur raportet e kërkesës dhe ofertës për valutë dhe duke u shoqëruar me tendenca nënçmuese të kursit të këmbimit. Banka e Shqipërisë reagoi duke ulur normën bazë të interesit në muajin janar dhe duke rritur injektimin e likuiditetit, në përgjigje të rritjes së preferencave të agjentëve ekonomikë për të. Së bashku me stimulim të lartë fiskal që shoqëroi këtë periudhë, këto masa arritën të ruajnë një kah pozitiv të rritjes ekonomike. Gjashtëmuji i dytë i vitit shfaqti një tablo cilësisht të ndryshme zhvillimesh. Ngadalësimi i kërkesës së brendshme u konfirmua më tej gjatë kësaj periudhe, në uljen e kërkesës për kredi dhe në ngadalësimin e mëtejshëm të aktivitetit të sektorit privat të ekonomisë. Së bashku me reduktimin e stimullit fiskal në këtë periudhë, ajo u shoqërua me uljen e ritmit të rritjes ekonomike gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, Banka e Shqipërisë vendosi për një ulje tjetër të normës bazë të interesit në muajin tetor, duke e sjellë atë në nivelin 5.25%. Ulja me 1.0 pikë përqindje e normës bazë të interesit si dhe nënçmimi i kursit të këmbimit rezultuan në kushte monetare stimuluese gjatë vitit 2009. Nga ana tjetër, në përgjigje të reduktimit të

importeve, pozicioni i jashtëm i ekonomisë shqiptare shfaq shenja korrektimi, të cilat u reflektuan në një ecuri më të qëndrueshme të kursit të këmbimit gjatë kësaj periudhe.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë është hartuar dhe zbatuar në funksion të përmbushjes së objektivit tonë ligjor: arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve të konsumit. Në këtë kontekst, viti 2009 shënoi një tjetër sukses në kontrollin e inflacionit dhe ankorimin e pritjeve inflacioniste. Norma mesatare e inflacionit gjatë vitit 2009 rezultoi 2.2%, ndërkohë që ai është luhatur gjatë gjithë vitit brenda objektivit tonë. Rritja nën potencial e ekonomisë si dhe çmimet e ulëta në tregjet botërore kanë gjeneruar presione të dobëta inflacioniste, duke balancuar efektet negative të nënçmimit të kursit të këmbimit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i punës tonë gjatë vitit që lamë pas ka qenë ruajtja e stabilitetit financiar, duke vlerësuar se sigurimi i tij është stimuli më i mirë për prosperitetin e vendit në kushtet aktuale. Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë ka bërë një punë të madhe, veçanërisht nëpërmjet rishikimit të bazës rregullative, përshtatjes së vazhdueshme të strukturave tona organizative dhe analitike, inspektimit të kujdesshëm *on-site* dhe *off-site*, si dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të informacionit me institucionet homologe. Ky investim i madh institucional është shpërblyer mbi të gjitha me ruajtjen e besimit të publikut në sistemin tonë bankar, duke mundur në të njëjtën kohë vazhdimin e funksionit të tij të ndërmjetësit financiar.


I dashur lexues,

Duke u përpjekur të evidentoj elementet më thelbësore të punës së Bankës së Shqipërisë, më duhet të theksoj se viti 2009 është karakterizuar nga thellimi i përpjekjeve tona për përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e bazës rregullative të nevojshme për një zhvillim sa më normal dhe të qëndrueshëm të tregjeve financiare. Arritje të dukshme janë shënuar: në drejtim të rishikimit dhe forcimit të rregulloreve të mbikëqyrjes; të plotësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ të zhvillimit të sistemit financiar; në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të pagesave; në drejtim të thellimit të kapaciteteve studimore dhe kërkimore; në drejtim të përmirësimit të statistikave të prodhuara nga Banka e Shqipërisë; në drejtim të përmirësimit sasior dhe cilësor të komunikimit të Bankës së Shqipërisë me autoritetet në vend dhe me publikun e gjerë; si dhe, në drejtim të forcimit të bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë dhe institucionet simotra. Të gjitha këto zhvillime, do t'i gjeni të pasqyruara në faqet e këtij Raporti Vjetor.

Më lejoni në fund ta mbyll këtë parathënie duke falenderuar specialistët e Bankës së Shqipërisë, puna e përkushtuar e të cilëve është në themel të arritjeve tona. Jam i bindur se viti 2010 do të shënojë hapa të mëtejshëm në forcimin e kapaciteteve institucionale të Bankës së Shqipërisë.

Me respekt,

ANDRI LESHAKU





¼ lek. Monedhë nikeli, emetim i vitit 1926.

KAPITULLI I. EKONOMIA BOTËRORE

I.1. ECURIA E AKTIVITETIT EKONOMIK

Viti 2009 u karakterizua nga një tkurrje e aktivitetit ekonomik botëror si rrjedhojë e rënies ekonomike të vendeve të zhvilluara dhe ngadalësimit të ndjeshëm ekonomik të vendeve në zhvillim¹. Kjo ecuri e ekonomisë shënoi vlerën e parë negative në një periudhë prej 20 vitesh. Aktiviteti ekonomik në vendet e zhvilluara ka qenë kryesisht negativ në gjysmën e parë të vitit, ndërsa është përmirësuar në gjashtëmujorin e dytë si pasojë e stimujve makroekonomikë dhe fiskalë të aplikuar nga qeveritë e vendeve të prekura nga kriza financiare. Nga ana tjetër, treguesit e tregtisë në nivel botëror kanë regjistruar vlera rritjeje gjatë këtij viti. Në kushtet e një klime më pozitive ekonomike, tregjet financiare janë karakterizuar nga stabilitet dhe prirje në rënie të normave të interesit.

Presionet inflacioniste kanë qenë të ulta si pasojë e rënies së kërkesës kryesish në vendet e zhvilluara gjatë gjysmës së parë të vitit, kur në disa prej tyre u vërejtën edhe vlera negative të ndryshimit të indeksit të çmimeve të konsumit. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, ka bërë që inflacioni botëror të jetë rreth 2.5% në vitin 2009.

- *EKONOMIA E EUROZONËS DHE E SHBA*

Ekonomia e Eurozonës është tkurrur ndjeshëm gjatë vitit 2009. Sipas vlerësimeve paraprake të Eurostat-it, rritja ekonomike e Eurozonës për vitin 2009 ka qenë -4.0%, ndërsa në vitin 2008 ajo shënonte vlerën 0.8%. Rënia ekonomike ka qenë më e theksuar në dy tremujorët e parë të vitit duke shënuar vlera negative të rritjes. Në tremujorin e tretë dhe të katërt, e shtyrë nga stimujt monetarë dhe fiskalë të ndërmarrë nga qeveritë e këtyre vendeve, ekonomia e Eurozonës ka shënuar vlera rritjeje pozitive në terma tremujorë, duke dalë nga recesioni që kishte filluar në vitin 2008. Gjatë vitit 2009, Banka Qendrore Evropiane ndoqi një politikë monetare lehtësuese nëpërmjet kombinimit të uljes së normave të interesit dhe furnizimit të tregut me likuiditet me qëllim përmirësimin e bilancit të bankave të sistemit dhe rritjen e aftësisë kredituese të tyre. Ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar pozitivisht rritjen ekonomike kanë qenë zgjerimi i eksporteve neto dhe i investimeve publike, ndërsa shpenzimet konsumatore dhe investimet private kanë pësuar rënie të ndjeshme. Indekset e besimit kanë filluar një tendencë rritëse në tremujorin e dytë të vitit 2009. Papunësia në Eurozonë ka vijuar të rritet e ndikuar prej dobësimit të kërkesës së brendshme e të jashtme, si dhe prej rënies së shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese. Në muajin dhjetor të vitit 2009, norma e papunësisë ishte 10%, ndër vlerat më të larta të saj në 10 vitet e fundit.

Norma vjetore e inflacionit në Eurozonë ka shënuar vlerën 0.3% për vitin 2009, e ndikuar nga kërkesa e ulët si edhe nga efektet bazë të çmimeve të

larta në gjysmën e parë të vitit 2008. Norma vjetore e inflacionit ka shënuar vlera negative në periudhën qershor-tetor, për t'u rikthyer më pas në vlera pozitive në dy muajt e fundit të vitit.

Gjatë vitit 2009, aktiviteti ekonomik në ShBA është shfaqur i luhatshtëm dhe me kahe të ndryshme gjatë dy gjysmave të vitit. Pjesa e parë e vitit u karakterizua nga një kontraktim ekonomik me ritme të përshpejtuara, ndërsa gjysma e dytë e tij shënoi rritje të ekonomisë. Megjithatë, PBB-ja për vitin 2009 ishte 2.4% më e ulët krahasuar me vitin 2008. Kontributin kryesor në këtë rënie e dhanë shpenzimet për konsum, investimet agregate dhe eksportet, të cilat u ulën me përkatësisht 0.6, 23.5 dhe 9.9% në terma vjetorë. Në anën tjetër, shpenzimet e qeverisë federale u rritën me 1.9% në terma vjetorë, ndërsa importet, të cilat japin efekt me kah negativ në përlllogaritjen e PBB-së, u zvogëluar me 14.3%. Gjatë vitit 2009, Rezerva Federale ndoqi një politikë monetare lehtësuese jo vetëm nëpërmjet reduktimit të normave të interesit, por dhe nëpërmjet hedhjes së likuiditetit në treg duke ndihmuar bankat e nivelit të dytë në përmirësimin e bilancit të tyre dhe në rritjen e potencialit të kreditimit. Presionet inflacioniste ishin të zbehta gjatë këtij viti si pasojë e çmimeve të ulta të energjisë e të lëndëve të para dhe kërkesës së dobët agregate. Inflacioni mesatar vjetor për vitin 2009 ishte negativ në 0.4%. Në të kundërt, norma e papunësisë rezultoi në rritje, duke shënuar 9.3%, nga 5.8% që ishte një vit më parë.

Tabelë 1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë.

	Ndryshimi i PBB-së			Norma e papunësisë	Norma mesatare e inflacionit		
	2008	2009	2010 ¹		2009	2008	2009
ShBA	1.3	-2.4	1.5	9.3	3.8	-0.4	1.7
Eurozonë	0.8	-4.0	0.7	9.4	3.3	0.3	1.1
Gjermani	1.0	-5.0	1.2	7.5	2.8	0.2	0.8
Mbretëri e Bashkuar	0.6	-5.0	0.9	7.6	3.6	2.2	1.4
Francë	0.4	2.2	1.2	9.4	3.2	0.1	1.1
Japoni	-1.2	-5.9	1.6	5.1	1.4	-1.3	-0.7

Burimi: Eurostat, Institutet statistikore përkatëse.

¹ Parashikime të Komisionit Evropian, EEF vjeshtë 2009.

• EKONOMITË E VENDEVE BRIK²

Gjatë vitit 2009, kryesisht në gjysmën e parë të tij, ekonomitë e vendeve BRIK përjetuan efektet e krizës ekonomike, të cilat kushtëzuan ecurinë ekonomike të vendeve në zhvillim. Këto efekte u pasqyruan në mënyrë të diferencuar në ekonomitë e këtyre vendeve. Në Kinë e në Indi, ritmet rritëse të PBB-së u moderuan ndjeshëm gjatë gjysmës së parë të vitit si pasojë e dobësimit të kërkesës së jashtme dhe rënies së investimeve në ekonomitë vendase. Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik u ndihmuar nga stimuj të ndryshëm fiskalë dhe monetarë të ndërmarrë prej qeverive vendase. Në këtë mënyrë, ekonomitë e Indisë dhe të Kinës u rritën me përkatësisht 7.2 dhe 8.7% krahasuar me vitin 2008. Në të kundërt, ekonomitë e Rusisë e të Brazilit, të ndikuara nga rënia e çmimeve të lëndëve të para dhe të energjisë, shënuan kontraktim të ekonomive të tyre këtë vit. Ky kontraktim ishte më i përqendruar gjatë gjysmës së parë të vitit, ndërsa pjesa e mbetur e tij regjistroi rritje ekonomike

në bazë tremujore. Normat përkatëse mesatare të inflacionit lëvizën në kahun rënës gjatë vitit 2009 në Rusi, në Brazil dhe në Kinë. Gjatë këtij viti, bankat qendrore të Brazilit e Ruisë ndërmorën politika monetare lehtësuese duke e ulur normën bazë të interesit, ndërsa bankat qendrore të Kinës e Indisë, për të penguar spiralet e mundshme inflacioniste, rritën rezervën e detyrueshme për bankat e nivelit të dytë.

Vendet	Ndryshimi vjetor i PBB-së reale			Inflacioni vjetor		
	2008	2009	2010 ¹	2008	2009	2010 ¹
Brazil	5.1	-1.7 ²	3.5	5.6	4.9	4.1
Rusi	5.6	-7.9	1.5	14.1	11.7	9.9
Indi	7.3	7.2	6.4	8.3	8.7	8.4
Kinë	9.0	8.7	9.0	5.9	-0.7	0.6

Burimi: FMN, OECD, Institutet statistikore përkatëse.

¹ Vlerësime të FMN-së, WEO tetor 2009.

² Mesatare për tre tremujorët e parë të vitit 2009.

Tabelë 2. Disa tregues makroekonomikë për vendet BRIK.

• EKONOMITË E RAJONIT

Vendet e rajonit u përballën me efektet e krizës botërore, të cilat ndikuan në kontraktimin e PBB-ve përkatëse gjatë vitit 2009. Treguesit kryesorë më të ndikuar prej këtij korrektimi ishin investimet agregate dhe eksportet. Në të njëjtën kohë, prirja rritëse e normës së papunësisë në rajon ushtroi ndikim të kahut rënës mbi kërkesën vendase dhe normën e inflacionit.

Prodhimi i brendshëm bruto në Itali, u tkurr me përafërsisht 4.8% gjatë vitit 2009. Kërkesa e dobët e brendshme si dhe rënia me ritme të përshpejtuara e investimeve agregate ishin dy prej faktorëve kryesorë që përcaktuan këtë ecuri. Nëse në Itali, ritmet më të përshpejtuara të rënies ekonomike u përqendruan gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, në Greqi ekonomia u përkeqësua gjatë gjysmës së dytë të tij. Në këtë vend, rënia e PBB-së kombinuar edhe me problemet strukturore makroekonomike kontribuan në thellimin e deficitit buxhetor në nivel katër herë më të lartë se kufijtë e përcaktuar në Traktatin e Maastricht-it³. Ekonomia e Turqisë shënoi një rënie prej 5.8% gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin 2008, e cila erdhi si pasojë e rënies së kërkesës së brendshme dhe e rënies së eksporteve. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka përjetuar një tkurrje të aktivitetit ekonomik si pasojë e rënies së shpenzimeve konsumatore dhe të eksporteve.

Si pasojë e rënies ekonomike, norma e papunësisë shënoi ritme rritëse në Greqi, Itali e Turqi gjatë vitit 2009. Ndikuar nga dobësimi i kërkesës vendase, norma mesatare e inflacionit në të gjithë vendet rezultoi më e ulët krahasuar me mesataren e të njëjtit tregues për vitin 2008.

Vendet	Ndryshimi i PBB-së			Inflacioni vjetor			Norma e papunësisë 2009
	2008	2009	2010 ¹	2008	2009	2010 ¹	
Itali	-0.9	-4.8	0.7	3.5	0.8	1.8	7.8
Greqi	3.0	-2.0	-0.3	4.2	1.3	1.4	9.5 ⁴
Maqedoni	5.5	-2.0 ²	1.5	8.3	-0.8	1.1	32.1 ³

Tabelë 3. Tregues ekonomikë për vendet e rajonit.

Serbi	5.5	-2.9	1.5	12.9	7.8	7.2	15.5 ⁵
Kroaci	2.4	-5.8 ²	0.2	5.8	2.2	3.0	14.9
Turqi	0.9	-5.8 ²	2.8	10.5	6.3	5.6	14.1 ⁴
Kosovë	5.4	:	:	9.4	-2.4	:	:
Shqipëri	8.0	5.1 ³	2.2	3.4	2.2	2.0	12.7 ³

Burimi: Institutet statistikore përkatëse, EuroStat, EcoFin, FMN.

¹ Parashikime të FMN, WEO tetor 2009, dhe të Komisionit Evropian, EEF vjeshtë 2009.

² Vlerësime të Komisionit Evropian, vjeshtë 2009.

³ Mesatare aritmetike e tre tremujorëve të parë të vitit 2009.

⁴ Mesatare aritmetike për periudhën janar-nëntor 2009.

⁵ Mesatare aritmetike për periudhën janar-tetor 2009.

: Të dhëna të padisponueshme.


I.2. POLITIKA MONETARE DHE TREGJET FINANCIARE

Gjatë vitit 2009, bankat qendrore kryesore kanë ndjekur politika monetare lehtësuese duke synuar të nxisin aktivitetin kreditues, i cili u zvogëluar ndjeshëm prej krizës financiare të vitit 2008. Banka Qendrore Evropiane ka ndryshuar katër herë në drejtimin lehtësues normën bazë të interesit, duke e çuar atë në 1%, nga 2.50% që ishte në fillim të vitit. Ndryshimi i fundit i kësaj norme ka qenë në muajin maj. Banka e Anglisë ka ulur tre herë me nga 0.5 pikë

përqindjeje normën bazë të interesit duke e çuar atë në 0.5%. Kjo vlerë, e cila është norma më e ulët historike, ka mbetur e pandryshuar prej muajit mars. Rezerva Federale dhe Banka e Japonisë, duke patur një hapësirë të kufizuar për lehtësimin e normave të interesit, nuk i kanë ndryshuar ato gjatë gjithë vitit 2009. Normat bazë të interesit për këto banka janë përkatësisht 0-0.25% dhe 0.1%.


Gjatë këtij viti, tregjet financiare botërore janë karakterizuar nga një ecuri rënëse e normave të interesit dhe nga një normalizim i tensioneve të krijuara nga kriza e zgjatur e vitit të kaluar. Sinjalet pozitive që vijnë nga ekonomitë kryesore kanë evidentuar një përmirësim të shumë treguesve ekonomikë dhe financiarë në tregjet botërore. Në pjesën e dytë të vitit, vendet kryesore të zhvilluara dhe ato në zhvillim kanë regjistruar vlera pozitive rritjeje ekonomike, në një kohë që treguesit e besimit dhe të tregtisë në nivel botëror kanë regjistruar vazhdimisht shenja rritjeje. Gjatë këtyre muajve, tregjet financiare kanë paraqitur ecuri pozitive dhe luhatshmëri të moderuar. Megjithatë, natyra e përkohshme e shumë stimujve të cilët kanë mbështetur këtë ecuri pozitive këshillojnë për një interpretim të kujdesshëm të shumë treguesve. Presionet inflacioniste kanë qenë të përmbajtura në pjesën më të madhe të vitit duke mundësuar ndjekjen e politikave monetare lehtësuese nga ana e bankave qendrore kryesore.

Normat e interesit Libor dhe Euribor në tregun e parasë gjatë këtij viti ranë dukshëm duke përcjellë uljen e normave bazë të BQE-së dhe Fed-it.



Normat e interesit Euribor me afat 1-, 3- dhe 6- mujor u ulën mesatarisht me 2.51, 2.58 dhe 2.37 pikë përqindjeje në harkun e kësaj periudhe krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar, ndërsa norma Libor me afat 3-mujor u zvogëlua me 1.58 pikë përqindjeje. Megjithëse normat e interesit në tregun ndërbankar tregojnë një ecuri rënëse, pasiguria dhe perceptimi i rrezikut nga agjentët e tregut nuk duket se janë larguar dhe primet e rrezikut të kërkuara sugjerojnë sjellje të kujdesshme për maturitetet afatgjata.

Tregu i obligacioneve në Evropë është karakterizuar nga luhatshmëri e lartë, ndërsa në ShBA *yield*-et kanë shfaqur ecuri rritëse gjatë kësaj periudhe. Rritja e *yield*-eve ka qenë më e theksuar në muajin prill, ndërsa periudha e mëvonshme paraqiti prirje më të përmbajtura. Presionet rritëse janë ndikuar kryesisht nga shtimi i emetimeve nga qeveritë në këto vende në një kohë që edhe përmirësimi i situatës ekonomike ka forcuar mendimin për një rritje të mundshme të normave bazë në periudhën afatmesme.




Në tregjet valutore, monedha euro është karakterizuar nga luhatshmëri e lartë dhe forcim kundrejt dollarit amerikan, ndonëse në terma vjetorë ajo qëndron në nivele më të ulëta se viti i kaluar. Ecuria e ekonomisë dhe e treguesve makroekonomikë respektivë kanë kushtëzuar luhatshmërinë dhe vlerësimin e njërës monedhë në favor të tjetrës. Euro, gjithashtu, është vlerësuar në lidhje me paundin britanik ndërkohë që ka lëshuar terren ndaj jenit japonez. Krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2009, euro u nënçmua me 5.17% ndaj dollarit amerikan.

1.3. ECURIA E ÇMIMEVE TË MALLRAVE KRYESORE

Çmimi i naftës në tregun ndërkombëtar u paraqit i luhatshëm gjatë vitit 2009, duke u ndikuar në mënyrë direkte nga ecuria e aktivitetit ekonomik në vendet e industrializuara. Çmimi mesatar i naftës për fuçi shënoi vlerën 61


Grafik 3. Ndryshimi vjetor i çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe i kursit të këmbimit euro/usd.



Burimi: Eurostat, EIA.

usd, duke regjistruar një rënie vjetore ndaj çmimit mesatar të vitit 2008 me përafërsisht 38.7%. Faktorët kryesorë që ndikuan në rënien e çmimit të një fuçje naftë këtë vit ishin dobësimi i kërkesës agregate dhe rënia e aktivitetit në industritë prodhuese në vendet me ekonomi të zhvilluar. Në të kundërt, vlerësimi i dollarit amerikan kundrejt disa prej monedhave kryesore ndërkombëtare gjatë vitit 2009, si dhe masat e kontrollit të prodhimit prej vendeve të OPEK-ut dhanë ndikim në kahun rritës të çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar. Kërkesa për naftë në botë rezultoi 1.6% më e ulët krahasuar me vitin 2008. Në të njëjtën kohë, ritme rënëse shënoi edhe oferta për naftë, e cila gjatë vitit 2009 u zvogëlua me përafërsisht 3.7% krahasuar me ofertën totale të vitit 2008.

Grafik 4. Ecuria e indekseve të çmimeve sipas grupmallrave kryesore.



Burimi: FMN.

Në terma mesatarë, *indekset kryesore të çmimeve* në vitin 2009 kanë shfaqur vlera më të ulëta se ato të vitit 2008 të ndikuara kryesisht nga çmimet e larta që u regjistruan në pjesën e parë të vitit 2008. Nëse analizojmë ecurinë e çmimeve përgjatë vitit 2009 vihet re një tendencë rritëse e ushqyer nga përmirësimi gradual i kushteve ekonomike botërore si dhe nga rritja e kërkesës për këto mallra. Rritjen më të shpejtë përgjatë vitit 2009 e ka treguar Indeksi i Çmimit të Karburantit, me 44.7%, ndërsa Indeksi i Çmimit të Mallrave dhe Indeksi i Çmimit të Ushqimeve janë rritur me 36.2 dhe 9.1% përkatësisht. Pavarësisht këtij zhvillimi, në raport me një vit më parë, Indeksi i Çmimit të Mallrave ka shënuar një vlerë mesatarisht 31% më të ulët, Indeksi i Çmimit të Karburantit ka pësuar një rënie prej 36.9%, ndërsa Indeksi i Çmimit të Ushqimeve është zvogëluar me 14.7%.

SHËNIME

¹ Sipas të dhënave të FMN, rritja ekonomike botërore për vitin 2009 ishte -0.8%; -3.2% për vendet me ekonomi të zhvilluar dhe 2.1% për vendet në zhvillim.

² Vendet BRIK janë Brazili, Rusia, India e Kina.

³ Deficiti buxhetor u vlerësua në 12.7% ndaj PBB-së, ndërsa borxhi publik u vlerësua në rreth 113% ndaj PBB-së për vitin 2009. Për vitin 2008, deficiti buxhetor dhe borxhi publik ishin përkatësisht 7.7 dhe 99.2% ndaj PBB-së. Traktati i Maastricht-it përcakton kufijtë maksimalë për deficitin buxhetor në 3% ndaj PBB-së dhe për borxhin publik në 60% ndaj PBB-së.



1 lek. Monedhë nikeli, emetim
i vitit 1930.

KAPITULLI II. EKONOMIA SHQIPTARE

II.1. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE OBJEKTIVI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Stabiliteti i çmimeve është kontributi më i madh që banka qendrore mund të japë për të garantuar një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë, nëpërmjet nxitjes së investimeve afatgjata, rritjes së eficiencës së shpërndarjes të fondeve në ekonomi dhe mbështetjes së stabilitetit financiar. Në përputhje me strategjinë e saj, Banka e Shqipërisë angazhohet në arritjen dhe ruajtjen e inflacionit vjetor në nivelin 3.0% me kufij tolerance +/- 1 pikë përqindjeje. Shpallja e objektivit sasior për inflacionin synon ankorimin e pritjeve të agjentëve ekonomikë dhe uljen e primeve të rrezikut të inflacionit.


II.1.1. ECURIA E ÇMIMEVE TË KONSUMIT, PËRMBUSHJA E OBJEKTIVIT DHE POLITIKA MONETARE

Zhvillimet makroekonomike në vend gjatë vitit 2009 u formuan në kontekstin e krizës globale. Megjithatë ekonomia botërore shfaqti shenja ripërtëritjeje në gjysmën e dytë të vitit, aktiviteti ekonomik mbetet shumë poshtë niveleve të tij të para-krizës. Në këtë skenar ndërkombëtar, rritja ekonomike në vend u ngadalësua si pasojë e ngadalësimit të kërkesës së brendshme dhe të jashtme, në prani të shtërngimit të kushteve të likuiditetit dhe reduktimit të flukseve hyrëse valutore. Këto zhvillime u shoqëruan nga presione të reduktuara inflacioniste.

Inflacioni vjetor gjatë vitit 2009¹ mori vlera brenda kufirit të tolerancës +/-1.0 pikë përqindjeje të objektivit 3.0% të Bankës së Shqipërisë për stabilitetin e çmimeve. Tendenca reduktuese e presioneve inflacioniste e vërejtur që në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008 u ndërpre në tremujorin e parë të këtij viti – inflacioni vjetor shënoi nivelin më të ulët 1.8% në këtë periudhë, për t'u stabilizuar pranë kufirit të poshtëm 2.0% në dy tremujorët pasues. Në tremujorin e katërt, inflacioni vjetor shfaqti prirje rritëse, duke shënuar 2.9% në terma mesatarë dhe duke konverguar drejt objektivit për inflacionin. Norma më e lartë e inflacionit 3.5% u regjistrua në muajin dhjetor.

Niveli i ulët i inflacionit vjetor dhe i atij bazë – respektivisht 2.2 dhe 1.3% në terma mesatarë për vitin 2009 – reflektoi efektin bazë nga krahasimi me

Grafik 1. Inflacioni vjetor* qëndroi pranë objektivit në fund të vitit 2009.



* sipas tremujorëve (në përqindje)


Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

nivelin e lartë të çmimeve të një viti më parë² dhe reduktimin në bazë të gjerë të presioneve të brendshme inflacioniste në kontekstin e ngadalësimit ekonomik dhe të mungesës së rritjeve në çmimet e administruara. Nga ana tjetër, përçimi i nënçmimit të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit³ dhe ndikim të konsiderueshëm dhe arriti të balancojë presionet rënës nga zgjerimi i hendekut negativ të prodhimit⁴.

Aktiviteti ekonomik u ngadalësua në mënyrë progresive gjatë vitit 2009. Sipas të dhënave paraprake të INSTAT, rritja ekonomike për nëntëmujorin e parë të këtij viti ishte 4.9%, rreth 2.9 pikë përqindjeje më e ulët se rritja mesatare e vitit 2008. Rritja vjetore e prodhimit të brendshëm bruto u tkurr nga 5.4% në tremujorin e parë në 4.1% në tremujorin e tretë. Ndër komponentët e kërkesës agregate⁵, investimet private kanë reflektuar goditjen kryesore të krizës botërore financiare dhe ekonomike, ndërsa kërkesa konsumatore u reduktua në tremujorin e tretë. Disponibiliteti i ulët i burimeve vendase dhe të huaja për financimin e shpenzimeve konsumatore dhe të projekteve për investime nga bizneset, si dhe pasiguria e lartë për të ardhmen kanë kontribuar në tkurrjen e investimeve private dhe në prirjen në rritje të konsumatorëve për të kursyer. Eksportet neto u tkurrën me 7.6% në terma mesatarë për vitin 2009.

Gjatë vitit 2009, politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë synoi krijimin e kushteve të përshtatshme për një zhvillim të ekuilibruar të ekonomisë në një situatë pasigurie të lartë. Banka e Shqipërisë mori vendim për uljen e normës bazë të interesit në dy raste, në muajt janar dhe tetor 2009, duke e zbritur atë në nivelin 5.25% nga 6.25% që ishte në fund të vitit 2008. Kushtet lehtësuese monetare u plotësuan dhe nga nënçmimi i kursit të këmbimit dhe injektimi i likuiditetit nga Banka e Shqipërisë. Ndjekja e një politike monetare lehtësuese u motivua nga presionet e kontrolluara inflacioniste, nga sinjalet e qarta për ngadalësim të kërkesës agregate dhe nga shkalla e ulët e shfrytëzimit të kapaciteteve në ekonomi. Ndërkohë, parashikimet për inflacionin dhe pritjet e agjentëve për të, kanë mbetur të ankoruara pranë objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 2. Luhatjet në inflacion dhe në prodhim⁶ në Shqipëri më të ulëtat në rajon.



Burimi: FMN Outlook Database, Tetor 2009.

Krahas kushteve të lehtësuara monetare, stimuli fiskal ka mbështetur normat pozitive të rritjes ekonomike gjatë këtij viti. Si rezultat i bashkërendimit të mirë të politikave makroekonomike, luhatjet e inflacionit dhe të prodhimit në Shqipëri janë në nivelet më të ulëta në rajon për periudhën 2000-2009. Politika monetare ka qenë e suksesshme në përmbushjen e objektivit të saj kryesor (inflacioni vjetor mesatar për periudhën në fjalë është 2.7%) duke ndihmuar në krijimin e një ambienti ekonomik të favorshëm për sektorin privat, për marrjen e vendimeve për konsum dhe investime, të cilat do të mund të mbështesin një rritje të qëndrueshme ekonomike.


II.1.2. ECURIA E ÇMIMEVE TË KATEGORIVE KRYESORE TË SHPORTËS SË MALLRAVE TË KONSUMIT

Inflacioni vjetor, megjithëse qëndroi në nivele të ulëta në krahasim me një vit më parë, shfaqti prirje rritëse nga një tremujor në tjetrin gjatë vitit 2009. Rritja e inflacionit në fund të vitit u shkaktua kryesisht nga përcimi më i plotë i nënçmimit të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit në prani të prirjes rritëse të çmimeve të lëndëve të para në tregjet botërore. Në krahasim me një vit më parë, inflacioni qëndron 1.2 pikë përqindjeje më poshtë, i shkaktuar kryesisht nga efekti bazë dhe presionet në rënie nga zgjerimi i hendekut të prodhimit.

Analiza e komponentëve përbërës evidenton ndikimin kryesor që ka dhënë kategoria “Ushqime të papërpunuara” në nivelin e përgjithshëm të inflacionit. Inflacioni i kësaj kategorie, në disa raste ka shënuar norma rritjeje të larta, duke formuar në masën 82% inflacionin total në terma mesatarë. Ndërkohë, në kategoritë e tjera të shportës së inflacionit ka ndikuar më pak në formimin e kësaj norme.

Inflacioni vjetor i kategorisë “Ushqime të papërpunuara” ka shënuar një normë mesatare rritjeje prej 9.9% gjatë vitit 2009. Çmimet e këtyre produkteve janë rritur në mënyrë progresive gjatë vitit. Në muajin dhjetor, inflacioni vjetor i kësaj kategorie arriti vlerën më të lartë, 15.1%, duke kontribuar me 2.8 pikë përqindjeje në inflacionin total prej 3.5% të këtij muaji. Artikujt e kësaj kategorie ndikohen kryesisht nga çmimet e frutave dhe të perimeve, të cilat janë shumë të luhatshme dhe me natyrë sezonale. Pamundësia e prodhimit vendas për të plotësuar kërkesën për këto mallra pothuajse gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit 2009, si dhe shtrenjtimi i importit të tyre në kushtet kur çmimet e këtyre artikujve u vendosën nën trysninë e sjelljes së kursit të këmbimit - dobësimit të lekut kundrejt dy monedhave kryesore të tregut - është përkthyer në çmime më të larta për to. Gjithashtu, sjellja sezonale e çmimeve të ushqimeve të papërpunuara gjatë muajit dhjetor e zhvendos kurbën e inflacionit me disa pikë përqindjeje në kahun rritës.


Grafik 3. Kontributi i kategorisë “Ushqime të papërpunuara” formoi në masën 82% inflacionin vjetor në terma mesatarë për vitin 2009 (në pikë përqindjeje).



Kategoria “Ushqime të përpunuara” regjistroi një rënie të çmimeve gjatë vitit 2009, duke shfaqur një ecuri krejtësisht të ndryshme krahasuar me një vit më parë. Inflacioni i saj mesatar gjatë vitit 2009 ishte 1.1%, ndërkohë që një vit më parë ishte 10.3%. Kontributi i kësaj kategorie në normën mesatare totale të inflacionit ishte 0.3 pikë përqindjeje (në krahasim me 2.3 pikë përqindje gjatë vitit 2008). Normat e ulëta të inflacionit të kësaj kategorie kanë ardhur kryesisht si rezultat i efektit bazë nga krahasimi me nivelet e larta të vitit 2008. Nga ana tjetër, rënia vjetore e çmimeve bazë të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare ka mundur të balancojë efektin e nënçmimit të kursit të këmbimit. Ndryshimi i kahut të ecurisë së këtyre çmimeve jashtë (gjatë gjatshëmujorit të dytë 2009 është vënë re një pririje e lehtë rritëse në terma mujorë) do të shtonte kontributin e kësaj kategorie në inflacionin total në prani të tendencës nënçmuese të lekut.

Çmimet e kategorisë “Mallra me çmime të administruara” shfaqën një sjellje jo të zakonshme gjatë vitit 2009. Për herë të parë në harkun kohor të dhjetë viteve të fundit, inflacioni vjetor i kësaj kategorie ishte negativ (mesatarisht -2.2%) deri në muajin shtator. Deflacioni i mallrave me çmime të administruara ishte rezultat i mosrritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe i rënies së tarifave të telefonisë celulare gjatë vitit 2009. Në tre muajt e fundit të vitit, inflacioni vjetor i kësaj kategorie shënoi një rritje të lehtë prej 0.5%, duke dhënë një kontribut pozitiv prej 0.1 pikë përqindjeje, kundrejt kontributit negativ (mesatarisht -0.4 pikë përqindje) që jepte kjo kategori te norma e përgjithshme e inflacionit.

Grafik 4. Inflacioni vjetor sipas kategorive të mallrave dhe shërbimeve (në përqindje).



Ndër kategoritë e tjera, kontributi i kategorisë “Shërbime”, ashtu si dhe ai i kategorive “Strehim” dhe “Mallra konsumi afatgjatë”, është luhatur brenda intervalit 0.1 – 0.2 pikë përqindjeje në normën vjetore të inflacionit, duke regjistruar disa nga normat më të ulëta historike të rritjes së inflacionit.


Çmimet e mallrave të konsumit joushqimorë vazhduan të kontribuojnë negativisht në inflacionin total (-0.1 pikë përqindje). Megjithatë, rënia e

inflacionit e vërejtur në nënkategorinë “Operacione ndaj mjeteve personale”, nënkategori ku bën pjesë dhe çmimi i naftës, nuk ka qenë aq e theksuar në pjesën e fundit të vitit sa në periudhën njëvjeçare prej nëntorit të vitit 2008. Për më shumë, për herë të parë në muajin dhjetor çmimet e karburanteve pësuan rritje me 4.4% në nivel vjetor, nga 11.5% që kishin rënë mesatarisht gjatë periudhës dhjetor 2008- tetor 2009.

• PRIRJET KRYESORE TË INFLACIONIT

Kontributet e inflacionit bazë dhe atij jobazë në inflacionin total vjetor gjatë vitit 2009, paraqiten me profil të ndryshëm krahasuar me atë të dy viteve të kaluara. Procesi inflacionformues gjatë vitit referues i dedikohet më së shumti luhatjeve afatshkurta të çmimeve të konsumit, të materializuara kryesisht tek inflacioni jobazë. Kontributi mesatar i tij rezultoi rreth 1.3 pikë përqindjeje duke formuar rreth 60% të shifrës së inflacionit mesatar vjetor. Vlerat e larta dhe në rritje të inflacionit jobazë gjatë muajve të fundit të vitit 2009, dëshmuuan për praninë e presioneve inflacioniste të shkaktuara më së shumti nga faktorë të ofertës, më pak të varur nga ndikimi i politikës monetare.

Kontributi i inflacionit bazë apo përbërëses afatgjatë të inflacionit, rezultoi pranë nivelit 0.9 pikë përqindjeje, me vlera të ulëta dhe në rënie deri në fund të vitit, duke konfirmuar praninë e presioneve modeste inflacioniste nga krahu i kërkesës së brendshme në ekonominë e vendit. Viti 2009 filloi me një inflacion bazë⁷ vjetor 1.8% për ‘u mbyllur me nivelin 1.2%. Në terma mesatarë, ky tregues shënoi një vlerë rreth 1.3%⁸ apo 1.5 pikë përqindjeje më poshtë sesa ajo e vitit paraardhës.



Inflacionet mesatare vjetore për sektorët e mallrave të tregtueshëm dhe të patregtueshëm të shportës së IÇK-së, për vitin 2009, rezultuan përkatësisht 2.7 dhe 1.6%. Kontributet e dy inflacioneve në atë total rezultuan në vlera relativisht të krahasueshme me njëra-tjetrën deri në fund të tremujorit të parë të vitit. Periudha në vijim u karakterizua nga vlera në rritje të inflacionit të

mallrave të tregtueshme duke arritur nivele maksimale historike në fund të vitit (5%). Nga ana tjetër, deri në mesin e vitit 2009, inflacioni i sektorit të mallrave të patregtueshme, reflektoi shuarjen e efektit të rritjes së çmimeve të energjisë elektrike dhe të shërbimit të transportit publik. Lulatjet e moderuara të çmimeve në këtë sektor, përcaktuan vlera të ulëta historike të inflacionit përkatës, i cili në pjesën e dytë të vitit rezultoi rreth nivelit 1%. Ecuria e inflacionit të mallrave të patregtueshme balançoi disi presionet inflacioniste të gjeneruara nga tendenca rritëse e çmimeve në sektorin e mallrave të tregtueshme e dhe të atij të shërbimeve të shportës së IÇK-së. Për vitin referues, kontributi i inflacionit të këtij sektori në inflacionin total rezultoi rreth 73%, ndërkohë që në periudhën 2007-2008 ai ishte rreth 50%. Sjellja gjithëvjetore nënçmuese e monedhës vendase kundrejt euros dhe dollarit amerikan, është përçuar në rritjen e çmimeve të mallrave të importuara. Ky efekt ka rezultuar më i plotë në tremujorin e katërt të vitit 2009.

Vlerat e ulëta të inflacionit bazë dhe atij të sektorit të patregtueshëm dëshmojnë për presione modeste inflacioniste nga kahu i kërkesës së brendshme gjatë vitit 2009.


- **INFLACIONI I IMPORTUAR**

Niveli i ulët i çmimeve të importit⁹ gjatë vitit 2009, ka reflektuar konjunkturën e favorshme të çmimeve të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar, tkurrjen ekonomike globale dhe efektin statistikor të krahasimit me një nivel shumë të lartë çmimesh regjistruar një vit më parë. Çmimet e konsumit në Itali dhe Greqi u rritën përkatësisht me 0.8 dhe 1.2% në terma mesatarë vjetorë. Inflacionet e regjistruara në këto vende janë rreth 3 herë më të ulëta sesa mesataret e tyre historike.

Pavarësisht niveleve të ulëta të çmimeve të huaja, inflacioni i importuar¹⁰ ka ardhur në rritje si pasojë e nënçmimit të lekut gjatë këtij viti. Inflacioni

i importuar shënoi një normë mesatare rritjeje prej 6.9%, ndërkohë që mesatarja e tij historike (1999-2008) është 2.4%. Gjatë vitit 2009, leku u nënçmua mesatarisht me 7.6 dhe 13.2% ndaj euros dhe dollarit amerikan. Përçimi i nënçmimit të kursit të këmbimit tek çmimet e konsumit ka qenë i dobët gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Bazuar në studime empirike¹¹, përçimi i kursit të këmbimit në çmimet e konsumit është thajse i plotë pas tre tremujorëve. Kjo sjellje nuk u vërtetua gjatë vitit 2009. Ngadalësimi i kërkesës së brendshme nuk mundësoi përcjelljen e plotë të nënçmimit të kursit të këmbimit. Përkeqësimi i situatës financiare të bizneseve që operojnë në sektorin e shërbimeve, ku bëjnë pjesë dhe aktivitetet importuese, mund të tregojë se ky nënçmim është absorbuar nga ulja e marzhit të fitimit të tyre.


Grafik 6. Përçimi i plotë i nënçmimit të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit, kryesisht në tremujorin e katërt të vitit.



• ÇMIMET E PRODHIMIT, PRODUKTIVITETI DHE KOSTOT E PUNËS

Kostot e prodhimit me të cilat janë përballur industritë prodhuese vendase, matur prej Indeksit të Çmimeve të Prodhimit, kanë shënuar rënie gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2009. Indeksi i çmimeve të prodhimit ka regjistruar një rënie vjetore 1.9% në terma mesatarë gjatë kësaj periudhe. Deflacioni i këtyre çmimeve është shkaktuar kryesisht nga rënia e konsiderueshme e çmimit të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare dhe rritja e moderuar e pagave. Megjithatë, në tremujorin e tretë të vitit, vërehet një frenim i ritmeve të rënies në këto çmime si pasojë e prirjes nënçmuese të kursit të këmbimit dhe e rritjes së lehtë në terma mujorë të çmimeve të lëndëve të para jashtë.

Grafik 7. Kostot e prodhimit kanë ardhur në rënie duke mos ushtruar presione inflacioniste.




Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Indeksi i çmimeve të grupit industrial të "Industrië së përpunuese", i cili zë peshën kryesore në shportën e IÇP-së, shënoi një rënie mesatare prej rreth 0.2% në bazë vjetore gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2009. Kontributin kryesor në këtë rënie e dha zvogëlimi i kostove në nëngrupin "Industria ushqimore". Rënia e çmimeve të prodhimit të këtij nëngrupi ishte mesatarisht 4.2%, duke lehtësuar presionet mbi çmimet e këtyre produkteve në shportën e mallrave të konsumit. Indekset e çmimeve të prodhimit të grupeve "Industria nxjerrëse" dhe "Industria e prodhimit dhe e shpërndarjes së energjisë elektrike, të gazit dhe të ujit" u rritën përkatësisht me 2.4 dhe 0.7% kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Ngadalësimi i ritmit të rritjes së pagave në terma nominalë dhe realë gjatë vitit 2009 sinjalizon për presione më të dobëta inflacioniste nga ana e kostove të punës. Produktiviteti real i punës (PP) dhe kostoja reale e punës për njësi të prodhuar (KPNj) në ekonomi¹², kanë shfaqur prirje më të qarta pas vitit 2006.

Grafik 8. Ritme rritjeje të PP-së dhe qëndrueshmëri në treguesin e KPNj.




Burimi: INSTAT (SASH dhe PBB-ja tremujore) dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Ritmet mesatare të rritjes vjetore të PP-së për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 vlerësohen në masën 4.6% duke zbutur tendencat rritëse që sjell rritja e pagave reale tek kostoja e punës për njësi të prodhuar. Kjo e fundit vlerësohet të ketë rënë për të njëjtën periudhë krahasuese (-0.7%), duke reflektuar më së shumti shuarjen e efektit të masave me natyrë administrative të ndërmarra gjatë pjesës së parë të vitit 2008, me qëllim rritjen e formalitetit në ekonominë e vendit.

Zhvillimet e mësipërme vlerësohet të mos kenë nxitur rritjen e presioneve inflacioniste nga krahu i kostove të punës në ekonominë e vendit.

• PRITJET PËR INFLACIONIN

Një nga qëllimet e politikës monetare është kontrolli dhe ankorimi i pritjeve të inflacionit në funksion të përmbushjes së objektivit të stabilitetit të çmimeve. Pritjet e aktorëve të ndryshëm të tregut për inflacionin ndikojnë sjelljen e tyre në të ardhmen duke gjeneruar pasoja ekonomike. Pritjet e inflacionit në periudhën afatshkurtër janë, gjithashtu, një tregues i mirë i besueshmërisë së politikës monetare në vend. Nisur nga rëndësia e tyre, matja e pritjeve për inflacionin nga grupime të ndryshme ekonomike zhvillohet periodikisht nga Banka e Shqipërisë, me anë të vrojtimeve të besimit të bizneseve, vrojtimet të besimit të konsumatorëve si dhe vrojtimet të ekspertëve të bankave.



Zbatimi i suksesshëm i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë është mbështetur në ankorimin e pritjeve të publikut për inflacionin, falë një historie të gjatë me inflacion të ulët¹³ dhe ndjekjes së një politike monetare transparente dhe të pavarur. Pritjet e inflacionit gjatë vitit 2009 janë karakterizuar nga vlera të ulëta pozitive, brenda intervalit 2-4%.

Inflacioni i pritur nga konsumatorët shënoi vlera të ulëta gjatë vitit 2009. Kjo është një sjellje e vërejtur që nga fillimi i matjes së pritjeve për inflacionin. Pritjet e konsumatorëve për inflacionin pas 12 muajsh, pasi arritën vlerën më të ulët për vitin në tremujorin e dytë (vlera +1.7%), gjatë dy vrojtimeve të fundit të vitit 2009 janë rritur përkatësisht në vlerat +2 dhe +2.2%. Ndërkohë, pritjet e bizneseve për inflacionin pas një viti kanë qëndruar pothuaj të pandryshuara, përreth vlerës +2.5%.

Inflacioni i pritur nga ekspertët e bankave gjatë vitit 2009 ka vijuar të shënojë vlera më të larta se inflacioni i pritur nga grupet e tjera. Këto vlera janë më të ulëta krahasuar me ato të shënuara gjatë dy viteve të mëparshme. Nga agregimi i probabilitetit me të cilat bankat vlerësojnë norma të ndryshme të inflacionit të pritur, gjatë vitit 2009, rezulton se rreziku që inflacioni do të kalojë kufijtë e intervalit objektiv është ulur në krahasim me vitin e kaluar.

II.2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Kriza që përfshiu ekonominë botërore është reflektuar në vendin tonë në terma të uljes së normave të rritjes ekonomike gjatë vitit 2009. Të dhënat për kërkesën agregate në vend sugjerojnë se ngadalësimi i konsumit privat, së bashku me rënien e investimeve, kanë qenë kontribuesit kryesorë në ngadalësimin e normave të rritjes së kërkesës në vend.

Tabelë 1. Disa tregues të ekonomisë në vite.

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Rritja reale e PBB-së (në %) ¹⁴	4.2	5.8	5.7	5.7	5.4	6.0	7.8*	4.9*
PBB (me çmime korente, në milionë lekë) ¹⁵	622,711	694,098	750,785	814,797	882,209	966,651	1,087,867 *	1,143,373*
PBB (me çmime korente, në milionë usd) ¹⁶	4,444.8	5,694.0	7,303.4	8,156.1	8,993.0	10,693.0	12,966.2*	12,035.5*
PBB (në usd për frymë)	1,437	1,831	2,336	2,597	2,854	3,394	4,073*	3,765*
Numri i të punësuarve (në mijë) ¹⁷	920	926	931	932	935	966	974	972*
Përqindja e papunësisë	15.8	15.0	14.4	14.2	13.9	13.5	13.2	12.8*
Përqindja e inflacionit (fund v/v)	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5	3.1	2.2	3.5
Deficiti i buxhetit (me grantet, në % të PBB-së)	-6.1	-4.9	-5.1	-3.5	-3.3	-3.5	-5.5	-7.0
Borxhi publik (në % të PBB-së) ¹⁸	62.9	58.9	56.5	57.4	56.1	53.5	54.8	59.5
Borxhi i jashtëm (në % të PBB-së) ¹⁹	21.0	18.4	17.2	17.3	16.5	15.2	17.9	23.1
Llogaria korente (pa transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-10.3	-9.0	-6.8	-10.0	-7.3	-11.4	-15.8	-15.6
Kursi mesatar i këmbimit, usd/lek	140.1	121.9	102.8	99.9	98.1	90.4	83.9	95.0
Kursi mesatar i këmbimit, euro/lek	132.4	137.5	127.6	124.2	123.1	123.6	122.8	132.1

*Vlerësime paraprake.

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, vlerësime të FMN-së dhe Banka e Shqipërisë.

Stimuli fiskal, krahas kushteve të lehtësuara monetare, mbështeti ekonominë në gjenerimin e normave pozitive të rritjes, megjithëse me ritme më të ulëta se vitet e kaluara. Ngadalësimi i kërkesës dhe i aktivitetit ekonomik sollën rritjen e lehtë të papunësisë. Veprimi i faktorëve të kërkesës dhe ofertës ka rezultuar në zgjerimin e hendekut negativ të prodhimit, duke ushtruar presione në rënie mbi inflacionin.


II.2.1. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Prodhimi i Brendshëm Bruto²⁰ rezultoi me një rritje vjetore 4.9% gjatë nëntëmuajorit të parë vitit 2009, duke u ngadalësuar nga 5.4% në tremujorin e parë në 4.1% në tremujorin e tretë. Një vit më parë rritja ekonomike ishte 7.8%. Paralelisht me rënien në kërkesën e jashtme, ecuria e prodhimit është ndikuar nga tkurrja e investimeve private dhe kontraktimi i kërkesës konsumatore.

Të dhënat e deritanishme sinjalizojnë ngadalësimin e mëtejshëm të kredidhënies për sektorin privat, uljen e ritmit të të ardhurave nga tatimet mbi aktivitetin ekonomik, dhe rënien e besimit në të gjithë sektorët e ekonomisë

gjatë tremujorit të katërt²¹. Mbështetur në këta tregues dhe në informacione të tjera cilësore, Banka e Shqipërisë gjykon se rritja e prodhimit të brendshëm bruto në tremujorin e katërt është në vlera minimale. Duke faktorizuar normat e rritjes në tre tremujorët e kaluar si dhe informacionin e disponueshëm për tremujorin e katërt, Banka e Shqipërisë vlerëson se rritja reale e ekonomisë për vitin 2009 rezulton rreth nivelit 3%.

Grafik 10. Ngadalësim i rritjes ekonomike dhe nivelet e ulëta të shfrytëzimit të kapaciteteve.



Burimi: INSTAT (PBB) dhe llogaritje e Bankës së Shqipërisë (IBB).

• KOMPONENTËT E KËRKESËS AGREGATE


Informacioni për kërkesën agregate në vend sugjeron ngadalësim të saj gjatë vitit 2009. Vlerësimi i masës së ngadalësimit është ende i pasigurt në kushtet e mungesës së të dhënave të sakta për kërkesën agregate dhe të të dhënave për tremujorin e katërt. Ndërkohë, eksportet neto (kërkesa e jashtme) janë ngushtuar me 7.6% gjatë vitit 2009 duke ulur kështu kontributin negativ në kërkesën agregate.

Konsumi privat është komponenti kryesor i kërkesës agregate. Përsa që konsumi final i popullatës zë në prodhimin e brendshëm bruto për periudhën 1996-2007 është rreth 80%. Konsumi privat, gjykuar nga të dhënat e tërthorta, rezulton i ngadalësuar gjatë vitit 2009, në kontrast me normat e larta historike të rritjes së tij.

Konsumi privat ka vazhduar të mbështetet nga të ardhurat e disponueshme, si burimi kryesor i financimit të tij. Duke qenë se taksat mbi të ardhurat nuk kanë ndryshuar, pagat kanë vazhduar të rriten – megjithëse me norma më të ulëta rritjeje se në vitin 2008 – dhe inflacioni ka rezultuar në nivele të ulëta, të ardhurat e disponueshme kanë vijuar të rriten gjatë vitit 2009. Nga ana tjetër, rënia e flukseve hyrëse të remitançave, frenimi i kredisë për individët dhe prirja nënçmuese e kursit të këmbimit²² nuk kanë ndihmuar financimin e konsumit gjatë vitit 2009.

Mbështetur në informacionin e marrë nga vërtetimi i besimit të konsumatorëve rezulton se kursimet e individëve kanë shënuar një kthesë rritëse gjatë tremujorit të dytë të vitit 2009. Balanca e situatës së kursimeve të individëve, prirja e së cilës ishte rënëse deri në tremujorin e parë të vitit 2009, u rrit ndjeshëm në tre tremujorët e tjerë. Aktualisht, balanca e kursimeve qëndron në një nivel më të lartë krahasuar me mesataren historike të saj. Rritja e kursimeve të konsumatorëve mund të interpretohet si një shenjë e shtimit të kujdesit në kontekstin e ngadalësimit ekonomik, rritjes së pasigurisë për të ardhmen, dhe kushteve të shtrënguara të kredisë.

Informacioni në lidhje me ecurinë e konsumit final të popullatës gjatë vitit 2009 mbështetet në të dhënat sasiore të tregtisë me pakicë dhe të konsumit të mallrave të importuara nga jashtë, si dhe në të dhënat cilësore nga vërtetimet e besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve. Analiza e këtyre të dhënave tregon për ngadalësimin e konsumit sidomos gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009. Indeksi i tregtisë me pakicë, i cili në terma vjetorë qëndroi thajse i pandryshuar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, pësoi ulje me 2.3% në tremujorin e tretë të këtij viti. Për herë të parë që nga viti 2005, ai shënoi normë negative rritjeje, ndërkohë që norma mesatare historike e ndryshimeve vjetore të indeksit (që nga fillimi i matjes së tij në vitin 1999) është 12.7%. Nga ana tjetër, importi i mallrave për konsum vijoi të rritej me norma të larta gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2009 të krahasueshme me normat e rritjes historike të tij. Në tremujorin e fundit të vitit 2009, ky tregues i rregulluar për sezonalitet ra me 11.3%, krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2008.



Të dhënat nga vërtetimet mbështesin informacionin sasior për ngadalësimin e rritjes së konsumit privat në vend gjatë vitit 2009. Treguesi i besimit të konsumatorit ka rënë ndjeshëm në tremujorin e parë të këtij viti. Edhe pas përmirësimit të tij në tremujorin e dytë, treguesi i besimit të konsumatorëve vijoi të shënojë vlera të ulëta negative. Ecuria e treguesit të besimit në sektorin e shërbimeve përkon me sjelljen e indeksit të tregtisë me pakicë gjatë vitit

2009. Niveli i këtij treguesi ra ndjeshëm në tremujorin e parë të vitit 2009 dhe vijon të qëndrojë në nivele më të ulëta se mesatarja e tij historike edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009, duke sinjalizuar për nivele të ulëta të konsumit edhe gjatë këtij tremujori.


Shpenzimet publike kanë dhënë kontribut pozitiv në kërkesën agregate gjatë vitit 2009. Shpenzimet qeveritare janë rritur me 13% në nivel vjetor gjatë vitit 2009. Kjo rritje është e krahasueshme me normën e rritjes së shpenzimeve publike gjatë vitit 2008. Në tremujorin e fundit të vitit u vërejt një tërheqje e stimullit fiskal vlerësuar nga zvogëlimi i kryerjes së shpenzimeve në këtë periudhë. Shpenzimet publike u rritën me 3% në terma vjetorë në tremujorin e katërt, ndërkohë që rritja vjetore mesatare e nëntë muajve të parë ishte 17.8%. Shpenzimet publike janë mbështetur në rritjen e deficitit buxhetor, ndërkohë që të ardhurat publike kanë shënuar rritje modeste vjetore prej 2.7% gjatë vitit 2009.

Ndërkohë, investimet publike kanë shënuar rritje mesatare 1.4% gjatë vitit 2009. Për nëntëmujorin e parë, investimet publike u rritën në masën 104% në terma vjetorë, ndërsa në tremujorin e fundit ato ranë me 47%.

Investimet private vlerësohen të jenë ndikuar më shumë nga kriza financiare dhe ekonomike botërore. Pasiguria lidhur me situatën ekonomike në vend dhe jashtë, niveli i ndrydhur i kërkesës së brendshme e të jashtme si dhe kushtet e shtrënguara të kreditimit kanë rezultuar në kontraktim të investimeve private gjatë vitit 2009. Importi i mallrave kapitale, të cilat janë një tregues i tërthortë i investimeve në ekonomi, ka rënë me 12.7% në vitin 2009. Kredia për investime është ngadalësuar ndjeshëm gjatë vitit 2009 duke u rritur nga 30% në fillim të vitit, në 3% në muajin dhjetor, krahasuar me një vit më parë.

Informacioni nga vrojtimet e besimit të bizneseve dëshmon për investime të kontraktuara gjatë vitit 2009. Treguesit cilësorë nga vrojtimet e besimit të

Grafik 12. Tkurria e aktivitetit investues në sektorin privat.




Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

bizneseve mbeten negativë dhe në rënie. Pjesa më e madhe e bizneseve (73%) nuk presin të kryejnë investime gjatë tremujorit të fundit të vitit 2009 dhe tremujorit të parë të vitit 2010, përcaktuar nga shkalla e ulët aktuale e shfrytëzimit të kapaciteteve të tyre. Bizneset e sektorit prodhues kanë akumuluar inventarë gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 për të ndryshuar kah në pjesën e dytë të tij. Pakësimi i gjendjes së inventarëve ka ulur kontributin e këtij zëri në komponentin investime në gjashtëmujorin e dytë.

Eksportet neto kanë vijuar të japin kontribut negativ në kërkesën agregate gjatë vitit 2009, megjithëse në një masë më të vogël krahasuar me vitin 2008. Ato janë ngushtuar me 7.6% në krahasim me nivelin e vitit të kaluar.

Grafik 13. Eksportet neto kanë kontribuar negativisht në kërkesën agregate por në masë më të ulët se vitin e kaluar (në milionë euro).




Gjatë këtij viti, si importet dhe eksportet e mallrave e të shërbimeve kanë shënuar rënie vjetore, përkatësisht me -6.3 dhe -5.2%. Nisur nga struktura e sektorit të jashtëm²³, rënia e importeve ka balancuar rënien e eksporteve duke rezultuar në përmirësim të eksporteve neto. Zhvillimet në importe dhe eksporte janë ndikuar përkatësisht nga tkurrja e kërkesës së brendshme dhe nga rënia e kërkesës së jashtme.

• *ECURIA E PRODHIMIT SIPAS SEKTORËVE*

Sektori i shërbimeve vijoi të jetë kontribuesi kryesor në gjenerimin e normave pozitive të rritjes ekonomike vendase. Të dhënat më të fundit bazuar në vrojtimet e besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve konfirmojnë ngadalësimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009.

Grafik 14. Kontributet e sektorëve në rritjen vjetore të PBB-së dhe treguesi i tendencës ekonomike (në pp, grafiku majtas) dhe ecuria e TBI-së, TBN-së dhe TBSH-së (në pp, grafiku djathtas).



Aktiviteti në sektorin prodhues²⁴ gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2009 u ngadalësua ndjeshëm duke zvogëluar kontributin pozitiv në rritjen ekonomike gjatë vitit. Ky kontribut vlerësohet të jetë rreth 0.6 pikë përqindje në krahasim 1.5 pikë përqindjeje për të njëjtën periudhë të vitit 2008.

Brenda sektorit prodhues, vlera e shtuar nga sektori i industrisë në prodhimin e brendshëm bruto ishte 5% më e ulët në terma mesatarë se ajo e gjeneruar gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2008. Përkeqësimi i ecurisë së sektorit industrial është shkaktuar kryesisht nga dobësimi i kërkesës së jashtme. Ky zhvillim është reflektuar në rënien e eksporteve dhe të shitjeve të përafuar nga shifra e afarizmit në vëllim. Kështu, eksporti i mallrave të përpunuara ka shënuar rënie vjetore prej 12% në terma mesatarë për vitin 2009, në krahasim me rritjet dyshifrore të një viti më parë. Shitjet në vëllim në sektorin e industrisë ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore në tre tremujorët e parë; ato shënuan një normë vjetore rritjeje mesatare prej rreth 7.3% në krahasim me normat e rritjes 11.3 dhe 8.3% në vitet 2007 dhe 2008. Kontraktimi i shënuar në degën e industrisë përpunuese u kompensua prej zgjerimit të regjistruar në degën 'energji, gaz, ujë', mbështetur në rritjen e ndjeshme të prodhimit vendas të energjisë elektrike.

Tabelë 2. Ngadalësim i aktivitetit prodhues në degën e industrisë (ndryshime vjetore,%).

	9M 2007	9M 2008	9M 2009
Industria	11.3	8.3	7.3
Industria nxjerrëse	21.8	2.0	-16.8
Industria përpunuese	11.9	7.9	6.5
Energji elektrike, gaz, ujë	5.6	12.5	20.2

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Të dhënat më të fundit të vrojtimeve sinjalizojnë se aktiviteti i sektorit të industrisë ka vazhduar tendencën e vërejtur në tremujorin e tretë edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009. Treguesi i besimit për këtë sektor është ulur me 0.6 pikë përqindjeje në tremujorin e katërt, duke ndërprerë zhvillimet disi më pozitive të regjistruara në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2009. Aktualisht, niveli i treguesit të besimit të industrisë qëndron 8.4 pikë përqindjeje poshtë mesatares së tij historike.

Gjatë vitit 2009, bilanci i energjisë elektrike në vend ka shënuar përmirësime të dukshme në disa prej treguesve kryesorë të tij krahasuar me vitin paraardhës. Këto zhvillime pozitive janë materializuar në rritjen e prodhimit, uljen e ndjeshme të nivelit të importit si dhe për herë të parë, eksportin e energjisë elektrike. Prodhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2009, u rrit me 34.1% në terma vjetorë. Situata e favorshme hidrike në vend ka bërë që prodhimi i brendshëm të plotësojë nevojat e brendshme me energji elektrike, pa rënduar bilancin tregtar. Energjia elektrike e eksportuar gjatë vitit 2009 ishte 486.4 GWh, ndërsa importet shënuan vlerën më të ulët që prej vitit 2003.

Raporti i humbjeve në shpërndarje ndaj prodhimit është përkeqësuar gjatë vitit 2009 duke shënuar nivelin 39.7%, nga 26.6% një vit më parë.

Tabelë 3. Tregues të bilancit energjetik.

Tregues të bilancit energjetik në GWh	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Prodhimi	4,904	5,491	5,451	5,550	2,947	3,835	5,140
Importe (-)	937.4	567.1	365.3	632.6	2,799.7	2,475.5	53.1
Eksporte(+)	0	0	0	0	0	0	397.4
Bilanci (eksporte-importe)	-937.4	-567.1	-365.3	-632.6	-2799.7	-2475.5	344.3
Marrë (-)	304.6	301.7	868.2	549.5	134.8	234.6	141.4
Dhënë (+)	326.2	390.3	729.5	637.2	106.6	293.4	131.9
Bilanci (dhënë - marrë)	21.6	88.6	-138.7	87.7	-28.2	58.8	-9.5
Bilanci total i shkëmbimit	-915.8	-478.5	-504.0	-544.9	-2827.9	-2416.7	334.8

Burimi: KESH.

Konsumi i energjisë elektrike gjatë vitit 2009 u rrit me 5.7% në terma vjetorë, rreth 3.8 pikë përqindjeje më pak se në vitin 2008. Ritmi i rritjes së konsumit të energjisë elektrike nga konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë, edhe pse pozitiv, tregoi shenja frenimi gjatë vitit 2009. Në linjë me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në sektorët kryesorë të ekonomisë, norma e rritjes së konsumit të energjisë elektrike nga bizneset rezultoi 1.3%, rreth 15.0 pikë përqindjeje më e ulët se ajo e shënuar në vitin 2008.


Tabelë 4. Sasia e konsumit të energjisë elektrike sipas përdoruesve*.

Tregues të konsumit të energjisë në GWh	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Energjia e konsumuar	4,200.1	4,565.8	4,502.0	5,684.7	5,514.2	6,036.6	6,381.5
Konsumi i pa faturuar	708.2	888.7	988.9	2259.8	1873.3	1927.4	2117.1
Konsumi familjar	2220.1	2234.2	2106.8	2121.6	2078.3	2291.9	2423.1
Konsumi jofamiljar	1271.8	1442.9	1406.3	1303.3	1562.5	1817.4	1841.2

Burimi: OSSH.

* Të dhënat për konsumin e energjisë merren nga OSSH, si furnizuesi i vetëm i energjisë elektrike me pakicë.

Sektori i ndërtimit, në terma të vlerës së shtuar, regjistroi një rritje mesatare vjetore rreth 5.2% në tre tremujorët e parë të vitit. Dinamika e zhvillimeve të aktivitetit ndërtues reflektoi një përsheptim të tij në dy tremujorët e parë të vitit, duke kompensuar kontributin negativ të aktivitetit industrial në sektorin prodhues.



Më konkretisht, u regjistrua një rritje vjetore prej 6.7 dhe 9.7% në tremujorin e parë dhe të dytë, ndërkohë që në tremujorin e tretë vlera e shtuar në prodhim ka shfaqur një rënie vjetore modeste prej 0.7%. Ritmet e larta të rritjes vjetore në gjashtëmujorin e parë të vitit vlerësohen të jenë nxitur kryesisht nga ndërtimet inxhinierike që financohen më së shumti nga burimet publike. Në tremujorin e tretë të vitit, treguesit e shifrës së afarizmit në vëllim, të vëllimit të ndërtimit dhe të konsumit të dukshëm të çimentos sinjalizuan ngadalësim të aktivitetit ndërtues, duke regjistruar norma pozitive vjetore rreth dy herë më të ulëta krahasuar me mesataret përkatëse të ritmeve vjetore gjatë tre tremujorëve të parë.


Treguesi i besimit në sektorin e ndërtimit dëshmon për ngadalësimin e aktivitetit në këtë sektor përgjatë vitit 2009. Në tremujorin e katërt të vitit 2009, treguesi i agreguar ra me 13 pikë përqindjeje, duke shënuar vlerën më të ulët historike të tij që nga fillimi i matjes (tremujori i dytë 2002).

Hapësirë informuese 1: Ecuria e çmimeve të pasurive të paluajtshme.

Tregu i pasurive të paluajtshme është karakterizuar nga rritja e çmimeve të shitjes së banesave dhe rënia e lehtë e çmimit të qirave gjatë vitit 2009²⁶. Zhvillimet në çmimet e banesave gjatë këtij viti shënuan një pikë kthese, pas frenimit të normave të rritjes gjatë vitit 2008.

Tregu i pasurive të paluajtshme në vend gjatë vitit 2009 është karakterizuar nga një rënie e kërkesës për banesa dhe nga ofertë e qëndrueshme. Vlerësimi për kërkesën në rënie bazohet në të dhëna të tërthorta sasiore dhe cilësore nga vrojtimet. Kështu, bizneset e sektorit të ndërtimit kanë vlerësuar në rënie kërkesën e individëve për blerje banese gjatë këtij viti. Rënia e remitançave si dhe ndjekja e një politike shtrënguese të bankave për akordimin e huave hipotekare për individët nuk kanë mbështetur kërkesën për blerje banese. Nga ana tjetër vlerësohet se oferta për banesa ka mbetur në nivele të qëndrueshme. Sipas të dhënave zyrtare, numri i lejeve të ndërtimit për banesa të miratuara për Qarkun e Tiranës gjatë nëntëmuajorit të parë 2009 ishte i krahasueshëm me ato të dhëna gjatë vitit 2008.

Grafik 16. Rritje e çmimeve të shitjes së banesave dhe rënie e lehtë e qirave gjatë vitit 2009.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ballafaqimi i kërkesës me ofertën në treg nuk është pasqyruar në ecurinë e çmimeve për banesa gjatë vitit 2009; indeksi i çmimit të banesave u rrit me 13.4% gjatë vitit. Një vit më parë ky ndryshim ishte -0.1%. Rritja e çmimit të banesave gjatë këtij viti shpjegohet në masën më të madhe nga vlerësimi me 7.6% i monedhës evropiane me të cilën emërtohen çmimet e banesave për shitje. Indeksi i çmimit të banesave është rritur 2.6 herë që nga fillimi i matjes së tij në vitin 1998.

Kostot e ndërtimit tregojnë për një prirje të lehtë rënësë gjatë vitit 2009, prirje kjo e nisur nga tremujori i fundit i vitit 2008. Indeksi i kushtimit në ndërtim, pasi shënoi një rritje të lehtë me 0.5% për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009, ra me 0.4% në tremujorin e tretë të tij, në terma vjetorë. Bazuar në informacionin më të fundit nga vrojtimi i besimit në sektorin e ndërtimit, çmimet e prodhimit megjithëse kanë pësuar një rritje të lehtë gjatë vitit 2009, mbeten në nivele të ulëta krahasuar me mesataren historike. Zhvillimet në ecurinë e kostos së ndërtimit dhe në atë të çmimeve të prodhimit nuk janë reflektuar në ecurinë e çmimit të shitjes.

Grafik 17. Rritja e raportit çmim/qira (majtas) dhe çmimet e prodhimit në ndërtim (balancë) e indeksi i kushtimit në ndërtim (djathtas).




Burimi: Vrojtimi i bizneseve dhe konsumatorëve, Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009, indeksi i qirasë të banesave ra mesatarisht me 0.7% në terma vjetorë. Në dallim me ecurinë e çmimeve të shitjes, indeksi i qirasë së banesave ka rënë me 40% që nga fillimi i matjes së tyre. Raporti i indeksit të çmimit të shitjes me qiranë, pas një periudhe "qetësie" 2006T4 – 2008T4, vijoi përsëri prirjen e tij rritëse gjatë vitit 2009 (grafiku 17).

Vlera e shtuar e gjeneruar prej sektorit bujqësor u rrit me një normë vjetore mesatare rreth 2.4% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009, rreth 1.2 pikë përqindje më shumë se rritja në vitin 2008. Si rezultat, ky sektor vlerësohet të ketë dhënë një kontribut modest në rritjen vjetore të produktit të brendshëm bruto. Të dhënat nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dëshmojnë për një rritje vjetore të prodhimit bujqësor²⁷ prej rreth 1% në terma mesatarë për gjithë vitin 2009, me kontribues kryesor degën e blegtorisë. Prodhimi agroindustrial, gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009, është tkurrur mesatarisht me 7.3% në terma vjetorë, krahasuar me rritjen e lartë prej 4% të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit 2008.

Grafik 18. Kontributet e nëndegëve në rritjen vjetore të prodhimit bujqësor (grafiku majtas, në pp) dhe ecuria e prodhimit agroindustrial (grafiku djathtas, ndryshime vjetore në për qind).




Burimi: Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ngadalësimi i kërkesës në vend vlerësohet të ketë ndikuar më pak ecurinë e sektorit të shërbimeve. Vlera e shtuar gjeneruar nga ky sektor dha një kontribut mesatar në rritjen vjetore të PBB-së që vlerësohet të luhatet rreth nivelit 4.4 pikë përqindje për tre tremujorët e parë të vitit 2009. Për këtë periudhë të vitit, vlera e shtuar regjistroi normën vjetore mesatare më të lartë të rritjes për aktivitetet e post-komunikacionit, rreth 26.3%. Dega e postë-komunikacionit zgjeroi aktivitetin me ritme më të larta vjetore në tremujorin e tretë të vitit, rreth 34.3%. Përshpejtim të aktivitetit në këtë tremujor, shënuan gjithashtu dega e transportit (rreth 15.5%) dhe dega 'tregtia, hotele dhe restorante' (rreth 6.4%). Në të kundërt, aktivitetet e përfshira në shërbimet e tjera²⁸ regjistruan një vlerë të shtuar më të ulët, rreth 2.3%, në terma vjetorë.

Besimi në sektorin e shërbimeve, bazuar në të dhënat nga vrojtimet e bizneseve të këtij sektori, paraqitet më pak pesimist se sa sektorët e tjerë.

Grafik 19. Shifra e afarizmit në vëllim (grafiku majtas) dhe vlera e shtuar në prodhimin e brendshëm bruto²⁹ (grafiku djathtas) sipas aktiviteteve të shërbimeve.




Burimi: INSTAT dhe Ilogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Treguesi i besimit të bizneseve që operojnë në sektorin e shërbimeve, pasi ra më ndjeshëm në tremujorin e parë të vitit 2009, ruajti një nivel të qëndrueshëm përgjatë tre tremujorëve të tjerë.

Bazuar në të dhënat nga vrojtimet, treguesi i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve shfaq tendenca të njëjta në të gjithë sektorët e ekonomisë. Në terma mesatarë për vitin 2009, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e industrisë dhe të ndërtimit ka shënuar rënien më të madhe, përkatësisht me 8.5 dhe 6.1 pikë përqindjeje në krahasim me normën mesatare të vitit 2008. Në sektorin e shërbimeve, kjo normë ka rënë me 3.9 pikë përqindjeje. Aktualisht, norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ekonomi qëndron në nivelin 66%, rreth 7 pikë përqindjeje më poshtë se mesatarja afatgjatë, duke sugjeruar për ekzistencën e kapaciteteve të lira në ekonomi.

• TREGU I PUNËS DHE PAGAT


Trendi i treguesve të tregut të punës, si dhe shpërndarja ndërsektoriale e të punësuarve (të dhënat deri në tremujorin e tretë të vitit 2009) vlerësohet të jenë ndikuar nga ngadalësimi ekonomik i këtij viti.



Norma e papunësisë shënoi një rritje të lehtë gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2009. Ngadalësimi i ritmit të rritjes vjetore të numrit të të punësuarve³⁰ – kryesisht në sektorin privat jobujqësor, ndërkohë që në sektorin shtetëror nuk u regjistruan ndryshime – krahas prirjes të lehtë rritëse të numrit të të punësuarve rezultuan në rritjen e normës së papunësisë, në rreth 12.8%, në tremujorin e tretë të vitit 2009.

Indeksi i të punësuarve³¹ për ndërmarrjet ekonomike jobujqësore reflektoi gjithashtu ngadalësimin e aktivitetit ekonomik vendas, duke ulur normën mesatare vjetore të rritjes në 1.5% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009, krahasuar me mesataret 13.5 dhe 11.3% të shënuara në të njëjtat periudha përkatëse për vitet 2008 dhe 2007. Tkurria e aktivitetit industrial u pasqyrua

në një rënie mesatare vjetore të të punësuarve në këtë sektor me rreth 4.1% në tre tremujorët e parë të vitit. Gjatë të njëjtës periudhë kohe, numri i të punësuarve në sektorin e ndërtimit u rrit mesatarisht me 7.1% në nivel vjetor, një ritëm rreth 5 herë më i ulët se norma vjetore e regjistruar në tre tremujorët e vitit 2008³². Një ngadalësim të ritmeve vjetore të rritjes së treguesit të punësimit njohën edhe aktivitetet e shërbimeve, duke shënuar një normë mesatare vjetore rritjeje rreth 3%, 4 herë më të ulët se ritmi mesatar vjetor i tre tremujorëve të parë të vitit 2008.




Të dhënat nga vrojtimet mbështesin tendencën e vërejtur në tregun e punës. Në kushtet e ngadalësimit ekonomik, kërkesa e bizneseve për të rritur numrin e punonjësve nuk gjykohej të jetë në rritje duke rezultuar kështu në kushte të lehtësuara të tregut të punës³³. Ky vlerësim, krahas normës së ulët të shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese, sugjeron se oferta potenciale në ekonomi është më e lartë se kërkesa dhe se janë krijuar kapacitete të lira. Kjo 'tepricë' kapacitetesh vlerësohet të ushtrijë presione në rënie në paga dhe në inflacion.

PAGAT NË EKONOMI

Pagat gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit kanë përvijuar prirjen rritëse, por me ritme më të ulëta sesa një vit më parë. Ecuria e pagave gjatë kësaj periudhe vlerësohet të ketë pasqyruar kushtet e lehtësuara të tregut të punës në kuadrin e ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe nivelin e ulët të inflacionit. Treguesi i pagës në ekonomi³⁴ regjistroi një normë mesatare vjetore rritjeje për tre tremujorët e parë të vitit rreth 6.6%, duke rënë ndjeshëm nga niveli 15.8% i rritjes në vitin 2008, por duke u luhatur pranë mesatares historike vjetore prej 6.4% të shënuar në vitet 2005-2008. Ndërkohë, paga reale³⁵ gjatë kësaj periudhe vlerësohet të jetë rritur me një ritëm mesatar vjetor rritjeje prej 4.5%, rreth 1 pikë përqindje më e lartë krahasuar me mesataren historike vjetore që prej vitit 2005.

Në tremujorin e parë dhe të dytë, paga mesatare vijoi të ngadalësojë ritmet vjetore të rritjes në përkatësisht 7.3 dhe 4.0%, duke ndjekur trendin e vërejtur që në tremujorin e dytë të vitit 2008. Zhvillimet e këtij treguesi në tremujorin e tretë të vitit ndërprejnë këtë tendencë, duke regjistruar rritje të pagës mesatare me rreth 8.4% në krahasime vjetore.


Ecuria e pagës mesatare sipas degëve të ekonomisë ka shfaqur dinamika të ndryshme gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2009. Normat mesatare të rritjeve vjetore regjistruan nivele më të larta në aktivitetin e shërbimeve (11.8%), i cili përfaqëson sektorin kryesor në rritjen ekonomike të dy viteve të fundit. Në sektorët e industrisë dhe ndërtimit, ky tregues është rritur përkatësisht me 7.1 dhe 4.1% në terma mesatarë duke u përgjysmuar në krahasim me nivelet e larta të vitit 2008.



Paga mesatare mujore shtetërore³⁶ përshpejtoi prirjen rritëse të shfaqur që në gjysmën e dytë të vitit 2008 duke reflektuar prirje të kundërt me treguesin e pagës për sektorin privat. Më konkretisht, u shënuar një rritje mesatare vjetore në rreth 12.7% krahasuar me normën mesatare vjetore prej 10.8% gjatë periudhës 2005-2008. Ecuria e pagës mesatare mujore në sektorin shtetëror ka pasqyruar kryesisht rritjen e pagave për disa kategori profesionesh në këtë sektor, për të regjistruar normën më të lartë vjetore në tremujorin e tretë, rreth 16.4%. Ky tregues në terma realë vlerësohet të jetë rritur mesatarisht me 10.4% në nivel vjetor, rreth 3 pikë përqindje më shumë se mesatarja e ritmeve vjetore të rritjes për vitet 2005-2008.

Gjatë vitit 2009, paga bazë minimale mujore regjistroi nivelin 18,000 lekë duke u rritur mesatarisht me 7.6% në terma vjetorë, ndonëse nën ritmin mesatar vjetor prej 17.9% të shënuar një vit më parë.

Grafik 23. Paga mesatare në ekonomi dhe paga mesatare mujore në sektorin shtetëror për periudhën T1:2004-T3:2009.



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

II.2.2. ZHVILLIMET NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË

Në kontekstin e ngadalësimit të kërkesës së brendshme dhe situatës së vështirë të ekonomisë globale, deficiti i llogarisë korente u ngushtua me rreth 3% në vitin 2009. Struktura e sektorit të jashtëm, e cila reflekton orientimin e ekonomisë shqiptare nga importet, ka ndikuar në reduktimin marxhinal të deficitit të bilancit tregtar, si pasojë e rënies së importeve. Rënia e kërkesës së jashtme u pasqyrua në rënieën e eksporteve, pavarësisht prirjes nënçmuese të kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, pozicioni negativ i të ardhurave neto dhe rënia e remitancave u balancuan nga rritja e suficitit të llogarisë së shërbimeve duke rezultuar në reduktimin e vogël të deficitit korent. Suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare u zvogëluua ndjeshëm në 11.8% të PBB-së si rezultat i rënies së konsiderueshme të investimeve të tjera neto.

Tabelë 5. Tregues të bilancit të pagesave.

	Milionë euro			Ndaj PBB-së		
	2007	2008	2009	2007	2008	2009
Llogaria korente	-831.0	-1370.3	-1327.0	-10.6	-15.5	-15.3
Bilanci tregtar (mallra)	-2104.0	-2431.5	-2303.7	-26.8	-27.4	-26.6
-Eksport	786.0	917.5	750.7	9.9	10.4	8.9
-Import	-2890.0	-3348.9	-3054.4	-36.8	-37.8	-35.3
Shërbime (neto)	12.0	69.4	120.9	0.2	0.8	1.4
Të ardhura (neto)	217.0	54.9	-78.7	2.8	0.6	-0.9
Transferta korente (neto)	1043.0	936.8	934.5	13.3	10.6	10.8
Llogaria kapitale dhe financiare	848.4	1580.9	1018.2	10.9	17.8	11.8
Gabime dhe harresa	131.2	-18.7	276.7	1.7	-0.2	3.2
Bilanci i përgjithshëm	149.0	191.9	-32.0	1.9	2.2	-0.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- **LLOGARIA KORENTE**

Llogaria korente gjatë këtij viti u mbyll me një deficit prej 1.33 miliardë euro. Shkëmbimet korente u zvogëluuan me rreth 460 milionë euro duke

rënë me rreth 4.9% në krahasim me vitin 2008. Shpenzimet u përqendruan kryesisht në blerje mallrash e shërbimesh, ndërsa flukset hyrëse valutore ishin kryesisht në formën e shërbimeve dhe të transfertave korente³⁷. Reduktimi i vlerës së shkëmbimeve korente është shkaktuar kryesisht nga rënia e flukseve tregtare në mallra dhe e transfertave korente.


Deficiti i eksporteve neto për vitin 2009 regjistroi një ngushtim prej përafërsisht 7.6% krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i deficitit të bilancit tregtar dha një kontribut të qenësishëm, ndërsa rritja e prurjeve financiare nga shërbimet dha një kontribut modest në këtë ecuri.

• **TREGTIA E JASHTME NË MALLRA**

Viti 2009 u karakterizua nga një reduktim i aktivitetit të jashtëm tregtar të vendit tonë mbështetur nga përkeqësimi i treguesve ekonomikë të partnerëve kryesorë tregtarë, si dhe nga ngadalësimi i kërkesës në vend. Shkalla e hapjes së ekonomisë u vlerësua në 46.2% ndaj PBB-së, përafërsisht 4.5 pikë përqindjeje më pak se një vit më parë. Megjithatë, ky tregues qëndron mbi mesataren historike të gjashtë viteve të fundit. Gjatë këtij viti, u regjistrua një ngushtim i deficitit tregtar me rreth 5.9% në nivel vjetor, i cili erdhi kryesisht si rezultat i rënies së importeve. Raporti relativ i mbulimit të importeve nga eksportet ishte 23%, vlerë kjo 2.6 pikë përqindjeje më e ulët krahasuar me raportin e mbulimit të regjistruar një vit më parë.


Megjithëse ekonomia botërore shfaq shenja përmirësimi gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, ekonomia e partnerëve tanë tregtarë kryesorë, Greqisë dhe Italisë³⁸, nuk u zhvillua në të njëjtin drejtim. Përqendrimi i eksporteve të vendit tonë drejt këtyre vendeve ka dhënë një ndikim negativ në ecurinë e eksporteve gjatë vitit 2009. Prirja nënçmuese e monedhës vendase kundrejt monedhës së përbashkët evropiane vlerësohet të ketë dhënë pak ndikim në rritjen e eksporteve tona në kushtet e turrjes së kërkesës së huaj. Vlera e eksporteve të mallrave e shprehur në euro u zvogëluar me rreth 18% në nivel vjetor në krahasim me vitin 2008. Rënia e kërkesës së jashtme rëndoi më shumë mbi aktivitetin prodhues të sektorit industrial. Kategoritë kryesore të eksporteve në vlerë që kontribuan në këtë rënie ishin “Materiale të papërpunuara e minerale”, “Mallra të përpunuara” dhe “Mallra të tjerë të përpunuara”, peshë e kombinuar e të cilëve mbulonte rreth 76% të totalit të eksporteve për vitin 2009. Analiza e eksporteve në vëllim dëshmon për një rënie të tyre në bazë vjetore me 7.2%.

Grafik 24. Kontribuesit kryesorë në llogarinë korente (flukse neto në milion euro, në përqind ndaj PBB-së*).



* Shënim: PBB nga INSTAT dhe vlerësimi i MF për 2009. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 25. Ngushtimi i lehtë i deficitit tregtar (ndryshim vjetor, %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlera totale e importeve të mallrave gjatë vitit 2009 shënoi një rënie prej përafërsisht 9% krahasuar me vlerën e regjistruar gjatë vitit 2008. Niveli i ulët i çmimeve në vendet e origjinës gjatë këtij viti, krahas ngadalësimit të kërkesës së brendshme, ka arritur të balancojë nënçmimin e kursit të këmbimit duke dhënë ndikim në kahun rënës mbi vlerën e importeve. Rënia e importeve në nivel vjetor gjatë vitit 2009 i atribuohet zvogëlimit të importeve të kategorive “Mallra kapitale” e “Mallra të ndërmjetme”³⁹. Importet e këtyre kategorive u zvogëluan me përkatësisht 12.7 dhe 12% në bazë vjetore. Krahas efektit statistikor të krahasimit me një bazë të lartë gjatë vitit 2008, rënia vjetore e këtyre mallrave sinjalizon për tkurrjen e investimeve në vend. Importet e kategorisë “Mallra për konsum” ruajtën thuajse të pandryshueshmëri në importin e mallrave të konsumit (%). Ndonëse pesha e kësaj kategorie importesh ndaj totalit është rritur me 2.4 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë, ajo ka shfaqur prirje rënëse që prej vitit 2004⁴⁰.

Grafik 26. Rënie vjetore në importin e kategorive mallra kapitale, të ndërmjetme dhe pandryshueshmëri në importin e mallrave të konsumit (%).



Aktiviteti tregtar i vendit tonë vijon të jetë i përqendruar drejt vendeve të BE-së, shkëmbimet tregtare me të cilat vlerësohen në 67% të totalit. Megjithëse është regjistruar një rritje e importeve prej Rumanisë, Polonisë, Çekisë e ShBA-së, vendin kryesor të origjinës së importeve e zënë Italia e Greqia. Në kushtet e dobësimit të aktivitetit ekonomik në destinacionin kryesor të eksporteve vendase, Italisë, gjatë vitit 2009 është regjistruar një rritje e eksporteve drejt ShBA-së, Kinës, Zvicrës e Gjermanisë.

• SHËRBIMET, TË ARDHURAT DHE TRANSFERTAT KORENTE

Prurjet financiare neto të shërbimeve, të të ardhurave dhe të transfertave korente shënuan një rënie prej rreth 8% këtë vit krahasuar me vitin paraardhës. Kriza globale është reflektuar dhe në rënien e të ardhurave nga investimet dhe të remitançave, të cilët ishin dy faktorët kryesorë në përcaktimin e kësaj ecurie. Vlera e kombinuar e këtyre zërave⁴¹ financoi rreth 67% të deficitit të llogarisë korente rreth 3 pikë përqindjeje më pak se raporti i financimit të një viti më parë.

Bilanci i shërbimeve neto gjatë vitit 2009 regjistroi një zgjerim prej rreth 51.5 milionë eurosh krahasuar me vitin 2008, duke vijuar prirjen rritëse për të katërtin vit radhazi. Zgjerimi i të ardhurave prej shërbimeve private, kryesisht i të ardhurave prej turizmit, dhanë kontributin kryesor në këtë rritje. Ndërkohë, niveli i lartë i importeve në vend ushtroi ndikim për rritjen e shpenzimeve për shërbime transporti e sigurimi, të cilat regjistruan një bilanc negativ për vitin 2009.

Në llogarinë e të ardhurave spikat bilanci negativ i regjistruar në zërin “Të ardhurat nga investimet” të cilat arritën të eklipsojnë prurjet valutore të të ardhurave nga puna jashtë vendit.

Transfertat korente neto gjatë vitit 2009 regjistruan një reduktim të suficitit të tyre për të tretin vit radhazi. Deri në vitin 2007, këto transferta financonin krejtësisht deficitin e llogarisë korente, ndërsa gjatë dy viteve të fundit ato kanë arritur ta mbulojnë pjesërisht atë. Vijimësia e prirjes rënëse të remitancave si pasojë e përkeqësimit të ekonomive në vendet rezidente që prej gjysmës së dytë të vitit 2008, ka luajtur rolin kryesor në këtë zhvillim. Remitancat shënuan rënie vjetore me rreth 6.5% në vitin 2009. Raporti i tyre ndaj PBB-së ishte 9%, ndërkohë që niveli i financimit të deficitit tregtar prej dërgesave të emigrantëve ishte rreth dy herë më i ulët se i njëjti nivel për vitin 2004⁴².

• **LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE**


Llogaria kapitale dhe financiare gjatë vitit 2009 rezultoi me zvogëlim të suficitit në krahasim me vitin e kaluar, shkaktuar kryesisht nga rënia e investimeve të tjera ku përfshihen zërat e huamarrjes dhe të investimeve të huaja direkte. Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare regjistruan vlerën 1.02 miliardë euro, duke qenë rreth 562.7 milionë euro më pak se një vit më parë. Rreth 84.9 milionë euro kanë hyrë në formën e transfertave kapitale dhe rreth 933.4 milionë euro në formën e flukseve financiare neto. Suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare ka arritur të financojë vetëm 76.7% të deficitit korent, në krahasim me 102.0 dhe 115.4% gjatë viteve 2007 dhe 2008.

Nga ana e detyrimeve, luhatjet më të mëdha janë shënuar në rënien e pozicioneve të bankave për huatë afatshkurtra me jashtë, të cilat për vitin 2009 ranë në 201 milionë euro. Nga ana tjetër, fluksi i huamarrjes neto për vitin 2009 rezultoi 366.1 milionë euro, rreth 8.5% më i ulët se ai i një viti më parë, si pasojë e rënies së huamarrjes private. Flukset hyrëse të investimeve direkte regjistruan shifrën 698.1 milionë euro duke shënuar një rritje modeste prej 3.4% në krahasim me rritjen vjetore dyshifrore 40.4% në vitin 2008. Raporti i investimeve të huaja direkte neto ndaj PBB-së për vitin 2009 vlerësohet 8.1%, rreth 0.4 pikë përqindjeje më i lartë krahasuar me një vit më parë. Të ardhurat nga privatizimet kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e investimeve të huaja; gjatë vitit 2009 vlera e tyre ishte rreth 220 milionë euro.

Huamarrja publike (tërheqjet) ishte rreth 396 milionë euro, rreth 4.5% më e lartë se ajo e një viti më parë. Ndërsa, huamarrja private regjistroi vlerën 39 milionë euro ose rreth 53.6% më e ulët se një vit më parë.

Në kahun e mjeteve financiare, llogaria që ka shënuar lëvizje më të theksuara ka qenë ajo e depozitave të rezidentëve kryesisht bankave rezidente jashtë, e cila me përjashtim të tremujorit të tretë të vitit 2009 ka regjistruar rënie. Për vitin 2009 kjo shumë ishte 129.7 milionë euro, rreth 41.9% më pak krahasuar me vitin paraardhës. Ndërkohë, investimet e portofolit të cilat ranë ndjeshëm

Grafik 27. Kontribuesit kryesorë në llogarinë financiare (flukse neto në milion euro, % ndaj PBB-së*).



*Shënim: PBB nga INSTAT dhe vlerësime të MF për 2009. Burimi: Banka e Shqipërisë.


gjatë vitit 2008 (70 milionë euro), këtë vit nuk kanë pasur lëvizje të mëdha në pozicione. Viti 2009 u mbyll me 1.5 milionë euro ulje të pozicionit të investimeve të portofolit. Nga ana tjetër, një fenomen i vërejtur gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009 është rritja e pozicioneve afatshkurtra të huasë, të cilat kanë kontribuar me 61 milionë euro në rritjen e mjeteve tona jashtë. Për pasojë, llogaria e mjeteve financiare për vitin 2009 u mbyll me një fluks prej 42 milionë eurosh, rreth 56.0% më i ulët krahasuar me vitin 2008.

Pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave për vitin 2009 rezulton negativ duke bërë që rezervat valutore të autoritetit monetar të ulen me 32.0 milionë euro. Si rezultat, stoku i rezervës valutore në fund të vitit 2009 shënoi vlerën 1.66 miliardë euro, i mjaftueshëm për mbulimin e 4.2 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

II.2.3. ZHVILLIMET NË TREGUESIT FISKALË

Zhvillimet në sektorin publik përgjatë vitit 2009, dëshmuar për një natyrë ekspansioniste të politikës fiskale, e cila, krahas stimullit monetar, ka ndihmuar ekonominë në gjenerimin e normave pozitive të rritjes. Të ardhurat buxhetore dhe shpenzimet publike rezultuan përkatësisht 299 miliardë dhe 379 miliardë lekë, duke u vlerësuar respektivisht 26.2 dhe 33.2% e PBB-së. Deficiti buxhetor njohu ritme të larta zgjerimi, sidomos pas tremujorit të parë, duke u vlerësuar në fund të vitit 2009 në rreth 7% të PBB-së. Burimet kryesore të financimit të deficitit ishin të ardhurat nga privatizimet dhe kredia syndikale.

Grafik 28. Shuma rrëshqitëse e balancës primare për 12 muaj, 1999M12 – 2009M12.



Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të stafit.

Deficiti primar gjatë këtij viti është zgjeruar konsiderueshëm krahasuar me vitet e mëparshme. Zgjerimi i tij reflekton natyrën ekspansioniste të politikës fiskale të ndjekur gjatë vitit 2009, duke ndikuar në këtë mënyrë dhe në rritjen e stokut të borxhit publik.

• TË ARDHURA BUXHETORE

Prioritetet e politikës fiskale me orientim nga të ardhurat buxhetore mbeten të njëjta me ato të vitit 2008 dhe janë përkthyer në tregues sasiorë në Kuadrin Makroekonomik Fiskal 2009-2011. Paketa fiskale në fuqi ishte e njëjtë me atë të vitit të kaluar, me përjashtim të disa ndryshimeve në ligjin për akcizat, ku u rishikuan disa norma të aplikuarra mbi mallrat e importuara subjekt i akcizës⁴³.

Tabelë 6. Zërat kryesorë të të ardhurave, në miliardë lekë dhe ndaj PBB-së 2008-2009 (%).

	Nominale në miliardë lekë							Ndaj PBB (%)	
	Mesatare '05-'08	2008	T1	T2	T3	T4	2009	2008	2009
Të ardhura totale	244.1	291.2	72.3	73.0	76.0	78.0	299.2	26.8	26.2
Grante	4.9	4.2	0.2	1.0	0.9	1.9	4.0	0.4	0.4
Tatime dhe dogana	168.2	205.3	48.3	52.5	56.2	51.9	208.9	18.9	18.3
- TVSH	83.4	107.1	24.4	27.7	29.1	28.9	110.1	9.8	9.6
- Tatim fitimi	20.2	18.1	5.5	3.6	3.6	4.4	17.1	1.7	1.5
- Akciza	25.7	32.5	6.9	7.5	11.6	7.6	33.5	3.0	2.9
- Tatim mbi të ardhurat personale	13.8	24.5	6.1	7.6	6.6	6.6	26.8	2.3	2.3
Pushteti lokal	11.0	11.3	3.0	3.9	2.6	2.6	12.1	1.0	1.1
Buxhetet e pavarura	41.3	47.8	13.0	12.5	11.9	12.5	50.0	4.4	4.4
Jotatimore	18.7	22.6	7.7	3.2	4.4	9.0	24.3	2.1	2.1

Burimi: Ministria e Financave.


Të ardhurat për vitin 2009 shënuan rritje vjetore prej 2.7%, normën më të ulët të dekadës së fundit. Kjo sjellje u diktua kryesisht nga rritja e ngadaltë e të ardhurave nga zërat me natyrë tatimore. Të ardhurat nga TVSH-ja⁴⁴ dhe akcizat për vitin 2009 janë rritur përkatësisht me nga 3%, normë kjo mjaft e ulët krahasuar me rritjen mesatare vjetore për periudhën 2005-2008, përkatësisht me 14 dhe 20%. Të ardhurat nga TVSH-ja kontribuuan me 1 pikë përqindjeje në rritjen e të ardhurave, ndërkohë që kontributi i këtij zëri në rritjen e të ardhurave totale ka qenë mesatarisht rreth 4.1 pikë përqindjeje gjatë periudhës 2005-2008.

Të ardhurat buxhetore gjatë vitit 2009 shfaqën prirje rritjeje ngadalësuese pas tremujorit të parë të vitit. Kjo sjellje është vërejtur pothuajse në të gjithë zërat e karakterit tatimor.

Të ardhurat buxhetore gjatë gjysmës së parë të vitit kanë shfaqur diferenca me nivelin e programuar. Normat më të ulëta të akumulimit të tyre gjatë gjashtëmujorit të parë, bënë të domosdoshëm rishikimin e buxhetit për vitin 2009, përkatësisht në muajin shtator dhe dhjetor 2009. Referuar ndryshimeve më të fundit në ligjin e buxhetit për vitin 2009⁴⁵, të ardhurat u reduktuan me 14.9 miliardë lekë dhe shpenzimet u rritën me 16.7 miliardë lekë krahasuar me nivelin fillestar të programuar.


Të ardhurat buxhetore përmbushën rreth 94% të programit të miratuar më së fundmi për vitin 2009. Pjesën më të madhe të diferencës me planin e mbartën të ardhurat nga pushteti lokal, akcizat, të ardhurat personale dhe TVSH-ja.

Grafik 29. Ndryshimet vjetore në zërat kryesorë të të ardhurave, janar '05-dhjetor '09.



Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të stafit.

Grafik 30. Të ardhurat dhe zërat kryesorë nga tatimet dhe doganat ndaj PBB-së (në %), në boshtin majtas dhe të ardhurat nominale në miliardë lekë në boshtin djathtas, 1999-2009.



Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të stafit.

• SHPENZIME BUXHETORE

Objektivat dhe prioritetet e qeverisë lidhur me sigurimin e mallrave dhe shërbimeve publike, të faktorizuara në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2009-2011, kanë përcaktuar kryesisht natyrën ekspansioniste të politikës fiskale gjatë vitit 2009. Investimet publike, sikurse dhe në vitin paraardhës, kanë gjeneruar kontribut të qenësishëm në kërkesën agregate.

Për vitin 2009, shpenzimet buxhetore kanë shënuar një rritje vjetore me rreth 8%, ku shpenzimet korente dhe ato kapitale kanë kontribuar respektivisht me 6 dhe 2 pikë përqindjeje. Shpenzimet korente gjatë vitit 2009, janë rritur në terma vjetorë me rreth 13% dhe kontributin më të qenësishëm e kanë dhënë shpenzimet për sigurime shoqërore, personelin dhe shpenzimet për interesa⁴⁶. Shpenzimet kapitale rezultuan rreth 96 miliardë lekë, 40% e të cilave kanë financuar rrugën Durrës-Kukës. Në terma vjetorë, shpenzimet për investime kanë shënuar një rritje prej 3%.

Tabelë 7. Zërat kryesorë të shpenzimeve në miliardë lekë dhe ndaj PBB-së (%).

	Nominale në miliardë lekë							Ndaj PBB%	
	Mesatare '05-'08	2008	T1 '09	T2 '09	T3 '09	T4 '09	2009	2008	2009
Shpenzime totale	282.08	351.5	76.0	102.2	92.1	108.8	379.1	32.3	33.2
Korente	217.3	250.3	57.8	71.8	70.2	83.2	282.9	23.0	24.7
- Personeli	59.0	66.6	14.1	15.5	15.8	16.9	62.4	6.1	5.5
- Interesa	27.0	31.3	8.4	9.0	8.2	10.7	36.3	2.9	3.2
- Operative	25.3	28.8	5.3	8.6	7.2	10.7	31.8	2.7	2.8
- Subvencione	3.4	2.6	0.5	0.7	0.4	0.5	2.0	0.2	0.2
- Sigurimet sociale	65.5	76.2	21.0	23.9	25.7	26.1	96.7	7.0	8.5
- Pushteti lokal	22.8	27.1	5.3	9.8	8.5	9.2	32.8	2.5	2.9
- Ndihma dhe Kompensime	14.0	17.8	3.2	4.2	3.8	7.9	19.1	1.6	1.7
Kapitale	60.0	93.6	18.2	30.4	22.0	25.6	96.1	8.6	8.4
Të tjera*	6.1	7.6	-	0.1	-	-	0.1	0.7	0.0

* Rindërtimi i Gërdëcit + Transferime Kapitale + Huadhënie KESH + Mbështetje për energjinë.
Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet publike, ndonëse janë zgjeruar me ritme rritjeje më të larta



se të ardhurat buxhetore, i kanë ngadalësuar ato sidomos pas tremujorit të parë të vitit. Kjo tendencë shpjegohet me faktin që baza krahasuese (viti 2008) është zgjeruar pikërisht pas tremujorit të parë, si pasojë e rritjes së shpenzimeve kapitale. Shpërndarja e shpenzimeve përgjatë tremujorëve të vitit 2009 ka qenë disi më e njëtrajtshme, duke mos shfaqur përqendrim të lartë vetëm në tremujorin e fundit të vitit. Kjo sjellje përkon me atë të vitit 2005, ku shpenzimet buxhetore kanë arritur pikun në tremujorin e dytë dhe të fundit të vitit⁴⁷.

Shpenzimet publike kanë përmbushur rreth 94% të nivelit të programuar. Shpenzimet korente dhe ato kapitale në fund të vitit 2009 rezultojnë përkatësisht 96 dhe 92% e nivelit të planifikuar në rishikimin më të fundit të buxhetit.

Të shprehura në raport ndaj PBB-së, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 33.2%, ose rreth 1 pikë përqindjeje më të larta se në vitin 2008. Shpenzimet afatshkurta shënuan një nivel prej 24.7% të PBB-së, vlerë kjo rreth 1.7 pikë përqindjeje më e lartë se një vit më parë. Ndërsa shpenzimet kapitale rezultuan rreth 8.4% e PBB-së, nga 8.6% në vitin 2008.

• DEFICITI BUXHETOR DHE FINANCIIMI I TIJ


Natyra ekspansioniste e politikës fiskale është pasqyruar në zgjerimin e konsiderueshëm të deficitit buxhetor, sidomos pas tremujorit të parë të vitit⁴⁸. Deficiti buxhetor në fund të vitit 2009 rezultoi rreth 80 miliardë lekë, duke shënuar një rritje me rreth 33% në terma vjetorë.

Zgjerimi i deficitit buxhetor, i cili vlerësohet në rreth 7% të PBB-së, ka kërkuar përdorim më intensiv të instrumenteve për financimin e tij. Një ndër burimet kryesore në financimin e deficitit, të ardhurat nga privatizimet, kanë financuar rreth 35% të deficitit buxhetor. Privatizimet e ndërmarrjeve me kapital shtetëror, si një nga reformat që plotëson kriterin ekonomik të shprehur në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, janë realizuar në nivel relativisht të lartë krahasuar me vitet paraardhëse. Vlera e tyre paraqitet në rreth 2.4% të PBB-së, ose rreth 28 miliardë lekë⁴⁹.

Krahas instrumenteve të përdorura gjerësisht në financimin e deficitit buxhetor, gjatë vitit 2009 ka gjetur vend dhe një instrument “jotradicional”, ai i kredisë sindikale⁵⁰. Ky zë ka mbuluar në masën 31% deficitin buxhetor të krijuar gjatë vitit 2009.


Rreth 75% e kredisë sindikale është mundësuar nga bankat jorezidente dhe pjesa e mbetur përfaqëson kreditimin e bankave dhe institucioneve rezidente në Shqipëri.

Grafik 32. Shpenzimet dhe zërat kryesorë ndaj PBB-së (%) në boshtin majtas, dhe shpenzimet nominale në miliardë lekë në boshtin djathtas, 1999-2009.



Burimi: Ministria e Financave, Ilogaritje të stafit.

Grafik 33. Balanca buxhetore dhe instrumentet e financimit të tij në raport ndaj PBB-së në boshtin majtas dhe balanca buxhetore në miliardë lekë në boshtin djathtas, 1999-2009.



Burimi: Ministria e Financave, Ilogaritje të stafit.

	2006	2007	2008	2009
Të ardhura	229.4	251.6	291.2	299.2
Shpenzime	258.8	285.7	351.5	379.1
Balanca buxhetore	-29.4	-34.1	-60.3	-79.9
Financimi	29.4	34.1	60.3	79.9
Financim i brendshëm	23.6	28.8	24.4	51.4
Huamarrje e brendshme	20.7	17.0	15.0	18.7
Të ardhurat e privatizimeve	2.0	13.2	5.5	27.6
Të tjera ⁵¹	0.9	-1.5	3.9	-1.1
Kredi sindikale nga rezidentët	0.0	0.0	0.0	6.2
Financim i huaj	5.7	5.3	35.8	28.5
Projektet me burime të huaja	5.7	5.3	35.8	10.1
Kredi sindikale nga jorezidentët	0.0	0.0	0.0	18.4

Burimi: Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Deficiti buxhetor dhe instrumentet e përdorura për financimin e tij në miliardë lekë, 2006-2009.

Huamarrja e brendshme nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë ka financuar deficitin në masën 23%. Deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2009, politika e huamarrjes së qeverisë ishte e orientuar kryesisht drejt zgjatjes së afatit të maturimit të borxhit, për të ndikuar në mënyrë indirekte në reduktimin e riskut të rifinancimit të tij. Për rrjedhojë, instrumentet afatgjata të borxhit (kryesisht obligacionet 5-vjeçare) zinin një pjesë të konsiderueshme të totalit të letrave me vlerë të emetuara deri në fund të kësaj periudhe. Në tremujorin e fundit të vitit 2009, fokusi i Ministrisë së Financave u zhvendos drejt instrumenteve më afatshkurtra, e kryesisht drejt bonove të thesarit 12-mujore. Ndryshimi në kahun e huamarrjes u diktua kryesisht nga preferencat e aktorëve kryesorë në tregun e letrave me vlerë të qeverisë, të cilët kanë shfaqur prirje drejt shkurtimit të horizontit të huadhënies, krahasuar me vitet paraardhëse.


• BORXHI PUBLIK

Në kuadrin e përmirësimit të menaxhimit dhe administrimit të borxhit publik, i shprehur dhe në Strategjinë e Borxhit Publik për periudhën 2009-2011, përpjekjet e Ministrisë së Financave kanë konsistuar në zgjatjen e maturimit të afatit të borxhit të brendshëm dhe përmirësimin e infrastrukturës për emetimin e letrave me vlerë. Kështu, në vitin 2008 fokusi i politikës së huamarrjes ka qenë i orientuar pothuajse gjatë gjithë vitit drejt emetimit të instrumenteve afatgjata të borxhit dhe ditët në maturim për borxhin e brendshëm rezultuan 401 kundrejt 346 ditë një vit më parë. Në fund të vitit 2009, ditët në maturim për borxhin e brendshëm rezultuan 406, një rritje modeste nga një vit më parë, për shkak të zhvillimeve të tremujorit të fundit në tregun primar. Si zhvillime pozitive në përmirësimin e infrastrukturës së tregut të letrave me vlerë mund

të përmendim reduktimin e frekuencës së zhvillimit të ankandeve të letrave me vlerë me maturitet nën një vit, si edhe rritjen e përqindjes së shumës në dispozicion të individëve (nga 30 në 50%).

Niveli i pritur i borxhit total⁵² publik për vitin 2009 vlerësohet rreth 680 miliardë lekë, ose 59.5% e PBB-së. Rreth 61% e stokut të borxhit publik përfaqësohet nga borxhi i brendshëm, dhe pjesa e mbetur i takon stokut të borxhit të jashtëm⁵³. Krahasuar me një vit më parë vërehet një rritje në peshën e borxhit të jashtëm ndaj totalit të borxhit publik, kryesisht si pasojë e kredisë sindikale të akorduar nga bankat dhe institucionet jorezidentë në Shqipëri. Stoku i borxhit të jashtëm në fund të vitit 2009 vlerësohet në rreth 23.1%, ose rreth 5.2 pikë përqindjeje më i lartë se në vitin 2008.

Grafik 34. Borxhi i brendshëm, i jashtëm dhe publik ndaj PBB (%) në boshtin majtas dhe stoku i borxhit publik në miliardë lekë në boshtin djathtas, 2000-2009.



Burimi: Ministria e Financave, llogaritje të stafit.

SHËNIME

¹ Përjashtim nga kjo sjellje bën tremujori i parë, ku norma vjetore e inflacionit ra lehtësisht poshtë kufirit të poshtëm rreth objektivit.

² Inflacioni vjetor rezultoi 4% në terma mesatarë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2008, kryesisht si pasojë e normave të larta të rritjes në çmimet e naftës dhe të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar.

³ Istrefi K., Semi V., (2007). "Përcimi i kursit të këmbimit në Shqipëri: evidencë nga vektorët autoregresivë". Material diskutimi i Bankës së Shqipërisë.

⁴ Ky është një tregues për shkallën e përdorimit të burimeve në ekonomi. Matet si diferencë midis PBB-së aktuale ndaj asaj potenciale.

⁵ Për më tepër vijon analiza e kërkesës agregate.

⁶ Matur si devijim standard për periudhën 2000-2009.

⁷ Mesatarja e dy matjeve (me përjashtim të përhershëm dhe me mesatare të reduktuar). Për informacion më të detajuar shihni: Çeliku dhe Hoxholli (2008), "Matje të tjera të inflacionit bazë: përdorimi i tyre në parashikim dhe analizë", Material diskutimi, Nr. 1(24) 2008, Banka e Shqipërisë.

⁸ Vlerë e përafërt me atë të mesatares së këtij treguesi për periudhën 2002-2009 (1.2%).

⁹ Përafëruar nga një tregues i llogaritur si mesatare e ponderuar e indeksit të çmimeve të konsumit në Itali dhe Greqi.

¹⁰ Në mungesë të matjeve direkte, inflacioni i importuar llogaritet si një indeks i derivuar nga produkti i indeksit të çmimeve të huaja me kursin e këmbimit euro/lekë me tre muaj kohëvonesë. Ky indeks ka vlerën e një treguesi teorik përsa kohë që nuk është produkt i matjeve reale.

¹¹ Referojuni Istrefi dhe Semi (2007); Tanku, Vika dhe Gjermani (2007).

¹² Përjashtuar 'bujqësia', sepse nuk mbulohet nga indekset e statistikave afatshkurtra (SASH) (INSTAT).

¹³ Inflacioni vjetor mesatar në dhjetë vitet e fundit ka qenë 2.7%.

¹⁴ Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 2001-2007 janë të INSTAT-it. Për pjesën tjetër, të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë. Rritja reale e PBB-së për vitin 2009 i përket nëntëmujorit të parë të vitit.

¹⁵ Tabela është ndërtuar duke u bazuar në PBB-në nominale të rishikuar.

¹⁶ PBB-ja nominale, e konvertuar me kursin mesatar të periudhës.

¹⁷ Të dhënat e të punësuarve dhe normës së papunësisë 2009 i përkasin tremujorit të tretë (fund periudhe), INSTAT.

¹⁸ Në mungesë të të dhënave të publikuara për vitin 2009, i jemi referuar të dhënave për treguesit fiskalë në Kuadrin Makroekonomik Fiskal 2011-2013 të miratuar me vendim të KM në datë 07.01.2010.

¹⁹ Borxhi qeveritar duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria. Për konvertimin e stokut të borxhit të jashtëm në lekë është përdorur kursi i këmbimit i fundit të vitit.

²⁰ Norma e rritjes së PBB-së për T3:2009, vlerë e publikimit të INSTAT, "Produkti i Brendshëm Bruto Tremujor", Publikimi i tremujorit të tretë për vitin 2009, dhjetor 2009. Normat e rritjes së PBB-së për T1:2009 dhe T2:2009, mund të jenë objekt rishikimi prej INSTAT.

²¹ Treguesi i Tendencës Ekonomike, i derivuar nga vërtetimet e besimit ra me 5.1 pikë përqindjeje në tremujorin e katërt.

²² E ka bërë më të shtrenjtë shlyerjen e kësteve të kredisë konsumatore, e cila në pjesën më të madhe është kredi dhënë në monedhë të huaj, duke lënë më pak fonde për konsum nga buxheti i kufizuar familjar.

²³ Struktura e sektorit të jashtëm është e orientuar drejt importeve dhe këto zënë një vëllim të madh në shkëmbimet tregtare.

²⁴ Në sektorin prodhues përfshihen dega e industrisë, e ndërtimit dhe ajo e energjetikës.

²⁵ Mesatarja e ndryshimeve vjetore të tre tremujorëve të parë të secilit vit, në përqindje.

²⁶ Çmimet e banesave llogariten vetëm për qytetin e Tiranës dhe në zonën qendrore të tij.

²⁷ Vlerësimi i prodhimit bujqësor me çmimet e vitit 2006. Vlera e prodhimit bujqësor për vitin 2010 është parashikim.

²⁸ Në këtë nëndegë përfshihen: aktivitetet financiare, pasuritë e paluajtshme, dhënia me qira, administrimi dhe mbrojtja publike, sigurimi shoqëror i detyrueshëm, edukimi, shëndetësia, aktivitetet të tjera shoqërore dhe individuale.

²⁹ Mesatarja e ndryshimeve vjetore të tre tremujorëve të parë të parë të secilit vit, si për vlerën e shtuar ashtu edhe për shifrën e afarizmit në vëllim.

³⁰ Numri i të punësuarve, marrë nga Konjuktura INSTAT, 2009.

³¹ Bazuar në të dhënat e Statistikave Afatshkurtra, INSTAT, treguesi i të punësuarve me pagesë.

³² Gjatë vitit 2008 u morën masa administrative për formalizimin e tregut të punës që u reflektua në normat e larta të rritjes së punësimit gjatë kësaj periudhe. Vlerësohet se ecuria e këtij treguesi në sektorin e ndërtimit është ndikuar dhe nga punësimi sezonal si pasojë e ndërtimeve inxhinierike me fonde publike gjatë vitit 2008.

³³ Oferta për punë vlerësohet të mos ketë ndryshuar shumë, duke qenë se numri i personave që kërkojnë punë është rritur vetëm me 0.9% dhe nuk ka ndryshime të forta strukturore në popullsi. Ndërkohë që kërkesa për punë – sipas rezultateve të vrojtimeve - ka rënë në kushtet e ngadalësimit ekonomik.

³⁴ Treguesi i pagës në ekonomi, referuar edhe nën termin “pagë mesatare”, është llogaritur si raport i indeksit të fondit të pagave me indeksin e numrit të punonjësve, burimi i të cilave është publikimi “Statistikat afatshkurtra” të INSTAT, ku përjashtohet “Bujqësia”. Frekuenca e të dhënave është tremujore.

³⁵ Paga reale përfaqëson pagën mesatare të deflatuar me inflacionin, e cila llogaritet si raport i indeksit të pagës mesatare në ekonomi me indeksin e inflacionit. Frekuenca e të dhënave është tremujore.

³⁶ Buxhetor dhe jobuxhetor.

³⁷ Pesha e kombinuar e shpenzimeve korente për mallra e shërbime ishte 90% ndaj totalit të shpenzimeve, ndërsa pesha e kombinuar e të ardhurave korente prej shërbimeve e transfertave korente mbulonte rreth 73% të totalit.

³⁸ Eksportet drejt Greqisë e Italisë vlerësohen në rreth 70% të totalit për vitin 2009.

³⁹ Importet e kategorisë “Mallra të ndërmjetëm” zinin rreth 57% të totalit të importeve.

⁴⁰ Në vitin 2004, pesha e importeve të kategorisë “Mallra për konsum” ishte 37.4%, ndërsa në vitin 2009 ajo ishte 27.6%.

⁴¹ Kjo vlerë ishte 890 milionë euro gjatë vitit 2009, ndërsa një vit më parë vlerësohej në 970 milionë euro.

⁴² Në vitin 2004, dërgesat e emigrantëve financonin rreth 61% të deficitit tregtar, ndërsa në vitin 2009 ato financonin vetëm 33% të këtij deficiti.

⁴³ Ndryshimet ndaj ligjit për akcizat u miratuan nga Kuvendi në datë 28.09.2009, dhe krahas rritjes së shkallës tatimore për disa artikuj subjekt akcize (kryesisht duhani), konsistuan dhe në shtimin e gamës së mallrave subjekt akcize me grupin e “Lamba Inkadeshente” (jo i përfshirë deri në 2009).

⁴⁴ Të ardhurat nga TVSH-ja janë zëri më i madh (35%) në totalin e të ardhurave.

⁴⁵ Rishikimit sipas aktit normativ.

⁴⁶ Kontributi i këtyre zërave sipas përkatësisë ka qenë me 3, 3 dhe 2 pikë përqindjeje.

⁴⁷ Në periudhën 2006-2008, raporti i shpenzimeve të realizuara gjatë T1, T2, T3 dhe T4 ndaj totalit vjetor përfaqësohej mesatarisht me nivelet e 16%, 21%, 23% dhe 40%. Të njëjtat raporte të ndërtuara për vitin 2009 paraqiten 20%, 27%, 24% dhe 29%, respektivisht për çdo tremujor ndaj totalit të realizuar për vitin 2009.

⁴⁸ Rritja e shpenzimeve me ritme më të larta se të ardhurat buxhetore përgjatë vitit, kanë kontribuar në zgjerimin e konsiderueshëm të deficitit buxhetor, sidomos pas T1 2009.

⁴⁹ Kjo shumë përfshin të ardhurat nga privatizimi i OSSH-së, një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i Armo-s, të ardhurat nga licenca e telefonisë së katërt celulare, të ardhurat nga shitja e një pjese të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë dhe një pjesë të aksioneve nga telefonia celulare AMC.

⁵⁰ Kredia sindikale është një formë huaje e marrë nga një grup bankash dhe institucionesh financiarë rezidentë dhe jorezidentë në Republikën e Shqipërisë, për të financuar deficitin buxhetor.

⁵¹ Zëri “Të tjera” përfaqëson shumën e gjendjes së Depozitës së qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë, Depozitës së Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, Mjetet në ruajtje si edhe principalin e nënhuasë.

⁵² Në mungesë të të dhënave të publikuara i jemi referuar të dhënave për treguesit fiskalë në Kuadrin Makroekonomik Fiskal 2011-2013 të miratuar me vendim të KM në datë 07.01.2010.

⁵³ Në vitin 2008, stoku i borxhit të brendshëm zinte rreth 67% të totalit të borxhit publik.


1 lek. Monedhë nikeli, emetim i vitit 1930.



KAPITULLI III. ZHVILLIMET MONETARE DHE ECURIA E TREGJEVE FINANCIARE


III.1. ZHVILLIMET MONETARE

Aktiviteti i ndërmjetësimit financiar në ekonomi është ndikuar nga tkurrja e burimeve financiare gjatë vitit 2009. Tërheqja e depozitave gjatë tremujorit të parë të vitit rezultoi në uljen e stokut të depozitave të sistemit bankar, duke ngadalësuar zgjerimin e masës monetare në ekonomi. Efekti statistikor i rënies së depozitave u pasqyrua në një normë vjetore më të ulët të ofertës monetare, si rezultat i mospërfshirjes së parasë në valutë jashtë sistemit bankar në paranë e gjerë M3, në një interval kohor prej dymbëdhjetë muajsh. Efekti ekonomik i tkurrjes së depozitave u materializua në formën e ngadalësimit të ritmit të kredithënies ndaj sektorit privat të ekonomisë në veçanti gjatë pjesës së parë të vitit 2009. Në pjesën e dytë të vitit tkurrja e ndërmjetësimit financiar u shoqërua edhe nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik dhe nga një kërkesë më e ulët për para në ekonomi, duke përforcuar më tej kontraktimin e ritmeve të rritjes së aktivitetit kreditues. Ky proces i efekteve zinxhir të tkurrjes së masës monetare rezultoi në ngadalësimin e ritmit të rritjes së ofertës së parasë në mesatarisht 6.0% në vitin 2009, kundrejt normës mesatare prej 12.3% gjatë vitit 2008. Në mungesë të efektit të kursit të këmbimit në stokun e depozitave në valutë, masa monetare është zgjeruar me rreth 3%.



Ritmi pozitiv i rritjes së M3 është ndihmuar në sajë të flukseve pozitive të bilancit të pagesave, kundrejt kërkesës në rënie për mjete të brendshme monetare në ekonomi. Ngadalësimi i kreditimit të sektorit privat në valutë i mundësoi sistemit bankar akumulimin e mjeteve valutore të lira, kundrejt një uljeje të këtij stoku në vitin 2008. Gjatë vitit 2009, vetëm 2 pikë përqindjeje


të zgjerimit të masës monetare u materializua si rezultat i aktivitetit kreditues ndaj sektorit privat, kundrejt ritmit të lartë prej mbi 10 pikësh përqindjeje të krijimit të parasë të vërejtur në vitet e mëparshme. Nga ana tjetër, huamarrja e brendshme e sektorit publik ka kontribuar në mënyrë gati të njëtrajtshme gjatë viteve të fundit me rreth 2-3 pikë përqindjeje në terma të M3.



Agreatatët më të ngushtë të parasë kanë pasqyruar rritjen e përbërësit likuid të parasë dhe qëndrueshmërinë e kërkesës për para në lekë. Krijimi i parasë në lekë është bazuar në huamarrjen e brendshme të sektorit fiskal dhe kreditimin në lekë të sektorit privat. Norma mesatare vjetore e rritjes së M2 gjatë viteve të fundit është luhatur në intervalin 8-10%. Për vitin 2009, norma mesatare vjetore llogaritet në 8.7%. Agreatatët likuidë të parasë, M1 dhe baza monetare, mbartin efektet e daljes së parasë jashtë sistemit bankar në sajë të tërheqjes së depozitave.

Tkurrrja e depozitave është neutralizuar nga rritja e financimit të aktiveve në lekë të bankave të nivelit të dytë nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet injektimit të likuiditetit në sistem. Detyrimet monetare të bankave në formën e depozitave, pësuan rënie në 55% të PBB-së në muajin mars 2009, kundrejt nivelit maksimal prej 63% në muajin shtator 2008. Ulja e stokut të depozitave u shoqërua me uljen e ritmeve të kreditimit, ndërkohë që prania e Bankës së Shqipërisë me anë të operacioneve rrefinancuese nxiti ruajtjen e stokut të aktiveve financiare të bankave në nivele më të larta sesa stoku i depozitave. Ulja me 1.00 pikë përqindjeje e kostos së rrefinancimit gjatë vitit 2009, ka mundësuar lehtësimin e barrës financiare të aktivitetit ndërmjetësues të sistemit. Gjithashtu, krahas uljes së normës bazë, lehtësimi i formës së rrefinancimit me shumë të pakufizuar ka mundësuar parandalimin e tkurrjes së stokut të kredisë në lekë për sektorin privat dhe rrjedhimisht, të totalit të aktiveve monetare të sistemit bankar. Në gjysmën e dytë të vitit 2009, totali i aktiveve monetare neto të bankave të nivelit të dytë u zgjerua deri në 66% të PBB-së si rezultat i rritjes së kredisë së brendshme për sektorin publik dhe ecurisë pozitive të kredisë në lekë për sektorin privat.

Zhvillimet afatshkurtra në strukturën e parasë tregojnë zhvendosjen e strukturës kohore të saj drejt përbërësit më likuid, parasë jashtë bankave, si rezultat i mbajtjes së një pjese të depozitave të tërhequra jashtë sistemit. Stoku i depozitave totale rezulton në nivelin 76% të agregatit M3 në dhjetor 2009, kundrejt nivelit 81% të shënuar në shtator të vitit 2008.



Hapësirë informuese 2: Shumëzuesi i parasë dhe implikimet për politikën monetare

Oferta e parasë në një ekonomi përkufizohet si shuma e parasë jashtë bankave dhe depozitave të sistemit bankar. Sistemi bankar kryen funksionin e akumulimit të depozitave dhe shumëfishimit të parasë së krijuar nëpërmjet kredidhënies². Shumëzuesi i parasë njihet gjerësisht si matësi i sasisë së parasë së krijuar nga një njësi e rezervës monetare (RM). Rezerva (baza) monetare, është detyrimi kryesor i autoritetit monetar dhe përfshin paratë të emetuar, e cila mbahet nga bankat në arkën e tyre dhe jashtë bankave si para në qarkullim, si edhe depozitat e bankave dhe jobankave në bankën qendrore. Banka qendrore kontrollon ofertën e parasë në ekonomi duke kontrolluar sasinë e injektuar të likuiditetit dhe duke caktuar normën e detyrueshme të rezervës për çdo njësi depozite në sistemin bankar.

Shumëzuesi i parasë përbën një rëndësi të veçantë për politikën monetare. Teorikisht, shumëzuesi i parasë tregon se nëpërmjet shfrytëzimit të ndërmjetësimit bankar, oferta monetare zgjerohet me një shumëfish të bazës monetare. Ecuria e shumëzuesit të parasë është subjekt i sjelljes së bankës qendrore nëpërmjet vendimeve të saj për injektimin e likuiditetit, përcaktimit të normës së rezervës së detyrueshme dhe përcaktimit të normës bazë të interesit. Gjithashtu, ai ndikohet nga sjellja e bankave para depozituese, vendimet e tyre për sasinë e kreditimit të ekonomisë dhe likuiditetin e mbajtur si rezervë të tepërt, si dhe nga sjellja e agjentëve ekonomikë, individë dhe biznese, nëpërmjet kërkesës së tyre për kredi dhe për para jashtë bankave. Nëse kërkesa për kredi nga agjentët ekonomikë është e lartë dhe bankat vendosin të japin në formë kredie maksimumin e lejueshëm të fondeve që ato kanë, oferta e parasë përafron me prodhimin e parasë së emetuar nga banka qendrore dhe shumëzuesit të parasë (duke supozuar mbajtje minimale të parasë në formë cash). Në këtë rast,

shumëzuesi i parasë shërben si një lidhje e fortë midis bazës dhe ofertës monetare. Në një situatë tjetër, kur bankat vendosin të akumulojnë rezerva të tepërta në vend të shfrytëzimit të plotë të fondeve për dhënie kredie dhe/ose publiku jobankar rrit kërkesën për cash, krijimi i parasë nga banka qendrore nuk përkthehet plotësisht në krijim të parasë nga ndërmjetësuesit bankarë, duke dobësuar kështu lidhjen midis bazës dhe ofertës monetare. Pra, shumëzuesi i parasë nuk është konstant në kohë dhe çdo injektim fillestar likuiditeti nga Banka e Shqipërisë në sistemin bankar ndikon ofertën monetare në harqe kohore të ndryshme në varësi të ecurisë së faktorëve të lartpërmendur.

SHUMËZUESI I PARASË NË RASTIN E SHQIPËRISË: ANALIZË KRAHASUESE ME VENDET E RAJONIT

Shumëzuesi i parasë në Shqipëri në periudhën 2002-2006 është luhatur rreth vlerës 3, vlerë kjo relativisht më e ulët krahasuar me ato të vendeve të rajonit. Pas vitit 2006 është vënë re një rritje graduale e saj, kryesisht si pasojë e krijimit më të shpejtë të parasë në ekonomi në sajë të normës së lartë të ndërmjetësimit bankar, ndërsa në fund të vitit 2008 dhe në vazhdim shumëzuesi i parasë ka shfaqur një tendencë rënëse.

Në përgjithësi, kërkesa e lartë për mjete monetare likuide është karakteristikë e vendeve me një sistem bankar dhe financiar më pak të zhvilluar. Në këto vende individët dhe agjentët e tjerë jobankarë të ekonomisë preferojnë të mbajnë sasi të konsiderueshme parash në cash dhe ndërmjetësimi bankar është më i ulët. Ndërsa një normë e lartë e rezervës së detyrueshme nga banka qendrore detyron bankat të mbajnë një nivel më të lartë rezervash për të njëjtin nivel depozitash, duke zvogëluar kështu aftësinë e sistemit bankar për të krijuar para. Kombinimi i këtyre faktorëve ndikon në rënien e shumëzuesit të parasë dhe ngadalësimin e ofertës monetare.

Tabelë 1. Shumëzuesi i parasë dhe pesha e parasë jashtë bankave ndaj M3 për disa vendet e rajonit.

	Shumëzuesi i parasë					Paraja jashtë bankave/M3					Norma e rezervës së detyrueshme
	2005	2006	2007	2008	2009	2005	2006	2007	2008	2009	
Shqipëria	3.0	3.0	3.3	3.5	3.0	25.3	23.9	21.6	19.8	24.5	10
Maqedonia	4.1	4	4.3	4.3	4.2	27.7	24.9	21.6	18.7	16.7	10-13
Hungaria	5.0	4.9	5.5	4.7	5.2	14	14.2	14.2	14.1	13.2	6
Kroacia	4.1	4.1	4.1	4.3	4.1	9.4	9.4	9.2	9.0	5.9	14
Polonia	5.7	5.7	5.5	5.5	5.6	14.5	14.9	15	14.8	14.5	3
Serbia	-	4.6	5.6	3.1	4.3	-	12.1	8.7	9.3	7.6	10-45


Burimi: Banka e Shqipërisë, bankat qendrore të vendeve të rajonit.

Siç mund të vërehet nga tabela, vendet që kanë vlera më të larta të shumëzuesit të parasë, shoqërohen me norma më të ulëta të treguesit të parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, si edhe me norma më të ulëta të rezervës së detyrueshme. Kështu, krahas Shqipërisë, vlera të ulëta të shumëzuesit të parasë rezultojnë edhe për Kroacinë e Maqedoninë. Në rastin e Kroacisë, pavarësisht mbajtjes nën kontroll të parasë cash jashtë bankave, norma më e lartë e rezervës së detyruar mund të ketë ndikuar në vlera krahasimisht të ulëta të shumëzuesit të parasë. Në rastin e Polonisë dhe Hungarisë, shumëzuesi i parasë rezulton më i lartë, duke reflektuar rrjedhimisht norma më të ulëta të rezervës së detyrueshme dhe parasë jashtë bankave.

IMPLIKIMET E RËNIES SË SHUMËZUESIT TË PARASË PËR POLITIKËN MONETARE

Ecuria e shumëzuesit të parasë gjatë vitit 2009 është prekur kryesisht nga ngadalësimi i kreditimit të ekonomisë si pasojë e reflektimit të efekteve të krizës globale në ekonominë shqiptare. Lëkundjet e besimit në sistemin bankar u manifestuan me rritjen e preferencës për likuiditet të ekonomisë, e cila rrjedhimisht ka rritur bazën monetare dhe është shoqëruar me uljen e vlerës së shumëzuesit të parasë. Zvogëlimi i shumëzuesit të parasë në mesatarisht 3 gjatë këtij viti ka ndikuar në uljen e efektivitetit të politikës monetare dhe ngadalësimin e përcimit të vendimeve të saj. Rënia e shumëzuesit të parasë është shoqëruar edhe me ngadalësim të aktivitetit ekonomik. Në këto kushte, banka qendrore ka ndjekur një politikë akomoduese duke plotësuar nevojat për likuiditet të sistemit me anë të instrumenteve të saj të tregut. Një pjesë e konsiderueshme e tij është përdorur për financimin e sektorit privat në monedhë vendase, ndërsa një pjesë është mbajtur nga ekonomia në formën e parasë cash. Megjithatë, shumëzuesi i parasë ka shfaqur shenja përmirësimi në fund të vitit 2009. Kthimi i tij në vlera normale do të kërkojë kthimin e operacioneve injektuese të këtij likuiditeti në vlera më të ulëta me qëllim tërheqjen e një pjese të likuiditetit nga sistemi bankar.


Grafik 4. Ecuria e shumëzuesit të parasë dhe likuiditetit në sistemin bankar.



• **KOMPONENTI NË LEKË I AGREGATIT M3**

Kushtet e likuiditetit në sistemin financiar janë dominuar nga ecuria e stokut të parasë jashtë sistemit bankar, në terma të agregatit në lekë të parasë, M2. Megjithatë, tendenca afatgjatë është ndikuar nga rritja e aktivitetit të ndërmjetësimit në lekë e bankave dhe normat reale pozitive të interesave, gjatë vitit 2009. Në fund të periudhës, stoku i parasë jashtë bankave rezulton vetëm 7% më i lartë kundrejt vitit 2008, ndërsa multiplikatori në lekë³ ka pësuar përmirësim të lehtë në gjysmën e dytë të vitit.

Grafik 5. Ecuria e multiplikatorit në lekë dhe ndryshimi vjetor i parasë jashtë bankave.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Stoku i depozitave në lekë ka shënuar një rritje vjetore prej 2.8% në fund të vitit 2009. Në vlerë absolute, stoku i depozitave prej 369 miliardë lekësh është në të njëjtin nivel me atë të vërejtur para tërheqjes së depozitave nga sistemi, në muajin shtator 2008.

Ndër instrumentet kryesore të depozitës, goditja kryesore e tërheqjeve pasqyrohet tek ulja e peshës së depozitave me afat të individëve, me rreth 7.5 pikë përqindjeje në fund të vitit 2008. Gjatë vitit 2009, ndonëse stoku i depozitave në nivel pësoi rënie të lehtë në tremujorin e parë, raporti i tij ndaj agregatit M2 njohu rikuperim gradual deri në 48.4% në pjesën e dytë të vitit.

Grafik 6. Raporti i depozitave në lekë ndaj M2 (majtas) dhe kontributi i secilit grup në rritjen vjetore të depozitave në lekë (në %, djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

• **KOMPONENTI NË VALUTË I AGREGATIT M3**

Krijimi i mjeteve valutore ka manifestuar ngadalësim si rezultat i tërheqjes së depozitave nga sistemi dhe kreditimit të ulët në monedhë të huaj. Në

periudhën afatmesme, krijimi i flukseve të parasë në valutë tenton të preket edhe nga ngadalësimi i prurjeve valutore nga remitancat. Kështu, ritmi vjetor i rritjes së depozitave në valutë rezultoi 2.8%, ndërsa pesha e tyre ndaj agregatit M3 pësoi rënie në 33.7% kundrejt 36.3% në muajin shtator të vitit 2008 dhe 32% në fund të këtij viti⁴.

Grafik 7. Raporti i depozitave në valutë ndaj depozitave total (majtas) dhe kontributi i secilit grup në rritjen vjetore të depozitave në valutë (djathtas).




Hapësirë informuese 3: Ekspozimi i agjentëve ekonomikë ndaj kursit të këmbimit.

Në këtë hapësirë informuese jemi përpjekur të analizojmë strukturën e bilanceve të bizneseve dhe të individëve, veçanërisht në aspektin e përbërjes valutore. Me qëllim studimin e sjelljes së tyre në një këndvështrim makro supozojmë një bilanc të agreguar me aktivet dhe pasivet financiare të bizneseve dhe të individëve.

Nga një vështrim i përgjithshëm i bilancit të agreguar të bizneseve, bie në sy fakti se ai karakterizohet nga një gap financiar negativ, i cili nënkupton vlerën më të ulët të aktiveve përkundrejt pasiveve financiare. Detyrimet e larta të bizneseve ndaj sistemit bankar në formën e kredive dëshmojnë për iniciativat e tyre investuese dhe sjelljen e tyre të orientuar drejt riskut. Ndërsa e kundërta ndodh me individët, bilanci i të cilëve karakterizohet nga një gap financiar pozitiv. Aktivitetet financiare të individëve në tërësi, të cilat përfaqësohen kryesisht nga depozitat e individëve në sistemin bankar, i tejkalojnë detyrimet e tyre. Bilanci pozitiv i individëve nënkupton kështu sjelljen e tyre të orientuar drejt kursimeve dhe më pak drejt formave të tjera të investimit që mbartin norma të larta rreziku.


Një analizë më e detajuar e bilanceve në bazë të strukturës valutore konfirmon të njëjtën sjellje të gap-it financiar në monedhë të huaj. Shkalla relativisht e lartë e euroizimit të ekonomisë reflektohet edhe në bilancet e agjentëve ekonomikë, një pjesë e konsiderueshme e aktiveve dhe detyrimeve financiare, si dhe e transaksioneve që ata kryejnë, realizohet në monedhë të huaj⁵. Vërehet një normë veçanërisht e lartë euroizimi në kahun e aktivitetit, më e spikatur kjo për individët.

Grafik 8. Totali i kredisë dhe depozitave të agjentëve ekonomikë në sistemin bankar (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 9. Aktivitet dhe pasivitet financiar të agreguara të bizneseve dhe individëve në valutë të shprehura në milionë euro⁶.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndër shkaqet kryesore iniciatore të eurozimit, në literaturë përmenden motivet paraprirëse mbrojtëse ndaj normave të larta të inflacionit apo luhatjeve në kursin e këmbimit. Stabilizimi i këtyre faktorëve përgjithësisht nuk shoqërohet me proces të kundërt de-euroizues. Kështu, për rastin e Shqipërisë, përveç faktorëve psikologjikë që veprojnë në vazhdimësi, në krahun e aktivitet të bilancit, euroizimi favorizohet kryesisht nga hyrjet valutore në formën e remitancave, investimet e huaja direkte apo linjat e kredisë bankare. Megjithatë, për shkak të normave të larta të interesit në lekë, një pjesë e konsiderueshme e depozitave të individëve mbahen në monedhë vendase. Në krahun e pasivitet, faktorët favorizues të kërkesës së lartë të bizneseve për kredi në valutë janë normat më të ulëta të referencës për interesat në valutë kundrejt monedhës vendase dhe burimi i të ardhurave në valutë. Ndërkohë vërehet një sjellje më e kujdesshme e individëve ndaj përbërjes valutore të portofolit të tyre. Krahas normave të interesit, kuotimi në valutë i çmimeve të disa mallrave dhe në veçanti i pasurive të patundshme janë faktorë nxitës të kërkesës për kredi në valutë për individët.

Aktivitet dhe pasivitet financiar në valutë, dhe rrjedhimisht gap-i financiar në valutë mbartin një sërë implikimesh financiare dhe makroekonomike. Një ndër rreziqet kryesore është ekspozimi i tyre ndaj luhatjeve në kursin e këmbimit. Agjentët ekonomikë përballen me rreziqe operationale në rastet e mospërputhshmërisë së monedhave në bilanc dhe të flukseve monetare të veprimtarisë së tyre. Kështu, luhatjet në kursin e këmbimit reflektohen në vlerën totale të bilanceve të agjentëve ekonomikë. Gjithashtu, ndryshimet në kurs përçohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në pasurinë financiare, pasi detyrimet e larta në valutë në formën e kredisë ndikojnë në pagesat e kësteve mujore apo detyrimeve të tjera. Agjentët ekonomikë bilanci i të cilëve shënon një gap financiar pozitiv, në këtë rast individët, mund të përfitojnë nga lëvizjet nënçmuese të kursit të këmbimit, pasi aktivitet e tyre pësojnë një rritje të vlerës nominale të konvertuar në lekë. Ndërsa agjentët ekonomikë që karakterizohen

nga një gap financiar negativ, në këtë rast bizneset në rolin e huamarrësit masiv, me nënçmimin e kursit të këmbimit mund të pësojnë humbje të konsiderueshme në varësi të shkallës së ekspozimit që kanë ndaj kursit. Megjithëse vlerësimi dhe monitorimi i rreziqeve nga kursi i këmbimit nuk është një proces i lehtë, ai është i rëndësishëm për mbrojtjen e agjentëve ekonomikë, kryesisht bizneseve, nga luhatjet të cilat mund të çenojnë marzhin e tyre të fitimit dhe vlerën e aktiveve në tërësi.


Kreditimi në monedhë të huaj mbart implikime edhe për sistemin financiar në përgjithësi. Ky i fundit, i përfaqësuar kryesisht nga bankat tregtare, edhe në rastet e financimit të kredive në bazë të principeve të përputhshmërisë së monedhës dhe maturitetit, është sërish i ekspozuar ndaj disa rreziqeve. Ndër më kryesorët është rreziku indirekt nga transaksionet në monedhë të huaj, i cili në rastet e një default-i të pagesave të kredisë nga huamarrësit kryesorë të kësaj monedhe⁷, prek drejtpërdrejt shëndetin e sistemit bankar. Ndryshimet në kursin e këmbimit ndikojnë gjithashtu në vlerën e bilanceve të bankave. Ndërkohë bizneset, të tërhequr nga

normat e ulëta të interesit në monedhë të huaj duket se nuk faktorizojnë sa duhet rrezikun nga kursi i këmbimit. Nga sa më sipër, është e rëndësishme që në kuadrin e ruajtjes së stabilitetit makrofinanciar të tregjeve në veçanti dhe të ekonomisë në tërësi, agjentët ekonomikë të vlerësojnë rreziqet dhe kostot që mbarten nga prania e monedhës së huaj në aktivet dhe pasivet e balanceve të tyre dhe të ndërmarrin masat përkatëse mbrojtëse.

• **KREDIA PËR SEKTORIN PRIVAT**


Huamarrja e sektorit privat gjatë vitit 2009 u diktua nga një sjellje konservatore e bankave në kredidhënie dhe nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik. Ndikimi i këtyre faktorëve nuk ka qenë i njëtrajtshëm përgjatë këtij viti. Në muajt e parë, bankat shtrënguan ndjeshëm kushtet e kredidhënies, fillimisht në përgjigje të një situatë të vështirë dhe të pasigurt likuiditeti, shkaktuar nga tërheqja e depozitave dhe paniku në tregjet ndërkombëtare financiare në fundin e vitit 2008. Në të njëjtën kohë, sjellja gjithnjë e më konservatore e bankave reflektoi edhe shqetësimin për rënien e vazhdueshme në cilësinë e portofolit të kredisë. Kushtet mbetën të shtrënguara edhe në muajt që pasuan, ndonëse me ritëm gjithnjë e më të ulët. Në gjysmën e dytë të vitit, standardet e shtrënguara të kredidhënies dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik kanë ndikuar në uljen e kërkesës për kredi.

Grafik 10. Rritja vjetore (majtas) dhe raporti ndaj PBB-së(djathtas) i kredisë për sektorin privat.



Në këto kushte, kredia për sektorin privat ndoqi një trend të njëtrajtshëm ngadalësimi përgjatë vitit 2009. Norma e rritjes vjetore në fund të vitit shënoi 12%, kundrejt vlerës 33% të shënuar një vit më parë. E pastruar nga efekti i nënçmimit të lekut, i cili ka qenë i pranishëm gjatë gjithë vitit, rritja vjetore e kredisë në fund të vitit 2009 ishte vetëm 4%⁸. Raporti i portofolit të kredisë për sektorin privat ndaj PBB-së u rrit me 2.2 pikë përqindjeje, duke arritur në 37.4%.


Ritmet gjithnjë e më të ulëta të kreditimit gjatë vitit 2009 janë udhëhequr nga ngadalësimi i shpejtë i kredisë në valutë, e më pas tkurrja e saj në pesë muajt e fundit. Në fund të vitit 2009, portofoli i kësaj kredie ishte 3 pikë përqindjeje më i ulët se një vit më parë. Ndërkohë, zgjerimi i kredisë në lekë ka ruajtur nivelet mesatare të tre viteve të mëparshëm. Portofoli i kredisë në lekë është rritur mesatarisht me 27% gjatë vitit 2009, duke shfaqur gjithsesi shenja ngadalësimi në muajt e fundit të vitit. Portofoli i kredisë në lekë përbën rreth 34% të kredisë për sektorin privat ose 5 pikë përqindjeje më tepër krahasuar me një vit më parë. Përveç vështirësive të likuiditetit në monedhën evropiane⁹, zhvillimet në kredi janë diktuar edhe nga politikat diferencuese të vetë bankave mes monedhave të ndryshme. Ato janë treguar më të kujdesshme në dhënien e kredisë në monedhë të huaj në krahasim me kredinë në lekë, duke faktorizuar më shumë rrezikun indirekt të kursit të këmbimit në cilësinë e portofolit të kredisë. Gjithashtu, nënçmimi i ndjeshëm i lekut gjatë vitit dhe luhatshmëria e lartë e kursit të këmbimit ka rritur ndërgjegjësimin e klientëve për implikimet e huamarrjes në valutë të huaj duke ndikuar kërkesën për kredinë në valutë.



Zhvillimet në portofolin e kredisë për biznese gjatë vitit 2009 shënuan një ngadalësim të dukshëm të normës të rritjes vjetore në mesatarisht 15%, krahasuar me normën mesatare prej 43% për vitin 2008. Si kredia për investime, ashtu edhe ajo për qëllime likuiditeti janë ngadalësuar ndjeshëm përgjatë gjithë vitit. Gjatë vitit 2009, zhvillimet në këtë portofol u dominuan nga kredia për financimin e likuiditetit afatshkurtër, e dhënë kryesisht në lekë. Norma vjetore e rritjes për këtë portofol ra në 10% në fund të vitit, nga 40% në fillim të tij. Ndërkohë, norma e rritjes vjetore të kredisë për investime arriti në 3% në fund të vitit, nga 30% që shënonte një vit më parë.

Kreditimi me ritme të ngadalta i bizneseve u ndje në të gjithë sektorët e ekonomisë. Veçanërisht, kredia për sektorin e ndërtimit u ngadalësua me ritme më të shpejta, duke shënuar rënie në terma vjetorë që nga muaji shtator.

Grafik 12. Rritja vjetore (në %, majtas) dhe fluksi tremujor neto (miliardë lekë, djathtas) i kredisë për biznese sipas qëllimit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë, sektori i vetëm që ka ruajtur ritmet e mëparshme të kreditimit është ai i telekomunikacionit dhe transportit. Në fund të vitit 2009, sektorët më të kredituar të ekonomisë janë tregtia¹⁰ (38%), ndërtimi (20%) dhe industria (24%).

Frenimi i kreditimit të ekonomisë ishte edhe më i ndjeshëm në kredinë për individë, e cila në fund të vitit 2009 u zvogëlua me rreth 2 pikë përqindjeje në krahasim me një vit më parë. Bankat kanë filluar të shtrëngojnë kushtet e kredisë për individë, veçanërisht të asaj për konsum, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2008, në përgjigje të rritjes së nivelit të borxhit të këtyre të fundit dhe të rritjes së kredive me probleme. Këta dy faktorë, të shoqëruar edhe me vështirësitë për gjetjen e likuiditetit kanë ndikuar në mbajtjen e shtrënguar të kushteve të kreditimit për individë edhe përgjatë vitit 2009. Në dhjetor të vitit 2009, kredia për konsum, e cila filloi të tkurret që në muajt e parë të këtij viti, ishte 12 pikë përqindjeje më e vogël se një vit më parë. Pas një zgjerimi

Grafik 13. Rritja vjetore (në %, majtas) dhe fluksi tremujor neto (në miliardë lekë, djathtas) i kredisë për individë sipas qëllimit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

modest në muajt e parë të vitit, edhe portofoli i kredisë hipotekare filloi të zvogëlohet gjatë gjashtëmuorit të dytë. Në fund të vitit, kjo kredi shënoi një rritje pozitive vjetore prej 1 pikë përqindjeje.

Hapësirë informuese 4: Shpërndarja gjeografike e ndërmjetësimit bankar

Grafik 14. Shpërndarja e depozitave dhe kredisë sipas rretheve, dhjetor 2009.




Shpërndarja gjeografike e aktivitetit kreditues dhe depozitues karakterizohet nga një përqendrim i lartë, duke pasqyruar kështu jo vetëm karakteristikat e përqendrimit të popullsisë, por edhe zhvillimin social-ekonomik të zonave të ndryshme të vendit. Përqendrimi në shpërndarje shfaqet më i madh në tregun e kredisë sesa në atë të depozitave. Kështu, agjentët ekonomikë me rezidencë në Tiranë zotërojnë 42% të depozitave, ndërkohë që kanë thithur rreth 69% të kredisë. Ndër vite, shpërndarja gjeografike e kredisë nuk ka paraqitur ndryshime të rëndësishme.

Tregu i depozitave shfaqet më i përqendruar për bizneset sesa për individët. Rreth 90% e depozitave të bizneseve qarkullon në rrethet me aktivitetin më të lartë ekonomik: Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Fier. Ndërkohë, aktiviteti depozitues për individët ndjek më nga afër shpërndarjen gjeografike të popullsisë në vend, duke u ndikuar njëkohësisht edhe nga faktorë të tjerë, si niveli i varfërisë dhe të ardhurat, emigracioni dhe prirjet për kursim/konsum. Përveç Tiranës, e cila zë rreth një të

tretën e depozitave të individëve, rrethet me emigracion të lartë, si rrethet bregdetare dhe ato të Shqipërisë së mesme, kanë gjithashtu një peshë të lartë në këto depozita. Nga ana tjetër, ndonëse një pjesë e mirë e remitancave shkon në zonat malore dhe ato më të varfura të vendit¹, ato duket të përdoren kryesisht për të mbuluar nevojat për konsum, duke mos u kanalizuar në sistemin bankar.

Bizneset e rrethit të Tiranës kanë thithur rreth 74% të kredisë për biznese. Ndonëse shpërndarja e aktivitetit kreditues për biznese përmban një zhvendosje subjektive në

Grafik 15. Shpërndarja e depozitave të individëve dhe e popullsisë (majtas) dhe e depozitave të bizneseve (djathtas), sipas valutës.




Shënim: Të dhënat e popullsisë janë të muajit janar 2008.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

kahun rritës¹², përqendrimi i lartë i depozitave të biznesit në Tiranë, rreth 78%, mund të jetë një tregues se kjo zhvendosje nuk duhet të jetë shumë e madhe. Për më tepër, në Tiranë operojnë mesatarisht 40% e bizneseve dhe gati gjysma e bizneseve me më shumë se 50 punonjës. Në përgjithësi, shpërndarja e kredisë, edhe pse shfaqet e pabarabartë, ndjek përqendrimin gjeografik të bizneseve në vend. Gjithashtu, shpërndarja gjeografike e kredisë është në linjë edhe me profilizimin e rretheve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Disproporcionaliteti në shpërndarjen e kredisë për individë është më i vogël në krahasim me kredinë për biznese. Rezidentët e Tiranës kanë marrë rreth 59% të kredisë për individë. Brenda kredisë për individë, kredia konsumatore figuron e shpërndarë më njëtrajtësisht në rrethet e tjera përveç kryeqytetit. Ndërkohë, kredia hipotekare është e përqendruar - 85% e saj është dhënë në Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë, duke reflektuar përqendrimin e lartë të aktivitetit të ndërtimit¹³ dhe zhvillimin e tregut të pasurive të paluajtshme në këto qendra. Kredia hipotekare zë pjesën më të madhe të portofolit të kredisë për individë vetëm në Tiranë dhe Durrës, ndërkohë që në rrethet e tjera ajo zë mesatarisht rreth 35%.

Grafik 16. Shpërndarja gjeografike e kredisë për biznese dhe numrit të bizneseve (majtas) dhe e kredisë për individë sipas qëllimit (djathtas).



III.2. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

Pasiguria që shoqëroi zhvillimet në treg në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, pas tërheqjes së depozitave dhe situatës së paqartë financiare në botë, ka ardhur duke u shuar gjatë vitit 2009. Sistemi bankar është furnizuar me likuiditet të bollshëm, të vazhdueshëm dhe me kosto në rënie nga Banka e Shqipërisë. Kjo e fundit ka ndërhyrë në treg me anë të operacioneve në treg të hapur, apo në mënyrë verbale, për të ulur tensionet në treg, për të nxitur tregtimin dhe për të siguruar agjentët ekonomikë e financiarë mbi ruajtjen e stabilitetit financiar në vend. Një herë në fillim të vitit, dhe më pas në fund të muajit tetor, Banka e Shqipërisë ka ulur normën bazë të interesit me nga 0.50 pikë përqindjeje. Këto dy lëvizje janë përcjellë menjëherë tek normat afatshkurtra të interesit në tregun ndërbankar, të cilat për rrjedhojë kanë


shënuar rënie dhe një luhatshmëri më të ulët nga viti i kaluar. Në tregun primar të letrave me vlerë, reagimi është vënë re vetëm pas muajit tetor. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë kanë shënuar rritje deri në muajin tetor si pasojë e ruajtjes së primeve të rrezikut në nivele relativisht të larta. Tremujori i fundit konfirmoi rikthimin e besimit të publikut tek sistemi bankar shprehur në rritjen e nivelit të depozitave. Nga ana tjetër, ulja e normës bazë si dhe sinjalizimi për ndjekjen e politikave më të kujdesshme fiskale u reflektuan në rënien e *yield*-eve në këtë periudhë.

Normat e interesit për depozitat kanë qëndruar në nivele relativisht të larta duke qenë faktor nxitës për tërheqjen e depozitave në sistem. Nga ana tjetër, marzhet mesatare të ndërmjetësimit janë rritur si pasojë e shtrëngimit të kushteve të kredidhënies. Këto të fundit, kanë qenë më të theksuara për monedhën evropiane duke shprehur midis të tjerash dhe korrektimin për perceptimin më të drejtë të rrezikut të kursit të këmbimit. Kursi i këmbimit ka vijuar të nënçmohet gjatë gjithë vitit 2009 si pasojë e ndryshimit të raporteve të kërkesës dhe ofertës në tregun valutor.

- *TREGU NDËRBANKAR*

Normat e interesit në tregun ndërbankar kanë paraqitur ecuri rënëse dhe luhatshmëri të moderuar gjatë vitit 2009. Luhatja e normave të interesit është zbutur, ndërkohë që ulja prej 1.00 pikë përqindjeje e normës bazë gjatë vitit është përcjellë në mënyrë të plotë në tregun ndërbankar. Mungesa e likuiditetit në treg, e mbartur nga viti i kaluar, është ndjerë dhe në pjesën e parë të vitit 2009, e cila për pasojë u karakterizua nga prime relativisht të larta rreziku dhe sjellje ngurruese të bankave për të qenë aktive në tregun ndërbankar. Ofrimi i pakufizuar i likuiditetit nga Banka e Shqipërisë duke plotësuar të gjitha kërkesat e sistemit bankar, si dhe masat e marra për të nxitur aktivitetin huadhënës dhe për të qetësuar pjesëmarrësit në treg, janë reflektuar si në ecurinë e normave të interesit ashtu edhe në volumet e shkëmbyera në tregun ndërbankar. Normat e interesit janë luhatur në nivele të qëndrueshme dhe relativisht të ulëta (norma njëditore është luhatur 0.40-0.50 pikë përqindjeje nën normën bazë të interesit).

Fillimi i vitit u karakterizua nga vëllime të ulëta shkëmbimesh në tregun ndërbankar, ku normat e interesit mbartnin prime të pasigurisë të lidhura kryesisht me shtrëngimin e kushteve të likuiditetit dhe vështirësinë e sigurimit të fondeve në tregun e depozitave. Në fundin e muajit janar, Banka e Shqipërisë uli normën bazë me 0.50 pikë përqindjeje me qëllim nxitjen e kreditimit dhe uljen e kostos së përgjithshme të tij. Nga ana tjetër, ndalimi i përkohshëm i përdorimit të depozitës njëditore pranë saj nga bankat u gjykua si masë e nevojshme për të gjallëruar tregun e parasë. Këto masa, krahas atyre që ishin ndërmarrë në muajt e mëparshëm u reflektuan në rritjen e vëllimit të transaksioneve dhe rënien e normave të interesit në tregun ndërbankar. Në tremujorin e dytë, huamarrja totale shënoi 2.3 miliardë lekë, vlerë kjo e afërt me atë të periudhës përpara muajit shtator të vitit 2008.




Në gjashtëmujorin e dytë të vitit, likuiditeti i bollshëm i ofruar nga Banka e Shqipërisë, frenimi i rrjedhjes së depozitave dhe rënia e aktivitetit kreditues, janë reflektuar në performancën e tregut ndërbankar. Shpërndarja e likuiditetit në sistem ka qenë më e njëtrajtshme duke u përcjellë në zbutjen e luhatshmërisë së normave të interesit. Presionet rritëse në raste të veçuara, kanë qenë të lidhura kryesisht me sjelljen shpesh joeficiente të bankave, për faktin se tregu ynë financiar vazhdon të karakterizohet nga një nivel i ulët zhvillimi që ndikon edhe në reduktimin e alternativave investuese të agjentëve ekonomikë. Përmirësimi i gjendjes së likuiditetit dhe ulja e perceptimit të rrezikut në treg janë konfirmuar në pjesëmarrjen e rritur të bankave në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë, veçanërisht pas tremujorit të parë të këtij viti. Ulja e mëtejshme e normës bazë nga Banka e Shqipërisë në fundin e muajit tetor është përcjellë tek normat e tregut ndërbankar. Në terma mesatarë, në tremujorin e fundit norma e interesit ditor shënonte 4.93% ndërsa ajo javore 5.35%. Gjatë muajve të fundit, prirja e tyre rënëse është ndjekur dhe nga rritja e vëllimit total të huamarrjes, ku bie në sy rritja e asaj me maturitetet javor. Kështu, në muajt nëntor dhe dhjetor, vëllimi total i transaksioneve në tregun ndërbankar arriti 2.05 miliardë lekë ose afërsisht i njëjtë me mesataren e vitit të kaluar.

- *TREGU PRIMAR DHE ECURIA E YIELD-EVE*

Ecuria e *yield-eve* të letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar në pjesën më të madhe të vitit ka qenë e karakterizuar nga prirje rritëse. Duke nisur që prej fundit të vitit të kaluar, *yield-et* janë rritur për të gjitha maturitetet. Në muajt e parë të këtij viti, ecuria e tyre duket të ketë reflektuar disi pjesëmarrjen e ulët të bankave në ankandet e kësaj periudhe. Ndonëse në periudhën në vazhdim kjo pjesëmarrje është rritur dukshëm, ajo gjithsesi nuk ka ndikuar në zbutjen e presioneve rritëse mbi *yield-et*. Perceptimi i lartë i rrezikut dhe ngurrimi i bankave në një kontekst të shtrënguar financiar kanë orientuar ecurinë rritëse të *yield-eve* gjatë muajve në vijim. Rritja më e theksuar në *yield-et* e bonove të thesarit është vërejtur për maturitetin më të gjatë, 12-mujor, duke u përcjellë më pas dhe në *yield-et* e obligacioneve të parametruar me

këtë tregues. Nga ana tjetër, rritja e kërkesës për financim të qeverisë duket të ketë ndikuar në shtimin e presioneve rritëse në ecurinë e *yield*-eve. Në fund të gjashtëmuajorit të parë, interesi i bonove 12-mujore arriti vlerën 9.24% ose 0.48 pikë përqindjeje më lart se fundi i muajit dhjetor të vitit 2008. Diferencat midis *yield*-eve janë rritur, kryesisht për ato me maturitet deri në 12-muaj, ndërkohë që ato midis obligacioneve kanë shfaqur rritje më të ulët. Kjo ka ndikuar pjerrësimin e mëtejshëm të kurbës së *yield*-eve dhe sheshimin e pjesës së fundit të saj.


Grafik 18. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar (majtas) dhe pjesëmarrja në ankandet e bonove të thesarit 12-mujore (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndryshimi i kahut të lëvizjes së *yield*-eve ndodhi në muajt e fundit të vitit pas uljes së mëtejshme prej 50 pikësh bazë të kryer nga Banka e Shqipërisë në një kontekst më të favorshëm financiar. Në muajin dhjetor, *yield*-i i bonove 12-mujore zbriti në 9.06% i shoqëruar gjithashtu nga uljet e *yield*-eve të bonove me maturim 3 dhe 6-mujor.

Grafik 19. *Yield*-et e obligacioneve në tregun primar (majtas) dhe pjerrësia e normave të interesit (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tregun primar të obligacioneve, *yield*-et kanë evidentuar të njëjtën prirje rritëse me atë të bonove të thesarit. *Yield*-et e obligacioneve janë rritur për të gjitha maturitetet dhe janë ndikuar nga vlerësimi i rritur i rrezikut nga ana e bankave. Në muajin tetor, *yield*-i i obligacioneve 2 dhe 3-vjeçare shënoi përkatësisht 9.70 dhe 9.90% ndërsa ai i obligacioneve 5-vjeçare (me interes të ndryshueshëm) 10.97%. Këto nivele tregojnë një rritje prej më shumë se 100 pikësh bazë nga ato të së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Ndërsa rritja e *yield*-eve të këtyre instrumenteve ka reflektuar kryesisht ecurinë e *yield*-it të bonove 12-mujore, edhe marzhi i pranuar në ankande ka qenë më i vogël. Muaji nëntor ka shënuar ndryshimin e kahut të ecurisë, pasi Banka e Shqipërisë uli normën bazë me 0.50 pikë përqindjeje për të dytën herë gjatë vitit. Në ankandet e këtij muaji dhe në vazhdim, *yield*-et e obligacioneve ranë dukshëm, duke dhënë gjithashtu sinjale për vijimin e kësaj ecurie.


• TREGU VALUTOR DHE ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT

Viti 2009 është karakterizuar nga një vijimësi e tendencës rënëse të lekut, në terma nominalë efektivë, të vërejtur që në tremujorin e fundit të vitit 2008. Në këtë periudhë, kriza financiare globale dha goditjen e saj në tregun e shkëmbimeve valutore si rrjedhojë e lëkundjes së besimit të publikut ndaj sistemit financiar dhe e instrumenteve të ofruar prej tij. Ritmet e përshpejtuara rënëse të indeksit NEER, të shfaqura pothuajse në të gjithë gjashtëmujorin e parë të vitit, duke kulmuar në 10.2% në muajin maj, janë pasuar nga një kthim i lehtë në pjesën e dytë të vitit duke u luhatur rreth një intervali të ngushtë. Kjo qëndrueshmëri e lekut duket se ka ardhur si pasojë e raporteve më të qëndrueshme midis kërkesës dhe ofertës për valutë, shuarjes graduale të efekteve psikologjike dhe tkurrjes së bilancit tregtar.




Në tregun e brendshëm valutore, leku u nënçmua ndaj dy monedhave kryesore të shportës, euro dhe dollar, mesatarisht me 7.6% dhe 13.2% gjatë vitit 2009. Tendenca mbiçmuese e euros ka qenë e pranishme pothuajse gjatë gjithë periudhës me përjashtim të disa momenteve që përkrijnë me

Grafik 21. Ecuria ditore e raportit euro/lekë dhe usd/lekë (majtas) ecuria e raportit euro/lekë e grupuar sipas muajve për periudhën 2007-2009 (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Ecuria ditore e raportit euro/usd dhe usd/lekë.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

prurjet sezonale të festave dhe të periudhës së verës. Megjithatë, duhet theksuar se gjatë vitit 2009 efekti sezonal ka rezultuar krahasimisht më i zbehtë se vitet e tjera, ndërkohë që efekti korigjues që pason këto periudha ka qenë më i ndjeshëm si rrjedhojë e balancave të lëkundura të ofertë-kërkesës dhe pasigurisë së agjentëve të tregut.

Nga ana tjetër, ecuria e raportit usd/lek pasqyron në një pjesë të konsiderueshme zhvillimet e monedhës së huaj në tregun ndërkombëtar.

Luhatshmëria e raporteve euro/lek dhe dollar/lek gjatë vitit 2009 ka rezultuar e lartë, duke reflektuar kështu raportin e lëkundur të ofertës me kërkesën si dhe pasigurinë e agjentëve të tregut. Megjithatë, në

Grafik 23. Luhatshmëria¹⁵ e kursit të këmbimit të lekut në terma mesatarë vjetorë (majtas) dhe ecuria ditore e raportit euro/monedhë vendase për vendet e rajonit,¹⁶ indeks me bazë 1 tetor 2008 (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

krahasim me vitin paraardhës, luhatshmëria e kursit usd/lek është paraqitur disi e moderuar ndërkohë që ai eur/lek ka prekur vlera historike.


Një vështrim krahasues i raportit euro/lek me monedhat e tjera të vendeve të rajonit tregon se leku tregoi qëndrueshmëri më të lartë nga monedhat e vendeve të tjera në fillimet e krizës globale. Në një periudhë të dytë, kur ekonomitë e tjera duket se asimiluan goditjet e krizës në tregun valutor dhe monedhat përkatëse filluan të jenë më pak të luhatshme, leku ka shfaqur një ritëm më të përshpejtuar të tendencës nënçmuese.

- *ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT PËR DEPOZITA DHE KREDI*

Viti 2009 është karakterizuar nga interesa relativisht të larta për depozitat si në monedhën vendase ashtu dhe në atë evropiane. Pavarësisht se norma bazë e interesit për lekun është ulur dy herë, në total me 1.00 pikë përqindjeje, interesi i depozitave në lekë nuk ka pësuar të njëjtën rënie. Kjo ecuri erdhi si pasojë e konkurrencës së lartë në sistemin bankar për thithjen e likuiditetit dhe përpjekjes së bankave për të ruajtur pjesët përkatëse të tregut me qëllim rikuperimin e depozitave të humbura në tremujorin e fundit 2008. Interesat në euro kanë ndjekur prirje rënëse, megjithëse ato kanë vazhduar të ruajnë vlera të larta krahasuar me normën bazë të BQE, e cila është ulur me 1.50 pikë përqindjeje në pjesën e parë të vitit 2009.

Në terma mesatarë, norma e interesit për depozitat me afat në lekë gjatë vitit 2009 shënoi 5.46%, 0.12 pikë përqindjeje më poshtë se në vitin 2008. Interesi mesatar i depozitave në lekë ra në muajt e parë, nga 5.84% në janar në 5.12% në shkurt, si pasojë e përfundimit të ofertave të fundvitit 2008 dhe ndalimit të tërheqjes së depozitave nga sistemi. Gjatë sezonit veror qershor - gusht, ky tregues është rritur duke arritur nivelin më të lartë, 5.94% në muajin gusht, e ndikuar nga ofertat sezonale. Në vazhdim, me normalizimin e nivelit të depozitave në sistem, interesat regjistruan rënie dhe në dhjetor shënuan vlerën 5.46%. Sipas afateve, vihet re se depozitat 12-mujore janë ulur mesatarisht vetëm 0.03 pikë përqindjeje në vitin 2009.

Grafik 24. Ecuria e interesave 12-mujore të depozitave në lek dhe në euro (majtas) dhe diferenca midis normave 12-mujore të interesit të depozitave në lek dhe në euro (djathtas).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesat për *depozitat me afat në euro* kanë ndjekur prirje rënëse gjatë vitit 2009. Ulje të interesave janë regjistruar për të gjitha afatet e përdorimit përveç atij 24-mujor. Norma e interesit për depozitat në euro shënoi mesatarisht 2.48% në vitin 2009, vlerë relativisht e lartë në krahasim me normën bazë të BQE-së, e cila qëndroi 1.00% gjatë gjithë pjesës së dytë të vitit 2009. Normat e larta të interesit janë kushtëzuar nga gjendja e likuiditetit si dhe orientimi individual i politikave për depozitat në valutë nga bankat e sistemit. Këto të fundit, kanë përdorur normat e interesit të depozitave (kosto e fondeve) si norma referencë për kreditë në euro, tendencë që ka filluar në fund të vitit 2008 dhe ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2009. Ulja e interesave ka qenë e orientuar nga prirjet individuale të bankave, ku në prill dhe në tetor janë regjistruar normat më të larta, periudhë kjo që përkon edhe me luhatjet sezonale të aktivitetit ekonomik.

Ruajtja e normave të larta të interesave për lekun dhe prirja rënëse për euron ka bërë që *spread*-i midis depozitave në lek dhe euro¹⁷ të shënojë 3.00 pikë përqindjeje në fund të vitit 2009, ose 0.84 pikë përqindjeje më lart nga muaji dhjetor 2008. Në terma mesatarë, ky tregues llogaritet 2.41 pikë përqindjeje në vitin 2009, nga 2.07 pikë përqindjeje një vit më parë.

Viti 2009 është karakterizuar nga luhatshmëri e lartë e normave mesatare të *interesit për kreditë* në lekë dhe prirje rritëse për kreditimin në euro. Si pasojë e pasigurisë së perceptuar, në gjashtë muajt e parë të vitit 2009, është regjistruar një prirje shtrënguese për kreditim për të dy monedhat kryesore. Bankat kanë reaguar drejt lehtësimit vetëm në pjesën e dytë të vitit, pas përmirësimit të dukshëm të nivelit të depozitave, uljes së normave të interesit në tregun primar dhe përpjekjeve të Bankës së Shqipërisë për të ulur koston e kreditimit në lekë.




Gjatë vitit 2009, interesi mesatar i ponderuar për *kreditë në lekë* shënon 13.59% nga 12.85% vitin e kaluar. Në pjesën më të madhe, kredia e re

është akorduar për financime afatshkurtra 0-6 muaj (*overdraft* për bizneset). Këto janë mbështetur dhe nga interesa më të favorshme për afatin e shkurtër krahasuar me ato për afatin e gjatë, të cilat mbartin rrezikun e lartë të perceptuar nga pasiguria për zhvillimet ekonomike në të ardhmen. Gjatë gjashtëmuajorit të parë, norma e interesit për kreditë në lekë ka qenë rritëse duke ndjekur të njëjtën prirje me interesin me të cilin indeksohen – bono thesari 12-mujore. Gjatë sezonit veror ato u ulën, si pasojë e disa politikave të veçanta promovionale të ndjekura nga sistemi bankar dhe vijuan sërish me rritje në shtator-tetor, si pasojë e kërkesës afatshkurtër për rritjen e inventarëve të kompanive. Në dy muajt e fundit të vitit 2009, në aktivitetin kredidhënës vihet re një prirje lehtësuese në monedhën vendase e cila u përputh me uljen e normës bazë dhe rënien e *yield*-it 12-mujor të bonove të thesarit. Ky zhvillim ka reflektuar vlerësimin në rritje të sistemit bankar për financim në monedhën kombëtare, në përgjigje të një perceptimi më të drejtë të rrezikut të kreditimit në valutë.

Përgjithësisht, kredidhënia në monedhën evropiane devijoi nga zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare, duke zgjeruar marzhet me euriborin dhe koston e fondeve. Norma mesatare e ponderuar e interesit për kredinë në euro shënoi 7.89% në vitin 2009 krahasuar me 8.19% në vitin 2008. Ndërkohë, norma e euriborit në tregjet ndërkombëtare është ulur me 3.16 pikë përqindjeje gjatë kësaj periudhe. Perceptimi i përgjithshëm mbi pasigurinë e projekt-investimeve në vend, monitorimi më i rreptë i kredidhënies në euro dhe faktorizimi i luhatshmërisë së kursit janë shprehur në rritje të çmimit nga ana e bankave. Në muajt e fundit të vitit, norma e interesit për kreditë në euro u rrit sërish si pasojë e rritjes së kërkesës për likuiditet sezonal nga bizneset. Mesatarisht, gjatë vitit 2009, janë regjistruar rënie të lehta të interesit për të gjitha afatet, por shtrëngimi i kriterëve, ku spikat ai për kreditë hipotekare për individët, mbetet konstant në bankat e sistemit.

Grafik 26. Marzhet e ndërmjetësimit në lek dhe në euro (majtas) dhe diferenca midis interesit mesatar të ponderuar të kredisë në lek dhe asaj në euro (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kostoja e ndërmjetësimit (*spread*-i i interesit të kredisë dhe depozitës) në lekë dhe në euro është rritur në vitin 2009. Në terma mesatarë, ky tregues për

lekun rezulton 8.13 pikë përqindjeje, nga 7.27 pikë përqindjeje vitin e kaluar. Norma mesatare e ndërmjetësimit për monedhën evropiane është 5.41 pikë përqindjeje, 1.00 pikë përqindjeje më lart krahasuar me vitin e kaluar. Për monedhën kombëtare kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes mesatare të kredive, ndërkohë që në rastin e monedhës evropiane, shkak i rritjes ka qenë rënia e interesit të depozitave.

Megjithë kufizimin e kredidhënies në euro dhe shtërngimit të standardeve për të, diferenca midis interesave për kreditë në lekë me ato në euro është zgjeruar në mesatarisht 5.7 pikë përqindjeje në vitin 2009 nga 4.6 pikë përqindjeje në vitin 2008.

SHËNIME

¹ Treguesi M3 real përfaqëson serinë e agregatit M3 të deflatuar nga norma e inflacionit dhe lëvizjet e kursit të këmbimit.

² Kështu, oferta monetare është $M3 = mm * RM_3$, ku mm është shumëzues i parasë.

³ Raporti i agregatit M2 ndaj bazës monetare.

⁴ Këta tregues nuk marrin parasysh efektin e ndryshimeve të kursit të këmbimit në stokun e depozitave në valutë dhe të M3. Rregullimi i tyre ndaj këtij efekti ul lehtësisht ritmin vjetor ose raportin e tyre ndaj agregatëve monetarë. Pastrimi i serisë së depozitave në valutë nga efekti i kursit e ul raportin e tyre ndaj M3 në fund të vitit 2009, nën nivelin e këtij raporti në fund të vitit 2008.

⁵ Teprica e kredisë totale të sistemit bankar në valutë, kryesisht në euro, është rreth 34% e parasë së gjerë.

⁶ Në një rast të tillë të thjeshtëzuar, aktivet financiare të agjentëve ekonomikë përfshijnë parandë jashtë bankave që mbajnë bizneset dhe individët në cash si dhe depozitat e tyre në sistemin bankar, ndërsa pasivet përfaqësojnë detyrimet e tyre ndaj sistemit bankar në formën e kredisë. Llogaritja e parasë cash në valutë është bërë në bazë të supozimit të ruajtjes së raportit të parasë cash në lekë ndaj depozitave në lekë si e njëjtë me raportin e parasë cash në valutë ndaj depozitave në valutë.

⁷ Rreth 70% e tepricës së kredisë në valutë është e akorduar për bizneset.

⁸ Shifrat e paraqitura në vazhdim në analizën e kredisë janë të pastruara nga efekti i kursit të këmbimit. Ky pastrim nuk reflekton besnikërisht zhvillimet nominale në bilancet e sistemit bankar, por ai pasqyron më mirë efektin e kredisë në aktivitetin ekonomik.

⁹ Këto kanë qenë të pranishme kryesisht në muajt e parë të vitit 2009.

¹⁰ Në kllapa është pasqyruar pesha e secilit sektor ndaj totalit të portofolit të kredisë për biznese.

¹¹ Banka Botërore, "Shqipëria, Rritja Urbane, Migrimi dhe Ulja e Varfërisë", Vlerësimi i Varfërisë 2007.

¹² Si rrjedhojë e procedurave të brendshme të bankave për të analizuar kredi të mëdha për biznese pranë njësisive vendimmarrëse në Tiranë. Një pjesë e kredive dhënë bizneseve nëpër rrethe të tjera figurojnë si kredi të dhëna për biznese në Tiranë.

¹³ Rreth 73% e firmave të ndërtimit janë të regjistruara në këto prefektura.

¹⁴ NEER – kursi nominal efektiv i këmbimit, i llogaritur kundrejt dy monedhave sipas një peshe të përafërt që zënë në tregtinë me jashtë, euro (80%) dhe usd (20%). Një rritje e NEER do të thotë mbiçmim i lekut. Ky indeks ka si periudhë bazë muajin janar të vitit 2001.

¹⁵ Llogaritur si mesatare vjetore e luhatshmërisë së kursit të këmbimit. Luhatshmëria e kursit të këmbimit është matur nga treguesi i devijimit standard.

¹⁶ Në vendet e rajonit janë përfshirë Serbia, Turqia dhe Rumania si vende me regjim të kursit të këmbimit të njëjtë me atë të vendit tonë.

¹⁷ Llogaritur si diferencë midis interesit të ponderuar të depozitave me afat njëvjeçar në lekë dhe në euro.




"500-vjetori i statujës së Davidit"
50 lekë. Monedhë bakri/nikeli, emetim i vitit 2001.

KAPITULLI IV. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE DHE ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

IV.1. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Në vazhdimësi të masave të marra në fund të vitit 2008 për të stabilizuar situatën e likuiditetit në sistemin bankar pas krizës së besimit të publikut, gjatë vitit 2009, operacionet në tregun e parasë u orientuan drejt furnizimit të sistemit bankar me gjithë likuiditetin e nevojshëm. Sasia e likuiditetit afatshkurtër e injektuar nga Banka e Shqipërisë arriti pikën më të lartë prej rreth 40 miliardë lekësh në muajt e verës, ndërkohë që ndikuar nga hyrjet e cash-it në sistemin bankar, kjo sasi u ul gradualisht në rreth 28 miliardë lekë në fund të vitit 2009. Numri i bankave që kanë përdorur instrumentet e përkohshme është rritur në krahasim me vitet e kaluara, duke krijuar premisa pozitive se tërheqja e likuiditetit nëpërmjet pjesëmarrjes në operacionet e tregut të hapur të Bankës së Shqipërisë, nuk do të jetë thjesht një pjesëmarrje në raste emergjence, por një operacion i zakonshëm. Kjo është shenjë e rritjes së rëndësisë së këtyre operacioneve dhe premtion rritje të efektivitetit të tyre.



IV.1.1. OPERACIONET E TREGUT TË HAPUR


Operacionet e tregut të hapur, të cilat konsistojnë në operacionin kryesor, operacione rregulluese dhe operacione strukturore, janë operacionet bazë për menaxhimin e likuiditetit nga banka qendrore. Gjatë vitit 2009, struktura e injektimeve të likuiditetit konsistoi në një mesatare prej 55% nëpërmjet instrumentit kryesor dhe 45% nëpërmjet instrumenteve rregulluese me afat më të gjatë se një javë.

- *OPERACIONI KRYESOR I TREGUT*

Gjatë vitit 2009, marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëjavor ishte instrumenti kryesor për realizimin e operacioneve të tregut të hapur. Ndërhyrjet me anë të këtij operacioni u realizuan nëpërmjet ankandit me çmim fiks të njëjtë me normën bazë të Bankës së Shqipërisë. Kjo formë ankandi filloi përdorimin në nëntor të vitit 2008, duke qenë një prej masave të marra për qetësimin e tensionit në sistemin bankar në kushtet e paparashikueshmërisë së likuiditetit të ndikuar nga tërheqja e depozitave nga publiku. Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2009, u gjykua se kushtet e tregut ishin rikthyer në normalitet e për rrjedhojë u vendos që operacioni kryesor të rikthehet në formën klasike

të tij – ankand me shumë çmime. Ndryshimi i formës së ankandit u vendos të bëhej efektiv në fillim të vitit 2010, por vendimi për këtë ndryshim u bë transparent për bankat e sistemit në fillim të tremujorit të katërt të vitit 2009.

Grafik 2. Operacioni kryesor i tregut sipas datave të ankandeve (në miliardë lekë).




Likuiditeti i injektuar nëpërmjet marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim njëjavor gjatë vitit 2009 ishte mesatarisht 17.70 miliardë lekë në javë. Numri i bankave pjesëmarrëse në ankandet javore ishte mesatarisht 6 banka. Ky numër shënoi ulje në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2008, gjatë të cilit pjesëmarrja në ankandet javore shënonte mesatarisht 9 banka. Por nga ana tjetër, numri i bankave pjesëmarrëse në ankandet javore në vitin 2009, shënoi një rritje krahasuar me pjesëmarrjen gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2008 përpara situatës së tensionuar në sistemin bankar (mesatarisht 2 banka për ankand).

Rënia e numrit të bankave pjesëmarrëse në krahasim me tremujorin e fundit të vitit 2008, reflektoi qetësimin e nevojës për likuiditet.

• OPERACIONET RREGULLUESE TË TREGUT

Gjatë vitit 2009, operacionet rregulluese për injektimin e likuiditetit me afat më të gjatë se një javë, u përdorën me frekuencë më të lartë se në vitet e kaluara. Ky përdorim më i shpeshtë ishte në funksion të minimizimit të presioneve mbi normat e interesit të tregjeve në kushtet e një nevojë për likuiditet në një nivel të paprovuar më parë nga sistemi bankar.

Grafik 3. Operacionet rregulluese të tregut sipas datave të ankandeve (në miliardë lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me maturim njëmuajor u përdorën në tetë raste, duke injektuar mesatarisht 3.2 miliardë lekë, ndërsa marrëveshjet

e anasjellta të riblerjes me maturim tremujor u përdorën në 16 raste duke injektuar mesatarisht 3.1 miliardë lekë. Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me maturim njëmujoje u përdorën kryesisht gjatë tremujorit të fundit të vitit në kushtet kur pritej një rritje e nivelit të likuiditetit e ndikuar nga hyrja e cash-it në sistemin bankar.

Ankandet mujore patën një raport mesatar kërkesë/ofertë prej 127%¹, ndërsa i njëjti raport për ankandet tremujore ishte 124%. Numri i bankave pjesëmarrëse në ankand ishte mesatarisht 4 banka për ankand, numër i cili gjykohej i kënaqshëm nisur nga historiku i pakët i përdorimit të këtyre instrumenteve.

Tensioni për likuiditetin në fundvitin 2008, i cili vazhdoi edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2009, u reflektua në normat e interesit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes me maturim tremujor. Diferenca e kësaj norme interesi kundrejt normës bazë të interesit ishte 81 pikë bazë gjatë tremujorit të parë të vitit, e më pas u ngushtua në 22 pikë bazë për pjesën tjetër të vitit. Kjo diferencë erdhi në ngushtim edhe për marrëveshjet e anasjellta njëmujoje, nga 20 pikë bazë në muajin gusht 2009, në 11 pikë bazë në fund të vitit.

- *OPERACIONET STRUKTURORE TË TREGUT*

Operacioni strukturor – blerja me të drejta të plota të bonove të thesarit - u përdor vetëm në një rast në fund të vitit 2009, në shumën 2.30 miliardë lekë.

IV.1.2. LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përhershme – depozita njëditore dhe kredia njëditore – janë instrumente në dispozicion të bankave të nivelit të dytë për të menaxhuar likuiditetin në bazë ditore. Gjithsesi, Banka e Shqipërisë gëzon të drejtën që të pezullojë përdorimin e këtyre instrumenteve në rast se e gjykon të përshtatshme.

Në vazhdimësi nga tremujori i fundit i vitit 2008, gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 u vu re një funksionim jo i mirë i tregut ndërbankar. Në një kohë kur një pjesë e madhe e bankave merrnin hua nga banka qendrore nëpërmjet instrumenteve të tregut të hapur, të tjera shfaqeshin si depozituese pranë saj duke përdorur instrumentin e depozitës njëditore. Në këto kushte, në muajin mars 2009, Banka e Shqipërisë vendosi pezullimin e përdorimit të depozitës njëditore. Ky pezullim zgjati deri në muajin maj 2009.

Pas rifutjes në përdorim të instrumentit të depozitës njëditore, u vu re një menaxhim më i mirë i likuiditetit duke përqendruar përdorimin e depozitës njëditore në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar. Përdorimi i depozitës njëditore u ul në mesatarisht 0.40 miliardë lekë në ditë për periudhën qershor–dhjetor 2009, në krahasim me 1.30 miliardë lekë në ditë gjatë periudhës janar-shkurt 2009.


Kredia njëditore gjeti përdorim të ulët gjatë vitit 2009. Konkretisht, ajo u përdor në vetëm 10 raste.

IV.1.3. INSTRUMENTE MBËSHTETËSE

Kredia lombard, që është instrumenti i fundit kreditues i Bankës së Shqipërisë i cili iu akordohet bankave me vështirësi të përkohshme likuiditeti, por që janë financiarisht të qëndrueshme, nuk gjeti asnjë përdorim gjatë vitit 2009.

IV.1.4. REZERVA E DETYRUAR

Rezerva e detyruar në lekë është instrument i politikës monetare që synon rregullimin e likuiditetit në sistemin bankar dhe stabilizimin e normave të interesit. Banka e Shqipërisë aplikon rezervë të detyruar si për depozitat në monedhë vendase ashtu edhe për depozitat në monedhë të huaj. Niveli i rezervës së detyruar korrespondon me 10% të depozitave të bankave të nivelit të dytë deri në 2 vjet në të tre monedhat – lekë, euro, dollar amerikan. Ecuria e saj gjatë vitit 2009 ka reflektuar ecurinë e depozitave sipas monedhave përkatëse, me një muaj vonesë, duke qenë se periudha e rezervës së detyruar fillon në datën 24 të çdo muaji dhe korrespondon me gjendjen e depozitave të muajit kalendarik që i paraprin.



Niveli i rezervës së detyruar pasqyroi efektin e tërheqjes së depozitave gjatë pjesës së parë të vitit dhe rikuperimin e tyre në pjesën e dytë të vitit. Rritja vjetore e rezervës së detyruar në lekë rezultoi 3.15%, ndërsa rritja vjetore e rezervës së detyruar në valutë rezultoi respektivisht 5.17% pozitive për rezervën në monedhën evropiane dhe 11.01% negative për rezervën në monedhën amerikane.

Pesha mesatare e komponentit të rezervës së detyruar në lekë gjatë vitit 2009 ka qenë mesatarisht 55.5%, ndërsa peshat mesatare të komponentit të rezervës së detyruar në valutë kanë qenë respektivisht 35% për rezervën e detyruar në euro dhe 9.5% për rezervën e detyruar në dollarë amerikanë.


Gjatë vitit 2009, mundësia e mesatarizimit të rezervës së detyruar në lekë duke përdorur 40% të rezervës së detyruar, ka gjetur përdorim në nivele thuajse të njëjta me një vit më parë. Devijimi i gjendjes së llogarisë nga niveli i rezervës së detyruar në fund të periudhës së mbajtjes, është ulur nga një mesatare pozitive prej 0.50 miliardë lekësh në vitin 2008, në një mesatare pozitive prej 0.40 miliardë lekësh. Në kushte optimale, shmangia duhet të jetë pozitive afër nivelit zero. Gjithsesi duhet theksuar se pezullimi i depozitës njëditore në muajt mars-maj reflektoi një angazhim më të madh të bankave

në drejtim të miradministrimit të likuiditetit nëpërmjet miradministrimit të rezervës së detyruar.

Ecuria e normave të remunerimit të rezervës së detyruar ka pasqyruar ecurinë e normave të interesit nga të cilat derivohen.² Konkretisht, remunerimi i rezervës së detyruar në lekë ka reflektuar uljen e normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, në muajt janar dhe tetor 2009, duke u ulur nga 4.375% në fillim të vitit në 3.675% në fund të tij.

Remunerimi i rezervës së detyruar në valutë bazohet në normat bazë të bankave qendrore respektive – Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës Federale në ShBA. Uljet e aplikuara nga këto banka sollën reduktimin e normës së remunerimit me respektivisht 158 pikë bazë për rezervën e detyruar në euro dhe 61 pikë bazë për rezervën e detyruar në dollarë.

Grafik 5. Normat e remunerimit të rezervës së detyruar.



IV.2. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

Si rrjedhojë e zhvillimeve që pasuan krizën financiare të tregjeve ndërkombëtare të vitit 2008, u evidentua nevoja e kryerjes së disa ndryshimeve në politikën e administrimit të rezervës valutore. Kjo nevojë lindi për të pasqyruar, pikësëpari mundësitë e investimit në instrumente të reja dhe së dyti, krijimin e hapësirës për realizimin e të ardhurave nga investimi i portofolit në kushtet e një mjedisi të karakterizuar nga norma interesi mjaft të ulëta. Gjithashtu, gjatë vitit 2009 janë hedhur hapa në drejtim të përmirësimit cilësor të funksioneve të lidhura me vlerësimin e rreziqeve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sidomos rrezikut të kreditit dhe përdorimit të modeleve të reja në mbështetje të analizës së rrezikut të besueshmërisë për kundërpalët.

Në kuadër të programit të asistencës me Bankën Botërore, gjatë vitit të shkuar u realizua trajnimi i punonjësve dhe përgatitja e infrastrukturës për fillimin e investimit në instrumentin e ri financiar të kontratave të së ardhmes si dhe në letrat me vlerë me të ardhura të ndryshueshme. Ndërkaq, afati i marrëveshjes së lidhur mes palëve për pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në programin e asistencës u shty me një vit, gjatë të cilit është planifikuar të merret asistencë për vënien në zbatim të një sistemi për vlerësimin dhe ndjekjen e rrezikut operacional si dhe për aspekte të tjera të funksioneve të kryera nga Departamenti i Operacioneve Monetare në kuadër të aktivitetit të administrimit të rezervës valutore.

- *STATISTIKA MBI ECURINË E REZERVËS VALUTORE GJATË VITIT 2009*

Gjatë vitit 2009, rezerva valutore bruto e vlerësuar dhe e raportuar në monedhën amerikane, është rritur me rreth 21.4 milionë usd, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 2,365.56 milionë usd.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar rezervën bruto paraqiten të grupuara si më poshtë:

- A. Veprimet e lidhura me aktivitetin e Ministrisë së Financave kanë patur ndikim negativ në shumën 118.27 milionë usd, sipas zërave të mëposhtëm:
- hyrje nga privatizimi, 253.55 milionë usd;
 - hyrje nga lëvrimi i huasë tregtare, 261.80 milionë usd;
 - hyrje nga lëvrimi i huave të dhëna nga Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) etj., 102.55 milionë usd;
 - transferta, 736.17 milionë usd³.
- B. Veprimet e bankave të nivelit të dytë kanë patur ndikim negativ në shumën 4.42 milionë usd, sipas zërave të mëposhtëm:
- derdhje nga bankat e nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyruar apo dhe veprime të tjera që lidhen me kapitalin e tyre, 97.57 milionë usd;
 - transferta, 101.99 milionë usd.
- C. Veprimet e Bankës së Shqipërisë kanë patur ndikim pozitiv në shumën 89.07 milionë usd, sipas zërave të mëposhtëm:
- hyrje nga lëvrimi i huave të dhëna nga FMN-ja, 76.32 milionë usd;
 - hyrje të tjera, në shumën 2.02 milionë usd;
 - blerje të valutës nga bankat e nivelit të dytë, nga Ministria e Financave dhe institucione të tjera, në shumën 237.92 milionë dollarë, ku:
 - 234.46 milionë usd (Ministria e Financave),
 - 3.46 milionë usd (institucione të tjera).
 - të ardhura të siguruara nga investimi i rezervës valutore deri në fund të muajit dhjetor, të cilat llogariten në rreth 55.85 milionë usd. Efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit llogaritet në një vlerë negative prej 16.39 milionë Usd;
 - shlyerje e detyrimeve të Bankës së Shqipërisë ndaj FMN-së, 14.15 milionë Usd;
 - kryerje e pagesave të lidhura me shërbimin e borxhit të jashtëm për Qeverinë Shqiptare, 52.90 milionë usd;
 - shitje e valutës Ministrisë së Financave dhe bankave të nivelit të dytë në shumën 194.74 milionë dollarë, ku:
 - 125.76 milionë usd (Ministria e Financave),
 - 68.98 milionë usd (sistemi bankar).
 - transferta, rreth 4.86 milionë usd.

Gjatë vitit 2009, luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar pozitivisht vlerën e rezervës bruto, duke regjistruar një efekt rreth 55.02 milionë usd.

SHËNIME

¹ Oferta në këtë rast është shuma e shpallur nga Banka e Shqipërisë në ankandin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, ndërsa kërkesa korrespondon me kërkesën e bankave për të marrë pjesë në këto ankande.

² Normat e remunerimit të rezervës së detyruar janë 70% të normave mbi të cilat derivohen.

³ Këtu përfshihet përdorimi i fondeve në valutë nga projekte të ndryshme në favor të qeverisë.

"Kostume popullore shqiptare"
10 lekë. Monedhë Cu-Ni-Al, emetim i vitit 2005.



KAPITULLI V. MBIKËQYRJA BANKARE

V.1. KUADRI RREGULLATIV

Ligji “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe zbatimi në vazhdimësi i objektivave afatmesme dhe afatgjata të Bankës së Shqipërisë, konsolidoi në vazhdimësi punën për rishikimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës për përputhshmërinë me dispozitat e ligjit, ndërthurjen me zbatimin e parimeve të rishikuara të Komitetit të Bazelit për një mbikëqyrje efektive dhe koncepte të reja të Akordit të Ri të Kapitalit, direktivave të Këshillit Evropian dhe praktikave më të mira në fushën e rregullimit e mbikëqyrjes së institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë, edhe gjatë vitit 2009 finalizoi hartimin e disa rregulloreve të reja dhe njohu ndryshime në disa rregullore të tjera të mbikëqyrjes bankare. Hartimi i akteve të reja dhe rishikimi i atyre ekzistuese ka synuar t’i paraprijë parandalimit të fenomeneve negative të sistemit dhe shpesh ka marrë shtysë nga zhvillimet në tregjet financiare botërore, në veçanti nga kriza e fundit financiare. Ky proces ka konsideruar përshtatjen e praktikave më të mira në fushën e kontrollit të brendshëm; në rritjen e nivelit të transparencës së bankave me klientelën dhe publikun si në procesin e ofrimit të produkteve dhe shërbimeve, ashtu dhe në prezantimin e fushatave promocionale për produkte të reja dhe informimin e gjendjes reale financiare dhe të profilit të rrezikut të tyre; në sigurimin e një drejtimi të përgjegjshëm dhe efektiv; në forcimin e kapaciteteve të administrimit të rreziqeve etj.

Akte të reja rregullative dhe ndryshime me rëndësi në aktet në fuqi për mbikëqyrjen bankare të miratuara gjatë këtij viti janë¹:

- Rregullorja “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët”, e cila plotëson dhe përsos në vazhdimësi rregullimin e procesit të transparencës ndaj individit në procesin e kreditimit nga bankat dhe subjektet financiare jobanka, duke siguruar transparencë dhe krahasueshmëri të ofertave nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe kërkesave lidhur me informacionin që i jepet klientit për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare, në veçanti për normën efektive të interesit, si dhe përcaktimit të të drejtave të tij në procesin e kredimarrjes.
- Rregullorja “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, e cila përcakton kushtet dhe rregullat për licencimin dhe veprimtarinë financiare të subjekteve financiare jobanka dhe miratimin e agjentëve të tyre si edhe licencimin e institucioneve financiare të mikrokredisë.

- Rregullorja “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, e cila përcakton kushtet, kërkesat, afatet, dokumentacionin dhe procedurat për licencimin e bankës dhe degës së bankës së huaj për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, tërësinë e rregullave dhe kritereve të autoritetit mbikëqyrës për zgjerimin e rrjetit bankar, riorganizimin juridik të bankës (bashkimin, ndarjen), për dhënien e miratimeve paraprake etj.
- Rregullorja “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, e cila përcakton rregullat dhe kriteret bazë për një drejtim të përgjegjshëm dhe efektiv të bankave dhe degëve të bankave të huaja, të kritereve që duhet të plotësojnë administratorët e tyre, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për miratimin nga Banka e Shqipërisë, dhe kriteret për lidhjen e marrëveshjeve me të tretët për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi për administrimin dhe drejtimin e bankës.
- Rregullorja “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e cila bën specifikimin e procedurave dhe të dokumentacionit për identifikimin e klientit, rregullave për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin nga subjektet e rregullores tek autoriteti përgjegjës në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe (40+9) rekomandimet e FATF-it.
- Rregullorja “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, e cila përcakton kërkesat dhe standardet minimale për administrimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga bankat dhe degët e bankave të huaja, me qëllim parandalimin e rreziqeve sistemike të shkaktuara nga rreziku i likuiditetit, si dhe sigurimin e një procesi më efektiv në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes bankare, në përmbushjen e objektivit të sigurimit të një sistemi bankar të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.
- Rregullorja “Për veprimtarinë valutore”, e cila përcakton rregullat për kryerjen e veprimeve në llogarinë korente dhe kapitale, në formën e pagesave dhe transfertave nga dhe në Republikën e Shqipërisë ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, dhe transferimin e njëanshëm të aktiveve. Rregullorja synon liberalizimin e mëtejshëm të lëvizjeve të kapitalit nëpërmjet thjeshtimit dhe lehtësimit të procedurave, dokumentacionit dhe rregullave për lëvizjen e kapitalit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian.
- Disa ndryshime të rëndësishme u realizuan në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave” dhe në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, të cilat synuan një lehtësim (zbutje) të masave të marra nga autoriteti mbikëqyrës gjatë fundvitit 2008 për parandalimin e fenomeneve negative në sistemin

bankar shqiptar, të cilat morën shtysë nga situata e problemeve të shfaqura në sistemet financiare në botë.

V.2. LICENCIMI

Procesi i licencimit, si pjesë e mbikëqyrjes bankare, gjatë vitit 2009 ka konsistuar në:

- Ndryshime në strukturën e aksionerëve të bankave. Gjatë vitit që lamë pas u evidentuan ndryshime cilësore e sasiore të kapitalit aksioner të bankave. Ndryshimet cilësore konsistojnë në rritjen e kapitalit të huaj në pjesëmarrjen në kapitalin aksioner të bankave. Ndryshimet sasiore evidentohen në rritjen e masës së kapitalit të nënshkruar dhe të paguar të bankave. Konkretisht, në vitin 2009 u miratua:
 - Rritja e pjesëmarrjes influencuese të Çalik Holding A.S. Turqi (aksioner i tërthorë), nga 25.2% në 45.6% në kapitalin aksioner të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.
 - Rritja e pjesëmarrjes influencuese të aksionerit Banka Islamike për Zhvillim, nga 15% në 55% të aksioneve, nëpërmjet blerjes së 40% (dyzet%) të aksioneve të Ministrisë së Financave në kapitalin aksioner të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.

Nga pikëpamja e origjinës, në të gjitha transferimet e aksioneve të bankave evidentohet tendenca në rritje e pjesës së kapitalit të huaj. Në fund të vitit 2009 në Republikën e Shqipërisë operojnë 16 banka, nga të cilat 14 janë banka dhe 2 janë degë të bankave të huaja. Gjatë vitit që u mbyll nuk ka patur kërkesë për licencim të ndonjë banke të re.

- Shtesë veprimtarie në aneksin e licencës. Në vitin 2009 u realizua përshtatja e dokumentacionit mbi të cilin mbështetet veprimtaria bankare dhe financiare e bankave që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Mbi këtë bazë u realizua përditësimi i anekseve ekzistuese të licencave të bankave dhe të degëve të bankave të huaja në përputhje me përcaktimet e veprimtarive bankare dhe/ose financiare sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë". Në këtë kuadër, bankat kanë aplikuar për marrjen e miratimit të Bankës së Shqipërisë për kryerjen e veprimtarive shtesë, të cilat janë në proces shqyrtimi. Gjithashtu, gjatë vitit 2009 u miratuan 8 raste të reja të ofrimit të produkteve *e-banking*, të cilat konsistojnë në implementimin e produktit të *internet banking*, *sms banking*, të kartave elektronike bankare, ATM-ve dhe POS-eve.
- Zgjerimi i rrjetit të bankave. Zgjerimi i rrjetit të degëve dhe agjencive bankare në territorin e Shqipërisë vazhdoi edhe në vitin 2009, por me ritme më të ulëta në krahasim me vitet paraardhëse. Konkretisht, këtë vit u miratuan dhe filluan veprimtarinë 17 degë dhe agjenci, ndërkohë që bankat kanë njoftuar për mbyllje të aktivitetit të 4 degëve. Në fund

të vitit që kaloi, numri i përgjithshëm i degëve dhe agjencive arriti në 530 nga 517 që ishin në fundvitin 2008.

Tabelë 1. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2008.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë	Nr. i degëve e agjencive
1	Banka Raiffeisen	101			101
2	Banka Kombëtare Tregtare	26	29	2	57
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	4	2		6
4	Banka Veneto (ish-Banka Italiane e Zhvillimit)	7			7
5	Banka e Tiranës	43	4		47
6	Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë	5	25		30
7	Banka Ndërkombëtare Tregtare	8			8
8	Dega e Bankës Alfa	48	1		49
9	Banka Intesa Sanpaolo, Shqipëri	18	16	4	38
10	Banka ProCredit	29	13		42
11	Banka Emporiki	10	10		20
12	Banka e Kreditit të Shqipërisë	2	1		3
13	Banka Credins	23	6		29
14	Banka Popullore	39			39
15	Banka Union	15	16		31
16	Banka e Parë e Investimeve	6	4		10
	Totali	384	127	6	517

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Treguesit e shtrirjes së rrjetit të bankave në fund të vitit 2009.

Nr.	Bankat	Nr. i degëve brenda vendit	Nr. i agjencive	Nr. i degëve jashtë Shqipërisë	Nr. i degëve e agjencive
1	Banka Raiffeisen	102			102
2	Banka Kombëtare Tregtare	27	29	2	58
3	Banka e Bashkuar e Shqipërisë	4	2		6
4	Banka Veneto	8			8
5	Banka e Tiranës	43	4		47
6	Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë	5	25		30
7	Banka Ndërkombëtare Tregtare	8			8
8	Dega e Bankës Alfa – Albania	48			48
9	Banka Intesa Sanpaolo, Albania	19	14	4	37
10	Banka ProCredit	30	15		45
11	Banka Emporiki	13	10		23
12	Banka e Kreditit të Shqipërisë	2	1		3
13	Banka Credins	27	6		33
14	Banka Popullore	42			42
15	Banka Union	15	16		31
16	Banka e Parë e Investimeve-Albania	5	4		9
	Totali	398	126	6	530

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- Miratime administratorësh. Në vitin 2009 u paraqitën nga bankat 66 kërkesa për miratimin e administratorëve të emëruar prej tyre si kërkesë e ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Këto kërkesa të cilat kanë marrë miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, konsistojnë në emërimet të:
 - Administratorëve për efekt të lëvizjeve të ndryshme në varësi të strukturave organizative të bankave, lëvizjeve paralele apo emërimeve të reja,

- Pozicione të reja si efekt i krijimit të strukturave të reja në banka,
- Emërime të reja si rezultat i vendosjes në drejtimin e bankave të përfaqësuesve të aksionerëve të tyre.

Në rastet e miratuara të administratorëve të bankave, 10 prej tyre janë për anëtarë të këshillit drejtues të bankës, 10 raste janë për anëtarë të komitetit të kontrollit, 4 raste janë për drejtor të përgjithshëm / ekzekutiv, 6 raste janë për zëvendës drejtorë të përgjithshëm, 36 raste janë për drejtorë departamentesh / divizionesh / drejtorish.

- Miratime të ndryshimeve në statutet e bankave. Në bazë të nenit 24 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak, ndër të tjera, edhe për ndryshimet në statutet e bankave. Në zbatim të kësaj kërkesë ligjore janë paraqitur kërkesa për miratim ndryshimesh në statut nga 6 banka. Ndryshimet e paraqitura të statuteve të bankave lidhen me detyrimin për zbatimin e kërkesave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- Krijimi i subjekteve financiare jobanka. Risi në vitin 2009 ishte shtimi i kërkesave pranë Bankës së Shqipërisë nga shoqëri që kërkonin të kryenin veprimtari financiare si subjekte financiare jobanka. Gjatë vitit janë dhënë 7 licenca për këto subjekte. Kërkesat konsistojnë kryesisht në kryerjen e veprimtarisë së kredidhënies, të qirasë financiare, të shërbimit të pagesave dhe të transferimit të parave. Gjithashtu evidentohet edhe paraqitja e kërkesave nga subjekte të cilat kërkojnë të kryejnë veprimtari si institucione financiare të mikrokredisë. Në vitin 2009 iu revokua licenca një subjekti financiar jobankë për shkak të transformimit të tij në shoqëri tregtare dhe licencimin rishtaz të tij si subjekt jobankë.
- Licencimi i zyrave të këmbimit valutor dhe revokime licencash. Në Bankën e Shqipërisë, gjatë vitit 2009 iu dha licenca 32 zyrave të këmbimit valutor, ndërsa nuk pati asnjë revokim licence të këtyre zyrave. Gjithashtu, si efekt i kërkesave të rregullores “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor” për 47 zyra të këmbimit valutor u miratua edhe veprimtaria shtesë e agjentit për transferimin e parave për llogari të një subjekti jobankë (Unionit Financiar të Tiranës ose Ak-Invest). Në fund të vitit 2009, në tregun e këmbimit valutor operojnë 221 zyra.
- Licencimi i shoqërive të kursim-kreditit dhe revokime licencash. Gjatë vitit 2009 u licencuan 4 shoqëri të reja të kursim-kreditit dhe iu revokua licenca 2 shoqërive si rezultat i bashkimit me një shoqëri ekzistuese. Numri i shoqërive të kursim-kreditit në fund të vitit 2009 është 135 dhe i unioneve të tyre është 2.
- Gjatë vitit 2009, në mbështetje të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar

me vendimin nr. 11, datë 25.02.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, filloi procesi i miratimit të agjentëve që vepronë në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jobankë të licencuar nga Banka e Shqipërisë. Konkretisht u miratuan 21 agjentë që kryejnë veprimtarinë e agjentit për transferim të parave për llogari të subjekteve financiare AK-Invest dhe Unioni Financiar i Tiranës. Ky proces do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2010 deri në miratimin e plotë të agjentëve financiarë.

Tabelë 3. Lista e subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë që prej vitit 2001 deri në fund të vitit 2009.

Nr.	Subjektet	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
1	Banka dhe degë të bankave të huaja	13	14	15	16	17	17	18	16	16
2	Subjekte financiare jobanka	4	5	7	7	7	6	6	7	13
3	Zyra të këmbimit valutor	38	58	58	54	58	60	112	189	221
4	Shoqëri të kursim-kreditit		113	131	130	131	125	130	133	135
5	Unione të shoqërive të kursim-kreditit		2	2	2	2	2	2	2	2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

V.3. ZHVILLIMET NË SISTEMIN BANKAR

Ecuria e sistemit bankar gjatë vitit 2009 u kushtëzua nga ambienti i brendshëm ekonomik, nga zhvillimet jo pozitive në ekonomitë e partnerëve tanë kryesorë duke krijuar rritje të pasigurive, sjellje më të kujdesshme për dhënien e kredive dhe realizimin e investimeve, si dhe rënie të konsumit. Megjithë ambientin e vështirë ekonomik dhe financiar, përshtatshmëria e nivelit të kapitalit rregullator ndaj shkallës së rreziqeve, kryesisht rrezikut të kredisë, ka mbetur përgjithësisht e balancuar si rrjedhojë e ruajtjes së niveleve dukshëm mbi minimumin rregullator të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Sistemi bankar në fund të vitit 2009, ka pësuar rritje të totalit të aktiveve, por me një ritëm më të moderuar se një vit më parë, rreth dy herë më të vogël. Ai vijon të financohet kryesisht nga depozitat e publikut dhe të jetë i përqendruar në aktivitetin e kredidhënies, kryesisht për bizneset. Burimet e sistemit dhe investimet në këndvështrimin e depozitave dhe kredive u rritën, por me një normë më të ulët se vitet e kaluara. Rritja e depozitave si pasojë e rikthimit të besimit të publikut dhe stabilizimit të situatës duket se ka rikuperuar rënie e tyre gjatë tremujorit të katërt të vitit 2008. Ndërkohë, analiza tregon se ka qenë nënçmimi i lekut kundrejt valutave që ka dhënë një impakt pozitiv të rëndësishëm në rritjen e këtyre treguesve.

Zhvillimet tregojnë për një rritje të ekspozimit të sistemit bankar ndaj rrezikut të kredisë si shprehje e rritjes së peshës së portofolit të kredive ndaj totalit të aktiveve, por jo vetëm. Kreditë me probleme kanë pësuar një rritje të shpejtë dhe cilësia e portofolit të kredive u përkeqësua ndjeshëm. Për rrjedhojë, rentabiliteti i sistemit bankar i vlerësuar nëpërmjet kthimit nga aktivet u përkeqësua, në sajë të rritjes së madhe të shpenzimeve për provigjone të humbjeve nga huatë. Nivelet e përlogaritura dhe dinamika e tyre janë në

mbikëqyrje të vazhdueshme nga Banka e Shqipërisë, duke vlerësuar implikimet e tyre dhe duke përgatitur masat e nevojshme.

Treguesit	Dhjetor'06	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Dhjetor '09
Rezultati neto (pas tatimit)	7.45	9.98	7.33	3.54

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4. Rezultati neto në miliardë lekë.

Performanca e sistemit bankar për vitin 2009, në këndvështrimin e rezultatit neto ka qenë dukshëm më e dobët sesa gjatë vitit 2008. Rezultati neto i realizuar gjatë vitit 2009 ka qenë rreth 52% më i vogël, ku shpenzimet për provigjone nga kreditë kanë qenë përcaktuese. Në të kundërt, rezultati neto operacional është rritur me rreth 1.9%, çka tregon se bankat në përgjithësi kanë arritur të gjenerojnë një rezultat neto të qëndrueshëm nga aktivitetet kryesore dhe një volum të qëndrueshëm aktiviteti bankar si shprehje e qëndrueshmërisë së rezultatit neto nga aktivitetet e tjera. Për rrjedhojë, vlerësojmë se rezultati neto ka vijuar të ruajë të njëjtën ndërvarësi nga rezultati neto i gjeneruar nga aktivitetet kryesore, si dhe një vit më parë.

Krahasuar me fundin e vitit 2008, niveli i NIM (marzhi neto nga interesat) ka pësuar rënie, që vjen kryesisht prej rritjes së komponentit që përcakton koston e financimit të aktiveve që sjellin interes. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e strategjisë së disa bankave për të ruajtur pjesën e tregut duke paguar më shumë për të shmangur rënien e mëtejshme të depozitave dhe për të kthyer potencialisht pjesën e humbur të tyre. Nga ana tjetër, edhe pse gjatë vitit të kaluar ka mbizotëruar një tendencë e qartë në rënie e normave bazë të interesit, veçanërisht për monedhat e huaja që janë aktive në bilancin e bankave të sistemit, vihet re një mungesë pasqyrimi në aktivet që fitojnë interesa përse kohë perceptimi i rrezikut të kredisë nga ana e bankave ndaj kundërpartive ka mbetur përgjithësisht i pandryshuar.

Tabelë 5. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative).

Treguesit	Dhjetor'06	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Dhjetor'09
Të ardhura nga interesat / aktive mesatare që sjellin të ardhura(1)	7.05	7.26	8.06	8.1
Shpenzime për interesa / aktive mesatare që sjellin të ardhura(2)	2.83	3.17	3.94	4.06
Marzhi neto nga interesat (NIM)[(1) – (2)]	4.22	4.09	4.13	4.04

Burimi: Banka e Shqipërisë.


Treguesi i RoAA deri në fund të nëntë muajve të parë të vitit përlloragitej në nivele shumë të ulta, por pozitive. Gjatë kësaj periudhe, treguesi ka qenë në nivele të qëndrueshme duke variuar në intervalin 0.13 – 0.16% si rrjedhojë e shpenzimeve të larta dhe relativisht të qëndrueshme për provigjonet nga kreditë, për të arritur nivelin më të lartë në tremujorin e fundit të vitit. Gjithashtu, vlen të theksojmë se RoAA asnjëherë nuk u ngjiti në nivelin e vitit 2008.

Treguesit	Dhjetor'06	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Dhjetor '09
RoAA	1.36	1.48	0.91	0.42
RoAE	20.17	20.32	11.35	4.58

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Tregues të përfitueshmërisë të sistemit bankar (në përqindje).

Grafik 1. Peshat e grupbankave në sistem sipas totalit të aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i efikasitetit tregon pothuaj të njëjtin nivel me një periudhë më parë, si edhe me fundin e vitit 2008, si rrjedhojë e rritjes së krahasueshme të shpenzimeve operacionale ndaj të ardhurave operacionale. Kjo dinamikë tregon për kujdes dhe një rritje të qëndrueshme të aktivitetit bankar në tërësi.

Sistemi bankar ka prezantuar gjatë vitit 2009 rritje të totalit të aktiveve me rreth 52.2 miliardë lekë ose me 6.25%, duke treguar moderim të ritmit të rritjes gjatë këtij viti kundrejt rritjes prej 91.8 miliardë lekë ose me 12.4% të prezantuar gjatë vitit paraardhës. Rritja në terma absolutë është rezultat kryesisht i ndryshimeve të ndodhura në bankat e mëdha (G3), të pasuara nga bankat e mesme (G2) dhe në fund nga bankat e vogla (G1).

Shkalla e ndërmjetësimit të sistemit bankar në ekonomi dhe kontributi i aktivitetit të kredihënies duket të jenë rritur ndër vite si shprehje e rritjes së totalit të aktiveve dhe kredive² ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Këta tregues përllogariten në fund të vitit 2009, në nivelet përkatësisht 77.5% dhe 39.3%, nga 76.7% dhe 36.5% një vit më parë.

Tabelë 7. Pësja e totalit të aktiveve dhe portofolit të kredive të sistemit bankar ndaj Produktit të Brendshëm Bruto.

Treguesi	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Totali i aktiveve (në mld lekë)	318.5	339.3	373.6	426.4	496.6	624.3	742.9	834.1	886.3
Totali i aktiveve/PBB (në %)	54.6	54.5	53.8	56.8	60.9	70.8	76.8	76.7	77.5
Totali i kredive/PBB (në %)	4.8	6.3	7.3	9.3	15.7	22.4	30.2	36.5	39.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerat e treguesit Herfindahl, të përllogaritura përkatësisht për totalin e aktiveve, depozitave dhe kredive, tregojnë për nivele të qëndrueshme. Vlerat e tij vazhdojnë të jenë ende larg nivelit optimal të përqendrimit, por ndër vite prezantohet një prirje drejt këtij niveli.

Tabelë 8. Indeksi H (Herfindahl) i përqendrimit të aktiveve, depozitave dhe kredisë.

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Indeksi H (aktivet)	0.30	0.27	0.21	0.18	0.15	0.15	0.14
Indeksi H (depozita)	0.35	0.31	0.24	0.20	0.17	0.17	0.16
Indeksi H (kredia)	0.15	0.11	0.10	0.11	0.11	0.12	0.11

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Viti 2009 vijon të prezantojë rritje të kredihënies, e cila përllogaritet me 53.1³ miliardë lekë ose me rreth 13.4%, krahasuar me 104.3 miliardë lekë ose me rreth 35.7% të vitit 2008. Ndërkohë gjatë vitit 2009, rritja tremujore ka qenë e luhatshme ku niveli më i ulët u shënua në tremujorin e dytë.

Rritja tremujore e kredisë	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Tremujori IV
Në milionë lekë	20,845.2	4,404.1	15,704.7	12,168.8
Në %	5.3	1.1	3.7	2.8

Tabelë 9. Rritja tremujore e kredisë gjatë vitit 2009.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Si rrjedhojë e ritmit disa herë më të lartë të rritjes së kredive me probleme ndaj rritjes së tepicës totale të kredisë gjatë vitit 2009, konkretisht 78.9%⁴ kundrejt rreth 13.4%, u evidentua një rritje e shpejtë e treguesit të cilësisë së portofolit të kredive “kredi me probleme ndaj tepicës totale të kredive” nga niveli 6.64% në fundvitin 2008, në 10.48% në dhjetor 2009. Ky tregues mbi baza neto llogaritet në nivelin 5.4% dhe në terma relative gati 70% më i lartë nga niveli 3.9% në fundin e vitit 2008.

Ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë për individët dhe bizneset vlerësohet e përkeqësuar gjatë vitit 2009. Portofoli i kredisë për biznese shfaqti rritje të raportit të kredisë me probleme ndaj totalit në 12.3% kundrejt 7.6% një vit më parë. Ky tregues për individët përllogaritet rreth 8.2% nga rreth 5.5% në dhjetor 2008. Ndërkohë, portofoli i kredive në valutë shfaqet disi më problematik në drejtim të cilësisë së tij krahasuar me portofolin në monedhën vendase. Treguesi i cilësisë për këto portofole shënoi përkatësisht nivelin 10.6% dhe 10.1%.

Gjatë vitit 2009, rritja e kapitalit të paguar në dhjetë banka, e shoqëruar edhe nga disa ndryshime strukturore në pronësinë e kapitalit të bankave, u reflektua në një rritje të dominimit të kapitalit të huaj. Në total, kapitali i huaj i sistemit është rritur 9.28 miliardë lekë (18.5%), përkundrejt rritjes me 474.6 milionë lekë (10.5%) të kapitalit shqiptar. Pesha e kapitalit të huaj ndaj kapitalit të sistemit u rrit në 92.3%, nga 91.8% në fund të vitit 2008. Kapitali me origjinë nga Bashkimi Evropian përfaqëson pjesën dërrmuese të kapitalit të sistemit, rreth 75.5%.

Në fund të vitit 2009, kapitali aksioner i sistemit paraqitet në nivelin 84.9 miliardë lekë. Gjatë këtij viti, rritja e tij vlerësohet 13.4 miliardë lekë (18.7%), kundrejt rritjes 15.4 miliardë lekë (27.5%) gjatë vitit 2008. Pesha e tij ndaj totalit të pasiveve përgjatë një viti është rritur me 1 pikë përqindjeje, duke arritur në 9.6%. Ecuria e kapitalit aksioner ndër vite ka ardhur vetëm në rritje, ndërsa dy vitet e fundit ritmet e rritjes kanë qenë më të ngadalta krahasuar me vitet e shkuara. Në kushtet kur edhe kapitali i paguar i sistemit, si komponenti kryesor i kapitalit aksioner ka njohur vetëm rritje, ngadalësimi i rritjes së tij duket të jetë shkaktuar nga përkeqësimi i rezultatit neto të sistemit.

Raporti i aktiveve mbi kapitalin aksioner të sistemit ose leva financiare, u zvogëlua gradualisht gjatë vitit 2009. Rënia e levës nga 11.7 në 10.4 përgjatë një viti, do të thotë se sistemi është mbështetur më pak në borxh për financimin e aktiveve. Leva e sistemit bankar në Shqipëri vijon të mbetet e ulët krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian.

Totali i kapitalit rregullator të sistemit bankar raportohet 81.3 miliardë lekë, në fund të dhjetorit 2009. Krahasuar me një vit më parë ai është rritur

me 22.7 miliardë lekë (ose 37.7%). Kapitali bazë vijon të dominojë në përbërjen e kapitalit rregullator të sistemit, duke zënë 94.4%, nga 94.6% të një viti më parë, ç'ka tregon për një kapital rregullator cilësisht të mirë dhe të qëndrueshëm.

Në fund të dhjetorit 2009, pesha e kredisë neto me probleme ndaj kapitalit rregullator të sistemit përlogaritet 28.2%, nga 21.7% në fund të vitit të kaluar dhe 9.9% në fund të dhjetorit 2007. Rritja vjetore e treguesit është rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të kredisë me probleme neto (52.3%), përkundrejt rritjes së kapitalit rregullator (37.7%). Për rrjedhojë, aftësia e sistemit për të mbuluar me kapital rregullator humbjet potenciale nga kredia rezulton të jetë kufizuar përgjatë një viti.

Tabelë 10. Ecuria e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar.

Treguesit	Dhjetor 2005	Dhjetor '06	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Dhjetor '09
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në %	18.6	18	17.1	17.2	16.2

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ka rënë me 1 pikë përqindjeje, duke u evidentuar në 16.2%. Treguesi i mjaftueshmërisë vijon të tregojë nivele më të larta në grupin e bankave të vogla G1. Ndërsa dy grupet e tjerë shfaqin vlera më të ulëta të tij.

Tabelë 11. Ecuria e treguesit kredi ndaj depozitave në përqindje.

Vitet	ALL	EURO	USD	Të gjitha monedhat
2006	17	98	36	38
2007	22	97	34	46
2008	30	112	34	62
2009	36	113	71	65

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një tregues tjetër i rëndësishëm i cili ndihmon në dhënien e një panorame sa më të plotë të situatës së likuiditetit në sistemin bankar është "kredi ndaj totalit të depozitave". Ky tregues në të gjitha monedhat është rritur me gati 3 pikë përqindje përgjatë një viti (nga 62%, në 65%). Vlerat më të larta vazhdojnë t'i shfaqin ato banka, që financohen në një masë të konsiderueshme me fondet nga bankat mëma.

Treguesi kredi/depozita për sistemin tonë bankar akoma prezantohet në nivele të ulëta në rast se krahasohet me shumicën e vendeve të rajonit apo me vendet e Bashkimit Evropian. Norma e ulët e treguesit për Shqipërinë është e lidhur me strukturën e thjeshtë të burimeve të bankave tona, ku përgjithësisht dominojnë depozitat, kurse borxhi i marrë qoftë nga bankat brenda vendit apo jashtë vendit është i kufizuar.

V.4. INSPEKTIMET NË VEND

V.4.1. VEPRIMTARIA E FUNKSIONIT TË MBIKËQYRJES NË VEND

Zyra e Inspektimeve është përgjegjëse për vlerësimin e aktivitetit të bankave dhe për kontrollin e respektimit të kuadrit ligjor e rregullativ nga ana e tyre. Puna e kryer bazohet në objektivin për të garantuar zhvillimin e një aktiviteti të shëndoshë financiar. Organizimi i punës është bërë në bazë të përcaktimeve të ciklit mbikëqyrës të vendosur nga politika operative e mbikëqyrjes. Si një hallkë e rëndësishme e përmbushjes së misionit të Bankës së Shqipërisë, ajo ka ushtruar funksionet e saj duke iu përmbajtur parimeve mbikëqyrëse, duke i qartësuar, thelluar e respektuar ato.

Gjatë vitit 2009, aktiviteti i subjekteve të licencuara i është nënshtruar një analize të thelluar, sidomos në drejtim të nevojave për likuiditet. Kjo ka kërkuar angazhim intensiv të burimeve njerëzore. Si rrjedhojë, përveç respektimit të ciklit mbikëqyrës, është mbajtur një kontakt i vazhdueshëm me bankat për fenomene që kanë përbërë shqetësim mbikëqyrës gjatë vitit. Janë marrë masa për adresimin në kohë të fenomeneve të shfaqura, veçanërisht për çështjet e menaxhimit të situatës së likuiditetit dhe cilësisë së portofolit të kredive.

V.4.2. BASHKËPUNIMI ME AUTORITETE TË TJERA

Bashkëpunimi me institucione të ndryshme të cilat monitorojnë aktivitete të veçanta të tregut financiar ka vijuar të funksionojë në mënyrë eficiente dhe këtë vit. Nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare janë marrë informacione dhe janë kryer inspektime të përbashkëta që prekin shoqëritë e sigurimeve dhe marrëdhëniet e këtyre të fundit me autoritetin mbikëqyrës.

Është bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Departamenti i Mbikëqyrjes ka qenë i pranishëm në takimet e organizuara në kuadrin e projektit të binjakëzimit me homologun gjerman dhe të financuar nga Komuniteti Evropian. Roli i Zyrës së Inspektimeve ka qenë mjaft i rëndësishëm veçanërisht në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Hetimin e Krimin Financiar, pjesë e rëndësishme e të cilit është edhe puna institucionale për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Me iniciativën e Bankës Qendrore Evropiane janë ngritur kolegje të supervisorëve për koordinimin e punës, shkëmbimin e informacionit dhe mbikëqyrjen e përbashkët të institucioneve të mëdha bankare e financiare evropiane me disa autoritete mbikëqyrëse të vendeve ku e kanë origjinën këto institucione. Në këtë kuadër jemi bërë pjesë e katër kolegjeve të supervisorëve për mbikëqyrjen e institucioneve, për të cilat është nënshkruar një prej marrëveshjeve përkatëse dhe është në proces nënshkrimi i marrëveshjeve të tjera. Pavarësisht nënshkrimit të marrëveshjeve, pjesëmarrja ka qenë e plotë që në fillimin e punës së këtyre kolegjeve.

V.4.3. INSPEKTIME TË KRYERA GJATË VITIT 2009

Inspektimet e kryera gjatë vitit 2009 përmbledhen në tabelën më poshtë.

Tabelë 12. Inspektimet e kryera gjatë vitit 2009.

Lloji i institucionit financiar	Inspektime të kryera
Banka	7 inspektime të plota 9 inspektime tematike
Institucione financiare jobanka	4 inspektime të plota
Shoqëri kursim – krediti	1 inspektim i plotë
Ambiente fizike të degëve dhe agjencive të bankave dhe të zyrave të këmbimit valutor	75 inspektime

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- **SUBJEKTET BANKARE**

Gjatë vitit 2009, sistemi bankar është përballur me situata të vështira në drejtim të nevojave për likuiditet dhe përkeqësimin të cilësisë së portofolit të kredisë. Në fillim të vitit, Zyra e Inspektimeve ka kryer analiza të veçanta për situatën e likuiditetit për të gjitha bankat e sistemit dhe njëkohësisht ka organizuar takime me drejtuesit e lartë të të gjitha subjekteve bankare në vend. Qëllimi i këtyre takimeve ishte marrja e gjithë informacionit të nevojshëm mbi gjendjen e likuiditetit të bankave, masave të marra nga secila prej tyre për përballimin e situatës dhe përgatitjen për administrimin e situatave të jashtëzakonshme. Gjatë këtyre analizave dhe takimeve janë marrë në konsideratë edhe probleme të tjera që mund të ishin problematike për banka të veçanta. Në veçanti bankave iu kërkua të mbështesin në mënyrë të vazhdueshme me kredi ekonominë shqiptare për të ruajtur tendencën e rritjes së kredisë të viteve të fundit.

Në ekzaminimet e kryera, fokus të veçantë ka patur mënyra e menaxhimit të likuiditetit në kushtet e tërheqjes së depozitave nga klientët. Përveç kësaj, rëndësi i është kushtuar edhe analizës së shkaqeve të përkeqësimin të cilësisë së kredisë dhe mbështetja e aktivitetit kreditues nga strukturat e bankave. Gjithashtu, objekt i rëndësishëm i ekzaminimeve ka qenë niveli i kapitalizimit dhe parashikimeve të nevojave për burime financimi në kushtet e gërryerjes së kapitalit nga kreditë me probleme dhe pritshmëritë për kushte të vështira ekonomike në vend dhe në rajon.

Nga mbikëqyrja në vend janë evidentuar problematika që lidhen kryesisht me menaxhimin e rreziqeve. Kështu, disa institucione të sistemit bankar janë përballur me pasojat e standardeve më të lehtësuara të kredidhënies gjatë viteve të fundit. Në disa raste janë vërejtur dobësi në sistemet e brendshme të kontrollit, në drejtim të thyerjes së limiteve të aprovimit të kredive dhe monitorimit në kohë të kredive problematike. Gjithashtu, është kërkuar që strukturat e brendshme të kontrollit, si Auditori i Brendshëm ashtu edhe Komiteti i Kontrollit, të orientohen më tepër në kontrollet e kryera drejt aktiviteteve më me rrezik të bankës. Rol të rëndësishëm në menaxhimin e rreziqeve vlerësohen të kenë edhe sistemet informatike të bankave. Disa nga sistemet informatike kanë natyrë të lartë operacionale dhe në disa raste kanë paraqitur vështirësi në dhënie të informacionit në kohë dhe me efikasitet, duke mbartur kështu rreziqe operacionale. Në përgjithësi është konkluduar se

ka nevoja reale për sisteme informatike të reja apo module të ndryshme për të mbështetur aktivitetet kryesore bankare.

Sistemi bankar përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kuadrin rregullativ të Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, janë evidentuar disa mangësi në drejtim të administrimit të rrezikut të kredisë, forcimit të kontrolleve të brendshme, kontrollit të riskut operacional, përputhshmërisë ndaj treguesit bazë të Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, ekspozimit ndaj rreziqeve të mëdha, transparencës me klientin etj.

Më konkretisht, nuk janë respektuar:

- Ligji "Për Bankat", ku janë evidentuar raste të shkeljes së limiteve për ekspozimet e bankave ndaj palëve të lidhura me to, si edhe ekspozimet ndaj palëve të treta të lidhura midis tyre. Gjithashtu, nuk janë respektuar dhe disa kërkesa të ligjit për dokumentacionet e nevojshme në transaksionet e kredisë. Ka pasur mangësi edhe në elemente të procedurave për emërimin e administratorëve, si edhe rënie të kapitalit rregullator nën nivelin e licencuar të kapitalit fillestar minimal.
- Rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë". Rreziku i kredisë ka qenë në fokus të veçantë të grupeve të inspektimit. Nga pikëpamja e autoritetit mbikëqyrës, niveli i rrezikut të kredisë të ndërmarrë në disa raste ka rezultuar të jetë më i lartë sesa vlerësonin bankat. Në këtë kuadër, janë kërkuar përmirësime të vazhdueshme të procedurave dhe manualeve të brendshme të kredidhënies, si dhe analiza lidhur me cilësinë e portofolit dhe plane veprimi për mbajtjen nën kontroll të rrezikut të kredisë.
- Rregullorja "Për mjaftueshmërinë e kapitalit". Kanë rezultuar disa pasaktësi në zbatimin e kërkesave rregullative në përcaktimet e rrezikut për grupe aktivesh të caktuara, por pa rëndësi materiale. Në përputhje me rregulloren në fjalë është propozuar të rritet pragu minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit aty ku është parë e nevojshme.
- Rregullorja "Për veprimtarinë valutore". Vërejtjet në zbatimin e kësaj rregulloreje lidhen kryesisht me qëllimin e transfertave dhe dokumentacionin mbështetës.
- Rregullorja "Për parandalimin e pastrimit të parave". Rekomandimet kanë qenë të lidhura me disa vërejtje mbi parandalimin e transaksioneve të dyshimta, trajnimin e personelit, krijimin e një baze të dhënash të klientëve dhe zbatimin e kërkesave të ligjit të ri që ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2008.
- Rregullorja "Për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë". Në zbatim të kësaj rregulloreje janë kërkuar përmirësime në drejtim

të vlerësimit të sistemeve, dokumentimit të veprimtarisë, planit të rikuperimit në rast fatkeqësie. Gjithashtu, është rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme kontrolli i sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga shoqëri apo struktura të specializuara.

- Rregullorja “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare” si dhe rregullorja “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët”. Rastet e mosrespektimit kanë të bëjnë me dhënien e informacionit paraprak klientëve në rastin e kreditimit, njoftimin e klientëve në rastet e ndryshimit të kushteve të produkteve, publikimin e normës efektive të interesit (NEI), si dhe plotësinë e informacionit të përmbledhur në kontrata.

• *SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA DHE ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR*

Në këtë grupim përfshihen dy lloje subjektësh, institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Ndërsa të parat nuk mund të grumbullojnë depozita nga publiku, të dytat mund të grumbullojnë depozita në bazë të përcaktimeve të ligjit përkatës.

Gjatë vitit 2009, duke pasur parasysh situatën e post krizës financiare të ndodhur në tremujorin e fundit të vitit 2008, fokusi mbikëqyrës dhe burimet e angazhuara kanë qenë të orientuara kryesisht në ekzaminimet e bankave si për ekzaminime të plota ashtu dhe tematike apo të pjesshme për vetë peshën dhe rëndësinë që ato kanë në sistemin financiar, por në asnjë moment nuk janë anashkaluar dhe subjektet financiare jobanka. Ndërkohë, ka munguar inspektimi i zyrave të këmbimit valutor.

Ndër problematikat më të shpeshta të ndeshura në ekzaminimet e kryera janë:

- Moslogaritja e saktë dhe mosrespektimi i normave mbikëqyrëse, të përcaktuara në rregulloret e hartuara për funksionimin e tyre. Këto norma mbikëqyrëse janë kryesisht të lidhura me nivelet e rrezikut.
- Nevojat për përmirësim të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe punës së njësisë së kontrollit të brendshëm.
- Proceset e mbetura pezull në lidhje me raportimin e informacionit të saktë në Zyrën e Regjistrimit të Kredive.
- Funksionimi i të gjitha strukturave në bazë të kuadrit të brendshëm rregullativ.
- Investimi në sisteme të teknologjisë së informacionit dhe respektimi i kërkesave të rregullores për teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, për krijimin e sigurisë së nevojshme të funksionimit normal të aktivitetit.

SHËNIME

¹ Referencat numerike për secilën rregullore janë listuar në kapitullin VI.7 “Ndryshime të bëra në legjislacionin bankar gjatë vitit 2009”.

² Totali i kredive i referohet portofolit në total të kredive duke përfshirë edhe kredinë për ndërmarrjet shtetërore si dhe kredinë për jorezidentët.

³ Treguesi i kredihënies i referohet ecurisë së portofolit në total të kredisë të bankave sipas bilancit të raportuar në lekë duke përfshirë edhe efektin e kursit të këmbimit.

⁴ Rritja e kredive me probleme gjatë vitit 2009 përlogaritet në nivelin 20.8 miliardë lekë.



½ lek. Monedhë nikeli, emetim i vitit 1926.

KAPITULLI VI. AKTIVITETE TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

VI.1. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE

Në Republikën e Shqipërisë, klerimi dhe shlyerja e pagesave ndërmjet bankave, në monedhën kombëtare Lek, realizohet nëpërmjet dy sistemeve të pagesave: “Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS” dhe “Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH”. Gjatë vitit 2009, sistemet e pagesave kanë reflektuar siguri dhe eficiencë, karakteristika të domosdoshme për funksionimin normal të tyre, njëkohësisht dhe ndër objektivat kryesorë të Bankës së Shqipërisë. Aktualisht, të gjitha bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë janë pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në sistemin AIPS, nga të cilat 15 banka janë pjesëmarrëse të drejtpërdrejta edhe në sistemin AECH.

- *SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE - AIPS*

Një total prej 55,701 transaksione pagesash u shlyen në sistemin AIPS gjatë vitit 2009, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 85 milionë lekë. Kundrejt vitit 2008, volumi i pagesave të shlyera në vitin 2009 rezulton të jetë ulur me 2%, ndërkohë që vlera e transaksioneve të shlyera është ulur me 8%.

Sistemi AIPS	2007	2008	2009
Numri i transaksioneve	45,480	56,717	55,701
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,745	5,146	4,718
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	82	91	85

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Ecuria e transaksioneve në AIPS për periudhën 2007-2009.

Numri më i madh i transaksioneve të shlyera është përqendruar në tremujorin e dytë të vitit, ndërkohë që qarkullimi më i madh i likuiditetit rezulton në tremujorin e tretë të vitit 2009. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar dhe shlyer rreth 225 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej 19 miliardë lekësh. Vlera totale e likuiditeteve të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2009, rezulton të jetë rreth 4.3 herë vlera e produktit të brendshëm bruto (PBB) për vitin.¹

Sistemi AIPS	Tremujori				Total 2009
	I	II	III	IV	
Numri i transaksioneve	13,303	14,479	14,036	13,883	55,701
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	1,118	1,131	1,255	1,214	4,718
Vlera mesatare/transaksion (milionë lekë)	84	78	89	87	85

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 2. Shpërndarja e transaksioneve në AIPS sipas tremujorëve të vitit 2009.

Një analizë më e detajuar e tipeve të transaksioneve të procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2009, si dhe pesha e tyre relative ndaj totalit të aktivitetit, paraqitet në tabelën në vijim. Nga transaksionet e procesuara dhe të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2009, vihet re se rreth 53% të numrit të transaksioneve e zënë pagesat që bankat shlyejnë ndërmjet tyre për llogari të klientëve të tyre, përfshirë këtu dhe pagesat që bankat transferojnë çdo ditë në llogarinë e buxhetit të shtetit për llogari të klientëve.

Tabelë 3. Llojet e transaksioneve në AIPS.

Lloji i transaksioneve në AIPS	Volum		Vlerë (miliardë lekë)	
	Numri i transaksioneve	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Transaksione/instrumente financiare të BSh	3,406	6.1%	2,702.3	57.3%
Transferta cash për/nga emisioni	9,151	16.4%	249.2	5.3%
Pagesa ndërbankare (MT202)	7,903	14.2%	768.7	16.3%
Pagesa për klientët (MT103)	29,456	52.9%	449.7	9.5%
Shlyerje neto për sistemet e klerimit	5,785	10.4%	548.4	11.6%
Totali	55,701	100%	4,718	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket vlerës së transaksioneve të shlyera në AIPS, qarkullimin më të lartë të likuiditetit, mbi 57% ndaj totalit, e zënë transaksionet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë, për përmbushjen e objektivave të saj ligjore. Në zërin “shlyerje neto për sistemet e klerimit” përfshihen transaksionet për shlyerje neto, të rezultateve nga sistemet e klerimit si: klerimi i pagesave me vlerë të vogël në sistemin AECH, klerimi i çeqeve bankare dhe personale në lek, shlyerjet neto për emetimin/maturimin e letrave me vlerë të qeverisë dhe shlyerjet neto të rezultateve të pagesave në lek me karta VISA, shërbime për të cilat Banka e Shqipërisë luan rolin e agjentit shlyerës.

Treguesi i përqendrimit reflekton peshën që zënë 3 dhe 5 bankat më aktive në sistemin AIPS, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem. Siç shihet dhe nga tabela në vijim, 5 banka (përfshirë dhe Bankën e Shqipërisë) kanë iniciuar gjatë vitit 2009 rreth 61% në numër dhe 86% në vlerë të transaksioneve, kundrejt totalit të aktivitetit në AIPS.

Tabelë 4. Treguesit e përqendrimit për sistemin AIPS.

Sistemi AIPS	Volum transaksionesh	Vlerë transaksionesh
	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka	48%	73%
5 banka	61%	86%
Totali (vlerë absolute miliardë lekë)	55,701	4,718

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009, përdorimi i kredisë brenda ditës (në formën e kredisë së kolateralizuar me interes zero) nga pjesëmarrësit në sistemin AIPS, ka rënë ndjeshëm krahasuar me vitin 2008, respektivisht me 64% në numër dhe 46% në vlerë. Rënia është kryesisht rezultat i ndryshimit të politikës së Bankës së Shqipërisë për rritjen e limitit (nga 20% në 40%) të përdorimit nga bankat të rezervës së detyruar në lekë, për nevoja likuiditeti gjatë ditës me qëllim garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit.

Kredi brenda ditës (ILF)	2007	2008	2009
Numri i transaksioneve	675	579	207
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	218	221	121
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	322	382	582

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 5. Kredia brenda ditës për pjesëmarrësit në sistemin AIPS.

• SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL - AECH

Një total prej 102,304 urdhërpagesa u kleruan në sistemin AECH gjatë vitit 2009, me një vlerë mesatare për transaksion të shlyer prej 150 mijë lekësh. Kundrejt vitit 2008, volumi i pagesave të kleruara gjatë vitit 2009, rezulton të jetë ulur me 10%, ndërkohë që vlera e transaksioneve të kleruara është ulur me 12%.

Sistemi AECH	2007	2008	2009
Numri i transaksioneve	71,857	113,682	102,304
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	12.01	17.61	15.46
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.17	0.15	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6. Ecuria e pagesave në AECH për periudhën 2007-2009.

Në sistemin AECH procesohen dhe klerohen pagesat e klientëve me vlerë nën 1 milion lekë. Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AECH janë procesuar rreth 413 pagesa, me një vlerë mesatare ditore prej 62.33 milionë lekë. Volumi dhe vlera më e madhe e transaksioneve të kleruara në AECH, vërehet në tremujorin e katërt të vitit 2009.

Sistemi AECH	Tremujori				Viti 2009
	I	II	III	IV	
Numri i transaksioneve	22,318	27,478	23,506	29,002	102,304
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3.50	4.03	3.63	4.30	15.46
Vlera mesatare /transaksion (milionë lekë)	0.16	0.15	0.15	0.15	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 7. Shpërndarja e pagesave në AECH sipas tremujorëve të vitit 2009.

Pagesat e kleruara në sistemin AECH, procesohen gjatë ditës së punës, në dy seksione (seksioni I - nga ora 09.00 deri në 11.00; dhe seksioni II - nga ora ora 12.00 deri në 14.30), dhe shlyhen për rezultat neto në sistemin AIPS, pas përfundimit të secilit seksion. Vërehet se, gjatë vitit 2009, në seksionin e parë janë kleruar volumi dhe vlera më e madhe e pagesave të iniciuara në këtë sistem.

Sistemi AECH	Seksioni		Viti 2009
	I	II	
Numri i transaksioneve	63,868	38,436	102,304
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	10.06	5.39	15.46
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.16	0.14	0.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Shpërndarja e pagesave në AECH sipas seksioneve të klerimit gjatë vitit 2009.

Treguesi i përqendrimit reflekton peshën që zënë 3 dhe 5 bankat më aktive në sistemin AECH, kundrejt totalit të aktivitetit në këtë sistem. Siç shihet dhe nga tabela në vijim, 5 banka kanë iniciuar gjatë vitit 2009 rreth 61% në numër dhe 67% në vlerë të transaksioneve, kundrejt totalit të aktivitetit në AECH.

Tabelë 9. Treguesit e përqendrimit për sistemin AECH.

Sistemi AECH	Volum transaksionesh	Vlerë transaksion
	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka	43%	46%
5 banka	61%	67%
Totali (vlerë absolute miliardë lekë)	102,304	15,457

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- INSTRUMENTET E PAGESAVE

Në fund të vitit 2009, në Republikën e Shqipërisë operojnë 16 banka, të cilat ofrojnë shërbime pagesash në 530 degë/agjenci bankare në të gjithë vendin, nga të cilat 14 banka janë të licencuara edhe si emetuese kartash, duke ofruar shërbimin e tërheqjes cash nga pajisjet ATM. Nga bankat që emetojnë karta, vetëm 8 banka janë njëkohësisht të licencuara edhe si pranuese kartash, duke ofruar shërbimin e pranimit të pagesave me karta nëpërmjet pajisjeve POS të vendosura në dyqane dhe qendra tregtare. Gjatë vitit 2009, numri i pajisjeve ATM dhe POS për përdorimin e kartave është rritur, përkatësisht me 15 dhe 48%, krahasuar me numrin e tyre në fund të vitit 2008.

Tabelë 10. Numri i pajisjeve ATM dhe POS në 31 dhjetor 2009, krahasuar me fundin e vitit 2008.

Përshkrimi	2008	2009
Makina ATM (Automated Teller Machines)	642	741
prej të cilave:		
1 - ATM me funksion tërheqje cash	642	741
2 - ATM me funksion urdhër transferta	59	66
3 - ATM me funksion depozitim cash	73	74
Terminale POS (Point of Sale)	2,953	4,370
prej të cilave :		
1 - terminale POS me funksion tërheqje cash	907	1,290
2- terminale pagesash EFTPOS	2,915	4,320
Terminale për përdorimin e parasë elektronike	-	-

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Nga raportimet e bankave rezulton se në fund të vitit 2009, numri total i llogarive bankare të klientëve, të vlefshme për të kryer pagesa në lek apo në valutë të huaj, është rritur rreth 33%, krahasuar me fundin e vitit 2008. Nga numri total i llogarive të pagesave, të hapura deri në 31 dhjetor 2009, rreth 93% e tyre janë llogari individuale dhe mbi 99% ndaj totalit janë llogari të rezidentëve.

Përshkrimi i llogarisë	Totali i llogarive të klientëve		Të aksesueshme nga interneti	
	Dhjetor 2008	Dhjetor 2009	2008	2009
Llogaritë e klientëve (1+2)	1,573,830	2,086,143	11,108	15,034
1- llogari të rezidentëve (a+b)	1,564,084	2,074,715	10,751	14,622
a - individuale	1,429,294	1,918,907	6,958	9,598
b - kompani	134,790	155,808	3,793	5,024
2- llogari të jorezidentëve (a+b)	9,746	11,428	357	412
a - individuale	9,311	10,799	314	328
b - kompani	435	629	43	84

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Tabelë 11. Numri i llogarive bankare të klientëve për kryerje pagesash.

Nga totali i llogarive të klientëve, vetëm 15 mijë llogari pagesash janë të aksesueshme nga interneti (*home banking*), për ofrimin e shërbimit të pagesave *online* apo për të kontrolluar gjendjen e llogarisë, nga të cilat rreth 66% i përkasin llogarive individuale. Referuar të njëjtës periudhë, vetëm 27% e totalit të llogarive të klientëve mund të aksesohen në distancë, nëpërmjet përdorimit të një karte debiti ose krediti. Ofrimi i shërbimit të pagesave apo tërheqjes *cash* nga llogaritë e tjera, kërkon domosdoshmërisht praninë fizike të klientëve në sportelet e bankave.

Kartat janë instrumente pagesash që kanë gjetur përdorim në Shqipëri, pavarësisht se shkalla e përdorimit të tyre është ende e ulët krahasuar me treguesit e vendeve të tjera të rajonit. Në 31 dhjetor 2009, vihet re një rritje prej 11% e numrit të kartave në qarkullim, krahasuar me fundin e vitit 2008. Brenda kësaj rritjeje, peshë ka patur edhe shtimi i kartave të kreditit të emetuara gjatë këtij viti, me një rritje prej 50%, kundrejt fundvitit 2008.

Numri i kartave sipas funksioneve	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2009
Karta me funksion <i>cash</i> -i	512,232	566,985
Karta me funksion pagese	498,003	566,985
prej të cilave :		
1- Karta debiti	482,072	543,141
2- Karta krediti	15,931	23,844
Karta me funksion para elektronike	-	-
Numri total i kartave në qarkullim	512,232	566,985
prej të cilave:		
- karta me më shumë se një funksion	498,003	566,985

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Tabelë 12. Numri i kartave bankare në qarkullim në 31 dhjetor 2009, krahasuar me fundin e vitit 2008.

Tabela në vijim pasqyron llojet e transaksioneve të kryera me karta bankare (debiti/kredit), në volum dhe vlerë, krahasuar me të dhënat për vitin e kaluar. Gjatë vitit 2009, në total u procesuan mbi 9 milionë transaksione me karta, me një qarkullim total vjetor prej 102 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 96% e përbëjnë tërheqje *cash* nga ATM, tregues ky i një ekonomie me përdorim të lartë të *cash*-it.

Tabelë 13. Transaksionet e realizuara me karta bankare gjatë vitit 2009, krahasuar me vitin 2008.

Transaksione me karta sipas llojit të transaksionit	Volum		Vlerë (milionë lekë)	
	2008	2009	2008	2009
1- ATM tërheqje cash	7,910,609	8,717,982	89,067.43	96,117.27
2- ATM depozitime	133	91	2.10	2.97
3- Urdhër transfertë nëpërmjet ATM	271	366	9.37	10.02
4- Tërheqje cash në terminale POS	2,999	2,647	451.51	453.86
5- Pagesa me karta në terminale POS	291,131	403,214	4,196.19	5,321.72
prej të cilave :				
- pagesa me karta debiti	187,720	252,780	2,013.71	2,565.67
- pagesa me karta krediti	103,411	150,434	2,182.39	2,756.05
Totali i transaksioneve me karta	8,205,143	9,124,300	93,726.60	101,905.3

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

Gjatë vitit 2009 është rritur në 10 numri i bankave që ofrojnë shërbime "home banking", krahasuar me 6 banka në fund të vitit 2008. Shërbimet e bankingut elektronik nënkuptojnë ofrimin e infrastrukturës së nevojshme klientit për të aksesuar llogarinë bankare nga shtëpia, nëpërmjet një linje interneti, telefoni apo një software-i, që banka i vë në dispozicion klientit.

Tabelë 14. Ecuria e transaksioneve "home banking" për periudhën 2007 – 2009.

Home Banking	2007	2008	2009
Numri i transaksioneve	42,447	88,261	136,482
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	48.49	63.42	78.16

Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".

• ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË SI MBIKËQYRËSE DHE

REFORMATORE E SISTEMIT KOMBËTAR TË PAGESAVE

Roli i bankës qendrore në reformimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave po merr një rëndësi gjithnjë dhe më të madhe në kushtet e turbulencave në tregjet financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë po punon për ndërtimin e një sistemi kombëtar pagesash të sigurt dhe eficient, në mbështetje të zhvillimit të tregut financiar në vend, por njëkohësisht duke synuar shmangien e rreziqeve që sjell ky zhvillim. Drejtimit kryesorë ku është fokusuar puna gjatë vitit 2009, janë:

(i) Forcimi i kuadrit ligjor në funksion të rolit mbikëqyrës për sistemet e pagesave

Hartimi i projektligjit "Për sistemet e pagesave në Republikën e Shqipërisë" është në fazën finale të tij. Projekti synon të përcaktojë një kuadër ligjor të domosdoshëm për funksionimin e sigurt dhe eficient të sistemit kombëtar të pagesave, rolin dhe detyrat e Bankës së Shqipërisë në lidhje me zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjeve në Republikën e Shqipërisë. Projektligji është bazuar në dy direktiva të rëndësishme të BE-së:

- Direktiva 98/26/EEC mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë; dhe
- Direktiva 2002/47/EC mbi kolateralin financiar.

Çështje të rëndësishme që rregullon ky projektligj janë:

- Rregullimi dhe mbikëqyrja e sistemeve, ku synohet të përcaktohet qartë roli i Bankës së Shqipërisë si mbikëqyrëse e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes së titujve, pavarësisht nëse janë sisteme që operohen brenda Bankës së Shqipërisë, apo jashtë bankës nga operatorë privatë, licencimi i subjekteve që operojnë sisteme të pagesave dhe të shlyerjeve në Republikën e Shqipërisë, kompetencat inspektuese dhe vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë për angazhimin në këtë rol etj.;
- Mbrojtja e sistemeve, ku synohet të rregullohen çështje që lidhen me mbrojtjen e sistemeve nga paaftësia paguese e pjesëmarrësve në sistem, karakteri përfundimtar dhe pakthyeshmëria e urdhërpagesave të hyra në sistem, përcaktimi i çastit të hapjes së procedurave për paaftësi paguese të një pjesëmarrësi në sistem etj.;
- Mbrojtja e marrëveshjeve të kolateralit financiar, ku rregullohen koncepte të tilla si vlefshmëria dhe zbatimi i marrëveshjeve të kolateralit financiar në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes, shlyerja e kolateralit financiar të lënë peng dhe të tjera koncepte juridike, rregullimi i të cilave është i domosdoshëm për funksionimin normal të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, nëpërmjet reduktimit të riskut në këto sisteme, por në terma më të përgjithshëm, kontribuojnë në stabilitetin e sistemit dhe të tregjeve financiare në vend.

(ii) Përmirësimi dhe nxitja e ndryshimeve në sistemin kombëtar të pagesave në funksion të rolit reformativ për sistemet e pagesave

Projekti për zbatimin e IBAN-it në Shqipëri, në zbatim të rregullores së miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë me vendimin nr. 42, datë 16.07.2008 "Për Strukturën dhe Përdorimin e Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN)", për standardizimin e numrave të llogarive që përdoren për kryerjen e pagesave në Republikën e Shqipërisë, u zhvillua në dy faza: (a) të gjitha bankat kanë përfunduar standardizimin e numrave të llogarive të klientëve në formatin IBAN, si dhe njoftimin e klientëve, brenda datës 1 qershor 2009; (b) duke filluar nga data 5 janar 2010, të gjitha bankat përdorin dhe kontrollojnë saktësinë e numrave IBAN, për pagesat brenda vendit dhe ato ndërkufitare.

Në vijim të projektit për transferimin automatik të transaksioneve të Thesarit nga Ministria e Financave në sistemet e pagesave, gjatë vitit 2009 është punuar për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme teknike dhe rregullative për vënien në zbatim të projektit. Marrëveshja "Për komunikimin elektronik midis sistemit të Thesarit dhe sistemeve të pagesave AIPS dhe AECH" ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave është nënshkruar në fillim të vitit 2010, duke mundur automatizimin e pagesave të Thesarit dhe fillimin live të projektit nga data 1 mars 2010.


Banka e Shqipërisë vazhdimisht ka dhënë kontributin e saj për reduktimin e pagesave cash në ekonomi, së fundmi nëpërmjet pjesëmarrjes në projektin

“SPI Project on Reducing Cash Transactions”. Projekti, i iniciuar nga SPI Albania, konkludoi me një analizë të detajuar të efekteve financiare në sistemin bankar, nga reduktimi i pagesave cash në ekonomi. Konkluzionet dhe analiza e grupit të punës, kryesuar nga Banka Raiffeisen dhe nga Banka e Shqipërisë, pasi u miratuan nga Komiteti (SPI Committee), në muajin nëntor 2009 janë propozuar në formën e një pakete me rekomandime për miratim dhe zbatim nga sistemi bankar dhe nga institucione të administratës publike.

VI.2. EMISIONI I MONEDHËS

• MONEDHA NË QARKULLIM

Monedha në qarkullim në fund të vitit 2009 arriti vlerën e 216,739,238 mijë lekëve, në krahasim me 203,713,429 mijë lekë në fund të vitit 2008. Rritja më e madhe u konstatua në tremujorin e katërt.



• STRUKTURA E MONEDHËS NË QARKULLIM


Kartëmonedha

Struktura e kartëmonedhës në qarkullim u karakterizua nga një rritje e peshës së prerjeve të mëdha 1000, 2000 dhe 5000 lekë, e diktuar kryesisht nga kërkesat e bankave të nivelit të dytë për të përballuar fluksin e pagesave në rritje dhe mbushjen e bankomateve me prerjet e lartpërmendura. Gjatë vitit 2009, pati një rritje të ndjeshme të kartëmonedhës 2000 lekëshe në qarkullim.

Monedha metalike

Struktura e monedhës metalike edhe këtë vit vazhdoi të orientohet nga një rritje e peshës së


Grafik 2. Struktura e kartëmonedhës.




prerjeve të mëdha 50 dhe 100 lekë. Një nga faktorët kryesorë që ndikoi në këtë rritje ishte përdorimi i këtyre monedhave për të zëvendësuar kartëmonedhën e prerjes 100 lekë e cila kishte kurs ligjor deri më 31 dhjetor 2008 dhe do të hiqet nga qarkullimi në 31 dhjetor 2010.

Grafik 3. Struktura e monedhës metalike.

Struktura e monedhës metalike 31.12.2008



Struktura e monedhës metalike 31.12.2009




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Monedha metalike kundrejt kartëmonedhës


Në fund të vitit 2009, raporti i përgjithshëm midis vlerës së kartëmonedhave dhe monedhave metalike rezultoi më i lartë se vitin e kaluar. Zëvendësimi gradual i kartëmonedhës së prerjes 100 lekë me monedha metalike dhe kërkesat për monedha metalike nga ana e tregtisë me pakicë dhe kryesisht e supermarketeve dhe ipermarketeve të çelura rishtaz, ishin faktorët kryesorë që raportin të ketë një tendencë rritëse, megjithë rritjen e dukshme të kartëmonedhës.

Grafik 4. Raporti i monedhës metalike kundrejt kartëmonedhës.

Monedha metalike ndaj kartëmonedhës në qarkullim 2008



Monedha metalike ndaj kartëmonedhës në qarkullim 2009



Burimi: Banka e Shqipërisë.

- TREGUES TË QARKULLIMIT TË PARASË

Vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim

Vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim në fund të vitit 2009 arriti në 1,163 lekë, nga 1,065 lekë që ishte në fund të vitit 2008.

Cilësia e monedhës në qarkullim

Në zbatim të standardeve bashkëkohore dhe shtimit të shpejtë të numrit të bankomateve në bankat e nivelit të dytë, edhe gjatë vitit 2009, Banka e Shqipërisë tërhoqi nga qarkullimi rreth 24,111 milionë copë kartëmonedha të papërshtatshme për përdorim duke i zëvendësuar ato me kartëmonedha të përshtatshme për përdorim. Një pjesë të konsiderueshme të sasisë së tërhequr e përbëjnë emisionet e periudhës para vitit 1996. Në fund të vitit 2009, emisionet e kësaj periudhe në qarkullim, zënë vetëm 4.57% të kartëmonedhës mesatare në qarkullim. Kartëmonedhat e reja të hedhura në qarkullim në vitin 2009, përfaqësojnë 24.75% të mesatares totale të kartëmonedhave në qarkullim.

VI.3. PUNA KËRKIMORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Disa nga fushat kryesore ku u përqendrua puna e Departamentit të Kërkimeve gjatë vitit 2009, janë: parashikimet dhe zhvillimi i modeleve ekonometrike; çështje të politikës monetare; të sektorit të jashtëm; të stabilitetit financiar; të rritjes ekonomike etj.

Duke vënë në përdorim njohuritë dhe punët studimore disavjeçare mbi ekonominë shqiptare, Departamenti i Kërkimeve ka kontribuar në debatet për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare nëpërmjet *modelit makroekonometrik*, MEAM. Ky makromodel, për herë të parë, është përdorur për të projektuar ecurinë e ekonomisë shqiptare për katër tremujorët në vazhdim. Nëpërmjet këtyre projeksioneve është bërë e mundur të analizohet ecuria e pritshme e kërkesës agregate dhe e përbërësve të saj si dhe presionet inflacioniste në vend. Gjithashtu, nëpërmjet MEAM-it janë ofruar analiza të ndikimit të "goditjeve" (skenarëve) të ndryshme në ekonominë shqiptare si dhe analiza të rreziqeve që lidhen me ecurinë e kursit të këmbimit dhe me efektet e krizës financiare botërore. MEAM-i vazhdimisht është pasuruar me kanale të reja transmetimi. Gjatë vitit 2009, modelit MEAM i është bashkëngjitur edhe sektori fiskal, për të lidhur ndikimin e politikave të ndryshme fiskale në ekonominë reale nga njëra anë, dhe ndikimin e goditjeve të ndryshme të ekonomisë reale në buxhetin e qeverisë, nga ana tjetër.

Në fushën e politikës monetare, janë vlerësuar për rastin e Shqipërisë, peshat relative të normave reale të interesit dhe të kursit real të këmbimit, për të llogaritur Indeksin e Kushteve Monetare, si një indikator që jep informacion mbi situatën e kushteve monetare. Një punim tjetër synoi të matë besueshmërinë e politikave ekonomike, duke u fokusuar në zhvillimet në kërkesën për para dhe luhatshmërinë në tregjet informale të valutës, reflektuar në primin e tregut të zi.

Përsa i takon rezervës valutore, fokusi kryesor ka qenë identifikimi i përcaktuesve kryesorë të saj dhe i nivelit të saj optimal. Vlerësimi i këtij niveli shërben për përcaktimin e një strategjie të qartë të bazuar mbi një objektiv real për rezervat valutore, në përputhje me politikën monetare dhe atë të kursit të këmbimit.

Në lidhje me kursin e këmbimit, kërkimi është fokusuar në dy aspekte kryesore: së pari në identifikimin e një kursi real këmbimi ekuilibër Euro/Lek në periudhën afatmesme; dhe së dyti, në vlerësimin e efektshmërisë së ndërhyrjeve të Bankës Qendrore në stabilizimin e luhatshmërisë afatshkurtër të kursit të këmbimit, duke ulur volatilitetin e padëshiruar të tregut.

Në kuadër të ruajtjes së stabilitetit financiar, u realizua një analizë e detajuar e elementeve përbërëse të rrezikut dhe kthimit, si dhe u sugjerua përdorimi i një indeksi për matjen e rrezikut të përgjithshëm të sistemit bankar. Në të njëjtën linjë u krijuan edhe modele të reja të matjes së rrezikut indirekt të kredisë, si në nivel sistemi, ashtu edhe për grupe bankash apo për ekspozime ndaj klientëve të ndryshëm.

Një tjetër çështje e adresuar në punët kërkimore është edhe lidhja shkak-pasojë midis zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike për rastin e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë variablat kyç të ekonomisë për analizimin e politikës monetare. Duke qenë se të dhënat mbi PBB-në tremujore në Shqipëri publikohen me 12 javë vonesë, është i nevojshëm parashikimi i ecurisë së këtij treguesi, para se ai të publikohet. Për këtë qëllim, është punuar mbi ndërtimin e modeleve për parashikimin afatshkurtër në tremujorin aktual të vlerës së PBB-së së vendit. Kjo gjë do të ndihmojë një vendimmarrje të mirinformuar dhe vlerësimin e situatës aktuale ekonomike.

- **PUBLIKIMET**

Një pjesë e mirë e punëve kërkimore dhe materialeve të diskutimit publikohen në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, nën kategorinë “Publikime/Kërkime dhe Materiale Diskutimi”, një seri që përfshin punime që prej vitit 1999 deri në 2009. Shpesh, punimet paraqiten edhe në një formë më të përmbledhur në *Buletin Ekonomik* i cili publikohet me frekuencë tremujore. Në vitin 2009, Departamenti i Kërkimeve filloi të publikojë periodikun gjashtëmujor “*Të Reja Shkencore në Bankën e Shqipërisë*”, i cili i drejtohet të gjithë ekspertëve të kërkimit shkencor brenda dhe jashtë Bankës, si edhe të gjithë atyre që u intereson kjo fushë në punën e përditshme. Ky periodik jep informacion të përmbledhur mbi punët dhe aktivitetet kërkimore të Bankës të përfunduara, si dhe ato që janë ende në proces.

- **AKTIVITETET E ZHVILLUARA**

Në muajin nëntor 2009, në Athinë u mbajt *workshop*-i i 3^{te} i Kërkimeve Ekonomike në Evropën Juglindore, një bashkëpunim mes Departamentit të Kërkimeve të Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Greqisë. Tashmë është shndërruar në traditë që Departamenti i Kërkimeve i Bankës së Shqipërisë të mbledhë çdo vit në një aktivitet të vetin, ekspertë dhe përfaqësues të bankave qendrore të rajonit e më gjerë. Kjo traditë synon të përmirësojë më tej kërkimin ekonomik në rajon, si dhe të zgjerojë njohuritë e bankave qendrore

të rajonit mbi karakteristikat dhe zhvillimet ekonomike të vendeve respektive. Gjithashtu, ky aktivitet kontribuon në rritjen e integritimit dhe bashkëpunimit institucional mes bankave qendrore të rajonit dhe më gjerë.

Në vijim të punës së nisur që prej disa vitesh, edhe gjatë vitit 2009, Departamenti i Kërkimeve vazhdoi të zhvillojë *“Serinë e Seminareve të së Premtes”*, ku gjatë vitit në fjalë u prezantuan 18 punime si nga autorë vendas ashtu edhe të huaj, nga punonjës të Bankës së Shqipërisë dhe nga të tjerë jashtë saj. Ky aktivitet shërben si një mundësi e mirë për të gjithë kërkuesit nga fusha bankare, nga sfera akademike dhe ajo shkencore, për të prezantuar dhe diskutuar materialet e tyre empirike dhe teorike.

VI.4. AKTIVITETET STATISTIKORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Si shumë banka të tjera qendrore, Banka e Shqipërisë zë një rol të rëndësishëm në sistemin statistikor kombëtar, si institucioni përgjegjës për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Roli i Bankës së Shqipërisë si agjenci statistikore, e autorizuar për të mbledhur informacion nga njësitë statistikore, si edhe për të prodhuar dhe publikuar statistika zyrtare rrjedh nga ligji *“Për statistikat zyrtare”*², ligji *“Për Bankën e Shqipërisë”*³ dhe *“Programi i Statistikave Zyrtare 2007-2011”*⁴. Në kryerjen e funksioneve të saj statistikore, Banka e Shqipërisë udhëhiqet nga parimet bazë të statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë që janë: paanshmëria, besueshmëria, pavarësia profesionale, përkatësia, kosto-efektiviteti, konfidencialiteti statistikor dhe transparencja. Gjatë vitit 2009, Banka e Shqipërisë ka vijuar të hartojë dhe të shpërndajë statistika monetare dhe statistika të sektorit të jashtëm, duke u kujdesur të përmirësojë shërbimin statistikor në të gjitha përmasat e tij. Të gjitha njësitë e përfshira në procesin e prodhimit të statistikave, sipas funksionit përkatës, kanë synuar të arrijnë përafrimin e metodologjisë me rekomandimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, rritjen e cilësisë së të dhënave nëpërmjet përmirësimit dhe informatizimit të proceseve të kontrollit, rritjen e numrit të treguesve të publikuar dhe detajimin e treguesve të përbërë, shkurtimin e kohëve të publikimit, standardizimin e tabelave dhe përgatitjen e materialeve shpjeguese në funksion të rritjes së transparencës së materialeve që shoqërojnë publikimet statistikore. Kërkesat e shpeshta dhe në rritje për informacion dhe udhëzime drejtuar njësive statistikore të Bankës së Shqipërisë nga përdorues brenda dhe jashtë vendit, flasin për vlerësimin dhe besimin që ata kanë krijuar në statistikën, që prodhohen nga Banka e Shqipërisë.

IV.4.1. MBULIMI DHE METODOLOGJIA

- *STATISTIKAT MONETARE*

Gjatë muajit dhjetor të vitit 2008 dhe fillimit të vitit 2009 u realizua shkëputja nga formati i mëparshëm i publikimit të treguesve monetarë dhe kalimi në formatin e ri në përputhje me *“Metodikën e statistikave*

monetare dhe financiare”, Banka e Shqipërisë, Korrik 2003⁵. Kjo metodikë mbështetet në “Manualin e statistikave monetare dhe financiare”, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2000. Të dhënat e përgatitura sipas standardeve të këtij manuali fillojnë nga muaji dhjetor i vitit 2002⁶, kanë periodicitet dhe kohëvonesë prej 30 ditësh dhe publikohen çdo fund muaji sipas Kalendarit të Statistikave të Bankës së Shqipërisë.

Aplikimi i standardeve të manualit të ri sjell përmirësime të dukshme në krahasim me aplikimin e standardeve të manualit të mëparshëm. Si një ndër përmirësimet më të rëndësishme mund të përmendet zgjerimi i mbulimit institucional. Ky mbulim shtrihet tashmë në të gjitha institucionet që pranojnë depozita dhe që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Këto institucione janë Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Këto të fundit nuk përfshiheshin në kompilimin e statistikave monetare sipas praktikës së mëparshme.

Një tjetër ndryshim lidhet me sektorizimin dhe klasifikimin e instrumenteve financiare, i cili është në përputhje me Sistemin e Llogarive Kombëtare (SNA), 1993. Të dhënat e hartuara sipas standardeve të reja paraqesin një ndarje më të detajuar të sektorëve ekonomikë rezidentë dhe të instrumenteve financiare. Përmirësime janë bërë edhe në drejtim të terminologjisë së përdorur, e cila është përshtatur me rekomandimet e standardeve ndërkombëtare. Për shembull, emërtimi “aksione dhe instrumente të tjera të kapitalit” ka zëvendësuar emërtimin “llogari kapitale”, ose emërtimi “korporata jofinanciare publike” ka zëvendësuar emërtimin “sektori publik”.

Treguesit në tabelat e reja paraqiten sipas formatit të përcaktuar në Metodikë, format i cili mundëson paraqitjen e detyrimeve të korporatave depozituese dhe mjeteve që ato financojnë; paranë dhe kundërpartitë e saj. Për çdo klasë subjektësh ose korporatë që pranon depozita, përgatitet dhe publikohet paraqitja dhe bilanci sektorial. Përveç tabelave të hollësishme të bilancit sektorial dhe paraqitjes, janë bërë përmirësime në drejtim të shtimit të treguesve dhe tabelave të reja dhe detajimit të tabelave ekzistuese. Publikimi i treguesve monetarë sipas Metodikës së vitit 2003 është shoqëruar me informacione shpjeguese, të publikuara në seksionin përkatës në faqen e Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009 është punuar në drejtim të përmirësimit të cilësisë së treguesve të publikuar, gjë që është arritur duke realizuar zgjatjen prapa në kohë të serive, kontrollin e saktësisë së vlerave të publikuara dhe llogaritjen e treguesve për periudhat e pambuluara me informacion deri në atë kohë. Ky përpunim ka prekur kryesisht seritë e flukseve mujore të depozitave dhe të kredive dhe seritë e normave të interesit. Gjatë këtij viti, bashkësisë së tabelave të publikuara në hapësirën “Seri kohore” iu shtua dhe një grup tabelash të kurseve kryesore të këmbimit, që paraqesin kursin mesatar të muajit dhe kursin në ditën e fundit të muajit. Paralelisht me përmirësimin e publikimit është punuar edhe për ndërtimin dhe përgatitjen për publikim të tabelave të reja, që paraqesin gjendjen në fund të periudhës dhe flukset e kredive dhe depozitave sipas afateve të maturimit, sektorëve institucionalë dhe sektorëve të ekonomisë, qëllimit të përdorimit, monedhave kryesore dhe

rretheve kryesore të vendit. Këto tabela do të publikohen gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2010.

Gjithashtu, në kuadër të iniciativës së përbashkët të vendeve të Evropës Juglindore për ndërtimin e serive statistikore të periudhave të mëparshme historike, janë bërë një sërë kërkimesh në dokumente të vjetër arkivorë. Deri tani është realizuar mbledhja dhe ndërtimi i disa serive kohore për të dhëna monetare, të dhëna të financave të qeverisë dhe të sektorit të jashtëm, seri këto që iu përkasin viteve 1920 - 1950. Këto statistika historike së shpejti do të bëhen pjesë e publikimeve statistikore të Bankës së Shqipërisë dhe do t'i ofrohen përdoruesit së bashku me statistikat korente dhe udhëzimet përkatëse mbi burimin dhe përdorimin e tyre.

- *STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM*

Tërësia e statistikave të sektorit të jashtëm përfaqësohet nga: treguesit e bilancit të pagesave, pasqyra e rezervave ndërkombëtare dhe likuiditetit të monedhës së huaj, importi dhe eksporti i mallrave, pozicioni i investimeve ndërkombëtare, kurset e këmbimit dhe borxhi i jashtëm. Edhe pse ligji "Për Bankën e Shqipërisë" cakton Bankën e Shqipërisë si autoritetin përgjegjës për hartimin e bilancit të pagesave të shtetit shqiptar, lidhja e ngushtë konceptuale dhe metodologjike midis statistikave të bilancit të pagesave dhe statistikave të tjera të sektorit të jashtëm si edhe praktika e ndjekur nga shumë banka të tjera qendrore, kanë bërë që Banka e Shqipërisë të ndërmarrë prej disa vitesh tashmë, mbledhjen, hartimin dhe publikimin e statistikave të borxhit të jashtëm dhe të pozicionit të investimeve ndërkombëtare⁷. Deri në fund të vitit 2009, këto pasqyra së bashku me metodologjitë përkatëse janë publikuar në Faqen Përmbledhëse të të Dhënave Kombëtare (FPDK)⁸, të cilën Banka e Shqipërisë e përditëson në kuadrin e kërkesave të Standardit Special të Shpërndarjes së të Dhënave të FMN-së (SDDS). Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2010, pasqyra e pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe pasqyra e borxhit të jashtëm do të jenë pjesë e publikimeve periodike statistikore të Bankës së Shqipërisë.

BILANCI I PAGESAVE

Gjatë vitit 2009 është punuar si në drejtim të përmirësimeve metodologjike, ashtu edhe në drejtim të përmirësimit dhe pasurimit të analizave statistikore që shoqërojnë publikimin e statistikave të bilancit të pagesave: njoftimet për shtyp dhe buletini vjetor i bilancit të pagesave. Në vazhdimësi është punuar për njohjen e rekomandimeve të Manualit të ri (Edicioni i gjashtë) si edhe për identifikimin e mangësive kryesore. Statistikat e bilancit të pagesave janë prodhuar në përputhje me Metodikën⁹ dhe janë publikuar sipas datave të shpallura në Kalendarin e Statistikave të Bankës së Shqipërisë.

Në rrafshin metodologjik është bërë rishikimi dhe vënia në përdorim e pyetësorit të ri të vrojtimit të ndërmarrjeve me kapital të huaj, në përputhje me metodologjinë e aplikuar nga Kombet e Bashkuara. Gjatë këtij viti, Banka e Shqipërisë u përfshi në "Grupin qendror për mbledhjen dhe krijimin e bazës së të dhënave dhe statistikave për investimet e huaja direkte, aktivitetin e kompanive transnacionale dhe për hartimin e raportit vjetor të investimeve të huaja". Në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Statistikave, Ministrinë e

Ekonomisë, Transportit dhe Energjitikës, Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Albinvest-in dhe institucione të tjera, Banka e Shqipërisë ka ndërtuar një bazë të përmirësuar të dhënash të ndërmarrjeve me kapital të huaj, që kanë aktivitet në Shqipëri, si edhe ka kontribuar me një analizë të plotë të kësaj popullate në "Raportin Vjetor të Investimeve të Huaja".

Edhe gjatë këtij viti është përgatitur analiza vjetore e të dhënave nga vrojtimi pranë familjeve për dërgesat e emigrantëve. Publikimi i vitit 2009 përmban një analizë më të gjerë në krahasim me publikimet e mëparshme, si edhe përfshin një shtojcë metodologjike me rekomandime për përmirësime të rezultateve të vrojtimit.

POZICIONI I INVESTIMEVE NDËRKOMBËTARE

Prej vitit 2007, Banka e Shqipërisë harton dhe publikon në FPDK pasqyrën e pozicionit të investimeve ndërkombëtare¹⁰ të Shqipërisë me periodicitet vjetor dhe kohëvonesë prej 3 tremujorësh. Publikimi i parë i pasqyrës paraprake të pozicionit të investimeve ndërkombëtare për vitin 2008 u realizua në muajin shtator të vitit 2009. Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet me kapital të huaj gjatë vrojtimit të vitit 2009 u përdorën si për rritjen e mbulimit të informacionit mbi transaksionet, ashtu edhe për përmirësimin e të dhënave mbi stokun e investimit të huaj në vend. Rakordimi i vlerave të transaksioneve në bilancin e pagesave dhe transaksioneve dhe pozicioneve stok në pozicionin e investimeve ndërkombëtare, përmendet si një tjetër arritje metodologjike në drejtim të përmirësimit të mbulimit dhe cilësisë së statistikave të sektorit të jashtëm. Në të njëjtën kohë është punuar për përgatitjen e formatit të publikimit të kësaj pasqyre, sipas formateve të publikimit të agjencive statistikore ndërkombëtare.

BORXHI I JASHTËM

Prej vitit 2007, Banka e Shqipërisë harton dhe publikon në FPDK pasqyrën e borxhit të jashtëm¹¹ të Shqipërisë me periodicitet dhe kohëvonesë tremujore. Përgatitja e një statistike cilësore dhe koherente të borxhit të jashtëm, kërkon përmirësime të vazhdueshme metodologjike për të rritur shkallën e mbulimit, si edhe rishikime të herëpashershme të serive kohore, për të reflektuar ndryshimet që rrjedhin nga shlyerjet, riskedulimi dhe falja e borxhit. Këto rishikime janë realizuar duke shfrytëzuar informacionin më të fundit dhe të plotë të ofruar nga burimet e informacionit: Ministria e Financave, sistemi bankar dhe sektori privat jofinanciar.

IV.4.2. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE

Banka e Shqipërisë i kushton një vëmendje të veçantë datave të publikimit të të dhënave si edhe shtrirjes dhe përmirësimit të rrjetit dhe mënyrave të publikimit të informacionit statistikor, duke u kujdesur që të respektojë parimin e shpërndarjes së njëkohshme dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit jashtë institucionit. Të dhënat publikohen në përputhje me periodicitetin dhe datat e shpallura në Kalendarin e Statistikave në fillim të çdo gjashtëmujori në faqen e Bankës së Shqipërisë në hapësirën Statistika/Seri Kohore. Gjithashtu, të

dhënat e Bankës së Shqipërisë publikohen në Raportin Statistikor Mujoor dhe në publikime të tjera periodike të Bankës së Shqipërisë. Data e publikimit të parë të statistikave është ajo e paraqitur në Kalendarin e Statistikave dhe vendi i publikimit të parë është faqja e Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009 është synuar të shkurtohet koha e prodhimit të treguesve statistikorë me qëllim përafrimin e afateve të publikimit sipas standardeve ndërkombëtare statistikore. Si shembuj të mirë përmenden statistikave të tregtisë së jashtme dhe statistikave të bilancit të pagesave, ndërkohë që statistikave monetare publikohen prej kohësh në afatet më të ngushta të rekomanduara nga standardet ndërkombëtare. Përsa u përket formave të shpërndarjes së statistikave, një vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit cilësor dhe pasurimit të seksionit të statistikave në faqen e Bankës së Shqipërisë. Është punuar në drejtim të ristrukturimit dhe pasurimit të bazës së të dhënave për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, ndërkohë që vazhdon puna për vendosjen e një programi të ri të publikimit, që do të lehtësojë kërkimin dhe përdorimin e të dhënave për përdoruesit e jashtëm.

Tabelë 15. Katalogu i tabelave të publikuara në faqen e Bankës së Shqipërisë.

STATISTIKAT MONETARE		Numri i treguesve	Data e fillimit të serisë
Periodiciteti: mujoor			
Kohëvonesa: 1 muaj			
1	Norma mesatare e depozitave mujore në lekë për sistemin bankar	14	Gusht 1995
2	Sasia e depozitave të reja mujore në lekë për sistemin bankar	14	Gusht 1995
3	Norma mesatare e depozitave mujore në USD për sistemin bankar	13	Dhjetor 2000
4	Sasia e depozitave të reja mujore në USD për sistemin bankar	13	Dhjetor 2000
5	Norma mesatare e depozitave mujore në Euro për sistemin bankar	9	Dhjetor 2000
6	Sasia e depozitave të reja mujore në Euro për sistemin bankar	9	Dhjetor 2000
7	Sasia e kredisë së re mujore në lekë për sistemin bankar	5	Gusht 1995
8	Norma mesatare e kredisë mujore në lekë për sistemin bankar	5	Gusht 1995
9	Norma mesatare e kredisë mujore në USD për sistemin bankar	5	Dhjetor 2000
10	Sasia e kredisë së re mujore në USD për sistemin bankar	5	Dhjetor 2000
11	Sasia e kredisë së re mujore në Euro për sistemin bankar	5	Dhjetor 2000
12	Norma mesatare e kredisë mujore në Euro për sistemin bankar	5	Dhjetor 2000
13	Bilanci sektorial i korporatave të tjera depozituese	115	Dhjetor 2006
14	Bilanci sektorial i Bankës Qendrore	90	Dhjetor 2006
15	Paraqitja e Bankës Qendrore	60	Dhjetor 2002
16	Bilanci sektorial i bankave paradepozituese	114	Dhjetor 2006
17	Paraqitja e korporatave depozituese	89	Dhjetor 2006
18	Paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese	83	Dhjetor 2006
19	Paraqitja monetare e bankave paradepozituese	83	Dhjetor 2006
20	Kredia për ekonominë	16	Dhjetor 2006
21	Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	39	Dhjetor 2006
22	Agregatët monetarë	5	Dhjetor 2006
STATISTIKAT BANKARE		Numri i treguesve	Data e fillimit të serisë
Periodiciteti: tremujor			
Kohëvonesa: 1 muaj			
23	Aktivet - Struktura për sistemin bankar	57	T4-1998
24	Pasivet - Struktura për sistemin bankar	54	T4-1998
25	Struktura e kapitalit aksioner në terma relative	7	T4-1998
26	Të ardhurat dhe shpenzimet për sistemin bankar	15	T4-1998
27	Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve	37	T4-1998
28	Tregues të kapitalit dhe cilësisë së aktiveve	17	T4-1998
29	Tregues të përqendrimit të veprimtarisë bankare	13	T4-1998

STATISTIKAT E SEKTORIT TË JASHTËM			
		Numri i treguesve	Data e fillimit të serisë
	Statistikat e bilancit të pagesave		
	Periodiciteti: tremujor; Publikimi: në format mujor		
	Kohëvonesa: 2 muaj e 10 ditë		
30	Bilanci i pagesave USD	7	Janar 1993
31	Bilanci i pagesave Euro	7	Janar 2004
32	Llogaria korente USD	40	Janar 1993
33	Llogaria korente Euro	40	Janar 2004
34	Llogaria financiare USD	9	Janar 1993
35	Llogaria financiare Euro	9	Janar 2004
Statistikat e tregtisë së jashtme			
		Numri i treguesve	Data e fillimit të serisë
	Periodiciteti: mujor		
	Kohëvonesa: 1 muaj		
36	Eksportet sipas shteteve USD	30	Janar 1993
37	Importet sipas shteteve USD	30	Janar 1993
38	Eksportet sipas shteteve Euro	30	Janar 2004
39	Importet sipas shteteve Euro	30	Janar 2004
40	Eksportet sipas SITC USD	10	Janar 1993
41	Importet sipas SITC USD	10	Janar 1993
42	Eksportet sipas SITC Euro	10	Janar 2004
43	Importet sipas SITC Euro	10	Janar 2004
Kursi i këmbimit			
		Numri i treguesve	Data e fillimit të serisë
	Periodiciteti: mujor		
	Kohëvonesa:		
44	Kursi mesatar i këmbimit për periudhën 1994 – 2001	26	Janar 1994 - Dhjetor 2001
45	Kursi i këmbimit në ditën e fundit të muajit për periudhën 1994-2001	26	Janar 1994 - Dhjetor 2001
46	Kursi mesatar i këmbimit nga viti 2002	13	Janar 2002
47	Kursi i këmbimit në ditën e fundit të muajit nga viti 2002	13	Janar 2002

STATISTIKAT MONETARE - ARKIVA			
		Numri i treguesve	Data e fillimit të serisë
1	Oferta e parasë	10	Dhjetor 1993
2	Mjetet e gjendjes monetare	7	Korrik 1994
3	Mjetet valutore neto të Bankës së Shqipërisë	3	Korrik 1994
4	Detyrimet e huaja totale të Bankës së Shqipërisë	10	Nëntor 1994
5	Mjetet valutore neto të bankave paradepozituese	9	Dhjetor 2000
6	Depozitat pa afat të rezidentëve	6	Dhjetor 1992
7	Depozitat me afat	6	Dhjetor 1992
8	Depozitat në valutë të huaj të rezidentëve	6	Dhjetor 1992
9	Kredia për ekonominë	7	Shtator 1998
10	Kredia për ekonominë në lekë	7	Shtator 1998
11	Kredia për ekonominë në valutë të huaj	7	Shtator 1998
12	Mjetet e autoritetit monetar	3	Korrik 1994
13	Mjetet e bankave që pranojnë depozita	7	Dhjetor 1994
14	Detyrimet e bankave që pranojnë depozita	8	Dhjetor 1994
15	Detyrimet e autoritetit monetar	6	Korrik 1994
16	Mjetet e huaja totale të Bankës së Shqipërisë	10	Nëntor 1994
17	Gjendja monetare	14	Korrik 1994

*Të gjitha tabelat paraqiten në seksionin: Statistika/Seri Kohore në lidhjen:
http://www.bankofalbania.org/web/Statistika_Hyrje_230_1.php

IV.4.3. BASHKËPUNIMI ME AGJENCI TË TJERA STATISTIKORE KOMBËTARE

Shqipëria ka hedhur hapa të rëndësishme drejt kalimit nga projekti i Sistemit të Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme (GDDS) të FMN-së në anëtarësimin në projektin e Standardit të Shpërndarjes së të Dhënave

Speciale (SDDS) të FMN-së. Banka e Shqipërisë ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë si koordinatori kombëtar për pjesëmarrjen e Shqipërisë në projektin e GDDS-së dhe në përgatitjen për anëtarësimin në projektin e SDDS-së. Për këtë qëllim, INSTAT-i dhe Ministria e Financave raportojnë periodikisht pranë Bankës së Shqipërisë informacionin mbi metadatat sipas kërkesave të GDDS-së, dhe të dhënat periodike për plotësimin e FPKD-së, e cila është publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

INSTAT-i kryen për llogari të Bankës së Shqipërisë disa vrojtime statistikore dhe Banka e Shqipërisë i ofron INSTAT-it të dhëna për sistemin bankar në bazë tremujore. Dy institucionet kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi si edhe aplikojnë praktikën e nënshkrimit të një kontrate vjetore në bazë të së cilës realizohen shërbimet reciproke. Bashkëpunimi në të ardhmen midis dy institucioneve do të shtrihet në drejtim të harmonizimit të metodologjive, koordinimit për plotësimin e detyrimeve për anëtarësimin në projektin e SDDS-së, ndarjes së detyrimeve për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave të bilancit të pagesave me qëllim evitimin e raportimit të përsëritur dhe përpunimit paralel të treguesve statistikorë, rishikimit të legjislacionit dhe infrastrukturës kombëtare statistikore, ndërtimit të regjistrit të ndërmarrjeve për hartimin e statistikave të investimeve direkte dhe FATS, përfshirjes në bazat përkatëse të raportimit të kërkesave të institucionit homolog dhe bashkëpunimit për hartimin e llogarive financiare.

Bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Ministrinë e Financave në drejtim të prodhimit statistikor shtrihet kryesisht në shkëmbimin e informacionit për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe të borxhit të jashtëm. Raportimi nga ana e Ministrisë së Financave është i rregullt dhe cilësia e informacionit të raportuar, falë edhe vendosjes së sistemeve të automatizuara të përpunimit të të dhënave ka ardhur në rritje gjatë viteve të fundit. Bashkëpunimi i ardhshëm me Ministrinë e Financave do të synojë rritjen e efikasitetit të prodhimit statistikor dhe përmirësimin cilësor dhe sasior të treguesve të sektorit të jashtëm duke zgjeruar bazën e informacionit.

VI.5. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Për Bankën e Shqipërisë, tashmë është evidente se rruga e arritjes së çdo objekti kalon nga perceptimi i publikut, të cilit i drejtohet dhe të cilit synon t'i shërbejë. Vendimet e politikës monetare, që merren nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, janë akoma më efektive nëse ato transmetohen në ekonomi në mënyrë sa më të plotë dhe brenda një kohe të arsyeshme. Që kjo të ndodhë, është e nevojshme që vendimet të merren jo vetëm në momentin e duhur, por gjithashtu të ekzistojnë kanalet e komunikimit të cilat e lehtësojnë transmetimin e informacionit. E thënë ndryshe, ekzistenca e një komunikimi efikas është thelbësore.

Nga ana tjetër, ndërgjegjësimi i publikut, pra i individëve që me vendimet e përditshme që marrin për ekonomitë individuale krijojnë efektin e përgjithshëm në ekonominë e vendit, është një mjet tjetër që ndihmon në rritjen e efikasitetit

të transmetimit të politikës monetare. Sa më e lartë të jetë shkalla e të kuptuarit të vendimeve të bankës qendrore, aq më racionale janë veprimet në treg dhe aq më shumë ndihmohet transmetimi i vendimeve të politikës monetare. Në këtë mënyrë, krijimi i një mjedisi që e kupton veprimtarinë e bankës qendrore është faktor që ndihmon në përmbushjen e detyrave të saja, në përmirësimin e imazhit të Bankës dhe në rritjen e përgjegjshmërisë së saj.

- *BOTIMET E BANKËS SË SHQIPËRISË*

Botimet e Bankës së Shqipërisë i japin mundësi publikut të marrë informacion rreth zhvillimeve më të fundit në ekonominë tonë dhe atë botërore; rreth zhvillimeve në sistemin bankar dhe atë financiar; rreth stabilitetit financiar e parasë, ndryshimeve e pasurimit të legjislacionit bankar e kuadrit rregullator të tij dhe të tjerave argumente me interes, duke u kthyer prej kohësh në një burim informacioni të saktë dhe të besueshëm për publikun.

Botimet e realizuara gjatë vitit 2009 konsistojnë si çdo vit, në botime periodike dhe botime joperiodike, dhe numërojnë mbi 4500 faqe analiza, statistika dhe studime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Vitin që lamë pas, përveç raporteve dhe buletineve periodike (7 tituj), Librit të punimeve të Konferencës VII të Bankës së Shqipërisë (*"Strategjitë e politikës monetare për ekonominë e vogla"* – Ideoi dhe përgatiti Ardian Fullani), materialeve të diskutimit (9 tituj), Katalogut të Publikimeve 2008, broshurave edukative (4 tituj), është publikuar për herë të parë revista *"Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë"*. Ky botim i drejtohet kryesisht personave që merren me kërkimin shkencor, brenda dhe jashtë Bankës, si edhe të gjithë atyre që në punën e përditshme u intereson kjo fushë, duke i njohur me punën kërkimore që zhvillohet në Bankën e Shqipërisë dhe dobishmërinë e saj në vendimmarrjen e Bankës e më gjerë.

Shpërndarja e botimeve të Bankës Qendrore gjatë vitit 2009, i ka shërbyer intensifikimit të marrëdhënieve me institucionet kërkimore, ekonomike dhe financiare si dhe me këdo tjetër të interesuar, në përmbushje të detyrimit të saj për të publikuar, informuar dhe shpjeguar politikën, procedurat, objektivat dhe opinionet e saj.

- *MARRËDHËNIET ME MEDIAN*

Një funksion i rëndësishëm në kuadër të komunikimit është mbajtja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kontakteve me organet e medias së shkruar dhe asaj televizive, duke informuar dhe sensibilizuar atë për çështje që lidhen me Bankën dhe me sistemin bankar në përgjithësi. Konferencat dhe deklaratat për shtyp, takimet me gazetarët dhe intervistat e ndryshme, ndihmojnë në njohjen e publikut me Bankën e Shqipërisë dhe aktivitetin e saj, me të rejtat në fushën monetare dhe financiare, si dhe i garantojnë publikut të gjerë të drejtën për informim.

Nisur nga viti kritik, i ngarkuar me pasojat e krizës financiare botërore që lamë pas, marrëdhënieve me median dhe informimit të publikut u është kushtuar një kujdes i veçantë nga Banka e Shqipërisë. Gjatë vitit 2009, politika e transparencës së Bankës së Shqipërisë ka njohur një ndryshim

thelbësor, ku pas mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës mbi vendimarrjen e politikës monetare, Guvernatori zhvillon një konferencë për shtyp në prani të përfaqësuesve të ndryshëm të medias, duke shpjeguar dhe informuar publikun mbi arsyet ekonomike dhe financiare në mbështetje të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës. Këto konferenca mujore për shtyp¹² përbëjnë boshtin mediatik të fushës ekonomike, duke bërë që edhe mediat t'i kushtojnë gjithnjë e më tepër vëmendje. Ky ndryshim përbën një hap të mëtejshëm të rëndësishëm në drejtim të përafrimit të Bankës së Shqipërisë me standardet e bankave qendrore evropiane. Gjatë vitit 2009 kanë vazhduar të zhvillohen dhe aktivitetet trajnuese për gazetarët, sipas një tradite të përcaktuar në vitet paraardhëse.

- *EDUKIMI FINANCIAR I PUBLIKUT*

Aspirata për të qenë një bankë qendrore moderne për nga objektivat, funksionet dhe roli i saj në shoqëri, trevjeçarin e fundit ka sjellë në fokusin e angazhimeve të saj edukimin ekonomiko-financiar të publikut. Kështu, nën kujdesin e veçantë të Guvernatorit, Banka e Shqipërisë ka përgatitur dhe zbatuar programin e edukimit “Banka qendrore në jetën e përditshme”. Programi promovon krijimin e një kulture financiare në shoqërinë shqiptare dhe që nga fillimi i tij në vitin 2007 është pasuruar me iniciativa të reja, si dhe është zgjeruar për të përfshirë një publik sa më të gjerë.

Hapësirë informuese 5: Programi i edukimit “Banka qendrore në jetën e përditshme”.

Pas rretheve të Tiranës dhe Vlorës, në vitin 2009 programi i edukimit përfshiu për herë të parë edhe rrethet e Shkodrës, Korçës, Gjirokastrës. Të gjitha shkollat e mesme të këtyre rretheve u ftuan të merrnin pjesë në aktivitetet e parashikuara nga programi ynë i edukimit. Me mbështetjen e Drejtorive Arsimore Rajonale të rretheve përkatëse dhe angazhimin e specialistëve të shumtë të Bankës së Shqipërisë, u realizuan për mësuesit e lëndës së ekonomisë të shkollave të mesme këto seminare trajnimi:

Seminaret e trajnimit të mësuesve të shkollave të mesme.

Datat e zhvillimit	Përshkrimi i seminarit
10 – 13 shkurt 2009	Seminar trajnues në fushat e financës, ekonomisë dhe bankngut, për mësuesit e ekonomisë së zbatuar të shkollave të mesme të Korçës.
23 – 27 shkurt 2009	Cikli i tretë i seminareve trajnuese për mësuesit e ekonomisë së zbatuar të shkollave të mesme të Tiranës.
10 – 13 mars 2009	Seminar trajnues në fushat e financës, ekonomisë dhe bankngut, për mësuesit e ekonomisë së zbatuar të shkollave të mesme të Shkodrës.
24 – 27 mars 2009	Seminar trajnues në fushat e financës, ekonomisë dhe bankngut, për mësuesit e ekonomisë së zbatuar të shkollave të mesme të Gjirokastrës.
23 – 29 shtator 2009	Seminar trajnimi për mësuesit dhe punonjësit socialë të shkollave të mesme të Elbasanit.

Seminaret e mësipërme ofruan një mundësi të mirë për njohjen e institucionit të bankës qendrore, formimin dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, dhe nëpërmjet rritjes së cilësisë së mësimdhënies shërbyen edhe si shtysë për

edukimin e brezit të ri. Gjatë këtyre seminareve, mësuesit u njohën edhe me punën e Bankës së Shqipërisë për edukimin financiar të publikut, si dhe u orientuan për ta përdorur informacionin e përfituar nëpërmjet seminareve dhe broshurave edukative si pjesë plotësuese të orëve mësimore.

I paraprirë nga takime konsultuese dhe kontakte të shumta me nxënësit e shkollave të mesme, konkursi “Vlera e vërtetë e parasë” u organizua për vitin shkollor 2008-2009, në 5 rrethe të vendit: Vlorë, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë dhe Tiranë. Konkursi “Vlera e Vërtetë e Parasë” është një sfidë midis ekipeve të shkollave të mesme, mbi njohuritë e tyre për Bankën e Shqipërisë, politikën e saj monetare, instrumentet që ajo përdor si dhe ndikimin e vendimeve të bankës qendrore në ekonominë e vendit. Të përfaqësuar nga skuadra prej tre nxënësish të vitit të tretë, shkollat e mesme vihen përballë një serie pyetjesh të drejtuara nga Juria e përbërë nga drejtues të Bankës së Shqipërisë dhe vlerësohen jo vetëm mbi njohuritë e tyre, por edhe mbi aftësitë analitike të argumentimit të përgjigjeve dhe punës në grup.

Në konkursin e organizuar për vitin shkollor 2008-2009, konkurruan 74 shkolla të mesme, të përfaqësuar nga 222 nxënës; u shpërndanë 75 çmime dhe po kaq certifikata për nxënësit fitues; u ndoq në sallë nga rreth 2000 nxënës, mësues dhe përfaqësues të Drejtorive Arsimore Rajonale të rretheve përkatëse. Më poshtë, në formë të përmbledhur jepen disa detaje mbi konkurset e zhvilluara gjatë këtij viti mësimor.

Konkursi “Vlera e vërtetë e parasë”.

Rrethi	Data	Ambienti i zhvillimit të konkursit	Nr. i shkollave pjesëmarrëse	Shkolla fituese
Vlorë	11-19 dhjetor '08	Teatri “Petro Marko”	15	“Ali Demi”
Shkodër	9 prill '09	Teatri “Migjeni”	16	“28 Nëntori”
Korçë	24 prill '09	Teatri “A.Z.Çajupi”	11	“Themistokli Gërmenji”
Gjirokastrë	8 maj '09	Teatri “Zihni Sako”	7	“Siri Shaplo”
Tiranë	25-26 maj '09	Holli i BSH	25	“Tirana Jonë”
Finalja kombëtare	13 dhjetor '09	Akademia e Arteve	5	“Themistokli Gërmenji”

Për të theksuar edhe më shumë rëndësinë që edukimi financiar duhet të ketë në mënyrë të veçantë për brezin e ri, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Ardian Fullani ka zhvilluar një sërë takimesh me nxënës dhe mësues të shkollave të mesme, nën sloganin “Edukimi kushton por nuk ka çmim!”. Këto takime kanë patur formën e bashkëbisedimeve të lira, mbi përgjegjësitë dhe objektivat kryesorë të Bankës së Shqipërisë, por edhe mbi çështje të përgjithshme që lidhen me situatën aktuale ekonomiko-financiare brenda dhe jashtë vendit.

Në të gjitha aktivitetet edukuese, vend të rëndësishëm kanë zënë broshurat edukative të Bankës së Shqipërisë, koleksioni i të cilave tashmë numëron rreth 35 tituj. Gjatë vitit 2009, është vijuar me rishikimin dhe përmirësimin e broshurave të mëparshme, si dhe janë hartuar disa tituj të rinj. Përveç shpërndarjes së broshurave, në periudhën janar–maj 2009, në 40 shkolla

të mesme të Tiranës është realizuar edhe një shpërndarje masive broshurash (rreth 19.200 copë broshura), të shkruara për nxënësit shkollat e mesme.

Me lançimin e faqes së re të internetit të Bankës së Shqipërisë, u krijua edhe një hapësirë e re kushtuar edukimit të publikut. Në rubrikën elektronike “Edukimi ekonomiko-financiar” ofrohet informacion mbi aktivitetet e edukimit të Bankës (seminare trajnimi, konkurse, takime), broshurat, si dhe një nyje e re interaktive e titulluar “Instrumentet llogaritëse”. Ajo është ndërtuar në trajtën e një makine llogaritëse të thjeshtë, e cila ndihmon që direkt nga faqja e internetit, përdoruesit të llogarisin shpejt kursimet e tyre, depozitat, planet e kursimit apo këstin mujor të kredisë.

Hapësirë informuese 6: Aktivitete edukuese me studentët universitarë.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë është angazhuar edhe në një sërë aktivitete, drejtuar studentëve universitarë. Tashmë, aktivitete të tilla si “Dita e Bankës së Shqipërisë”, “Çmimi i Guvernatorit për diplomën më të mirë” dhe leksionet e Guvernatorit në auditore të ndryshme universitetesh brenda dhe jashtë vendit janë kthyer në një traditë të mirë të Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2009, leksionet e Guvernatorit kanë trajtuar problematika të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, zhvillimet ekonomike që kanë karakterizuar vendin tonë gjatë viteve të fundit dhe përballja e ekonomisë shqiptare me sfidat e kohës, konvergimit ekonomik dhe institucional të vendit drejt të ardhmes evropiane, krizën financiare globale dhe zhvillimet e ardhshme etj. Kumtesat janë shoqëruar me pyetje dhe diskutime të studentëve dhe trupit akademik mbi temat e trajtuara apo argumentet “e nxehta” të momentit. Më konkretisht, në vitin 2009 Guvernatori Fullani ka mbajtur këto leksione:

- Leksion i Guvernatorit në konferencën “Krizë financiare globale dhe zhvillimet e ardhshme”, e organizuar nga Universiteti “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe Universiteti i Bolonjës, 27 mars 2009;
- Leksion i Guvernatorit në Universitetin e Prishtinës me temë “Ekonomia shqiptare përballë sfidave të kohës dhe perspektivës evropiane”, 29 tetor 2009;
- Leksion i Guvernatorit në Universitetin Bujqësor të Tiranës me temë “Ekonomia shqiptare përballë sfidave të kohës dhe perspektivës evropiane” (shoqëruar nga aktiviteti edukues “Dita e Bankës së Shqipërisë”), 16 nëntor 2009.

• FAQJA E RE E INTERNETIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Krahas mënyrave të komunikimit të ndërmjetësuar nga mediat apo nga grupe të tjera interesi që për nga profesioni përçojnë informacion në një numër më të madh personash, Banka e Shqipërisë komunikon drejtpërdrejt dhe në kohë reale me publikun edhe përmes faqes së saj të internetit, me botimet, njoftimet për shtyp dhe informacionet e tjera të publikuara në të. E krijuar për herë të parë në vitin 1999 dhe me një version të dytë të lançuar në vitin 2004, në shkurt të vitit 2009 u prezantua faqja e re e internetit të Bankës së Shqipërisë. Në ridizenjimin dhe riorganizimin e informacionit, kjo faqe synon të jetë më e lehtë për përdoruesin (më *user friendly*) dhe ofron një grafikë të qartë, të këndshme për syrin dhe të përshtatshme për një bankë qendrore bashkëkohore.

VI.6. INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI

- ÇËSHTJE TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), pas ratifikimit të saj nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian, hyri në fuqi në datën 1 prill 2009, duke hapur kështu Shqipërisë rrugën drejt aplikimit në Bashkimin Evropian për marrjen e statusit të vendit kandidat. Aplikimi për anëtarësim në Bashkimin Evropian u paraqit në datën 28 prill 2009 dhe në bazë të procedurave të përcaktuara në Traktatin e Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian duhet të paraqesë opinionin e tij në lidhje me aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur kushtet e anëtarësimit.

Hapësirë informuese 7: Angazhimi i Bankës së Shqipërisë në plotësimin e Pyetësorit të KE-së.

Në datën 16 dhjetor 2009, Kryetari i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, z. Helmut Lohan i dorëzoi Kryeministrit, z. Sali Berisha Pyetësorin, mbi të cilin do të përgatitet Opinioni i Komisionit Evropian në lidhje me aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur kushtet e anëtarësimit në BE. Pyetësori përmban 2280 pyetje, të cilat prekin të gjithë segmentet e kuadrit ligjor evropian dhe kriteret e Kopenhagenit për anëtarësim. Plotësimi i këtij Pyetësori nga autoritetet shqiptare do të ndihmojë Komisionin Evropian për të kuptuar dhe vlerësuar situatën aktuale në vend për sa i përket përmbushjes së detyrimeve në fusha të caktuara dhe perspektivën e vendit në plotësimin e standardeve për anëtarësim.

Banka e Shqipërisë, në përputhje me strukturën organizative për koordinimin e procesit të hartimit të përgjigjeve të Pyetësorit, është angazhuar në plotësimin e Pyetësorit sipas ndarjes së pyetjeve për çdo institucion. Banka e Shqipërisë është institucion koordinues për përgjigjet e pyetjeve të Kapitullit 4 - Lëvizja e lirë e kapitalit, dhe Kapitullit 17 - Politikat ekonomike dhe monetare. Megjithatë, vlen të theksohet se Banka e Shqipërisë është institucion kontribues edhe në kapituj të tjerë të Pyetësorit si për shembull, Kapitulli 9 – Shërbimet financiare dhe Kapitulli i Kriterit Ekonomik.

Në këtë kontekst, puna për përgatitjen dhe dorëzimin e Pyetësorit do të vazhdojë edhe në tremujorin e parë të vitit 2010 dhe Banka e Shqipërisë do të jetë në ndjekje të vazhdueshme të mirëmenaxhimit të këtij procesi, në përputhje me objektivin e përfundimit me sukses të tij. Detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja për Bankën e Shqipërisë lidhen me përmbushjen e kriterit ekonomik të Kopenhagenit për anëtarësim në BE, garantimin e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime financiare për bankat dhe institucionet e tjera financiare komunitare, liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar (acquis communautaire) në këto fusha.

Në përputhje me procesin e zbatimit të MSA-së, Banka e Shqipërisë ka kontribuar në rishikimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) për vitet 2009 – 2014, duke identifikuar dhe përditësuar përparësitë dhe masat e marra në fushat e stabilitetit makroekonomik, lëvizjes së lirë të

kapitalit, lirisë së vendosjes si dhe lirisë për të ofruar shërbime dhe gjithashtu duke parashikuar nismat ligjore, aktivitetet zbatuese, asistencën e nevojshme teknike si dhe kostot e pritshme gjatë procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis*-në.

Banka e Shqipërisë ka mbajtur kontakte të rregullta me Ministrinë e Integritimit Evropian, duke i përcjellë raporte mujore të progresit, të cilat pasqyrojnë progresin e arritur në drejtim të realizimit të masave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese, në përputhje me afatet e parashikuara në PKZMSA si dhe një përshkrim të shkallës së përputhshmërisë me *acquis*-në të akteve juridike të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Në 14 tetor 2009, Komisioni Evropian publikoi Raportin e Progresit 2009 për Shqipërinë, shoqëruar edhe me Strategjinë e Zgjerimit 2009-2010 të Bashkimit Evropian. Të dy këto dokumente përshkruajnë progresin e bërë nga Shqipëria dhe sfidat me të cilat përballlet ajo, duke skicuar njëkohësisht edhe përqasjen e Komisionit Evropian, për të udhëhequr dhe mbështetur vendin tonë në të ardhmen. Raporti¹³ analizoi progresin e arritur nga Shqipëria për periudhën 1 tetor 2008 - 30 shtator 2009 në drejtim të përmbushjes së kriterëve të Kopenhagenit.

Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë rregullisht në takimet periodike të zhvilluara ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së gjatë vitit 2009, si në Takimin e parë me hyrjen në fuqi të MSA-së të Nënkomitetit mbi Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën ashtu edhe në Takimin e parë të Nënkomitetit për Çështjet Financiare dhe Ekonomike dhe Statistikat, ku Banka e Shqipërisë prezantoi zhvillimet kryesore në fushën e politikës monetare, atë të kursit të këmbimit, në sektorin e jashtëm dhe në sistemin bankar.

Në datën 18 maj 2009, në Bruksel u mbajt takimi i parë i Këshillit të Stabilizim-Asociimit¹⁴ midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes të Stabilizim Asociimit në datën 1 prill 2009. Lidhur me kriterin ekonomik, Këshilli i Stabilizim Asociimit nënvizoi masat anticiklike të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në fillim të vitit 2009 me qëllim forcimin e besimit të pjesëmarrësve në treg dhe të publikut në përgjithësi si dhe ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, si dhe nënvizoi dëshirën e autoriteteve shqiptare për një bashkëpunim më të ngushtë me autoritetet e vendeve, në të cilat kanë selinë qendrore bankat dhe degët e bankave të huaja që operojnë në Shqipëri.

Në lidhje me projektin e binjakëzimit të Bankës së Shqipërisë me një ose dy banka qendrore anëtare të SEBQ-së të financuar nga Instrumenti i Paraderimit (IPA) 2008 i BE-së, i cili synon forcimin e kapaciteteve institucionale veçanërisht në fushat e mbikëqyrjes bankare, të statistikave, të sistemeve të pagesave dhe të zbatimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë për përzgjedhjen e bankave të interesuara në këtë projekt. Në këtë kuadër, projekti në fjalë i është shpërndarë 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe bankave të tyre qendrore, si rezultat i së cilës pritet të evidentohen bankat binjakëzuese gjatë tremujorit të parë 2010.

Në kuadër të zhvillimit të dialogut të Komisionit Evropian me Bankën e Shqipërisë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë u ftua dhe mbajti një diskutim në konferencën “Ballkani Perëndimor: Kalimi i krizës – nga bashkëpunimi rajonal në integrimin evropian”, të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit të Komisionit Evropian dhe Presidenca Suedeze e Bashkimit Evropian në datën 9 dhjetor 2009 në Bruksel.

- *BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR*

(i) **Marrëdhëniet me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN)**

Republika e Shqipërisë është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar që prej muajit tetor të vitit 1991. Kuota e saj gjatë vitit 2009 mbeti e pandryshuar, në shumën prej 48.7 milionë SDR, ashtu si edhe votat e saj (737 vota ose 0.03% e shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së). Shqipëria ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën, San Marinon dhe Timorin Lindor. Kjo konstituencë ka një total prej 90.968 votash (ose rreth 4.1% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së) dhe kryesohet nga përfaqësuesi italian, z. Arrigo Sadun, i cili shërben si Drejtor Ekzekutiv i konstituencës.

Në datën 8 janar 2009, autoritetet shqiptare të përfaqësuara nga Kryeministri, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe Ministri i Financave i paraqitën zyrtarisht FMN-së Letrën e Mirëkuptimit. Mbi bazën e këtij dokumenti si dhe të vlerësimeve të misionit rishikues të FMN-së, i cili vizitoi Shqipërinë në muajt tetor-nëntor 2008, Bordi Ekzekutiv i FMN-së në datën 28 janar 2009 kreu rishikimin e gjashtë dhe të fundit të ecurisë së Shqipërisë, lidhur me zbatimin e marrëveshjes trevjeçare PRGF/EFF, të miratuar në datën 27 janar 2006. Ky rishikim mundësoi disbursimin në total të 2.435 milionë SDR për Shqipërinë, duke e çuar totalin e shumës së lëvruar që nga miratimi i marrëveshjes në 17.045 milionë SDR.

Shqipëria gjithashtu i pagoi FMN-së gjatë vitit 2009 rreth 9.4 milionë SDR në kuadër të shlyerjeve të detyrimeve (pagesa principali, interesa, shpenzime periodike etj.), të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e kaluara PRGF si dhe ajo ekzistuese PRGF/EFF.

Në të njëjtën kohë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka përfaqësuar rregullisht Republikën e Shqipërisë në vendimmarrjen e Bordit të Guvernatorëve, i cili është dhe organi më i lartë i FMN-së. Një vend të rëndësishëm në marrëdhëniet me FMN-në gjatë këtij viti, kanë zënë edhe mbledhjet e pranverës dhe ato vjetore të FMN-së dhe të Bankës Botërore, të organizuara përkatësisht në muajt prill dhe tetor, ku delegacioni i Bankës së Shqipërisë, i kryesuar nga Guvernatori, ka zhvilluar takime me përfaqësues të lartë të FMN-së, takime të cilat janë përqendruar në zhvillimet më të fundit makroekonomike si dhe në çështjet që lidhen me stabilitetin monetar dhe atë financiar. Në këto takime është bërë një ekspozë e gjerë e situatës makroekonomike si dhe e sistemit bankar e financiar në Shqipëri. Gjatë takimeve janë evidentuar marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet FMN-së dhe autoriteteve shqiptare si dhe është

vlerësuar puna e bërë nga ana e Bankës së Shqipërisë. Përfaqësuesit e lartë të FMN-së kanë shprehur gatishmërinë për të vazhduar projektet e ndihmës teknike për Bankën e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2009 ka vazhduar të përfitojë nga asistenca teknike e FMN-së, në lidhje me trajnimin e personelit të saj duke përfituar konsulencë në fusha të tilla si politika monetare dhe mbikëqyrja bankare.

(ii) Marrëdhëniet me Grupin e Bankës Botërore

Shqipëria është anëtare e Grupit të Bankës Botërore që prej vitit 1991 dhe ka përfituar nga ky institucion një total fondesh prej 1.1 miliardë dollarësh për 68 projekte. Strategjia trevjeçare 2006-2009 e asistencës së Bankës Botërore për Shqipërinë e cila u përqendrua në nxitjen e rritjes ekonomike përmes mbështetjes së zhvillimit të sektorit privat dhe përmirësimit të shërbimeve publike të ofruara, përfundoi në muajin qershor.

Edhe gjatë vitit 2009, bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Grupin e Bankës Botërore vazhdoi në kuadrin e marrëveshjes "Për Administrim dhe Konsulencë të Investimit të Rezervës Valutore", të nënshkruar në muajin shtator 2005. Kështu, Grupi i Bankës Botërore i ka ofruar asistencë teknike Bankës së Shqipërisë nëpërmjet programit RAMP (Programi Këshillues për Administrimin e Rezervës Valutore), në kuadër të Partneriteteve për Investimet Sovrane (SPI). Kjo konsulencë dhe asistencë teknike është konkretizuar nëpërmjet vizitave të ekspertëve të Thesarit të Bankës Botërore si dhe pjesëmarrjes së punonjësve të Bankës së Shqipërisë në seminare të organizuara nga Banka Botërore jashtë vendit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2009 Banka Botërore ka ofruar asistencë teknike edhe në kuadër të një projekti për planet e kontigjencës dhe simulimin e situatave të krizës financiare. Misioni i Bankës Botërore ka zhvilluar takime dhe diskutime intensive jo vetëm me stafin e Bankës së Shqipërisë, por edhe me atë të institucioneve të tjera si Ministria e Financave, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Në takimet e zhvilluara nga ana e delegacionit të Bankës së Shqipërisë me përfaqësuesit e lartë të Grupit të Bankës Botërore në kuadër të mbledhjeve të pranverës dhe vjetore të FMN-së dhe Bankës Botërore janë prezantuar zhvillimet makroekonomike në Shqipëri si dhe masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në drejtim të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik.

(iii) Marrëdhëniet me institucionet e tjera financiare ndërkombëtare

Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2009 ka vijuar të mbajë kontakte të vazhdueshme edhe me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), kryesisht në drejtim të ofrimit të informacionit dhe statistikave për zhvillimet në ekonominë shqiptare në përgjithësi, dhe për sektorin financiar në veçanti. Në Raportin e Tranzicionit 2008, BERZH-i vlerësoi pozitivisht kuadrin e

politikës monetare të Bankës së Shqipërisë në lidhje me mbajtjen e inflacionit brenda objektivave si dhe forcimin e mbikëqyrjes bankare nëpërmjet ligjit për bankat.

Në muajin maj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mori pjesë në mbledhjen e 18-të vjetore të Bordit të Guvernatorëve dhe Forumin e Biznesit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ky eveniment i cili u fokusua në ndikimet e krizës financiare botërore, mbledhi në një tryezë të përbashkët diskutimi aksionerët e kësaj banke së bashku me rreth 1000 drejtues të lartë të qeverive si dhe përfaqësuesve të biznesit, organizatave jofitimprurëse dhe medias nga vende të ndryshme në të cilat BERZH investon.

Vlen të përmendet gjithashtu, kontributi dhe asistenca e dhënë nga Banka e Shqipërisë për Sekretariatit e Organizatës Botërore të Tregtisë në kuadër të përgatitjes së raportit final mbi Rishikimin e Politikës Tregtare për Shqipërinë. Në këtë kontekst, është koordinuar puna për përgatitjen e komenteve dhe sugjerimeve në lidhje me draft –raportin e Sekretariatit të OBT-së për fushën e politikës monetare, kursit të këmbimit si dhe të zhvillimeve në sektorin bankar.

(iv) Marrëdhëniet me bankat qendrore dhe bashkëpunimi teknik

Në vijim të intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me bankat e tjera qendrore, gjatë vitit 2009, me ftesë të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë kanë zhvilluar vizita zyrtare në Tiranë Guvernatori i Bankës Qendrore të Luksemburgut dhe Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, ndërsa është zhvilluar një vizitë zyrtare e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë pranë Bankës së Greqisë. Në të njëjtën kohë, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka marrë pjesë edhe në shumë konferenca ndërkombëtare apo seminare rajonale. Këto takime, vizita dhe konferenca kanë shërbyer për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit teknik gjithnjë e në rritje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve homologe.

Në planin rajonal, vlen të theksohet pjesëmarrja në takimet e Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Detit të Zi, Azisë Qendrore dhe Ballkanit, takime të cilat kanë si qëllim të forcojnë lidhjet midis bankave qendrore të rajonit dhe të nxisin bashkëpunimin rajonal nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës më të mirë e trajtimit në tryeza të rrumbullakëta në nivel guvernatorësh ose ekspertësh të çështjeve aktuale.

Ndërkohë, në muajin tetor, me rastin e 10-vjetorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë zhvilloi një vizitë zyrtare dhe mbajti një fjalim në konferencën e organizuar me këtë rast. Në takimet e zhvilluara, u vlerësuan jo vetëm marrëdhëniet e shkëlqyera të bashkëpunimit midis dy institucioneve por u shpreh edhe gatishmëria për vazhdimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi teknik.

Gjatë vitit 2009, Banka e Italisë, Banka Kombëtare e Çekisë, Banka Kombëtare e Polonisë, Banka Kombëtare e Austrisë, Banka e Francës dhe

Center of Excellence in Finance (CEF) kanë qenë ofrueset më të mëdha të asistencës teknike për Bankën e Shqipërisë, kryesisht nëpërmjet organizimit të kurseve e seminareve si dhe organizimit të vizitave të punës të ekspertëve të huaj pranë Bankës së Shqipërisë.

Kështu, në bashkëpunim me CEF-in dhe me mbështetjen e instrumentit TAIEK të Komisionit Evropian në Tiranë u zhvillua *workshop*-i me temë: "Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin e politikave". Ky *workshop* adresoi sfidat kryesore që shoqërojnë hartimin dhe ankorimin e politikave, me një theks të veçantë në ndërtimin e kapaciteteve individuale dhe institucionale në këtë fushë shumë të rëndësishme. *Workshop*-i mblodhi në Tiranë përfaqësues nga bankat qendrore dhe ministritë e financave të vendeve të Evropës Juglindore, ndërsa të ftuar ishin edhe përfaqësues nga FMN-ja, Banka Qendrore Evropiane dhe Komisioni Evropian.

Në të njëjtën kohë, janë intensifikuar marrëdhëniet e bashkëpunimit teknik edhe me bankat qendrore të rajonit ku vlen të përmendet nënshkrimi i Protokollit të Bashkëpunimit me Bankën Kombëtare të Serbisë, i cili do të synojë vendosjen e marrëdhënieve të ndërsjellta me qëllim nxitjen e zhvillimit profesional të punonjësve, që do të realizohet nëpërmjet organizimit të vizitave studimore, takimeve dypalëshe e realizimit të projekteve të përbashkëta.

Si në vitet e kaluara ashtu edhe gjatë vitit 2009, në bashkërendimin e asistencës teknike përparësi kishte dhe ofrimi i ekspertizës teknike për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQRK) nga ana e Bankës së Shqipërisë. Kështu, janë realizuar disa vizita pune të delegacioneve të BQRK-së pranë Bankës së Shqipërisë dhe anasjelltas, të përqendruara në fusha si kontrolli i brendshëm, sistemet e pagesave, administrimi etj. Me rastin e 10-vjetorit të BQRK-së, u zhvilluan disa takime pune të cilat mbuluan çështje të tilla si marrëdhëniet me jashtë, burimet njerëzore, marrëdhëniet me mediat dhe shërbimi protokollar. Me këtë rast, vlen të theksohet bashkëpunimi dhe eksperiencia e dhënë nga ana e Bankës së Shqipërisë në organizimin e këtij aktiviteti mjaft të rëndësishëm për BQRK-në.

VI.7. NDRYSHIME TË BËRA NË LEGJISLACIONIN BANKAR GJATË VITIT 2009

- *AKTET LIGJORE TË LIDHURA ME STABILITETIN E SISTEMIT BANKAR*

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë nëpërmjet vendimit nr. 09, datë 11.02. 2009 për propozimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave"", i ka propozuar Ministrisë së Financave projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave"". Ky projektligj u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10106, datë 30.03.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 "Për sigurimin e depozitave"".

Në tërësinë e tyre, shtesat dhe ndryshimet në ligjin për sigurimin e depozitave sollën këto risi:

- Shuma maksimale që shërben si kriter për përcaktimin e depozitave të siguruara u rrit në vlerën prej 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ndërkohë që vlera e mëparshme ishte 700.000 (shtatëqind mijë) lekë;
- U rrit niveli i kompensimit të depozitave të siguruara, duke parashikuar kompensimin e plotë të tyre (100%), në çdo rast jo më shumë se 2.500.000 lekë (dy milionë e pesëqind mijë), në dallim nga rregullimi i mëparshëm i ligjit për sigurimin e depozitave, i cili ishte i përshkallëzuar në nivele, në përputhje me shumën e depozitës së siguruar;
- U saktësuan dhe përcaktuan më mirë afatet për fillimin dhe kryerjen e procesit të kompensimit të depozitave;
- U hoq kushti për bashkë-sigurimin (co-insurance) e depozitave të siguruara;
- U rrit kompetenca e Këshillit Drejtues të Agjencisë duke parashikuar të drejtën e këtij të fundit për të nxjerrë akte nënligjore, në ndryshim nga rregullimi i mëparshëm i ligjit për sigurimin e depozitave i cili këtë kompetencë ia rezervonte vetëm Autoritetit Mbikëqyrës;
- U bë një përcaktim më i mirë për mjetet e financimit të Agjencisë lidhur me përdorimin nëpërmjet huamarrjes të mjeteve të buxhetit të shtetit, kur shuma që kërkohet për kompensimin e depozitave të siguruara gjatë procesit të kompensimit është më e madhe se mjetet financiare të zotëruara nga Agjencia, duke përcaktuar formën dhe procedurën e marrjes hua nga buxheti i shtetit, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit do të përcaktohet shuma e kësaj huaje;
- U rrit mbrojtja ligjore e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë dhe personelit të saj, në funksion të përmbushjes së kompetencave dhe detyrave të tyre ligjore.

- *PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR NË LIDHJE ME SISTEMIN E*

PAGESAVE

Në funksion të sigurisë dhe eficiencës së sistemit të pagesave, gjatë vitit 2009, Banka e Shqipërisë filloi punën për hartimin e projektligjit "Për sistemin e pagesave në Republikën e Shqipërisë", projekt i cili pritet të kalojë për shqyrtim në procedurat parlamentare gjatë vitit 2010. Ky projektligj paraqet një harmonizim të plotë me parimet themelore të direktivave të BE-së në fushën e sistemeve të pagesave (veçanërisht me Direktivën 98/26/EC për finalitetin e pagesave në sistemet e pagesave dhe të titujve, Direktivën 2002/47/EC për rregullimin e kolateralit financiar dhe Parimet kryesore të Komitetit të Baselit për sistemet e pagesave me rëndësi sistematike).

- *PËRMIRËSIMI I KUADRIT RREGULLATIV MBI MBIKËQYRJEN E VEPRIMTARIVE TË BANKAVE DHE INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA*

Aktet e reja rregullative për mbikëqyrjen bankare të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2009 janë:

1. Rregullorja nr. 05, datë 11.02.2009 *“Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët”*. Ky akt rregullon për herë të parë në mënyrë të posaçme kredinë konsumatore në funksion të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe përcakton kërkesat mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së informacionit parakontraktor dhe kontraktor për kredimarrësin, përpara lidhjes dhe gjatë ekzekutimit të kredisë konsumatore dhe kredisë hipotekare për individin.
2. Rregullorja nr. 14, datë 11.03.2009 *“Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”*. Kjo rregullore zëvendëson rregulloren e mëparshme *“Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë”* miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 71, datë 11.09.2002, ndryshuar me vendimin nr. 03, datë 26.01.2005, ndryshuar me vendimin nr. 80, datë 25.10.2006. Ky akt parashikon edhe këto risi:
 - Dhënien e miratimit për zgjerimin e rrjetit bankar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
 - Dhënien e miratimeve paraprake gjatë ushtrimit të veprimtarisë së bankës dhe degës së bankës së huaj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 *“Për bankat në Republikën e Shqipërisë”*. Për rrjedhojë, në rregullore është përcaktuar dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e miratimit paraprak në rastet e hapjes së një zyre përfaqësimi nga një bankë e huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndryshimit të pjesëmarrjes influencuese, ndryshimit të emrit, ndryshimit të statutit, ndryshimit të statutit në rastet e rritjes së kapitalit me mjete jolikuide, zvogëlimit të kapitalit, shpërndarjes së kapitalit, zmadhimit të kapitalit me mjete jolikuide, riblerjes së aksioneve të saj ose të personave të lidhur me të në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një personi tjetër duke dhënë kredi ose duke lëshuar garanci.
 - Detyrimin për njoftim në Bankën e Shqipërisë në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 *“Për bankat në Republikën e Shqipërisë”*. Në rregullore parashikohet dokumentacioni që bankat ose degët e bankave të huaja duhet të paraqesin në Bankën e Shqipërisë në rastet e zmadhimit të kapitalit me mjete likuide, ndryshimet në strukturën e kapitalit, ndryshimet në selinë e drejtorisë qendrore dhe vendit/adresës së ushtrimit të aktivitetit të degëve ose agjencive të saj.
 - Riorganizimi i bankës (bashkimi, ndarja). Në rregullore parashikohen edhe dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë banka në rastet e bashkimit ose të ndarjes. Vlen të theksohet që banka mund të kryejë regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të procesit të riorganizimit nëpërmjet bashkimit ose të ndarjes vetëm pasi të ketë marrë miratimin nga Banka e Shqipërisë.

3. Rregullorja nr. 11, datë 25.02.2009 *“Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”*. Kjo rregullore zëvendëson rregulloren e mëparshme *“Për licencimin e subjekteve jobanka”*, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 96, datë 26.11.2003 dhe ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 88, datë 16.11.2005. Përveç kërkesave dhe dokumentacionit të nevojshëm për licencimin e subjekteve financiare jobanka, në këtë rregullore përfshihet për herë të parë edhe licencimi, si kategori e veçantë, i institucioneve financiare të mikrokredisë duke parashikuar kriteret e licencimit të këtyre institucioneve. Me qëllim harmonizimit me ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 *“Për bankat në Republikën e Shqipërisë”*, janë përcaktuar edhe kriteret për dhënien e miratimeve paraprake gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve financiare jobanka dhe të institucioneve të mikrokredisë; detyrimet për njoftime në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtyre subjekteve, si dhe kriteret e miratimit të agjentit të subjekteve financiare jobanka, në rastet kur këto të fundit e ushtrojnë veprimtarinë e tyre financiare nëpërmjet agjentit.
4. Rregullorja nr. 40, datë 27.05.2009 *“Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”*, e cila zëvendëson rregulloren *“Për administratorët e bankave dhe të degëve të bankave të huaja”* miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 120, datë 30.12.2003 dhe ndryshuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 69, datë 13.09.2006. Me dispozita të veçanta të kësaj rregulloreje përcaktohen përgjegjësitë e strukturave drejtuese të bankës si këshilli drejtues, drejtoria dhe drejtuesve ekzekutivë të saj në funksion të drejtimit të bankës në përputhje me objektivat, strategjitë, politikat e miratuara, si dhe në interesin më të mirë të saj. Rregullorja parashikon gjithashtu dhe mënyrën e komunikimit dhe ndërveprimit të këtyre strukturave.
5. Rregullorja nr. 44, datë 10.06.2009 *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*, e cila zëvendëson rregulloren *“Për parandalimin e pastrimit të parave”*, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 10, datë 25.02.2004. Kjo rregullore është hartuar me qëllim harmonizimit e kërkesave rregullative me ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*.
6. Rregullorja nr. 45, datë 10.06.2009 *“Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas sistemit raportues të unifikuar”*, objekti i së cilës është përcaktimi i rregullave, kushteve dhe afateve të raportimit në Bankën e Shqipërisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja, me qëllim marrjen e informacionit të standardizuar nga subjektet raportuese si dhe përpunimin e tij për efekte të mbikëqyrjes bankare dhe përgatitjes së statistikave monetare e financiare.

7. Rregullorja nr. 70, datë 30.09.2009 “Për veprimtarinë valutore”, e cila shfuqizon rregulloren “Mbi veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr. 64, datë 07.03.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Kjo rregullore harmonizon kuadrin rregullator për veprimtarinë valutore me:
 - kërkesat e reja të ligjit për bankat, të miratuar pas hyrjes në fuqi të rregullores ekzistuese “Mbi veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr. 64, datë 30.07.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar;
 - kërkesat dhe detyrimet e reja ligjore të lindura nga procesi i zbatimit të MSA-së, e cila ndër të tjera parashikon përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *Acquis Communautaire*;
 - si dhe me angazhimet e tjera ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të liberalizimit të lëvizjes së lirë të kapitalit dhe pagesave.
8. Rregullorja nr. 71, datë 14.10.2009 “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”, e cila shfuqizon udhëzimin “Për likuiditetin e bankave”, miratuar me vendimin nr. 04, datë 19.01.2000, ndryshuar me vendimin nr. 08, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

SHËNIME

¹ Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar, World Economic Outlook Database, tetor 2009.

² Ligji 'Për statistikat zyrtare' nr. 9180, datë 05.02.2004.

³ Ligji 'Për Bankën e Shqipërisë' nr. 8269, datë 23.12.1997.

⁴ 'Programi i Statistikave Zyrtare 2007-2011' miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendim nr. 153, datë 31.01.2008.

⁵ Deri në kohën e fillimit të aplikimit të rekomandimeve të këtij manuali, statistikat monetare janë hartuar sipas "Metodikës për paraqitjen e gjendjes monetare" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 21.09.1994, në përputhje me rekomandimet e "Udhëzuesit për statistikat monetare dhe bankare në statistikat financiare ndërkombëtare", FMN, 1984.

⁶ Të dhënat sipas standardit të ri që nga dhjetori i vitit 2002 janë shpërndarë për përdorim të brendshëm, ndërkohë që publikimi sipas të dy standardeve shtrihet në periudhën dhjetor 2006 - dhjetor 2008.

⁷ Rekomandimi për kompilimin e pasqyrës së pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe të borxhit të jashtëm së bashku me pasqyrën e bilancit të pagesave, reflektohet edhe në rikonceptimin e edicionit të pestë të manualit të bilancit të pagesave të FMN-së, i cili e zgjeron fushën e mbulimit nga "Manuali i Bilancit të Pagesave" (Edicioni i pestë, 1993) në "Manuali i Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare" (Edicioni i gjashtë, Janar 2010).

⁸ Lidhja në faqen e Bankës së Shqipërisë: http://www.bankofalbania.org/web/SDDS_330_1.php

⁹ Metodika e Bilancit të Pagesave, Banka e Shqipërisë, Dhjetor 2006.

¹⁰ Pozicioni i investimeve ndërkombëtare hartohet në përputhje me "Manualin e Bilancit të Pagesave" (Edicioni i Pestë, FMN 1993) "Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare – Një Udhëzues për Burimet e Informacionit" (FMN, 2002) dhe "Shënime metodologjike të kompilimit të PIN të Shqipërisë", Banka e Shqipërisë.

¹¹ Borxhi i jashtëm i Shqipërisë hartohet në përputhje me "Manualin e Bilancit të Pagesave" (Edicioni i Pestë, FMN, 1993), "Statistikat e Borxhit të Jashtëm: udhëzues për kompilues dhe përdorues" (FMN, 2003) dhe "Shënime metodologjike për kompilimin e borxhit të jashtëm të Shqipërisë", Banka e Shqipërisë.

¹² Duke filluar nga muaji korrik 2009, në përfundim të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës për vendimmarrjen e politikës monetare janë zhvilluar rregullisht, 6 konferenca për shtyp.

¹³ Raporti është bërë publik nga Ministria e Integrimit Evropian, www.mie.gov.al.

¹⁴ Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në 1 prill 2009, u krijua Këshilli i Stabilizim-Asociimit (SA) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë. Ky këshill mbledhet të paktën një herë në vit në nivel të lartë drejtuesish (ministrash) si dhe bashkëkryesohet nga një përfaqësues i Shqipërisë dhe nga një përfaqësues i Këshillit të Bashkimit Evropian, në emër të Komunitetit dhe shteteve anëtare të tij. Këshilli i SA-së ndihmohet në punën e tij të vlerësimit të reformave dhe progresit të bërë gjatë një viti nga Komiteti i Stabilizim-Asociimit si dhe nënkomitetet e tjera të ngritura për çështje të caktuara (7 të tilla).



"2600-vjetori i qytetit të Durrësit"
50 lekë. Monedhë argjendi, emetim i vitit 1987.

KAPITULLI VII. RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN QË PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2009



KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPTJ91619001D

Telephone +355 4 2274 524
+355 4 2274 534
Telefax +355 4 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
internet www.kpmg.al

RAPORTI I AUDITORËVE TË PAVARUR

**Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
Tiranë, 24 mars 2010**

RAPORT MBI PASQYRAT FINANCIARE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Bankës së Shqipërisë ("Banka"), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2009, pasqyra e veçantë e të ardhurave, pasqyra përmbledhëse e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, dhe shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

PËRGJEGJËSIA E DREJTIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë siç është shpjeguar në Shënimin 2 (a) të pasqyrave financiare. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm, për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

PËRGJEGJËSIA E AUDITUESVE

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet

KPMG Albania Sh.p.k., an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International cooperative ('KPMG International'), a Swiss entity.

Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomalie materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

OPINION

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2009, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë siç është shpjeguar në Shënimin 2 (a) të pasqyrave financiare.

KPMG Albania Shp.k.

KPMG Albania sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

KPMG Bulgaria OOD

KPMG Bulgaria OOD
45A, Bulgaria Boulevard
Sofia 1404
Bulgaria

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
AKTIVET			
Aktive në monedhë të huaj			
Ari dhe metale të çmuara	5	7,324	5,265
Llogari me Fondin Monetar Ndërkombëtar	6	14,737	6,910
Depozita në bankat e huaja	7	47,113	58,824
Investime të vlefshme për shitje	8.1	154,488	132,339
Investime të mbajtura për tregtim	8.2	11,365	10,614
Aktive të tjera në monedhë të huaj	9	1,196	1,577
Totali i aktiveve në monedhë të huaj		236,223	215,529
Aktive vendase			
Ari dhe metale të çmuara	5	3,477	2,462
Kredi transite	10.1	46	69
Kredi ndaj Qeverisë	10.2	-	3,000
Kredi ndaj bankave vendase	10.3	32,326	20,072
Investime të vlefshme për shitje	11	76,589	74,594
Aktive të tjera vendase	12	4,927	4,547
Totali i aktiveve vendase		117,365	104,744
Totali i aktiveve		353,588	320,273
DETYRIMET			
Detyrime në monedhë të huaj			
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	13	20,452	12,869
Detyrime ndaj institucioneve financiare jo vendase	14	1,279	1,178
Detyrime të tjera të huaja		-	261
Totali i detyrimeve në monedhë të huaj		21,731	14,308
Detyrime vendase			
Para në qarkullim	15	216,739	203,713
Detyrime ndaj bankave vendase	16	68,075	67,803
Detyrime ndaj qeverisë	17	13,355	21,096
Detyrime të tjera vendase	18	1,140	1,480
Totali i detyrimeve vendase		299,309	294,092
KAPITALI I VET DHE REZERVAT			
Fondi i themelimit		2,500	2,500
Rezerva ligjore	19	9,994	7,515
Rezerva e rivlerësimit	20	2,399	(15,837)
Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme		1,907	1,947
Rezerva të tjera	21	15,748	15,748
Totali i kapitalit të vet dhe rezervat		32,548	11,873
Totali i detyrimeve, kapitali i vet dhe rezervat		353,588	320,273

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 158 deri në faqen 195, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E VEÇANTË E TË ARDHURAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Veprime me jorezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	22	5,169	6,503
Shpenzime për interesa dhe komisione	23	(1,792)	(607)
Totali neto nga veprimet me jorezidentë		3,377	5,896
Veprime me rezidentë			
Të ardhura nga interesa dhe komisione	24	7,134	4,972
Shpenzime për interesa dhe komisione	25	(1,713)	(2,751)
Totali neto nga veprime me rezidentë		5,421	2,221
Të ardhura operative të tjera, neto	26	2,848	1,891
Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto	27	138	673
Fitim neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit valutor		20,668	4,670
Totali i të ardhurave operative		32,452	15,351
Shpenzime të tjera administrative			
Shpenzime personeli	28	(893)	(769)
Shpenzime zhvlerësimi	12	(159)	(135)
Shpenzime amortizimi	12	(279)	(84)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative		(500)	(375)
Totali i shpenzimeve të tjera administrative		(1,831)	(1,363)
Të ardhurat neto nga aktiviteti i Bankës		30,621	13,988

Shpërndarja e fitimit më 31 dhjetor 2009:

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Të ardhurat neto nga aktiviteti i Bankës		30,621	13,988
Transferim në rezervën e rivlerësimit		(20,668)	(4,670)
Fitimi bruto para shpërndarjes		9,953	9,318
Zbritje për provigjoneve të llogaritura	18	(78)	(20)
Fitimi neto para shpërndarjes		9,875	9,298
Shpërndarja e fitimit			
Rimarrje në të ardhura nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		40	38
Shtesë në rezervën ligjore		(2,479)	(2,334)
Shpërndarja e fitimit në favor të Qeverisë Shqiptare		(7,436)	(6,941)
Të drejta ndaj qeverisë për interesin e letrave me vlerë për mbulim humbjeje		-	(61)
Totali		9,875	9,298

Pasqyra e veçantë e të ardhurave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faja 158 deri në faqen 195, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Të ardhurat neto nga aktiviteti i Bankës		30,621	13,988
Të ardhura të tjera përmbledhëse:			
Rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme		(40)	192
Rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshme për shitje		(2,270)	2,169
Të ardhura të tjera përmbledhëse për vitin		(2,310)	2,361
Totali përmbledhës i të ardhurave		28,311	16,349

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 158 deri në faqen 195, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET DHE REZERVAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Fondi i themelimit	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme	Rezerva të tjera	Fitim i pashpërndarë	Fitimi neto	Totali
Gjendja më 1 janar 2008	2,500	5,181	(22,759)	1,755	14,614	-	-	1,291
Veprimet drejtuar nga ligji dhe me qeverinë shqiptare të regjistruara drejtpërdrejt në kapital								
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	4,670	-	-	-	(4,670)	-
Të tjera rivlerësime	-	-	83	-	-	-	-	83
Rezerva në ar dhe metale të çmuara	-	-	-	-	7,042	-	-	7,042
Fonde nga qeveria për mbulim humbje të kapitalit dhe zbritje interesi nga fitimi	-	-	-	-	(5,908)	-	(61)	(5,969)
Zbritje për provigjone nga fitimi (Shënimi 18)	-	-	-	-	-	-	(20)	(20)
Shpërndarja e fitimit (Shënimi 19)	-	2,334	-	-	-	(38)	(9,237)	(6,941)
Totali i kontributeve nga / dhe shpërndarjeve të qeverisë shqiptare	-	2,334	4,753	-	1,134	(38)	(13,988)	(5,805)
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	(38)	-	38	-	-
Totali përmbledhës i të ardhurave për vitin								
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	13,988	13,988
Të ardhura të tjera përmbledhëse								
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	2,169	-	-	-	-	2,169
Rivlerësimi i aktiveve 2008 (shtypshkronja, Shënimi 12)	-	-	-	230	-	-	-	230
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	(38)	-	38	-	-
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	2,169	192	-	-	-	2,361
Totali përmbledhës i të ardhurave për vitin	-	-	2,169	192	-	-	13,988	16,349
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,500	7,515	(15,837)	1,947	15,748	-	-	11,873

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET DHE REZERVAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Fondi i themelimit	Rezerva ligjore	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme	Rezerva të tjera	Fitim i pashpërndarë	Fitimi neto	Totali
Gjendja më 1 janar 2009	2,500	7,515	(15,837)	1,947	15,748	-	-	11,873
Veprimet drejtuar nga ligji dhe me qeverinë shqiptare të regjistruara drejtpërdrejt në kapital								
Transferime nga/për në rezervën e rivlerësimit	-	-	20,668	-	-	-	(20,668)	-
Të tjera rivlerësime	-	-	(162)	-	-	-	-	(162)
Zbritje për provigjone nga fitimi (Shënimi 18)	-	-	-	-	-	-	(78)	(78)
Shpërndarja e fitimit (Shënimi 19)	-	2,479	-	-	-	(40)	(9,875)	(7,436)
Totali i kontributeve nga / dhe shpërndarjeve të qeverisë shqiptare	-	2,479	20,506	-	-	(40)	(30,621)	(7,676)
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	-	-	40	-	40
Totali përmbledhës i të ardhurave për vitin								
Fitimi neto nga aktiviteti bankar	-	-	-	-	-	-	30,621	30,621
Të ardhura të tjera përmbledhëse								
Rivlerësimi i letrave me vlerë	-	-	(2,270)	-	-	-	-	(2,270)
Rimarrje e tepicës nga rivlerësimi i aktiveve të qëndrueshme	-	-	-	(40)	-	-	-	(40)
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	(2,270)	(40)	-	-	-	(2,310)
Totali përmbledhës i të ardhurave për vitin	-	-	(2,270)	(40)	-	-	30,621	28,311
Gjendja më 31 dhjetor 2009	2,500	9,994	2,399	1,907	15,748	-	-	32,548

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit të vet dhe rezervave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 158 deri në faqen 195, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSEVE TË PARAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Flukset e parave nga operacionet			
Fitimi neto i vitit		9,875	9,298
Zëra jomonetarë në pasqyrimin e operacioneve			
Të ardhura nga interesat (jorezidentë)		(5,169)	(6,503)
Shpenzime për interesat (jorezidentë)		1,792	607
Të ardhura nga interesat (rezidentë)		(7,134)	(4,972)
Shpenzime për interesat (rezidentë)		1,713	2,751
Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto		(138)	(673)
(Fitimi) / Humbja nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje		(2,771)	(1,881)
Fitim nga kontratat forward dhe future		(3)	-
Amortizimi i grantit dhe ndihmës		-	(3)
Provigjone për hua të dyshimta		80	18
Zhvlerësimi dhe amortizimi		438	219
Flukset e parave para lëvizjes së kapitalit punues		(1,317)	(1,139)
Ndryshime në kapitalin punues			
(Rritja)/ ulja në depozita me Fondin Monetar Ndërkombëtar		(7,826)	121
(Rritja)/ ulja në aktive të tjera në monedhë të huaj		(14)	238
Ulje në kreditë transite		23	26
(Rritja)/ ulja në kredi ndaj Qeverisë		3,000	(3,000)
Rritje në aktive të tjera vendase		(205)	(491)
Rritje/(Ulje) në detyrimet ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar		7,581	(992)
Rritje/(Ulje) në detyrimet ndaj institucioneve financiare		101	(6)
Rritje/(Ulje) në detyrime të tjera të huaja		(261)	10
Rritje në detyrimet ndaj bankave vendase		283	756
(Ulje) / Rritje në detyrimet ndaj Qeverisë		(8,436)	5,042
(Ulje) / rritje në detyrime të tjera vendase		(417)	554
Blerja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim të huaja		(41,811)	(17,708)
Shitja e letrave me vlerë të mbajtura për tregtim të huaja		41,889	16,670
Flukset e parave të (përdorura) /gjeneruara nga operacionet		(6,093)	1,220
Interesa të marra		6,514	7,003
Interesa të paguara		(1,789)	(2,834)
Paraja neto e (përdorur) /gjeneruar nga aktivitete operacionale		(2,685)	4,250

PASQYRA E NDRYSHIMEVE TË KAPITALIT TË VET DHE REZERVAVE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk është shënuar ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2008
Fluksi nga investimet			
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		(221)	(283)
Blerja e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara		(395)	(278)
Blerja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje të huaja		(376,526)	(338,361)
Blerje e letrave me vlerë të vlefshme për shitje vendase		(192,884)	(180,678)
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë të vlefshme për shitje të huaja		367,921	337,258
Shitja dhe maturime të letrave me vlerë të vlefshme për shitje vendase		196,278	177,137
Rritje në marrëveshjet e riblerjes		(12,191)	(18,496)
Rregullime për efekt kurs këmbimi		5,405	883
Fluksi neto i përdorur nga investimet		(12,613)	(22,818)
Flukset e parave prej financimit			
Rritja në ar dhe metale të tjera të çmuara		-	7,042
Rritja në emetimin e parasë në qarkullim		16,000	45,500
Rimarrje e fondeve nga Qeveria për mbulimin e humbjeve të kapitalit		-	(61)
Fitimi i shpërndarë		(6,741)	(5,200)
Fluksi neto i gjeneruar nga financimet		9,259	47,281
(Ulja) /Rritja në para gjatë vitit		(6,039)	28,713
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	29	81,882	53,169
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	29	75,843	81,882

Pasqyra e flukseve të parave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 158 deri në faqen 195, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në 24 mars 2010 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:




Drejtor i Dep
Kontabilitetit dhe Financës

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2009
(të gjitha shumat janë në milionë LEKË, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Banka e Shqipërisë ("Banka") është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë" dhe në zbatim të këtij ligji detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor;
- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë regjimin e këmbimit valutor, si dhe politikën e kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
- të licencojë ose t'ia revokojë këtë licencë bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar;
- të disponojë dhe të administrojë rezervat e saj valutore;
- të veprojë me cilësinë e bankierit, këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë; dhe
- të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë".

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshtatura në Manualin e Kontabilitetit të Bankës, miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 50, datë 26 janar 2001 dhe politika të tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Këto politika kontabël janë përgjithësisht në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë;
- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë;

- ari është matur me vlerë të drejtë;
- ndërtesat janë matur me vlerën e rivlerësuar.

(c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare prezantohen në LEK Shqiptar ("LEKË"), e cila është monedha funksionale e Bankës. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në LEK është rumbullakosur në milionin më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi i Bankës që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në baza vijueshmërie. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në Shënimin 4 jepet informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare. Ndryshimi më i rëndësishëm nga SNRF sqarohet më poshtë:

SNK 39 'Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja'

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat mbi aktivet dhe detyrimet financiare janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të të drejtave të konstatuara, llogaritur bazuar në metodën lineare (shënimi 3.a). Kjo metodë nuk është në përputhje me SNK 39, i cili kërkon llogaritjen mbi bazën e interesit efektiv. Gjithashtu, huatë nga institucionet financiare ndërkombëtare janë njohur me kosto në vend të njohjes me vlerë të drejtë siç kërkohet nga SNK 39.

a. Njohja e interesave dhe komisioneve

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas parimit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa përfshijnë interesat e fituara nga kuponat si edhe amortizimin e çdo primi apo skontoje apo çdo diference tjetër ndërmjet vlerës fillestare kontabël të instrumentit fitimprurës dhe vlerës së tij në maturim, llogaritur bazuar në metodën lineare.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat mbi gjithë aktivet dhe detyrimet për tregtim konsiderohen të lindin me operacionet tregtuese të Bankës dhe prezantohen së bashku me gjithë ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve në të ardhurat nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet lindin nga shërbimet financiare të siguruara nga Banka dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që shërbimi kryhet. Shpenzime dhe të ardhura të tjera operative përfshijnë fitimet dhe humbjet që vijnë nga shitjet dhe ndryshimet në vlerën e tregut të aktiveve dhe detyrimeve financiare të vlefshme për shitje.

b. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kursin aktual të këmbimit në datat e kryerjes së veprimeve. Në çdo datë të raportimit, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e raportimit. Disa zëra jomonetarë të shprehur në monedhë të huaj që maten me kosto historike nuk rivlerësohen.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet fillimisht në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën lindin dhe më pas transferohet në llogarinë "Rezerva të rivlerësimit" në Kapital, siç parashikon Ligji nr 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë".

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, Banka kryen veprime të këmbimit valutor me datë pagesë një ose dy ditë pas datës të tregtimit. Këto veprime regjistrohen në pasqyrat financiare me datën e pagesës. Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me datën e pagesës.

Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura nga Banka (LEK për njësi të monedhës së huaj) për monedhat e huaja më kryesore, më 31 dhjetor 2009 dhe 2008 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Dollari amerikan ("USD")	95.81	87.91
Monedha evropiane ("EURO")	137.96	123.80
Paundi britanik ("GBP")	154.64	127.66
Të drejta të veçanta tërheqjeje ("SDR")	149.65	136.07
Jen japonez (JPY)	1.0372	0.9743
Ari ("XAU") për 1 onz	105,774.24	76,042.15

c. Të ardhurat nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto

Të ardhurat nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto përbëhen nga fitime minus humbje që lidhen me aktivet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe përfshijnë gjithë ndryshimet e realizuara dhe të porealizuara në vlerën e drejtë, interesat dhe diferencat nga ndryshimet në kursin e këmbimit.

d. Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në të ardhura dhe shpenzime në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë mbi jetëgjatësinë e qirasë.

e. Tatimi dhe politika e Bankës për shpërndarjen e fitimit

Banka është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin në bazë të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”.

Politika e shpërndarjes së fitimit të Bankës nga aktiviteti bankar bazohet në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, i gjithë fitimi i realizuar kalon në buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve të fondeve rezervë të kërkuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Në bazë të nenit 64, pika (a) e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, fitimi/humbja neto si rezultat i rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të shprehura në monedha të huaja, transferohet në kapital tek një llogari rezervë “Rezerva e rivlerësimit”. Në bazë të nenit 64, pika (b), Qeveria e Republikës së Shqipërisë lëshon letra me vlerë të borxhit me norma interesi të tregut për të mbuluar vlerën negative të rezervës së rivlerësimit si rezultat i aktivitetit të Bankës.

Në përputhje me kërkesat e nenit 9 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, Banka ka krijuar një Rezervë Ligjore në të cilën transferohet 25% e fitimit neto të çdo viti, derisa shuma e rezervës arrin 500% të fondit të themelimit. (shiko politikën kontabël 3.f).

Në bazë të nenit 11 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, asnjë transferim, shpërndarje apo pagesë sipas neneve 8, 9 ose 10 të këtij ligji nuk do të bëhet nëse aktivet e Bankës janë më pak se shuma e detyrimeve dhe fondit të themelimit. Në këto kushte, bazuar në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” sipas nenit 7, Ministria e Financave duhet t’i transferojë Bankës letra me vlerë të qeverisë me interes të negociueshëm, në shumën e nevojshme për të mbuluar pamjaftueshmërinë.

f. Rezerva ligjore

Pas shpërndarjes së rezervës siç kërkohet nga ligji “Për Bankën e Shqipërisë” (shiko politikën kontabël 3.e), Banka përcakton pjesën e mbetur që do t’i paguhet Buxhetit të Shtetit.

g. Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Të gjitha aktivet financiare të mbajtura deri në maturim, ose aktive financiare të vlefshme për shitje njihen fillimisht me kosto në datën e pagesës. Investimet

financiare të mbajtura për tregtim njihen në datën e tregtimit. Banka fillimisht i njeh kreditë dhe paradhëniet, depozitat dhe detyrimet financiare në datën e lindjes së tyre.

Një aktiv apo detyrim financiar fillimisht matet me kosto. Kostoja e aktiveve në përgjithësi përaftron me vlerën e tyre të drejtë.

(ii) Klasifikimi

Shiko politikat kontabël 3(h), (i), (j) dhe (k).

(iii) Çregjistrimi (Mosnjohja)

Banka çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të parasë që vijnë nga aktivi financiar, ose kur transferon të drejtat mbi aktivin financiar për të marre flukset e parasë të kontraktuara, në një transaksion në të cilin transferohen në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar. Interesat në aktivin financiar të transferuar të cilat janë krijuar apo mbajtur njihen si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbytur, ndërprerë apo përfunduar. Banka nxjerr jashtë nga pasqyra e pozicionit financiar ato kredi dhe investime në letra me vlerë të cilat vlerësohen si të pambledhshme (shiko shënimin 4).

(iv) Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma paraqitet neto në pasqyra atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtues të Bankës.

(v) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është shuma me të cilën një aktiv mund të shkëmbehet, ose një detyrim mund të shlyhet, midis palëve të mirinformuara dhe me vullnet të plotë në kushte të lira tregu në datën e matjes. Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet aktiv në qoftë se çmimet e kuotuar janë rregullisht të gatshëm dhe paraqesin transaksionet aktuale të vazhdueshme në kushte të lira tregu.

Për investimet e tregtuara në tregje financiare të organizuara, vlera e drejtë përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në tregjet e kapitalit në mbylljen e biznesit në datën e raportimit. Për investimet që nuk ka një çmim të

kuotuar tregu, përcaktohet një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së drejtë duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një instrumenti tjetër thua jse të njëjtë.

(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Aktivët financiare, me përjashtim të atyre klasifikuar si "Të mbajtura për tregtim", vlerësohen në çdo datë raportimi nëse kanë pësuar rënie në vlerë. Aktivët financiare pësojnë rënie në vlerë kur ka evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit financiar, janë ndikuar flukset e ardhshme të parave që pritet të merren nga investimi. Për aktivët financiare të mbajtura me kosto, shuma e zhvlerësimit është diferenca midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuar si më poshtë:

- për huatë e krijuara nga Banka - shuma e rikuperueshme e huasë së krijuar llogaritet bazuar mbi vlerësimin në fund të vitit për huatë, duke përfshirë dhe interesin e akumuluar. Në përcaktimin e shumave të rikuperueshme nga huatë për personelin, drejtuesit duhet të konsiderojnë shumë faktorë, duke përfshirë dhe historinë e pagesave të ish-punonjësve. Provigjoni për rënie në vlerë të huave raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim dhe zbritet nga kategoria përkatëse e aktiveve në bilanc. Kur vendoset që një hua nuk mund të rikuperohet më, të gjitha procedurat e nevojshme ligjore janë përfunduar dhe humbja përfundimtare është përcaktuar, huaja hiqet nga librat.
- për aktivët financiare të mbajtura deri në maturim – vlera e mbartur e aktivit ulet deri në shumën që vlerësohet të merret në mënyrë direkte ose nëpërmjet përdorimit të një llogarie provigjoni dhe shuma e humbjes përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- për aktivët financiare të vlefshme për shitje – në qoftë se rënia në vlerën e drejtë të një aktivi të disponueshëm për shitje është kaluar direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse dhe ka një evidencë objektive që aktivi mund të jetë zhvlerësuar, humbja e akumuluar që është njohur direkt të ardhura të tjera përmbledhëse do të hiqet nga të ardhura të tjera përmbledhëse dhe do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve edhe nëse aktivi financiar nuk është çregjistruar.

(vii) Marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë

Investimet e dhëna hua nën marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë raportohen në bilanc dhe maten në përputhje me politikat kontabël të zbatueshme për aktivët me vlerë të tregtueshme dhe aktivët e vlefshme për

shitje. Investimet e dhëna hua nën marrëveshjet e huadhënies së letrave me vlerë vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Për letrat me vlerë të dhëna hua, banka merr kolateral në formë monetare ose letra me vlerë të tjera. Banka regjistron në interesa vlerën e të ardhurave nga huadhënia e letrave me vlerë.

h. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj. Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Për përpilimin e pasqyrës së flukseve të parave, Banka përfshin dhe arin dhe metalet e tjera të çmuara tek paraja dhe ekuivalentet e saj (shiko politikën kontabël 3.m).

i. Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Banka ka kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë mbahen me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, duke i kaluar kostot direkte të transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë njihet si pjesë e "Të ardhura nga letrat me vlerë të tregtueshme, neto". Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme nuk riklasifikohen pas regjistrimit fillestar.

j. Investime të vlefshme për shitje

Këto investime, në momentin e parë, njihen me kosto. Më pas, letrat me vlerë të vlefshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre. Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave sipas parimit të të drejtave të konstatuara.

Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në të ardhura të tjera përmbledhëse deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, kur vlera progresive e njohur në të ardhura të tjera përmbledhëse, kalon si fitim ose humbje.

k. Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare joderivative, me pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhën afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur konstatohen.

I. Derivatët e mbajtur për qëllime të menaxhimit të riskut

Derivatët e mbajtur për qëllime të menaxhimit të riskut përfshijnë të gjitha aktivet dhe detyrimet derivative të cilat nuk janë të klasifikuara si aktive ose detyrime të tregtueshme. Derivatët maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

m. Ari dhe metalet e tjera të çmuara

Ari dhe metalet e tjera të çmuara mbahen me vlerë tregu duke u bazuar në çmimin e Tregut të Arit në Londër (London Bullion Market), në datën e raportimit. Ky vlerësim është në përputhje me legjislacionin vendas.

n. Aktivet e qëndrueshme

(i) Njohja dhe vlerësimi

Zërat e aktiveve të qëndrueshme vlerësohen me koston historike zvogëluar për zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, përveç tokës dhe ndërtesave, të cilat paraqiten me shumën e rivlerësuar, që është llogaritur duke përdorur metodën e koston së zëvendësimit.

Çdo rritje nga rivlerësimi e ardhur nga rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave kreditohet në llogarinë e kapitalit ose të ardhura të tjera përmbledhëse tek "Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara", përveç rastit kur kjo rritje anulon rënien nga vlerësimi të të njëjtit aktiv, të njohur më parë në fitim ose humbje, rast ky kur rritja nga rivlerësimi njihet direkt në fitim ose humbje deri në masën e rënies së njohur paraprakisht.

Çdo rënie në vlerën e mbetur të ndërtesave, rezultuar nga procesi i rivlerësimit njihet direkt fitim ose humbje deri në masën e balancës së njohur në rezervën e rivlerësimit, rezultuar nga rivlerësimi i mëparshëm i ndërtesave. Kostoja e aktivitetit përfshin dhe shpenzime që lidhen direkt me blerjen e tij.

(ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një aktivi të qëndrueshëm regjistrohet me vlerën e mbartur të këtij aktivi, nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike nga ky aktiv do jenë për Bankën dhe që kosto e zëvendësimit të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e pjesës

së zëvendësuar çregjistrohet nga pasqyra e pozicionit financiar. Kostot e mirëmbajtjes ditore të aktiveve të qëndrueshme njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Zhvlerësimi vjetor llogaritet me metodën lineare duke përdorur norma specifike për çdo aktiv, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të tij. Toka dhe Ndërtime në proces nuk zhvlerësohen.

Vlerësimi i jetës së dobishme për periudhën aktuale dhe atë krahasimore është si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|-------------|
| • Ndërtesa, Zyra Qendrore | 40 vjet |
| • Ndërtesa, degët | 25 vjet |
| • Aktive transporti | 5 - 10 vjet |
| • Pajisje zyre | 3 - 20 vjet |

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

o. Aktivet e patrupëzuara

(i) Kosto të shtypjes dhe prerjes së parësë

Kostot e shtypjes së kartëmonedhave dhe të prerjes së monedhave kapitalizohen si aktive të qëndrueshme të patrupëzuara dhe amortizohen respektivisht me 2.5 vjet dhe 10 vjet.

(ii) Programet kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është 2 vjet.

p. Rënia në vlerë e aktiveve jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për rënie të saj. Nëse ekziston një tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e këtij aktivi.

Humbja nga rënia e vlerës njihet kur vlera e mbetur e aktivit tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës nga përdorimi i aktivitetit dhe vlerës së tregut zvogëluar me kostot e shitjes. Për llogaritjen e vlerës nga përdorimi, aktualizohen flukset e ardhshme të parasë nga përdorimi i këtij aktiviteti, me një normë interesi e cila reflekton vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të lidhura me aktivitetin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Humbja nga rënia në vlerë rimerret nëse ka patur ndonjë ndryshim në vlerësimin e përdorur për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë rimerret vetëm për pjesën që vlera aktuale e mbetur të mos e tejkalojë vlerën e mbetur neto nga amortizimi apo zhvlerësimi, nëse kjo humbje nuk do të ishte njohur më parë.

q. Grantet

Grantet fillimisht regjistrohen si të ardhura të shtyra kur ekziston siguria se ato do të përfitohen dhe Banka do të veprojë në përputhje me kushtet e këtij granti. Grantet që lidhen me zëra shpenzimi kalojnë tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës që është bërë shpenzimi. Grantet që lidhen me blerjen aktiveve kalojnë tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së aktivitetit përkatës në shumën që i përket zhvlerësimit ose amortizimit që i zbritet aktivitetit.

r. Huatë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Huatë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar ('FMN') për Qeverinë e Shqipërisë merren nëpërmjet Bankës dhe tregohen në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Interesi për këto hua paguhet direkt nga Banka. Huatë nga FMN shprehen në SDR (Special Drawings Rights). Këto hua maten fillimisht me kosto.

s. Marrëveshjet e riblerjes

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe njëkohësisht hyn në marrëveshje për ta riblerë këtë aktiv, me një çmim fiks në një datë të caktuar ('REPO'), marrëveshja regjistrohet si depozitë dhe aktiviteti vazhdon të jetë i regjistruar në pasqyrat financiare të Bankës.

Marrëveshjet e riblerjes regjistrohen në bilanc në zërin "Detyrime ndaj bankave vendase". Bazuar mbi rregulloren e Bankës mbi marrëveshjet e riblerjes, Bankës nuk i kërkohet të vendosë garanci për këto letra me vlerë.

Interesi i fituar mbi marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe interesi i pësuar mbi marrëveshjet e riblerjes njihen si të ardhura ose shpenzime nga interesi gjatë jetëgjatësisë së çdo marrëveshjeje duke përdorur normën bazë të interesit të shpallur me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës.

t. Provigjone

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi.

u. Përfitimet e punonjësve

(i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Kontributet e Bankës ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione.

(ii) Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës regjistrohen atëherë kur Banka në mënyrë të dukshme ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension, ose të ofrojë përfitime për të paguar në rastin e largimit vullnetar të punonjësve. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që do të pranohet, dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

(iii) Përfitime afatshkurtra

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi. Një provigjon mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para, nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

v. Informacioni krahasues

Kur është e nevojshme, shifrat e periudhave të mëparshme riklasifikohen për qëllime krahasimi. Banka nuk ka bërë ndonjë riklasifikim të tillë në këto pasqyra financiare.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMIT DHE GJYKIMEVE

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 33).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje
Fonde të lejuara për humbje nga kreditë

Aktivet e regjistruara me kosto vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivitetit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(g)(vi).

Përbërësit specifikë të kundërpartisë për totalin e provigjoneve për rënie në vlerë aplikohen ndaj aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, dhe bazohen në vlerësimin më të mirë të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parave, drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovet në mënyrë të pavarur.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka një çmim tregu kërkon përdorimin e një metode vlerësuese. Për instrumentet financiare të cilat nuk tregtohen në mënyrë sistematike, dhe që transparencja në çmim është e vogël, vendosja e vlerës së drejtë është më pak objektive, dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi të cilat variojnë në bazë të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimeve dhe rreziqeve të tjera të cilat kanë një ndikim në instrumentin financiar. Gjithashtu referohuni “Vlerësimi të Instrumenteve Financiare” më poshtë.

Gjykime në përdorimin e politikave kontabël

Gjykime në përdorimin e politikave kontabël përfshijnë:

Shtypshkronja

Banka ka kontrolluar aktivitetin e Shtypshkronjës në 31 dhjetor 2007. Shtypshkronja ka ushtruar veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare deri në datën 30 shtator 2008 në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 598, datë 5 shtator 2007, “Për mbylljen e veprimtarisë ekonomike-financiare të Shtypshkronjës”, ndryshuar me vendimin nr. 862, datë 18 qershor 2008.

Sipas pikave 7 dhe 8 të vendimit nr. 598, kapitalet e patrupëzuara dhe inventari ekonomik transferohen për llogari të Ministrisë së Financave, teknologjia dhe makineritë për shtypjen e pullave fiskale i transferohen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Sipas pikës 10 po të këtij vendimi, administrimi (pronësia) i ndërtesës i mbetet Bankës së Shqipërisë.

Pas mbylljes së aktivitetit, Banka ka përfshirë në Detyrime të tjera vendase (Shënimi 18) një shumë prej 231 milionë LEKË (2007: 215 milionë LEKË), e cila përfaqëson shumën e pagueshme ndaj shtypshkronjës në datën e mbylljes së saj, plus një shumë shtesë prej 8 milionë LEKË (2007: zero), e cila përfaqëson transferime të tjera ndërmjet Bankës dhe shtypshkronjës në mbyllje

të aktivitetit. Këto transferime u bazuan në vendimet e sipërpërmendura. Banka nuk ka marrë ende një vendim për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

Vlerësimi i instrumenteve financiare

Banka i mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmimet e tregut janë të publikuara në një treg aktiv për një instrument identik.
- Niveli 2: Teknikat e vlerësimit bazohen në të dhëna të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e publikuara për instrumente të ngjashme; çmimet e publikuara për instrumente të ngjashme në tregje jo aktivë; ose teknika vlerësimi ku të gjitha të dhënat mund të vëzhgohen direkt apo indirekt në treg.
- Niveli 3: Teknikat e vlerësimit bazohen në të dhëna jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilët, teknikat e vlerësimit nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme mund të kenë ndikim të rëndësishëm në vlerësim. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur çmimet e publikuara për instrumente të ngjashme, mbi të cilët kërkohen rregullime apo supozime të rëndësishme dhe jo të vëzhgueshme për të reflektuar ndryshimin midis instrumenteve.

Për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare aktive, vlera e drejtë përcaktohet duke iu referuar çmimeve të kuotuar në treg ose atyre të kuotuar nga tregtues të instrumenteve. Për të gjitha instrumentet financiare Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të vlerësimit. Teknikat e vlerësimit përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto, flukset e skontuara të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekziston një vlerë tregu dhe metoda të tjera. Objektivi i teknikave të vlerësimit është të arrijë në një përcaktim të vlerës së drejtë e cila reflekton çmimin e instrumentit financiar që do të ishte përcaktuar nga tregu në datën e raportimit.

Banka përdor metoda gjerësisht të njohura të vlerësimit për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve të thjeshta financiare, të cilat përdorin vetëm të dhëna të publikuara tregu dhe që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim. Çmime dhe të dhëna të publikuara janë të disponueshme në bursa për ato letra me vlerë të cilat janë të listuara dhe për derivativë të tregtueshëm e të këmbyeshëm si kontratat e të ardhmes apo derivativë të tjerë të thjeshtë, të tregtueshëm. Disponibiliteti i vlerës së publikuar redukton nevojën për gjykim dhe vlerësim nga drejtimi i Bankës, dhe redukton pasigurinë e shoqëruar me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponibiliteti i çmimeve të publikuara në bursë dhe faktorëve të marrë në llogaritje, varion sipas produkteve dhe tregjeve, dhe ndikohet prej ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

Llogaritë me Bankat

Vlera e drejtë e këtyre instrumenteve bazohet në metodën e Nivelit 2 të përshkruar me sipër.

Investimet në letrat me vlerë

Vlera e drejtë e investimeve në letrat me vlerë bazohet në çmimet e tregut ose ato të kuotuar nga brokera e agjentë këmbimi. Vlera e drejtë e këtyre instrumenteve bazohet në metodën e Nivelit 1 të përshkruar më sipër. Kur ky informacion nuk është i disponueshëm, vlera e drejtë bazohet në metodën e Nivelit 2 të përshkruar më sipër.

5. ARI DHE METALE TË ÇMUARA

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Ari depozitë në bankat e huaja	7,324	5,265
Ar dhe metale të çmuara në kasafortë	3,477	2,462
Totali	10,801	7,727

Më 31 dhjetor 2009, vlera e arit të vendosur në depozita dhe llogari rrjedhëse në bankat e huaja, ishte 7,324 milionë LEKË (2008: 5,265 milionë LEKË).

Ari dhe metale të tjera të çmuara të përfshira në aktive vendase përfshin gjendjet e arit jomonetar, platinin dhe të argjendit në kasafortë, të vlerësuara me kursin e këmbimit fiks të Londrës në datën e raportimit, me një shumë totale prej 3,477 milionë LEKË (2008: 2,462 milionë LEKË).

Rritja prej 3,074 milionë LEKË (2008: rënia prej 301 milionë LEKË), që rezulton nga rivlerësimi i arit dhe metaleve të çmuara, është regjistruar në rezervën e rivlerësimit.

6. LLOGARI ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Kuota në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN)	7,191	6,269
Të drejta speciale të tërheqjes ("SDR") të mbajtura	7,543	639
Interes i përlogaritur	3	2
Totali	14,737	6,910

Kuotat tek Fondi Monetar Ndërkombëtar ("FMN") rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë pranë FMN-së, në përputhje me Ligjin nr. 8269, datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë". Këto depozita kanë si kundërparti huatë e dhëna nga FMN për Republikën e Shqipërisë siç paraqitet në Shënimin 13.

Kuotat e Republikës së Shqipërisë pranë FMN janë 7,191 milionë LEKË ose 49 milionë SDR më 31 dhjetor 2009. 495 milionë LEKË ose 3 milionë SDR të kuotave të Republikës së Shqipërisë në FMN, përfaqësojnë këstin rezervë të mbajtur me FMN. FMN paguan kompensim (interes) për ata anëtarë të cilët kanë pozicion kësti rezervë të kompensueshëm me 0,23% normë interesi vjetore të ndryshueshme.

Të drejtat speciale të tërheqjes ("SDR") përfaqësojnë depozitat e vendosura pranë FMN-së. Këto depozita kanë një interes të përcaktuar në bazë javore. Norma e interesit vjetor më 31 dhjetor 2009 ishte 0.23% (2008: 0.82%).

Një shumë prej 6,951 milionë LEKË ose 46 milionë SDR të përfshira në të drejtat speciale të tërheqjes përfaqëson shumat e fituara përmes alokimit të SDR më 31 dhjetor 2009 siç paraqitet në Shënimin 13. Alokimet e SDR-ve përfaqësojnë shumat e marra nga FMN, qëllimi i së cilave ishte përgjigje e menjëhershme ndaj nevojave afatshkurtra dhe afatgjata për likuiditet të vendeve anëtare. Shuma e të drejtave speciale të tërheqjes e cila tejkalon atë të alokimeve ishte 592 milionë LEKË ose 4 milionë SDR më 31 dhjetor 2009.

7. DEPOZITA NË BANKAT E HUAJA

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Llogari rrjedhëse	38,953	53,509
Depozita afatshkurtra	8,146	5,292
Kontrata të së ardhmes	11	-
Interes i përlogaritur	3	23
Totali	47,113	58,824

Llogaritë rrjedhëse në bankat e huaja kanë norma interesi që bazohen në monedhën e depozitës apo të llogarisë rrjedhëse. Depozita afatshkurtra është me normë interesi 0.04%.

8. INVESTIME NË LETRA ME VLERË NË MONEDHË TË HUAJ

8.1. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj të vlefshme për shitje i kontabilizuar me vlerë tregu është si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Nota thesari të Qeverive të huaja	122,083	75,473
Investime afatmesme të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS)	7,311	39,011
Investime me kurs fiks të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (FIX BIS)	-	8,723
Bono thesari të agjencive	14,120	5,269
Nota thesari të agjencive	10,974	3,863
Totali	154,488	132,339

Notat e thesarit të qeverive të huaja kanë kurse kuponash që variojnë nga 0.875% në 8% (2008: 0.875% në 9%). Interesi paguhet në baza gjashtëmujore (USD dhe GBP) dhe vjetore (EURO) si dhe maturimet variojnë nga janari i vitit 2010 në qershor të vitit 2021. Norma e brendshme e kthimit varion nga 0.364% në 5.166% (2008: 0.74% në 5.81%).

Investimet afatmesme të BIS përbëhen nga letra me vlerë me kupona fikse, të përcaktuara në USD, EURO dhe GBP me kurse që variojnë nga 2.75% në 5.85% (2008: 2.5% në 5.85%). Interesi është i pagueshëm në baza vjetore për investimet në EURO dhe gjashtë mujore për investimet në USD dhe në GBP dhe maturimet variojnë midis marsit 2010 dhe marsit të vitit 2014. Norma e brendshme e kthimit varion nga 2.94% në 5.88% (2008: 2.84% në 5.88%).

Notat e agjencive janë të shprehura në USD dhe EUR me kurse kuponi nga 0.585% në 5.375% (2008: USD 2.75% në 4.75%). Interesi është i pagueshëm në baza gjashtë mujore dhe kufijtë e maturimit janë nga shkurti 2010 deri në nëntor 2014. Norma e brendshme e kthimit varion nga 0.42% në 3.15% (2008: 2.11% në 3.26%).

Bonot e thesarit janë të shprehura në USD dhe EUR me normë të brendshme kthimi që varion nga 0.27% në 1% dhe me kufij maturiteti nga shkurti 2010 në shtator 2010.

8.2. INVESTIME TË MBAJTURA PËR TREGTIM

Portofoli i letrave me vlerë në monedhë të huaj, klasifikuar si "Të mbajtura për tregtim" paraqitet me vlerë tregu si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Nota thesari të qeverisë	3,141	5,667
Nota thesari të agjencive	8,109	4,752
Bono thesari të qeverisë	115	195
Totali	11,365	10,614

Notat e Qeverisë të shprehura në USD, kanë kurse kuponi fiks, që variojnë ndërmjet 0.875% dhe 4.75% (2008: 1.125% dhe 7.5%). Interesi është i pagueshëm çdo gjashtë muaj dhe maturiteti varion ndërmjet mars 2011 dhe gusht 2014.

Notat e Agjencive të shprehura në USD, kanë kurse kuponi fiks, që variojnë ndërmjet 0.645% dhe 5.875% (2008: 2.25% dhe 5%) dhe kurse të ndryshueshëm që variojnë ndërmjet 0.55% dhe 0.56% (2008: 0.56% dhe 4.59%). Interesi është i pagueshëm në baza të ndryshme që variojnë nga tremujore në vjetore dhe maturiteti varion ndërmjet qershor 2010 dhe tetor 2012.

Bonot e thesarit të Qeverisë të shprehura në USD, me kupon zero, maturohen në tetor 2010.

Ky portofol administrohet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) në kuadrin e marrëveshjes së Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore "Për administrimin dhe asistencën teknike mbi investimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë" (Program Menaxhimi për Rezervë dhe Këshillim) e lidhur me datë 23 shtator 2005. Investimet në këtë portofol njihen në pasqyrat financiare në datën e tregtimit.

9. AKTIVE TË TJERA NË MONEDHË TË HUAJ

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Kuotizacione në institucionet ndërkombëtare		
Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)	358	355
Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA)	12	12
Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA)	6	6
Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)	71	65
Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	56	52
Banka Islamike e Zhvillimit (IDB)	22	20
Totali i kuotizacioneve	525	510
Arka në valutë	671	1,067
Totali aktiveve të tjera në monedhë të huaj	1,196	1,577

Më 31 dhjetor 2009, aktivet e tjera në monedhë të huaj përbëhen nga kuotizacionet për pjesëmarrjen e Bankës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare financiare prej 525 milionë LEKË (2008: 510 milionë LEKË) (shënimi 30), si dhe nga arka në valutë me një vlerë prej 671 milionë LEKË (2008: 1,067 milionë LEKË).

10. KREDI PËR PALËT E TRETA

10.1. KREDI TRANSITE

Totali prej 46 milionë LEKË (2008: 69 milionë LEKË) përfaqëson kredi për sektorin e shërbimeve, akorduar Bankës Italo-Shqiptare (sot Intesa SanPaolo Bank) për t'iu shpërndarë huamarrësve me qëllim mbështetjen e programeve qeveritare. Për këtë hua nuk është vendosur kolateral.

10.2. KREDI NDAJ QEVERISË

Kredia ndaj qeverisë është kredi afatshkurtër dhe për fundin e vitit 2009 është paguar plotësisht. Më 31 dhjetor 2008 balanca e kredisë ishte 3,000 milionë LEKË.

10.3. KREDI NDAJ BANKAVE VENDASE

Kredia ndaj bankave vendase përfaqëson marrëveshje të anasjellta riblerjeje midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave të nivelit të dytë në vlerën 32,326 milionë LEKË me afat maturimi nga njëjavor në tremujor (2008: 20,072 milionë LEKË me afat maturimi njëjavor). Në 31 dhjetor 2009, normat vjetore të interesit të marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes variojnë nga 5.25% në 6% (2008: 6.25% në 7.65%).

11. INVESTIME TË VLEFSHME PËR SHITJE (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Bono thesari afatshkurtër të Qeverisë Shqiptare	76,589	74,594
Totali	76,589	74,594

Më 31 dhjetor 2009, bonot e thesarit afatshkurtra përfaqësojnë bono thesari të Qeverisë me kupon zero, me afat maturimi afatshkurtër, të cilat matorohen në periudhën janar - dhjetor 2010. Normat e tyre të kthimit në blerje variojnë nga 5.61% në 9.3% (2008: 6.05% në 8.65%).

12. AKTIVE TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, neto	2,825	2,645
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, neto	421	305
Kredi punonjësve	1,500	1,167
Debitorë të tjerë	80	333
Numizmatika	39	38
Inventari	40	48
Të tjera	22	11
Totali	4,927	4,547

Në 31 dhjetor 2009, Banka ka përfshirë në kategorinë "Toka, ndërtesa dhe konstruksione të përgjithshme", vlerën e ndërtesës së shtypshkronjës. Metoda e rivlerësimit është ajo e kostos së zëvendësimit, që rezultoi në shumën prej 234 milionë LEKË, nga vlera neto kontabël e ndërtesës prej 4 milionë LEKË. Efekti në rritje nga rivlerësimi i ndërtesës në shumën prej 230 milionë LEKË u kreditua direkt në llogarinë e Rezervës së Rivlerësimit. Gjithashtu në këtë kategori është përfshirë dhe vlera e ndërtesave të degëve prej 176 milionë LEKË, rindërtuar gjatë vitit 2008.

Në 31 dhjetor 2009, kreditë e punonjësve përfshinë provigjone për çështje gjyqësore që lidhen me to, në masën 13 milionë LEKË (2008: 10 milionë LEKË).

Në 31 dhjetor 2009, vlera e regjistruar e kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të Bankës arrin në shumën 1,747 milionë LEKË (2008: 1,352 milionë LEKË). Vlera e kredive ende të padisbursuara në favor të punonjësve (në bazë të rregullores së dhënies së kredive nr 77, datë 25 tetor 2006) është 167 milionë LEKË (2008: 267 milionë LEKË).

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për çdo kategori më 31 dhjetor 2009 paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa konstruksione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Aktive transporti	Ndërtime ne proces	Totali
Kosto/Vlerësimi					
Gjendja më 1 janar 2009	2,382	855	253	36	3,526
Shtesa	54	145	2	140	341
Pakësime	-	(51)	(69)	-	(120)
Gjendja më 31 dhjetor 2009	2,436	949	186	176	3,747
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2009	45	650	186	-	881
Amortizimi i vitit	56	85	18	-	159
Pakësime	-	(49)	(69)	-	(118)
Gjendja më 31 dhjetor 2009	101	686	135	-	922
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2009	2,335	263	51	176	2,825
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,337	205	67	36	2,645

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për çdo kategori me 31 dhjetor 2008 paraqitet si më poshtë:

	Toka, ndërtesa konstruksione të përgjithshme	Pajisje të përgjithshme	Aktive transporti	Ndërtime ne proces	Totali
Kosto/Vlerësimi					
Gjendja më 1 janar 2008	1,942	778	241	48	3,009
Shtesa	264	77	12	164	517
Transferime	176	-	-	(176)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,382	855	253	36	3,526
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2008	-	576	170	-	746
Amortizimi i vitit	45	74	16	-	135
Gjendja më 31 dhjetor 2008	45	650	186	-	881
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2008	2,337	205	67	36	2,645
Gjendja më 31 dhjetor 2007	1,942	202	71	48	2,263

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Bankënota të shtypura dhe monedha të prera	Totali i aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2009	377	2,707	3,084
Shtesa	6	389	395
Gjendja më 31 dhjetor 2009	383	3,096	3,479
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2009	352	2,427	2,779
Amortizimi i vitit	20	259	279
Gjendja më 31 dhjetor 2009	372	2,686	3,058
Vlera kontabël neto:			
Më 31 dhjetor 2009	11	410	421
Më 31 dhjetor 2008	25	280	305

Vlera neto kontabël e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara për çdo kategori paraqitet si më poshtë:

	Programe kompjuterike	Bankënota të shtypura dhe monedha të prera	Totali i aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2008	353	2,453	2,806
Shtesa	24	254	278
Gjendja më 31 dhjetor 2008	377	2,707	3,084
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2008	338	2,357	2,695
Amortizimi i vitit	14	70	84
Gjendja më 31 dhjetor 2008	352	2,427	2,779
Vlera kontabël neto:			
Më 31 dhjetor 2008	25	280	305
Më 31 dhjetor 2007	15	96	111

13. DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Alokim i SDR-ve	6,951	-
Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit ("PRGF")	5,549	6,116
Llogaria e letrave me vlerë tek FMN	5,786	4,871
Llogari e FMN-së në LEKË	2,160	1,878
Interes i përllogaritur	6	4
Totali	20,452	12,869

Huatë PRGF janë të lidhura me kuotizacionet për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në FMN dhe janë tërhequr në emër të Qeverisë për reformat makroekonomike. Këto hua përfshijnë programet e mëposhtme:

- "Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 2" u miratua me marrëveshjen e datës 13 maj 1998 në shumën 45,040,000 SDR, duke u disbursuar nga viti 1999 deri në vitin 2001. Gjendja më 31 dhjetor 2009 është 4,956,700 SDR (2008: 11,241,400 SDR), dhe është ekuivalente e 742 milionë LEKË (2008: 1,530 milionë LEKË). Kjo është një hua me maturitet e kthyeshme deri në vitin 2011, në 10 këste gjashtëmujore duke filluar nga viti 2004. Norma e interesit është 0.5% dhe është e pagueshme çdo gjashtë muaj.
- "Huaja e Uljes së varfërisë dhe Zhvillimit PRGF 3" u miratua me marrëveshjen e datës 21 qershor 2002 në shumën 28,000,000 SDR dhe është disbursuar deri më 20 qershor 2005. Gjendja në fund të vitit 2009 është 23,600,000 SDR (2008: 26,400,000 SDR) dhe është ekuivalente e 3,532 milionë LEKË (2008: 3,592 milionë LEKË), me një interes prej 0.5% i pagueshëm çdo gjashtë muaj. Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysëm, me 10 këste gjashtëmujore të barabarta.
- "Huaja e Uljes së Varfërisë dhe Zhvillimit" (PRGF 4) dhe "Huaja-Lehtësia e Financimit Afatmesëm" (EFF) u miratuan me marrëveshjen

trevjeçare të datës 27 janar 2006 në shumën 17,045,000 SDR. Disbursimi i transhit të fundit të PRGF 4 prej 1,217,500 SDR , u bë në vitin 2009, me një interes prej 0.5% të pagueshëm çdo gjashtë muaj. Gjendja më 31 dhjetor 2009 është 8,522,500 SDR (2008: 7,305,000 SDR) dhe është ekuivalente e 1,275 milionë LEKË (2008: 994 milionë LEKË). Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas pesë vjet e gjysmë, në dhjetë këste gjashtëmuajore të barabarta.

Llogaritë e FMN përfaqësojnë detyrimet përkundrejt pjesëmarrjes së Shqipërisë në FMN. Më 31 dhjetor 2009, shuma e këtyre detyrimeve është 7,946 milionë LEKË ose 54 milionë SDR (më 31 dhjetor 2008: 6,749 milionë LEKË ose 53 milionë SDR). Detyrimet e lidhura me kuotat e FMN nuk mbartin interes dhe janë me maturitet të papërcaktuar. Këto detyrime përfshijnë llogaritë Nr.1, Nr.2 dhe llogari të letrave me vlerë, në të cilën janë depozituar notat premtuese të panegociueshme dhe që nuk mbartin interes. Balancat në këto llogari janë krijuar nga pagesa e komponentit të monedhës vendase të nënshkrimit të kuotave dhe blerjet e burimeve të Fondit në shkëmbim të monedhës vendase.

E përfshirë në llogaritë e FMN-së është dhe huaja “Lehtësia e Financimit Afatmesëm” (EFF) prej 1,257 milionë LEKË. Huaja është disbursuar gjatë viteve 2006-2009 dhe është ekuivalente e 8,522,500 SDR (2008: 7,305,000 SDR). Principali i huasë do të fillojë të shlyhet pas katër vjet e gjysmë dhe do të paguhet brenda 10 vjetëve. Interesi i këtyre kredive është i ndryshueshëm dhe paguhet çdo tre muaj. Më 31 dhjetor 2009, interesi vjetor ishte 1.24% (2008: 1.84%).

14. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOVENDASE

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Detyrime transite (Shënimi 10.1)	46	69
Hua e Republikës së Greqisë	1,215	1,090
Detyrime ndaj Bankës Botërore	13	14
Interes i përlogaritur	5	5
Totali	1,279	1,178

Detyrime transite prej 46 milionë LEKË ose 0.3 milionë EURO përfaqëson huanë e dhënë nga Banka Evropiane e Investimeve (shënimi 10.1). Interesi paguhet nga përfituesit e këtyre kredive transite (Bankat dhe kompanitë vendase) drejtpërsëdrejti tek siguruesit e financimit.

Huaja e Republikës Greke prej 1,215 milionë LEKË ose 8.8 milionë EURO është dhënë me qëllim financimin e Bilancit të Pagesave të Republikës së Shqipërisë. Norma vjetore e interesit është 1.17 për qind, e pagueshme çdo 6 muaj. Huaja maturohet në vitin 2018.

Detyrimi ndaj Bankës Botërore përbëhet nga shumat detyruar organizatave ndërkombëtare si Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), Agjencia Ndërkombëtare e Zhvillimit (IDA) dhe Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe (MIGA).

15. PARA NË QARKULLIM

Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës shqiptare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka.

Më 31 dhjetor 2009 dhe 2008 gjendja e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim është si më poshtë:

Vlera nominale LEKË	31 dhjetor 2009		31 dhjetor 2008	
	Copë (në mijë)	Totali LEKË (milionë)	Copë (në mijë)	Totali LEKË (milionë)
100	3,536	354	4,121	412
200	12,043	2,409	16,022	3,204
500	56,156	28,078	61,830	30,915
1,000	78,000	78,000	84,030	84,030
2,000	9,284	18,568	502	1,004
5,000	17,345	86,725	16,349	81,744
Monedha		2,605		2,404
		216,739		203,713

16. DETYRIME NDAJ BANKAVE VENDASE

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Në monedha të huaja		
Rezerva e detyrueshme dhe llogari rrjedhëse	29,258	26,660
Në monedhë vendase		
Rezerva e detyrueshme dhe llogari rrjedhëse	37,141	35,984
Depozita njëditore	1,648	5,120
Interes i përlogaritur	28	39
Totali	68,075	67,803

Interesi mbi llogarinë e rezervave të detyrueshme llogaritet si më poshtë:

- gjendjet në LEKË: 70% e normës së fitimit të marrëveshjeve repo: 3.675% më 31 dhjetor 2009 (2008: 4.375%);
- gjendjet në USD: 70% e normës bazë të Bankës Federale: 0.09% më 31 dhjetor 2009 (2008: 0.7%);
- gjendjet në EURO: 70% e normës bazë të Bankës Qendrore Evropiane: 0.7% më 31 dhjetor 2009 (2008: 2.28%).

Depozitat njëditore me bankat vendase kanë normë interesi vjetore prej 3.5% (2008: 4.5%).

17. DETYRIME NDAJ QEVERISË

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Fitim për t'iu shpërndarë Qeverisë	2,436	1,741
Depozita në emër të Qeverisë	10,897	19,335
Të tjera	22	20
Totali	13,355	21,096

Depozita në emër të Qeverisë prej 10,897 milionë LEKË, përmban llogarinë kryesore prej 1,300 milionë LEKË, fonde të donatorëve ndërkombëtarë të depozituara në Bankë për transferim të mëtejshëm në projektet e ndihmës në Shqipëri prej 1,679 milionë LEKË, fonde rezervë të qeverisë për Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) prej 2,498 milionë LEKË, si dhe fonde me destinacion për financime të tjera prej 5,420 milionë lekësh.

Zëri "Të tjera" përmban fonde të marra nga Banka për një hua të dhënë qeverisë nga Banka Islamike e Zhvillimit prej 22 milionë LEKË (2008: 20 milionë LEKË).

18. DETYRIME TË TJERA (NË MONEDHË VENDASE)

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Depozita të individëve nga pjesëmarrja në bono thesari	693	891
Detyrimi neto ndaj fondit të pensionit	13	-
Detyrim ndaj institucioneve financiare jobankare	1	206
Marrëdhënie me të tretët	239	239
Të tjera	194	144
Totali	1,140	1,480

Skema e fondit të pensionit bazohet në kontributin e punonjësve në vlerën 2% të pagës së tyre bruto si dhe kontributi i punëdhënësit 15% mbi totalin e pagave. Në 31 dhjetor 2009, vlera e aktiveve të fondit të pensionit e investuar në letra me vlerë të qeverisë me afat maturimi 12-mujor është 231 milionë LEKË (2008: 272 milionë LEKË) dhe në obligacionet e Qeverisë Shqiptare me afat maturimi 5-7 vjeçar është 469 milionë LEKË (2008: 302 milionë LEKË).

Vlera e akumuluar e kontributeve të derdhura nga punonjësit e siguruar në fond deri në 31 dhjetor 2009 është 53 milionë LEKË (31 dhjetor 2008: 43 milionë LEKË), ndërkohë që totali i kontributeve të derdhura nga Banka në Fond që nga krijimi i Fondit deri në 31 dhjetor 2009 është në vlerën 431 milionë LEKË (31 dhjetor 2008: 359 milionë LEKË). Pasqyra e ndryshimit të kontributeve dhe aktiveve neto të vlefshme për përfitim fond pensioni është si më poshtë:

	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2008
Aktive në 1 janar	574	466
Të ardhura nga investimi (humbje)		
Interesa ose kthimi nga investimi	59	43
Të ardhura neto nga investimi	59	43
Kontributi i pjesëmarrësve	10	8
Kontributi i punëdhënësit	72	57
Totali i kontributeve	82	65
Pagesa të kryera në favor të pensionistëve	(2)	-
Rritja neto	139	108
Aktive më 31 dhjetor	713	574
Detyrime më 31 dhjetor	(700)	(574)
Neto në fund të vitit	13	-

Marrëdhëniet me të tretët prej 239 milionë LEKË përbëhen nga kapitali, rezervat dhe fitime të mbartura nga veprimtaria e shtypshkronjës pas datës së mbylljes së saj (shënimi 4).

Në zërin “Të tjera”, përfshihen kryesisht shpenzime të llogaritura prej 40 milionë LEKË (2008: 54 milionë LEKË), të cilat lidhen me fatura shpenzimesh të ndryshme si sistemi i mbrojtjes elektronike e shërbime të tjera. Këtu përfshihet edhe provigjoni i pretendimeve për disa çështje ligjore, krijuar në kushte normale biznesi. Në 31 dhjetor 2009, rezulton një provigjon prej 108 milionë LEKË (2008: 39 milionë LEKË).

Gjatë vitit 2009 lëvizjet në provigjon janë:

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2009	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008
Gjendja në 1 janar	39	21
Provigjon shtesë për periudhën	78	20
Rimarrje dhe pagesa gjatë periudhës	(9)	(2)
Gjendja në fund të vitit	108	39

Provigjoni shtesë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009 është njohur në kapital, si zbritje nga fitimi.

19. REZERVA LIGJORE

Në përputhje me ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, në fund të çdo viti financiar Banka duhet të shtojë fondin e rezervës së përgjithshme me një shumë prej 25% të fitimit neto të Bankës, deri sa të arrijë 500% të fondit të themelimit të Bankës.

Në vitin 2009, Banka transferoi në rezervë 2,479 milionë LEKË (2008: 2,334 milionë LEKË).

20. REZERVA E RIVLERËSIMIT

Përbërësit e rezervës së rivlerësimit janë si më poshtë:

	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2009	Viti që mbyllet 31 dhjetor 2008
